

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CLXIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 56

EDI SHUKRIU

STUDIME PËR DARDANINË

Kulti i diellit, Përkrenarja ilire, Monumentet epigrafike, Shandanet
paleo-kristiane dhe aspekte të zhvillimeve etnolitike,
arkeologjike, letrare dhe të antropologjisë fizike

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CLXIII
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
BOOK 56

EDI SHUKRIU

STUDIES ON DARDANIA

The cult of the sun, Illyrian helmet, epigraphic monuments, paleochristian chandeliers and the aspects of the ethnolithic, archaeological, literary developments and the issues related to the anthropological physics

Approved for publication at the meeting of the Section of Social Sciences,
held on 16th November 2016, after review by
correspondent member Jusuf Bajraktari and correspondent member Anton K. Berishaj.

Editor: Correspondent member Jusuf Bajraktari,
Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CLXIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 56

EDI SHUKRIU

STUDIME PËR DARDANINË

Kulti i diellit, Përkrenarja ilire, Monumentet epigrafike, Shandanet
paleo-kristiane dhe aspekte të zhvillimeve etnolitike,
arkeologjike, letrare dhe të antropologjisë fizike

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 16 nëntor 2016, në bazë të recensioneve të
anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Anton K. Berishaj.

Redaktor: Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari,
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

ASPEKTE TË ZHVILLIMEVE ETNOLITIKE NË KOSOVË	7
FAZA PARAQYTETARE DARDANE E KOSOVËS	25
KULTI I DIELLIT TE DARDANËT	55
TRAJTESË ARKEOLOGJIKE E TOPONIMIT GRADINË	83
PËRKRENARJA ILIRE E DENJIT (KOSOVË) DHE ZHVILLIMI I PËRKRENAREVE ILIRE	99
MONUMENTI MORTOR PARAROMAK I DARDANËS - KAMENICËS.....	127
PESË MONUMENTE EPIGRAFIKE NGA SMIRA	145
SHANDANET PALEOKRISTIANE ME KRYQ NGA DARDANIA	175
DARDANËT NË KOMEDITË ANTIKE.....	191
ARKEOLOGJIA DHE ÇËSHTJE TË ANTROPOLOGJISË FIZIKE NË KOSOVË.....	203
ARKEOLOGJIA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE: AT SHTJEFËN GJEÇOVI	215
LISTA E FOTOVE / PHOTOS LIST	241

ASPEKTE TË ZHVILLIMEVE ETNOLITIKE NË KOSOVË

Ecejaket kohore kanë sjellë faza të ndryshme të proceseve etnolitike në Kosovë, si dhe në shumë territore të tjera të rruzullit tokësor. Por mitizimi i Kosovës dhe çështjet e të drejtës për të e shtrojnë edhe sot nevojën që historia dhe proceset etnolitike të saj të ritheksohen, ndonëse parimi historik për përcaktimin e të drejtës për subjektivitet do të duhej të shihej si anakronik. Manipulimet politike me strukturën etnike dhe historinë e Kosovës shkaktuan edhe konflikte të shumta, madje dhe të armatosura, dhe, si rredhojë, edhe ngarkesa të shumta etnopsikologjike. Në kuadër të kësaj, relacionet shekullore dhe komplekse shqiptaro – serbe u bënë njëra nga relacionet më të ndjeshme të historisë së Ballkanit, të cilat kanë ende refleksione në aktualitet.

Kosova, e zhveshur nga mitet dhe mitizimi, banorë të parë të njohur historikisht i kishte dardanët. Është çështje tjetër se në territorin e Dardanisë kishte dhe fise të tjera të konsideruara si dardane (galabrët, daunët, thunatët), ato thrake, meze e të tjera. Dardanët u krijuan nga gërshetimi i substratit neolitik dhe adstratit eneolitik të fiseve indoeuropiane, ndërsa lidhur me relacionet me dardanët e Trojës ende trajtohet koha dhe drejtimi i migrimeve.¹

Janë dhënë dhe mendime të tjera lidhur me lëvizjet e dardanëve, gjë që nuk është temë e këtij studimi. Por duhet thënë se konfuzionet e krijuara mbi drejtimitet e lëvizjeve, lindje - perëndim apo perëndim - lindje mund ta gjejnë shpjegimin në faktin se janë zhvilluar që të dyja, por në periudha kohore të ndryshme.

Nga e dhëna e autorit antik Diodorit kuptohet se Dardani sundonte mbi shumë fise në Azi dhe se ky:

“...i ka vendosur edhe dardanët që janë nga ana tjetër e Trakisë”

(Diodorus Bibliotheca historica V 48)

Nga kjo e dhënë e Diodorit nënkuptohet edhe se kishte dardanë në Europë kur Dardani sundonte mbi shumë fise në Azi dhe kur e themeloi Trojën. Me të dhënë e autorit tjetër antik Solinit po ashtu bëhet lidhja me

¹ Thrämer, E. (1901) 2177; Bürchner, C. (1901) 2157; Wilkes, J. (1992) etj.

prejardhjen trojane të dardanëve europianë, por sipas tij dardanët kaluan nga Azia në Europë dhe ishin:

“...njerëz të gjinisë trojane, të cilët u bënë barbarë në doke...”

(Solinus II, 51 D 2).²

Këto dhe burimet e ngjashme i sollën në përfundime të ndryshme studiuesit e mëvonshëm. J. Wilkes, i cili nuk e trajton kohën e degëzimit të dardanëve dhe mbase duke e pasur për bazë të dhënën e Solinit, i sheh dardanët europianë si një degë e retarduar e dardanëve trojanë.³ V. Thrämer lidhet me “dyndjet dorike”/“dyndjet egjeane” (shek. XIII-XII) kur thotë se lëvizjet e dardanëve shkonin nga perëndimi në lindje dhe se “...një pjesë e këtyre dardanëve u nda dhe kaloi te frigët në Azinë e Vogël,“ së bashku me mezët dhe frigët.⁴ W. Leaf thotë se frigët dhe akejtë zbritën në jugperëndim nga veriu i rrafshit të Danubit dhe se dardanët, themeluesit e Trojës, u drejtuan nga juglindja,⁵ që do të thotë se autori i referohet dhe migrimëve të mëhershme kur i përmend dardanët si themelues të Trojës.

Zbërthimi i çështjes së migrimit të dardanëve nga Europa në Azi dhe anasjelltas është mjaft kompleks, sepse kërkon analizë të thukët të burimeve të shkruara anike dhe mbështetje në burimet materiale arkeologjike të periudhave të caktuara. Për këtë duhet pasur parasysh valët e dyndjeve indoeuropiane të drejtimit lindje-perëndim të epokës së eneolitit, valët e drejtimit veri-jug nga mijëvjeçari II p.K., të quajtura “dyndjet e akejve”, si dhe valët nga shek. XII p.K., të njohura me emrin “dyndjet dorike” apo “dyndjet egjeane”.

Studimet e kulturës materiale të epokës së bronzit dhe të epokës së hekurit kanë dëshmuar përkatësi në kuadër të kompleksit ilir të kulturës së Gllasinacit. Kjo i bën dardanët të shihen me prejardhje ilire, me elemente paleoballkanike dhe me gërshetime të elementit trakas në lindje të territorit. Proceset integruese të epokës së hekurit bënë që dardanët të jenë prezent si një popullatë me territor të njohur dhe me kulturë të formuar nga shek. VIII p.K..

Dardania u pa deri vonë vetëm si një subjekt mbifisnor, i cili nuk arriti shkallën e formësimit shtetëror.⁶ Kjo ishte pasojë e njohjes së pakët të materialit relevant arkeologjik të Kosovës, si pjesë e territorit të shtrirjes

² “...hominess Troiana prospolia in mores barbaros efferati.”

³ Wilkes, J. (1992) p. 145.

⁴ Thrämer, E. (1901) 2177.

⁵ Leaf, W. (1915) p. 72.

⁶ Papazoglu, F. (1969) p. 111.

dardane. Kësaj i ndihmuan paragjykimet mbi retardimin dardan,⁷ bashkë me mosnjohjen e materialit përkatës arkeologjik. Si rrjedhojë, të gjitha enët e punuara në çark automatikisht u konsideruan se i takojnë periudhës helenistike dhe mbisundoi mendimi se dardanët e njohën çarkun e poçarit përmes keltëve, pra nga shek. IV p.K. (Foto 1).




Foto 1 Qeramika dardane e punuar në çark, shek. VI-IV p.K.
(Gadime e Epërme)

Pas analizës së materialit arkeologjik të epokës së hekurit, sidomos të poçarisë, u dëshmuua se qeramika ishte prodhim lokal i poçarëve dhe se një pjesë e madhe e tyre ishte bërë sipas modeleve helene të shek. VI-V p.K. (skifosë, kilikë, kantarosë, hidria, lekanë, kraterë, pitosë, amfora).⁸ Prezenca e qeramikës vendore e punuar në çark sipas modeleve helene solli te përfundimet vijuese lidhur me zhvillimet gjatë fazës paraurbane dardane (shek. VI-IV p.K.):

1. U njoh çarku i poçarit, rreth dyqind vjet para dyndjeve kelte.
2. U intensifikuan kontaktet me botën mesdhetare.
3. U zhvillua tregtia e brendshme.
4. U krijua aristokracia fisnore dhe nisi diferencimi shoqëror.
5. U krijuan qendrat paraurbane.

Në fazën vijuese proceset u zhvilluan më tej dhe bashkë me diferencimin shoqëror sollën krijimin e shtetit dardan dhe hapërimin dardan në antikë. Lidhur me këtë ende ka dilema: Ishte ky vërtet shtet apo vetëm një organizim mbifisnor? Përgjigje relevante ofrojnë teori mbi shtetin, të dhënat e shkruara antike dhe materiali arkeologjik. Në kuadër të

⁷ Wilkes, J. (1992) p. 145.

⁸ Shukriu, E. (1996). Shih dhe Disertacionin: Shukriu, E.(1991) Helenizovana keramika starijeg gvozdenog doba u SAP Kosova, Filozofski Fakultet, Beograd.

kësaj duhet pasur parasysh se studimet për krijimin e shteteve të hershme përfshijnë si karakterisikë “diferencimin e lartë shoqëror, me klasën sunduese të pasur dhe të privilegjuar, të subordinuar mbretit, e cila e dallon veten përmes trajtave të arkitekturës dhe të praktikave të tjera kulturore.”⁹

Ekzistenca e shtetit dardan dëshmohej nga një varg elementesh që flasin për komunitetin e organizuar nën një qeverisje, siç janë territori kompakt, institucioni i mbretit (Longari, Bato, Monuni), fronti trashëgues (Longari dhe djali i tij Bato), institucioni i skllavërisë (dulët: “duloi” dhe robërit e luftës), ushtria e organizuar (fallanga me 8.000 ushtarë), veprimtaria diplomatike dhe aleancat (me shtetin ilir, etolët, medët, skordiskët, republikën romake etj.) apo martesat dinastike (martesa e vajzës së mbretit dardan Etutës me mbretin ilir Gentin).¹⁰

Territori i shtetit dardan kishte shtrirje më të gjerë, për dallim nga ai i Dardanisë parahistorike, dhe ky përfshinte Kosovën e sotme, Serbinë Juglindore bashkë me Nishin, Maqedoninë Veriperëndimore dhe një pjesë të Sanxhakut. Ndonëse çështja e kufijve diskutohet ende, kryesisht është përvetësuar mendimi se Mali Sharr përbënte kufirin jugperëndimor të Dardanisë, përkatësisht se ishte trekufirëshi midis provincave të Mezisë, Dalmacisë dhe Maqedonsë, për të cilin mendohet se ishte i ngjashëm me trekufirëshin pararomak maqedon – dardan – ilir.¹¹

Lidhur me malin Sharr si trekufirësh është me interes të shtrohet pyetja: Ishte vërtet mali Sharr kufiri jugperëndimor i Dardanisë? Si rrjedhojë shtrohet dhe pyetja vijuese: Përfshihej dhe lugina e Pollogut në Dardani? Për të dhënë përgjigje në këto pyetje duhet pasur parasysh faktin se Tetova dhe jugu i saj edhe sot kanë qasje shumë të afërt dhe të lehtë gjeografike me Shkupin, rrjedhmisht me Skupin antik, njërin nga qendrat e mëdha dhe të rëndësishme të Dardanisë. Kjo nënkupton se Luginën e Pollogut duhet parë ngusht të lidhur me Skupin dhe në kuadër të vetë territorit të Dardanisë, duke lënë anash qëndrimin se mali Sharr ishte kufiri jugperëndimor dardan dhe se Pollogu nuk pëfshihej në Dardani.

Në Dardani u përfshi dhe Peonia, që u bë një prej shkaqeve kryesore të konflikteve të vazhdueshme me shtetin e Maqedonisë. Ishte kjo arsye që në burimet antike dardanët u quajtën “gens semper infestissima Macedoniae”.¹² Andaj dhe studiuesi F. Walbank pohon se “për çdo mbret maqedon çështja e parë dhe më qenësore ishte ajo e kufijve verior.”¹³

U zhvilluan dhe qendrat urbane pararomake, për të cilat gjenden dëshmi në të dhënat e shkrimtarëve antikë. Kështu, Livi i shënon si qytet:

⁹ Thompson, D. (1995) "State"; Cohen, R. (1978) p. 36.

¹⁰ Shukriu, E. (1996).

¹¹ Mount Scardus: Ptol. II 16, 1; III 9 1; Petrović, V. (2007) p. 15.

¹² Papazoglu, F. (1969) p. 111.

¹³ Walbank, F.W. (1940) p. 270.

urb (Livius XIV 4, 7-10; XXVI 25, 3), ndërsa Straboni jo rastësisht përmend qytetin e vjetër: *πολις αρχαία* (polis arhaia) (Strabo VII 5 12).

Është bërë e njohur se Dardania, përkatësisht shteti dardan ishte forca e vetme e madhe politike në Ballkanin Qendror nga shek. IV p.K. deri në kohën e pushtimeve romake¹⁴ dhe po aq është e njohur se kjo i rezistoi vërshimeve kelte, i mposhti planet maqedone dhe bastarne për gjenocid (Polyb. *Historiae* XXV 6, 2) dhe i rezistoi ushtarakisht pushtimeve romake deri në mesin e shek. I, kur Dardania u pushtua tërësisht nga perandoria romake.

Pas ndarjes së Perandorisë Romake (395), u bë pjesë e Perandorisë Romake të Lindjes dhe pastaj të Perandorisë Bizantine. U përfshi në mjaft kriza që kapluan perandoritë, duke u nisur nga sulmet e hunëve, të cilët pushtuan Nishin, njërin nga qytetet më të rëndësishme të Dardanisë (441), të gotëve e të fiseve të tjera dhe, më vonë, të avarëve të përcjellë nga sllavët (Procop. *Historiae quae dicitur arcane* 18 20).

Mvetësia 400-vjeçare, zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe kulturor dardan krijuan entitetin dhe vetëdijen etnike që u ruajt edhe pas sundimit romak, atij bizantin dhe të atyre pasuese. Gjatë periudhës romake mbijetuan në panteonin dardan Hyjnesha Dardane dhe hyu Andin,¹⁵ u ringjall tradita parahistorike e varrimit në tuma, u ruajt tradita e veshjes autoktone dhe mbijetuan emrat dardan-ilir ashtu si mbijetoi dhe emri i dardanëve dhe i Dardanisë deri në mesjetë.¹⁶

Dardania qëndroi si tërësi më vete në kuadër të provincës romake Moesia Superior falë dhe etnitetit të krijuar, andaj dhe u krijua më pas Provinca e Dardanisë në kohën e perandorit Aurelian (279). Pas reformave të perandorit Dioklecian (279) u bë pjesë e diocezës së Ilirikut deri te reformat e Justinianit (shek. VI). Fakti se në Dardani kishte më së shumti stacione beneficiare me ushtarë beneficiarë (policia territoriale)¹⁷ flet për rezistencën dardane ndaj pushtimit romak, si dhe ndaj romanizimit të plotë. Kjo rezistencë shprehet edhe përmes kryengritësve dardanë, të njohur si latronë dardanë (latrones dardanici).¹⁸

Traditat pararomake dhe fuqizimi i Hyjneshës Dardane deri te niveli i hynjisë së Diellit u përputhën me besimin mbi Diellin e Pamposhur (Sol Invictus), të personifikuar me Krishtin. Ndonëse besimi i krishterë në

¹⁴ Papazoglu, F. (1969) p. 337.

¹⁵ Shukriu, E. (1989) ff. 15-19.

¹⁶ Shih dhe: Papazoglu, F. (1989) p. 169.

¹⁷ Papazoglu, F. (1989) p. 156.

¹⁸ Mócsy, A. (1968) pp. 351-354; Čerškov, E. (1969) p. 54.

Dardani u paraqit që herët, krishterimi i organizuar u paraqit në shek. IV. Kryepeshkopia gjendej në Shkup, por në shek. VI Justiniani e bëri Iustiniana Primën qendër kishtare (vikariat) për provincat Dardania, Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Moesia Prima, Praevalitana, Macedonia Secunda dhe Panonia Secunda (Novela XI e Justinianit, v. 535). Vikariati pushoi së ekzistuari në vitin 733, kur iu nënshtrua plotësisht patriarkut të Konstantinopojës.¹⁹

Dëshmi e mishërimit të hershëm dardan me krishterimin dhe të jetës së organizuar kishtare janë kishat e krishterimit të hershëm në Ulpianë, Vërmicë, Bellacërkë, Shën Prendës në Prizren, Bajicë të Pejës, Shën Florit në Lipjan, si dhe ato brenda dhe jashtë fortesave, në Veletin, Brainë, Harilaç, Bajicë, Strezoc, Marec, Samadrezhë, Balloc e të tjerat. Ndërkohë në Ulpianë u zbulua dhe një bazilikë më e madhe afër të cilës është ngrehur baptiseriumi (Foto 2).

Ndarja e perandorisë (395) e bëri Dardaninë territor kufitar në mes të perandorisë Lindore dhe të asaj Perëndimore dhe njëkohësisht edhe të dy botërave në krijim e sipër, po aq sa dhe lidhjet midis tyre. Në vitin 437 Dardania u vendos në Perandorinë Lindore. Integrimet etnolitike nuk u ndërpre në pushtimet romake dhe proceset integruese u intensifikuan pas përfshirjes së trojeve ilire nën ambrellën e një perandorie. Kështu u krijua baza për formimin mesjetar të arbërve/shqiptarëve, pasardhësve të ilirëve. Kontinuiteti u dëshmuar përmes kulturës së Komani, që kishte shtrirje të gjerë dhe kombinim të traditave vendëse me elemente të kulturës bizantine (Foto 3).²⁰

Pos tjerash, shtrirja e dikurshme territoriale e shteteve ilire përputhet me shtrirjen e sotme të shqiptarëve, gjë që sjell në përfundim se në territorin ku u krijuan shtetet ilire u fuqizua elementi identitar ilir, i përcjellë pastaj te arbërit - shqiptarët. Këtë mendim e përforcon kërkimi i vendgjenezës së shqiptarëve nga studiues të ndryshëm në arealet më të ngushta, herë në Shqipërinë e Mesme, herë në Kosovë e gjetiu, por gjithnjë në kuadër të shtrirjes së territoreve të shteteve ilire.

Depërtimi dhe vendosja e sllavëve në Ballkan, për ndryshim nga lëvizjet tranzitore të fiseve të tjera, ndryshoi rrjedhat historike të Ballkanit. Vendosja e tyre u zhvillua për një periudhë më të gjatë, që nisi me inkursionet avare. P. Lemerle pohon se kjo u zhvillua përmes:

¹⁹ Čerškov, E. (1969) p. 40.

²⁰ Anamali, S. (1966) ff. 185-196.

“...depërtimit të mëvetësishëm të fiseve të veçanta sllave, depërtimit në përbërjen e "ushtrive" masovike etnike nën udhëheqjen e avarëve, vendosjes paqësore të bashkësive më të vogla.”²¹

Në territorin e Kosovës depërtuan më pak valët avaro-sllave të shek. VI-VII, pasi që shkonin kryesisht në drejtim të brigjeve të Trakisë, të Konstantinopojës²² dhe të Selanikut (Miraculla II 1. 180).²³ Burimet bizantine thonë se në Dardani, Prevalitanë, Epir të Ri e Epir të Vjetër nuk është evidentuar asnjë territor i pushtuar nga sllavët (skllavinia) në mesin e shek. VII, përderisa ato ekzistonin nga Thrakia deri në Peleponez.²⁴

Depërtimi sllav në Kosovë dhe në jug, siç pohon K. Jireček, nisi tek nga fundi i shek. XI.²⁵ Popullata autoktone vazhdoi të jetojë në vendbanimet e fortifikuara, të ngritura me teknikën identike të ndërtimit dhe me kulturë materiale si në ato të trojeve të tjera arbërore, nën ndikimin e kulturës bizantine. Kishat e shumta të Kosovës vërtetojnë të dhënat e burimeve të shkruara të kohës mbi besimin e krishterë dhe të arbërve që jetuan në Kosovë. Këtë e vërtetojnë edhe toponimet që ndeshen në Kosovë në trajtën burimore të tyre, si “Kisha e Vjetër”, “Kisha e Kalasë”, “Arat e Kishës”, “Varret e Kishës” etj..

Në kapërcyell të shek. X-XI Kosova u përfshi në shtetin e mbretit bullgar Samuil (976-1014), në të cilin bënin pjesë Bullgaria, Maqedonia, Thesalia, Epiri, Shqipëria, Dukla, Travunja, Zahumlja, Rashka, Sremi dhe Bosnja.²⁶ Kosova u përfshi sërish nën pushtetin bizantin deri në kohën e pushtimit nga shteti mesjetar i Rashkës (1275).²⁷ Periudha e pushtimit të tërësishëm të Kosovës nga shteti mesjetar serb (1275-1455) është një prej periudhave të rënda të historisë së popullatës arbërore dhe të persiatjeve të saj për ruajtjen e identitetit.

²¹ Barišić, F. (1969) p. 11.

²² Lemerle, P. (1954) p. 294.

²³ Lemerle, P. (1954) p. 170.

²⁴ Miraculla Lib.2 I, 158; Stojanov, D. (2013) p. 28: E konstatojnë skllavininë e parë në Maqedoni në fund të shek. VI.


²⁵ Jireček, K. - Radonić, J. (1952) pp. 124, 137, 152, 157.

²⁶ Enciklopedia (1969) p. 599.

²⁷ Historija (1953) p. 412.



Foto 2 Ulpiana: Bazilika peshkopale dhe Pagëzimorja (Baptiserium: IAK)



b



a

Foto 3 a. Nekropoli i Komanit; b. Vathë nga nekropoli i Matiçanit




Foto 4 Kisha e Shën Prendës në Prizren gjatë periudhës bizantine
(Nenadović, 1963)

Kjo u bë aq më vështirë për shkak se ilirët, siç shkruan K. Jireček:

“...duken në mesjetë si popull i vjetër i krishterë me kulturë më të lartë urbane, e cila është shumë më e afërt grekëve dhe romanëve dalmatinë se sa serbëve të posapagëzuar.”²⁸

Këtij pohimi duhet shtuar dhe faktin se banorët iliro-arbëror ishin kryesisht bartës të krishterimit që nga institucionalizimi i tij dhe se pas ndarjes së kishave në shek. XI një pjesë përcolli ritin ortokods dhe tjetra ritin katolik. Andaj dhe jo rastësisht u dëbuan peshkopët ortodoksë grekë dhe u zëvendësuan me peshkopë serb, si dhe u përvetësuan objektet sakrale, që ishin në shërbim të popullatës autoktone arbërore.

Rast i përvetësimi të objektit sakral është dhe Kisha e Shën Prendës në Prizren, e ndërtuar mbi tempullin e periudhës romake dhe të bazilikave të shek. V - VI, XI dhe XIII (Foto 4).²⁹ Në të gjendej dhe qendra e peshkopatës së Prizrenit që në vitin 1019.³⁰ Pas rindërtimit nga mbreti mesjetar serb Millutini (1307) iu ripërkushtua "Të ngriturit të Zojës në Qiell", por banorët vazhduan ta quanin Kisha e Shën Prendës, si e quanin Sveta Petka banorët serb, në përkthim nga emri i vjetër. Kisha vazhdoi të njihej dhe me emrin Kisha Greke, pasi që në të predikuan një kohë mjaft të gjatë shërbyesit grekë.³¹

Mbështetja arbërore në Kishën Perëndimore dhe përkatësia lindore e kishës ortodokse serbe kishin si pasojë asimilimin sllav të një pjese të arbërve ortodoks dhe ndëshkimin e popullatës joslave. Është e njohur se mbreti serb Stefan Dushani ishte “mjaft jotolerant ndaj katolikëve dhe nuk e duronte katolicizmin në masa.”³² Për shkak të presioneve të shuma dhe uzurpimit të kishave katolike në Prizren, Novobërdë, Trepçë, Janjevë dhe në vende të tjera, në vitin 1347 reagoi Papa Klementi VI te mbreti i Rashkës, Stefan Dushani.³³ Edhe Papa Inocenti VI, kur iu kërkua pajtim me kishën romake, ia përkujtoi delegacionit të mbretit serb Stefan Dushanit premtimet se asnjë person laik apo kishtar nuk do të guxojë t'i pagëzojë latinët apo besimtarët e tjerë.

Politikën fetare, të mpleksur me motive politike, Stefan Dushani e fiksoi në Kodin e vitit 1349, në të cilën shkruan:

²⁸ Jireček, K. – Radonić, J. (1952) p. 86.

²⁹ Nenadović, S. (1963); Shukriu, E. (2014); Shukriu, E. (1993) ff. 89-100.

³⁰ Nenadović, S. (1963) p. 23; Gjini, G. (1992) f. 87.

³¹ Shukriu, E (1993) ff. 97, 99.

³² Purković, M. (1934) p. 49.

³³ Gjini, G. (1986) p. 100.

“Lidhur me herezinë latine... në qoftë se ndokush nuk dëgjon të konvertohet e të kthehet në besimin e vërtetë, ai do të dënohet me vdekje... Klerikët heretikë të një komunioni të huaj që përpiqen të bëjnë proselitë, do të kapen, do të dërgohen në miniera ose do të dëbohen. Kishat heretike do të konsakrohen e do t’u besohen klerikëve të besimit të vërtetë... në rast se nuk dëgjon të pagëzohet, atij do t’i hiqen gruaja, fëmijët dhe shtëpia, do të katandiset në mjerim dhe do të detyrohet të emigrojë...”³⁴

Nga teksti kuptohet se në shek. XII-XIV besimi katolik, të cilin serbët e njohën si “Arbanaška vera” (Feja arbënore),³⁵ ishte i përhapur në Kosovë dhe se presionet e shtetit mesjetar serb dhe të kishës ortodokse serbe ishin të vazhdueshme. Synimi ishte asimilimi etnokulturor dhe fetar i arbërve - shqiptarëve, pasi që këta kishin veçori dalluese në kuadër të shtetit të Rashkës.³⁶ Duket se kjo është faza kur një pjesë e popullatës u serbizua, gjithnjë duke e parë edhe në kontekstin e lidhshmërisë shpirtërore me kishën ortodokse dhe me nivelin e ulët arsimor të popullatës në këtë kohë. Kjo kohë është përgjithësisht kohë e identifikimit të përkatësisë ortodokse me përkatësinë etnike serbe dhe kohë e presionit të shtetit të Rashkës dhe të kishës ortodokse serbe ndaj popullatës joslave.

Në mbështetje të prezencës shqiptare në Kosovë flasin edhe vetë burimet serbe. Në krisobullat e mbretërve serbë, të Stefan Dushanit dhe të Stefan Deçanit, pos antroponimeve tipike shqiptare Gjini, Leshi, Dedë, Tanush apo Barda, paraqiten edhe emra të pazakontë asokohe për sllavët: Domenik, Dhimitër, Andrea apo Aleks.³⁷ Në krisobulat e mbretërve mesjetarë serbë shumë emra arbërorë kanë marrë sufiks sllav -iq. Të tillë janë emrat Vogliq (shqip: i vogël), Kuqeviq (shqip: i kuq), Gjoni-oviq, Tishani-oviq apo Flokovci (shqip: flokë).³⁸ Janë dhe raste të shpeshta kur Pribisllavi apo Dobrosllavi janë djem apo vëllezër të Gjinit, Bushatit ose Leshit.³⁹

Të dhënat e mësipërme e kundërshojnë stilin e hipnozës së përsëritur mbi pronësinë serbe mbi kishat ortodokse dhe mbi tezën se shqiptarët erdhën në Kosovë tek në shek. XVII-XVIII.⁴⁰ Këto u shfrytëzuan dhe në mëtimet për ndarjen e Kosovës nga trugu iliro-arbëror-shqiptar në nismë

³⁴ Novaković, S. (1898) pp. 153-154.

³⁵ Bogdano, P. (1685) Introduc.

³⁶ Xhufi, P. (1990) p. 103.

³⁷ Xhufi, P. (1990) f. 104 dhe literatura.

³⁸ Grujić, R. (1934) p. 63.

³⁹ Tërnavi, M. (1974) f. 104.

⁴⁰ Cvijić, J. (1966) p. 339; Urošević, A. (1965) p. 21; Filipović, M. (1937) p. 687.

të shek. XX dhe vazhdon nga disa qarqe edhe në fillim të shek. XXI. Tezave të tilla qysh herët iu kundërvu autori i historisë voluminoze serbe, K. Jireček, i cili thotë:

“Është i gabuar mendimi, i cili përndryshe ndeshet shpesh në kohën tonë, se elementi arbanas ka depërtuar tek në kohën turke në lindje.”⁴¹

Pushtimi osman solli sërish ndryshime të mëdha, pas Betejës së Kosovës (1389) dhe fitores mbi koalicionin e krishterë, të përbërë nga popuj të ndryshëm (serbët, arbanasët/shqiptarët, boshnjakët, hungarezët etj.). Veprim të mëtejshëm të lirë të Kishës Ortodokse Serbe ndaj popullatës joslave paraqet nënshkrimi i marrëveshjes së Patrikanës së Konstantinopojës me Portën e Lartë (1453). Të gjendur midis Scilës dhe Haribdës mesjetare, të presionit shtetëror otoman, atij islam dhe ortodoks serb, shqiptarët u gjendën para dy zgjedhjeve jetike: të ndërrimit të fesë në favor të ruajtjes së identitetit apo të serbizimit nën presionin e kishës ortodokse serbe. Një pjesë e shqiptarëve e bëri zgjedhjen e parë, duke u konvertuar në fenë islame.

Prezencën shqiptare në Kosovë gjatë mesjetës e vërtetojnë edhe të dhënat mbi strukturën etnike të vetë qytetit Prizren. Në vitin 1591 qyteti kishte 56% shtëpi myslimane dhe 44% shtëpi të krishtera, ndërsa nga raporti i Pjetër Mazrekut kuptojmë se në vitin 1623 kishte 12.000 myslimanë, 200 katolikë shqiptarë dhe 600 serbë.⁴² Në vitin 1624, sipas raportit të Kryepeshkopit Gjergj Bardhi, Prizreni kishte 3.500 shtëpi myslimane, 80 ortodokse dhe 40 katolike.⁴³

Në vitin 1875 konzulli rus në Sarajevë, A. Gilferding, shkruan se shumica e familjeve myslimane në Prizren (3.000) dhe të gjitha familjet katolike (100) janë shqiptarë, ndërsa në familjet ortodokse (900) bëjnë pjesë serbët, cincarët, bullgarët dhe grekët. Edhe B. Nushiqi, konsul serb në Prishtinë, pohon se në gjysmën e dytë të shek. XIX Prizreni nuk kishte më shumë se 10 deri në 15 familje turke dhe konstaton:

“...mjerisht, për kah madhësia Prizreni është qytet shqiptar e ata e konsiderojnë seli të tyre.”⁴⁴

⁴¹ Jireček, K. (1962) pp. 49-50.

⁴² Kosova (1969) f. 923.

⁴³ Radonić, J. (1950) p. 107.

⁴⁴ Nušić, B. (1936) pp. 259-260.

Përqindja e tillë e popullatës shqiptare në Prizren në periudhat e ndryshme të mesjetës e lejon mundësinë e konstatimit se në pjesët e tjera të Kosovës përqindja e strukturës etnike shqiptare ishte po aq e madhe, mos më shumë. Prezenca e shqiptarëve me përkatësi ortodokse dhe të konventuar gjatë rrjedhave të kohës në besimin islam dëshmohet dhe nga një varg mbiemrash të mbijetuar dhe sot në Prizren që nuk kanë prapashtesë shqiptare, sllave apo turke: Koro, Butko, Dalo, Dapko e shumë të tjerë. Sipas traditës gojore, familja e pasur Koro e Prizrenit ka trashëguar dhe kishën e vet dhe pas konvertimit ajo është shndërruar në xhami, ndërsa i gjithë dokumentacioni kishtar është dorëzuar në Bogoslllovinë e Prizrenit.

Represioni i sërishëm ndaj popullatës shqiptare në Kosovë pas vitit 1912, me qëllim të ndryshimit të strukturës etnike, edhe pse krijoi disa valë migrimesh të dhunshme, kryesisht në drejtim të Turqisë, nuk e ndryshoi këtë strukturë në disfavor të shqiptarëve. Kjo nuk u arrit as me planet famëkeqe andriqiane, qubriloviqiane e të tjerëve për spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët.⁴⁵ Nuk u arrit as me planet milosheviqiane e të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë të fundit të shek. XX, falë rezistencës së popullit të Kosovës dhe intevernimit të NATO-s.

E kaluara e Kosovës është një begati dhe mbase dhe mallkimi i saj, nëse kihen parasysh pasuritë natyrore dhe pozita gjeografike. Megjithëkëtë, baza etnolitike dhe diversiteti kulturor e etnik i krijuar gjatë historisë janë bërë pasuri e saj.

⁴⁵ Čubrilović, V. (1937); Andrić, I. (1977).

Summary

ASPECTS OF ETHNOLITIC DEVELOPMENTS IN KOSOVA

Ethnolytic processes in Kosova have passed through different phases since the Neolithic period. Stripped of myths and mythologization, Kosova recognized Dardanians as its first historically known inhabitants. It is another matter that the territory of Dardania had also other tribes considered as Dardanians (Galabrii, Daunii, Thunatae), then Thracian tribes, Moesian ones, or other. Dardanians were created by the combination of Neolithic substratum and Indo-European Eneolithic ad-stratum.

Regarding relations with the Dardanians of Troja, the time and direction of their migration is under treatment [Thrämer, E. (1901) 2177; Bürchner, C. (1901) 2157; Wilkes, J. (1992)], given the fact that the created confusion over the movements directions, East-West or West-East, can find explanation in the fact that they developed in two directions in different time periods.

Studies of Bronze Age and Iron Age material culture proved affiliation within the Glasinac complex of Illyrian culture. Integration processes of the Iron Age made Dardanians to be present as a population with a known territory and a formed culture since the VIII century B.C. Dardania was seen until recently as a tribe formation, which didn't reach the stage of state formation [Papazoglu, F. (1969) p. 111], mainly due to the lack of knowledge on archaeological material and prejudices on retardation of European Dardanians [Wilkes, J. (1992) p. 145]. Consequently, all ceramics made in the pottery wheel were automatically considered to belong to the Hellenistic period, prevailing thus the view that they accepted the pottery wheel from Celts in IV century B.C.

Analysis of the Iron Age pottery testified that Dardanians used the pottery wheel about two hundred years before the Celtic invasions, and that a great deal of them had been made after Greek models from VI-V centuries B.C., that is, during the proto-urban phase (VI-IV B.C. Photo 1) [Shukriiu, E. (1996); Shukriiu, E. (1991) *Helenizovana keramika starijeg gvozdenog doba u SAP Kosova*, Filozofski Fakultet, Beograd - PhD]. The following development brought to the creation of the state and the entry of Dardanians to the antique period.

Dardania became the only great political power in central Balkans starting from the IV century B.C. [Papazoglu, F. (1969) p. 337], resisting Celtic flooding and Macedonian plans for genocide through using Bastarnae

for this purpose [Polyb. *Historiae* XXV 6, 2], as well as Roman conquest till I century B.C.. In meantime, pre-Roman urban centers were developed, mentioned by Livy as “urbs” [Liv. XIV 4, 7-10; XXVI 25, 3], while by Strabo as *πολις αρχαία* [Strab. VII 5 12]. The territory became part of the Roman province of Moesia, Moesia Superior and then the province of Dardania (279).

After the division of the Roman Empire (395) it became part of Eastern Roman Empire, and then of the Byzantine Empire. It was involved in the crisis that engulfed empires, starting from the attacks of the Huns, the Goths and other tribes, and then the Avars followed by Slavs [Procop. *Historiae quae dicitur arcane* 18 20].

Ethnolytic integrations have not been ceased by the Roman conquests; in fact, integration processes intensified after the inclusion of Illyrians under the umbrella of the empire, creating thus the basis for the formation of Arbërs (Albanians), descendants of the Illyrians. Continuity has been proven by the Koman culture, which was widespread and created by the combination of the local tradition with elements of the Byzantine culture (Photo 3) [Anamali, S. (1966) pp. 185-196].

Penetration and establishment of Slavs in Balkans, unlike the transitional movements of different tribes, changed the course of history. Avar-Slavic waves in the present-day territory of Kosova broke less during the VI-VII centuries as they mainly went toward the Thrace coast and Constantinople [Lemerle, P. (1954) p. 294]. In this term, Byzantine sources indicate that in Dardania, Prevalitana, New Epirus and Old Epirus, there is no territory registered as occupied by Slavs in the middle of the VII century: Sclavinia, while such territories existed from Thrace to the Peloponnese [Miraculla Lib. 2 I, 158]. During the X-XI centuries, the present-day territory of Kosova was incorporated in the state of Bulgarian Tsar Samuil (976 - 1014) [Enciklopedia (1969) p. 599], then included back again into the Byzantine empire, until the invasion of the medieval state of Raska (1275) [Historija (1953) p. 412].

The repetitive hypnotic approach about Serbian ownership over churches and the thesis that Albanians came to Kosova in the XVII-XVIII centuries were used in the XX century in tentative to separate Kosova from the Illyrian-Arbër -Albanian trunk [Cvijić, J. (1966) p. 339; Urošević, A. (1965) p. 21; Filipović, M. (1937) p. 687]. Sadly, this thesis has continued by certain individuals in the beginning of the XXI century too. Such theses were however refuted quite early by the author of the voluminous Serbian history, Konstantin Jireček, who has written: “It is a wrong opinion which otherwise occurs often in our time that the Arbanas element penetrated to East during Turkish times.” [Jireček, K. (1962) pp. 49-50]

The Albanian presence in Kosova is proven also by the medieval Chrysobulls, such as of the Serbian kings Stefan Dusan and Stefan of Decan, which contain typical Albanian anthroponomy like: Gjin, Lesh, Dedë, Tanush or Barda, as well as unusual names for Slavs like: Dhimiter, Andrea, Aleks or Domenik [Xhufi, P. (1;990) f. 104]. Many Albanian names in medieval Chrysobullas have a Slavic suffix “-ic” and Albanian meanings, eg. name “Voglic” (Alb: small), Kucevic (Alb: red), also: Gjon-oviv, Tishan-oviv or Flokovci (Alb: hair) [Grujić, R. (1934) p. 63]. Also, quite frequent are cases where persons holding Slavic names like Dobroslav or Pribislav, emerge as sons or brothers of Gjin, Bushat or Lesh [Těrnava, M. (1974) p. 104].

Ottoman conquest brought major changes after the Battle of Kosova (1389) and their victory over the Christian coalition. However, the Serbian Orthodox Church had further the freedom to act against non-Slavic population thanks to the signed agreement between Patriarchate of Constantinople and Ottoman government (1453). Faced between Medieval Scylla and Charybdis, and the pressure of the Ottoman state and the Serbian Orthodox Church, the Albanians found themselves caught between two crucial dilemmas: change of religion in favor of preserving the identity, or Serbisation. Much later and in mass, they choose the first one.

Serbian re-repression against the Albanian population in Kosova after 1912 did not change the ethnic structure in disfavor of Albanians. This was not achieved neither by Andrić’s nor Cubrilović’s projects for ethnic cleansing of Kosova [Čubrilović, V. (1937); Andrić, I. (1977)], or by the plans of Milosevic and the Serbian Academy of Science and Arts at the end of the XX century, due to the resistance of the people of Kosova, and the NATO intervention.

Ethnolytic base of Kosova and its created cultural and ethnic diversity should be seen as the richness of the country which has to be used for mutual recognition, understanding and respect.

Bibliografia / Bibliography

- Anamali, Skender (1966) "Mbi kulturën e hershme Shqiptare", Ilirët dhe Gjenezja e Shqiptarëve, Tiranë, ff. 185-196.
- Andić, Ivo (1977) *Elaborat o Albaniji*, Časopis za Suvremenu Povijest, Zagreb.
- Barišić, Frano (1969) "Proces slovenske kolonizacije istočnog Balkana", *Predslovenski etnički elementi na Balkanu u etnogenezi južnih slovena*, Sarajevo.
- Bogdano, Pietro (1685) *Cuneus Prophetarum, pars prima. Patavii*.
- Bürchner, C. (1901) *Pauly-Wissova Realencyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Stuttgart.
- Cabanes, Pierre (1988) *Les Illyriens de Bardulis à Genthios IV^e-II^e siècles avant J.-C.*, Cedes, Paris.
- Cohen, Ronald (1978) "State Origins: A Reappraisal". *The Early State* (By H. J. M. Claessen, Peter Skalník), Walter de Gruyter, pp. 31-76.
- Cvijić, Jovan (1965) *Balkansko poluostrvo*, Institut društvenih nauka Beograd.
- Čerškov, Emil (1969) *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, ADJ, Beograd.
- Čubrilović, Vasa (1937) *Isterivanje Albanaca*, Memorandum, Beograd.
- Enciklopedia Leksikografskog Zavoda 5* (1969), Zagreb.
- Filipović, Milorad (1937) "Etničke prilike Južne Srbije", *Spomenica 25 godišnjice oslobadjanja Južne Srbije*, Skopje.
- Gjinari, Jorgji (1988) "Dëshmi për historinë e gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar", *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë.
- Gjini, Gasper (1986) *Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Kršćanska sadašnjost, Zagreb.
- Historija Naroda Jugoslavije I* (1953) Školska knjiga, Zagreb.
- Grujić, R. (1934) "Lična vlastelinstva srpskih crkvenih predpostavnika u XIV i XV veku", *Glasnik Srpskog Naučnog Društva*, Skoplje.
- Islami, S. - Anamali, S. - Korkuti, M. - Prendi, F. (1985) *Les Illyriens*, Academie des Sciences de la RPS d'Albanie, Tirana.
- Jireček, Konstantin – Radonić, Jovan (1952) *Istorija Srba I*, Beograd.
- Jireček, Konstantin (1962) "Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjeg veka", *Zbornik K. Jirečeka II*, Beograd.
- Kosova, dikur dhe sot* (1969), Prishtinë.
- Leaf, Walter (1915) *Homer and History*, Macmillan and Co., London.
- Lemerle, Pierre (1954) "Invasions et migrations dans les Balkans depuis la

- fin de l'époque Romaine jusq'au VIIIe siècle”, *Revue Historique* 211/2, Paris, pp. 265-308.
- Mócsy, András. (1968) “*Latrones Dardaniae*”, *Acta Antiqua Academiae Scientiarum Hungaricae*, pp. 351-354.
- Nenadović, Slobodan (1963) *Bogorodica Ljeviška*, Beograd.
- Novaković, Stojan (1898) *Zakonik cara Stefana Dušana*, Beograd.
- Nušić, Branislav (1936) *Razni spisi*, Izdavačko i knjižarsko preduzeće Geca Kon A.D., Beograd.
- Papazoglu, Fanula (1989) “*Dardanska Ilirska kraljevina*”, *Iliri i Albanci*, SANU, Beograd, pp. 145-171.
- Papazoglu, Fanula (1969) *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, ANUBIH Knj. XXX, Sarajevo.
- Purković, Miodrag (1934) *Avinjonske pape i srpske zemlje*, Požarevac.
- Radonić, Jovan (1950) *Rimska kurija u juznoslovenske zemlje od XV-XIX veka*, SANU, Beograd.
- Shukriu, Edi (2004) *Ancient Kosova*, MEST, Prishtina.
- Shukriu, Edi (2014) *Kisha e Shën Prendës - Prizren*, MASHT, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1996) *Dardania paraurbane*, Dukagjini, Pejë.
- Shukriu, Edi (2010) “*Zhvillimet etnolitike në Kosovë përmes historisë*”, *Bankanlarda Tarih ve Kultur Kongresi, Sakarya Universitiesy - Universiteti i Prishtinës, Sakarya*.
- Shukriu, Edi (1993) “*Kisha e Shën Premtes në Prizren*”, *BFF XXI*, Prishtinë, ff. 89-100.
- Shukriu, Edi (1989) “*Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut*”, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 14*, Prishtinë.
- Stojanov, Darko (2013) *Les villes de l’Illyricum protobyzantin face aux grandes invasions*, Paris (Thèse de doctorat).
- Tërnavë, Muhamet (1974) “*Shqiptarët në feudin e Deçanit*”, *BFF*, Prishtinë. ff. 255-271.
- Thompson, Della, ed. (1995) “*State*”: *Concise Oxford English Dictionary* (9th ed.), University Press Oxford, Oxford.
- Thrämer, Eduard (1901) *Paulys Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft anianos*, Band IV 2, Stuttgart.
- Urošević, Atanasije (1964) “*Kosovo*”, *Naselja i poreklo stanovništva 39*, Srpski etnografski zbornik LXXVIII, Beograd.
- Wilkes, John (1992) *The Illyrians*, Bllackwell, Oxford.
- Xhufi, Pëllumb (1990) “*Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe*”, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë*.

FAZA PARAQYTETARE DARDANE E KOSOVËS

Të dhënat e shkruara antike dëshmojnë mbi ekzistimin e Mbretërisë Dardane para pushtimeve romake dhe mbretërit e saj i quajten "basileos" dhe "rex", ashtu si i quanin dhe mbretërit e Maqedonisë e të tjerët. Në kuadër të kësaj mbretërie, pos Kosovës, përfshihej dhe Serbia Jugore, një pjesë e Sanxhakut dhe Maqedonia Veriperëndimore. Nga mesi i shek. III p.K. në të u përfshi dhe Peonia, territor të cilin Dardania e shihte si të vetin dhe për të cilin ishte në konflikt me Maqedoninë.

Çështje e rëndësishme që shtrohet është pyetja se a u shndërrua kjo mbretëri në shtet të organizuar apo jo? Qëndrime mbi dardanët u nxorën kryesisht nga të dhënat e fragmentuara të burimeve të shkruara antike dhe në mungesë të njohurive të plota të burimeve arkeologjike. Si pasojë, ishte i përhapur mendimi se njohja e zejes së poçarisë të dardanët lidhet me ndikimet dhe prezencën kelte nga shek. IV p.K. e më pas dhe jo si rezultat i zhvillimeve më të hershme dardane dhe të kontakteve e ndikimeve helene.¹

Të dhënat e mësipërme bënë që të mendohej se dardanët e arritën vetëm nivelin e një "organizimi mbifisnor", i cili nuk e arriti shkallën e organizimit shtetëror, pasi që procesi u ndërpre nga pushtimet romake. Si argument qenësor në dëm të ekzistimit të shtetit dardan theksohet moskrijimi i qendrave urbane dardane dhe prapambetja e përgjithshme e tyre.² Kjo nënkupton dhe shkëputjen dardane nga rrjedhat e botës mesdhetare.

Studimet e burimeve arkeologjike sjellin dhe përfundime me vlera të reja, sidomos në bazë të qeramikës së prodhuar dhe të trajtuar në këtë studim e që vazhdon të jetë treguesi më i sigurt i prodhimeve dhe i traditave lokale. Këto i dëshmojnë proceset që i paraprinë krijimit të organizimit politik dardan, falë zhvillimit ekonomik të brendshëm, atij shoqëror dhe paraqytetar, si dhe përfshirjen dardane në rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit të botës helene dhe ndikimet kulturore që vinin nga bota mesdhetare.

Të dhënat arkeologjike provuan edhe zhvillimin protoqytetar në protohistorinë dardane, ndërsa nga ato të burimeve të shkruara mund të provohet dhe zhvillimi qytetar më pas. Zhvillimi urban nuk njihej as te

¹ Shukriu, E. (1996) ff. 105-107.

² Papazoglu, F. (1988) pp. 161-162.

ilirët e jugut deri në gjysmën e dytë të shek. XX, zhvillim ky sot i pranueshëm pas studimeve të shumta arkeologjike.

Jeta dhe rrita e vendbanimeve dardane përcjell në përgjithësi proceset e zhvilluara në hapësirat e tjera, nga vendbanimet parahistorike, ato paraqytetare e deri te qendrat qytetare. Përderisa vendbanimet parahistorike kishin treg të përbashkët në një hapësirë të caktuar natyrore, në fazën paraqytetare tregu gjendej më afër qendrave më të mëdha, ku ishin prezent dhe zejtarët e caktuar, ndërsa në fazën qytetare zejtarët dhe tregu ishin brenda qytetit, duke ndihmuar kështu zhvillimin e tij (Foto 1).




Foto 1 Zhvillimi i vendbanimeve paraqytetare dhe qytetare

Materiali arkeologjik i Kosovës, i ritrajtuar dhe i krahasuar me territoret e tjera dardane, mundëson që zhvillimi i dardaneve të shihet në periudhat vijuese:

I	Epoka e bronzit	Faza paradardane
II	shek. XII-IX p.K.	Faza protodardane
III	shek.VIII - mes. IV p.K. (a, b, c)	Faza dardane
IV	mes. shek. IV-I p.K.	Faza dardane helenistike

I Faza paradardane

Faza paradardane u zhvillua gjatë epokës së bronzit dhe nënkupton nismën e krijimit të fiseve dardane. Të dhëna të reja dhe të plota stratigrafike të epokës së bronzit gjenden në vendbanimin e Hisarit të

Suharekës, Vlashnjës, Korishës e Harilaqit,³ ndërsa është konstatuar dhe varrimi në tuma, si në Përçetë / Përçevë, Ujz te Rogova (shek. XV - XIV p.K.), Gllarevë te Klina etj..⁴

Mungesa e derivonshme e materialit arkeologjik i fazës paradardane solli dhe mendime për mundësinë e depërtimit të një elementi të ri etnik, gjë që e mohojnë, pos të dhënave nga vendbanimet kodrinore, edhe të dhënat nga hulumtimet në vendbanimet rrafshinore të Glladnicës së Graçanicës,⁵ Nosalës e Kllokotit te Gjilani⁶ dhe Fafosit II te Mitrovica, ku gjendet dhe zbukurimi me instrument të dhëmbëzuar.⁷ Motivet në linja horizontale, vertikale e të pjerrëta janë bërë në trajtë katrorësh të imët përmes instrumentit vulë, me trajtë të lakuar dhe me pjesë të dhëmbëzuar të parme. Instrument i tillë është gjetur në lokalitetin e Bardhit të Madh dhe, më parë në Rahovicë të Preshevës.⁸ Janë prezent dhe tasat që u zbuluan në Glladnicë të Graçanicës, në Kllokot, Nosalë, Fafos II dhe nënshtrësën e nekropolit të Karagaçit te Mitrovica.⁹

Ekzistimin e vendbanimeve në rrafshje dhe pranë lumenjve në këtë periudhë e dëshmojnë dhe analogjitë me hapësirat e rrjedhës së Moravës dhe të Timokut.¹⁰

Periudha e bronzit të vonë duket më komplekse dhe ajo është e përfaqësuar nga vendbanimi i Lushtës te Mitrovica, Glladnicës te Graçanica, Korishës (Korisha III), Vlashnjës (Vlashnja IVc),¹¹ e Bardhit të Madh / Bellaçecit.¹² Në to paraqiten edhe forma të reja të qeramikës, siç janë pjatat me buzë të fryra dhe buzëbrenda, të faqëzuara ose të përshkuara nga kanelyra të tipit turban-dish, që u bënë karakteristike për fazën dardane (Faza II). Këto trajta të shek. XII-XI p.K. lidhen në jugperëndim dhe me trevën lindore të Shqipërisë (Kukës, Dibër, Korçë) dhe në lindje me grupin kulturor të Medianës (Mediana II, III).¹³

Janë paraqitur dhe enë me vegje në trajtë kalemi, të cilat duken në fund të periudhës II të epokës së bronzit,¹⁴ janë prezente në epokën e vonë

³ Peja, F.- Hajdari, A. (2014) ff. 256, 259.

⁴ Katalog (2013) f. 100.

⁵ Gërmimet e Muzeut të Kosovës (J. Glišić 1961, 1974).

⁶ Gërmimet sondazhe të Muzeut të Kosovës (1961).

⁷ Shukriu, E. (1996) f. 25.

⁸ Vukmanović, M.- Popović, P. (1982) p. 204.

⁹ Srejović (1973) T. III 2, 3.

¹⁰ Stojić, M. (1986) pp. 100; Stojić, M. (1980) pp. 13-15; Vasić, R. (1987) p. 655.

¹¹ Katalog (2013) f. 100.

¹² Mehmetaj, H. (2014) ff. 38-39, 41-43.

¹³ Garašanin, M. (1973) p. 312.

¹⁴ Lokaliteti Glozhdar te Paraçini: Garašanin, D. (1971) 174/2.

të bronzit në lokalitetin e Glladnicës te Graçanica.¹⁵ Ekzemplarët e epokës së hershme të bronzit u zbuluan në lokalitetin Kritzana (sot: Greqia Veriore).¹⁶ Nga kjo konkludohet se vegjet në trajtë kalemi janë më të hershme në Kosovë se kotoni me të njëjtat vegje të shek. VII-VI p.K. nga Dyrrihu dhe tuma I e Kuçit të Zi, për të cilat u mendua se ishin rrugët e ndikimit në qeramikën dardane.¹⁷

Relacionet me dardanët e Trojës janë çështje që ende trajtohen,¹⁸ si rrjedhojë e të dhënave shumë më të vona të autorëve antikë dhe të dhënave jo aq të plota arkeologjike për zhvillimet gjatë epokës së bronzit dhe krahasimit me ato trojane të të njëjtës periudhë. Kështu, Diodori shkruan se Dardani, duke sunduar mbi shumë fise në Azi, aty i vendosi dhe dardanët nga ana tjetër e Trakisë (v.a. nga Europa) (Diodorus Bibliotheca historica V 48). Sipas Solinit, i cili nuk e vë në dyshim lidhjen e dardanëve, dardanët kaluan nga Azia në Europë, ishin të gjinisë trojane dhe u bënë barbarë në doke (Solinus II, 51 D 2).

Konfuzionet e krijuara mbi drejtimet e lëvizjeve të dardanëve lindje - perëndim apo perëndim - lindje, mund të shpjegohen me faktin se janë zhvilluar migrimet në periudha të ndryshme kohore. Për këtë duhet pasur parasysh valët e dyndjeve indoeuropiane të drejtimit lindje - perëndim të epokës së eneolitit, ato në drejtimi veri - jug nga mijëvjeçari II p.K. (dyndjet e akejëve) dhe valët nga shek. XII p.K. (dyndjet dorike apo dyndjet egjeane).

Duke lënë anash dilemat rreth migrimëve, duhet cekur rëndësinë e studimit të kulturës materiale të epokës së bronzit dhe ato më të hershme në trojet dardane europiane dhe krahasimin me atë trojane. Nga të dhënat e derisotme konkludohet se dardanët europianë lidhen kryesisht me kompleksin ilir të epokës së bronzit të kulturës së Gllasinacit.

II Faza protodardane

Faza protodardane (shek. XII - IX p.K.) është mjaft komplekse dhe lidhet edhe me kohën e dyndjeve dorike apo egjeane dhe ndërlidhet edhe me kulturën e fushave me urna. Disa vendbanime të kësaj faze janë konstatuar të jenë të vendosura në rrafsh, në tarraca pranë lumenjve, si janë

¹⁵ Garašanin, M. (1973) p. 314.

¹⁶ Heurtley, A. (1939) Fig. 137.

¹⁷ Parović-Pešikan, M. (1987) pp. 33-34.

¹⁸ Thrämer, E. (1901) 2177; Bürchner, C. (1901) 2157; Leaf, W. (1915) p. 72; Wilkes, J. (1992) etj..

ato të evidentuara te Nosala, Kllokoti apo Fafosi II. Duket se disa janë vendosur dhe në kodra të ulëta, si në rastin e Gradishtës së Vlashnjës. Fundit të kësaj faze i përkasin dhe nekropolet e grupit kulturor të Bërnicsës, që lidhet me traditat e kulturës së fushave me urna.

Qeramika e kësaj faze është punuar me dorë dhe ka sipërfaqe të latuar dhe pjekje ngjyrë hiri. Kjo qeramikë përbëhet kryesisht nga trajta të enëve me buzë të kthyer nga brenda, të cilat kanë shpesh kanelyra të gjera në buzë. Ndonëse më rrallë, në to paraqitet dhe zbukurimi me instrument të dhëmbëzuar (Foto 2a, 3a). Ky lloj zbukurimi zhvillohet në ornament dallues të qeramikës dardane në fazën vijuese.

III Faza dardane

Proceset integruese të fazave paraprake bënë që dardanët të jenë prezent si një popullatë me territor të njohur dhe me kulturë plotësisht të formuar nga shek. VIII p.K..

Në fazën dardane vendbanimet janë vendosur në kodra të mbrojtura mirë nga natyra dhe janë ndërtuar mure rrethuese. Në mesin e vendbanimeve kodrinore dallohen dy lloje, ato të vendosura në kodra të ulëta dhe në kodra të larta. Vendbanimet e kodrave të ulëta përfaqësohen nga gradinat e gërmuara në Gadime të Epërme, Bardh të Madh - Bellaçec, Cernicë, Duboc, Vlashnjë, Hisar i Suharekës, Teneshdoll etj.), ndërsa ato të vendosura në kodrat e larta nga ato në Zatriq, Lamë e Art në Artanë - Novobërdë, Pidiq, Samadrexhë, Llapushnik, Vuçak etj.). Që të dy variantet lidhen me ekonominë bujqësore e blegtorale, por edhe me atë xehtare.

Të gjitha vendvarrimet e fazës dardane janë tumulare, me varr qendror dhe varre në radiusin e tij, të cilat datojnë nga shek. VIII-IV p.K.. Të tilla janë tumat e hulumtuara në Romajë, Rogovë, Përçetë / Përçevë, Llashticë e të tjera. Në kuadër të fazës dardane veçohen nënfazat Iia, Iib dhe Iic.

Nënfaza IIIa

Nënfaza IIIa është zhvilluar nga shek. VIII-VI p.K. dhe karakterizohet nga enë balte të punuara me dorë. Përfaqësohet me dy lloje të qeramikës, të asaj finoke dhe të vrazhdë. Qeramika finoke është e latuar dhe ka pjekje ngjyrë hiri të mbyllët ose të murme. Përbëhet kryesisht nga enë buzëbrenda, shpesh me një vegje në trajtë gjuhe, por paraqiten dhe enë

buzëdala me një vegje, tasa me një vegje dhe enë të thella buzëdala (Foto 1a, 1b). Këto janë zbukuruar me vija vertikale apo të pjerrëta, të realizuara me instrument të dhëmbëzuar.

Zbukurimi me instrument të dhëmbëzuar paraqitet si karakteristikë e qeramikës dardane dhe shpesh kombinohej dhe me kanelyra (Foto 2b, 3a, 3c, 4, 5). Prejardhja e këtij zbukurimi në enët prej balte, të bërë para pjekjes, ka traditë të hershme dhe shfaqet në qeramikën paradardane të vendbanimeve rrafshinore.

Zbukurim i ngjashëm shfaqet më rallë dhe në qeramikën e lokalitetit Ezero-Slivensko të epokës së hershme të bronzit, në rrjedhën e sipërme të Strumicës, si dhe në lokalitetin Pernik të Bullgarisë gjatë gjysmës së dytë të epokës së bronzit.¹⁹ Duket në këtë drejtim nuk duhet kërkuar ndikimin trak, aq më tepër që në zbukurimet e qeramikës së epokës së hekurit mbizotëronte teknika e inkrustimit.²⁰

Qeramika e vrazhdë nuk përmban dekorime të qeramikës finoqe, por ka vetëm brez relievor në pjesën e epërme të enës, që mban gjurmë gishtërinjsh ose të thonjve. Nga fundi i kësaj nënfaze paraqiten dhe amfora për transport, të importuara nga Hiosi (Foto 12a).

Nënfaza IIIb

Nënfaza IIIb zhvillohet nga shek. VI deri në mesin e shek. V p.K. dhe në të janë konstatuar trajta të reja të jetës. Gjatë kësaj nënfaze vendbanimet rriten dhe zgjerohen edhe rrëzë kodrave, si në rastin e lokalitetit të Veletinit. Vetëm vendbanimi i Bardhit të Madh - Bellaçecit pushoi së ekzistuari në fillim të kësaj nënfazë për shkaqe të paqarta.

Nënfazën e karakterizon qeramika e punuar me dorë, si vazhdimësi e traditës së mëhershme, dhe qeramika e punuar në çark të poçarit, e cila ishte risi teknologjike e kohës. Në kuadër të qeramikës së punuar me dorë duken dhe trajtat e reja të enëve, siç janë enët e thella me vegje që dalin nga buza në trajtë gjuhe të zgjatur dhe me të cilën ndërlihet në kënd të drejtë vegja me prerje rrethi (Foto 5b).

Janë prezente dhe enët buzëbrenda me vegje në trajtë kalemi (Foto 3b) nga Hisari i Suharekës,²¹ Bellaçeci, Vallaçi,²² por edhe në lokalitetet e

¹⁹ Changova, Ī. (1983) p. 43, Fot. 35 1-3.

²⁰ Changova, Ī. (1983) p. 46 ff.

²¹ Djurić, N. (1970) T. III 1.

²² Tasić, N. (1960) p. 24, T. VI 5.

rrethit të Shkupit.²³, të cilat janë zbukuruar me instrument të dhëmbëzuar e që përcjellin trajtat e mëhershme. Vegja në trajtë kalemi paraqitet në fund të periudhës II të epokës së bronzit²⁴ dhe në epokën e vonë të bronzit në Glladnicë.²⁵

Në kuadër të qeramikës veçohen dhe broket buzëpjerrta, me qafë të gjatë, bark të fryrë të rumbullakuar dhe fund të rrafshtë. Ekzemplarët janë zbukuruar me instrument të dhëmbëzuar (Foto 4).²⁶

Nënfaza IIIb sjell edhe disa risi të vlefshme për zhvillimet e mëtejme në shoqëri dardane dhe të cilat shihen si ndikime të drejtpërdrejta helene. Pikësëpari është dukja e qeramikës së punuar në qark të poçarit, kryesisht sipas modeleve helene. Kjo qeramikë është krijuar me forma të llojllojshme dhe për përdorime të ndryshme, gjë që flet për përparimin dhe nevojat e zgjeruara të banorëve. Pjekja e saj ka ngjyra të llojshme, nga ajo e kuqërremtë, e murme e okër deri te ajo e mëvonshme ngjyrë hiri.

Së dyti, në këtë nënfazë krijohet qeramika e pikturuar, kryesisht në amfora dhe hidria. Pikturimi është bërë me shije vendore, përmes brezave horizontale me zbulurime të varuar në trajtë pikash loti. Varësisht nga trajta e enës, këto janë vendosur në buzë, në qafë dhe në krahët e enëve (Foto 7).

Së treti, nënfaza karakterizohet me një numër të konsiderueshëm të objekteve të importuara. Në mesin e tyre më e rëndësishmja është qeramika atike me figura të zeza, kiliksi e skifosët nga Banja e Pejës (Foto 13a) dhe ena nga Gradina e Gadimes së Epërme me mbishkrim arkaik (Foto 11a). Prezenca e materialit të tillë të importuar dëshmon për kontaktet e intensifikuara dardane me botën helene gjatë shek. VI p.K., siç dëshmon dhe Menada e Prizrenit (Foto 13b).

Nënfaza IIIc

Nënfaza IIIc përfshinë mesin e shek. V deri në mesin e shek. IV p.K.. Jeta vazhdoi në vendbanimet kodrinore të kësaj nënfaze, por është konstatuar se shumica prej tyre nuk janë banuar më dhe se në asnjërin prej vendbanimeve të hulumtuara kodrinore nuk janë gjetur gjurmë të zbrazjes së tyre të dhunshme.

²³ Pašić, R.(1976) p. 151.

²⁴ Lokaliteti Glozhdar te Paraçini: Garašanin, D. (1971) 174/2.

²⁵ Garašanin, M. (1973) p. 314.

²⁶ Analogjitë dhe literatura: Shukriu, E. (1996) f. 32.

Në nënfazën IIIc mbizotëroi qeramika e punuar në çark të poçarit, e ngjashme me parapraken. Nga fundi i nënfazës dominoi qeramika ngjyrë hiri, gjë që nënkupton se dardanët përvetësuan teknologjinë më të përparuar të prodhimit të qeramikës.

Në këtë nënfazë është konstatuar zvogëlimi i importit, i përfaqësuar nga grupi Saint Valentin (Foto 11b), ndërsa qeramika vendëse është punuar sipas modeleve të enëve me vernik të zi të rrethit atik. Nënfazën e karakterizon edhe nisma e qarkullimit të monedhave.

IV Faza dardane helenistike

Faza dardane helenistike u zhvillua nga mesi i shek. IV deri në fund të shek. I p.K.. Nga kjo periudhë katërqindvjeçare të historisë dardane nuk janë gjetur shumë të dhëna arkeologjike në Kosovë. Nga kjo fazë disponohet vetëm me qeramikën e Megarës dhe enët prej bronzi nga tuma e Romajës (Foto 14), lacrimarium (lotore) / urgumentarium nga Zotaj (Vojnovc. Foto 15a), Cjapin prej bronzi nga Prizreni (Foto 15b), shpatën e tipit mahaira të shek. III-II p.K. nga Shiroka dhe disa fibula të bronzit të tipit të latenit të vonë.

Në këtë fazë qarkulluan në botën antike prodhimet dardane, siç ishin rrathët prej ari, shpatat e tipit mahaira, djathi dardan, dhjami i derrit, hekuri e plumbi, për të cilat dëshmojnë autorët antikë. Livi përmend në mënyrë të veçantë arin dardan që vinte nga Dardania.²⁷




Foto 2 Enë me vegje në trajtë gjuhe (VIII-VI p.K.)

²⁷ Livy, *Naturalis Historiae* XXXIII xii 39: "...quod ex Dardanis venit - itaque et Dardanium vocabatur".




Foto 3 Enë me buzë të kthyera nga brenda dhe zbukurim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)






Foto 4 Broke: zbukurim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)



a



b

Foto 5 Enë me zburkim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)




Foto 6 Skifosë (VI-IV p.K.)




Foto 7 Enët e pikturuara të fazës paraqytetare (VIII-VI p.K.)




Foto 8 Disa trajta enësh të fazës paraqytetare (VIII-VI p.K.)




Foto 9 Skifosa dhe tas (Katalogu 2013)



Foto 10 Kantaros (Harilaq) (Peja 2014)



a



b

Foto 11 a. Mbishkrimi arkaik grek në amforë;
b. Import i grupit Saint Valentin (Gadime).



a



b

Foto 12 a. Amforë e Hiosit (Gadime); b. Import i Italisë Jugore, Harilaq, (Peja 2014)



a



b

Foto 13 a. Olpa me figura të zeza, Banjë e Pejës (Muzeu i Kosovës);
b. Menada e Prizrenit (British Museum)

Si rezultat i intensifikimit të qarkullimit të monedhave janë gjetur në Kosovë monedha të Histrisë, të Damastionit nga shek. IV p.K., pastaj të Tebës, Apollonisë së Thrakisë, Lekës së Madh, të Filipit III, Athinës, Peonisë, Pellagonisë, si dhe më pas një numër i madh i monedhave të Dyrrahut dhe të Apollonisë së Adriatikut dhe denarët e Republikës së Romës.

Qarkullimi i monedhave dëshmon se dardanët zhvilluan ekonominë monetare, si dhe shteti Ilir (Ballaeus, Gent) apo dhe daorsët, të cilët farkuan monedhat e tyre,²⁸ për dallim nga fisi ilir i dalmatëve, për të cilët Straboni shkruan se kishin ekonomi jomonetare, tipike për popujt barbar.²⁹

Faza dardane helenistike përkon me zhvillimin urban dardan dhe me krijimin e shtetit dardan, kohë kjo kur dardanët paraqiten si faktor tejet i rëndësishëm politik në pjesën qendrore të Europës Juglindore. Si dhe shtetet e tjera të hershme, të krijuara nga “diferencimi i lartë shoqëror, klasën sunduese të pasur dhe të privilegjuar, të subordinuar mbretit,”³⁰ shteti dardan kishte shoqëri të diferencuar, territor kompakt, komunitet të organizuar nën një qeverisje, institucion të mbretit (Longari, Bato, Monuni) dhe fron trashëgues (Longari dhe djali i tij Bato), institucion të skllavërisë (dulët: “duloj” dhe robërit e luftës), ushtri të organizuar (fallanga me 8.000 ushtarë), veprimtari diplomatike dhe aleanca me shtetin ilir, etolët, medët, skordiskët, republikën romake, madje dhe martesë dinastike, siç ishte martesë e Etutës, vajzës së mbretit dardan, me mbretin ilir Gentin.³¹

Në aristokracinë skllavopronare në krye me mbretin, pos shtresës së “miqve të mbretit”, përfshiheshin dhe priftërinjtë dhe shtresa e lartë ushtarake. Shtresën vijuese e përbënin zejtarët, tregtarët dhe xehetarët, pastaj fshatarësia e lirë dhe shtresa më e ulët ishin skllëvërit (dulët, si kategori e veçantë të dardanët dhe robërit e luftës).

*

Faza dardane II është faza më e hulumtuar dhe ajo mundëson ndjekjen e zhvillimeve gjatë shek. VIII–IV p.K. dhe rrugët e zhvillimeve më pas. Kështu, mund të konkludohet se nga shek. VI p.K. ngjanë ndryshime të rëndësishme në jetën ekonomike dhe shoqërore dardane, të cilat sollën një kualitet më të përparuar të jetës. Një prej treguesve të drejtpërdrejtë të këtyre ndryshimeve është qeramika me vlerat e saj

²⁸ Marić, Z. (1995) pp. 31-72, Tab. 1-24.

²⁹ Strabo VII 5 5 C 315.

³⁰ Thompson, D. (1995) "State"; Cohen, R. (1978) p. 36.

³¹ Shukriu, E. (1996); Artikulli në libër: “Aspekte të zhvillimeve etnolitike në Kosovë”.

polivalente, me teknikat e prodhimit, me trajtat dhe funksionet e ndryshme, me frymën vendore dhe ndikimet. Sipas prejardhjes, qeramika e kësaj faze ndahet në qeramikën e importuar, atë të punuar me qarkun e poçarit, kryesisht sipas modeleve greke, dhe në qeramikën e punuar me dorë. Nga mesi i kësaj faze dominon qeramika e punuar në qark, ndërsa qeramika e punuar me dorë duket më rrallë.

Importet më të hershme të fazës II janë amforat për transport të Hiosit (Foto 12a), pastaj duken ato të Atikës, të Halkidikut dhe nga territoret fqinje. Rrugët e arritjes së importit nga jugu dhe të ndikimeve nga Athina, Korinthi apo Halkidiku ishin të ndryshme, por më kryesore ishte rruga që shkonte rrjedhës së Vardarit dhe ajo përmes Pollogut. Në këtë rast duhet pasur parasysh dhe rrugën përmes rrjedhave të Drinit të Zi dhe të Drinit të Bardhë, e cila kishte po ashtu rëndësi për Dardaninë, por është cekur më pak. Në përfundimin të tillë sjellin analogjitë që gjenden në Shqipërinë Juglindore dhe në Maqedoninë Jugperëndimore.

Ndikimi helen në këtë fazë mund të ndërlihdet dhe me vendosjen e helenëve në Damastion, pas largimit të banorëve të Eginës dhe të Mendes së Halkidikut gjatë luftërave të Peleponesit. Për këto migrime, që kanë mundur të zhvillohen në masë më të madhe dhe në disa vende, flet autori antik Straboni.³²

Deri më sot nuk është konstatuar se në Kosovë ka import atik të enëve me figura të kuqe të shek. V p.K., por është provuar se është prezent imitimi i qeramikës atike me vernik të zi. Dukuri e ngjashme, si dhe shfaqja e prodhimeve lokale me trajta helene gjatë shek. VI – V p.K., ngjan edhe në territoret fqinje. Arsyet për këtë shihen në rrjedhat e kohës dhe politikën e Athinës ndaj mbretit të Maqedonisë, Aleksandrit I.³³

Prodhimtaria lokale me trajta helene duket në tumat e rrjedhës së poshtme të Vardarit që nga shek. VII p.K.. Ishte kjo arsye që materiali nga këto tuma u veçuan si "grup maqedon lokal", i cili imiton qeramikën e qendrave zejtare të Halkidikut.⁵ Prodhimtaria lokale me trajta helene ishte po ashtu e përhapur në Ilirinë e Jugut. Madje kjo prodhimtari dominon në tumat e Devollit në raport me qeramikën e importuar.³⁴ Në Selcën e Poshtme është konstatuar se importi paraqet vetëm 10% të qeramikës së përgjithme.³⁵

³² Shih: Papazoglu, F. (1967) p. 16.

³³ Georgiev, Z. (1984) p. 52; Vasić, R. (1979) p. 224.

³⁴ Prendi, F. (1978) ff. 75-76.

³⁵ Ceka, N. (1985) f. 122.




Foto 14 Importet e shek. III-II p.K. (Romajë)



Foto 15 a. Lotore (lacrimarium) shek. III-II p.K., Zotaj (Vojnovc);
 b. Cjap bronzi: shek. III-II p.K., Prizren (Vranjski Muzej);
 c. Fragment ene e shek. II-I p.K., Vlashnjë (Katalog 2013).

Në mesin e objekteve të zbuluara në lokalitetet e Kosovës një rëndësi të posaçme ka qeramika vendëse me trajta helene, e punuar në qark e shek. VI-IV p.K.. Prodhimin e tyre lokal e dëshmojnë elementet e shumta, siç është dukja në masë e tyre, mungesa e analogjive direkte për shumë trajta, veçoritë e qeramikës së pikturuar dhe, në veçanti, zbulimi i bazamenteve për pikturimin e enëve.

Për shkak të zgjerimit të nevojave të banorëve dhe përdorimit të enëve për nevoja të caktuara, qeramika e kësaj faze ndahet sipas funksioneve kryesore në:

1. Qeramikë tryeze,
2. Qeramikë kuzhine,
3. Qeramikë për përdorim shtëpiak,
4. Qeramikë për transport.

Në mesin e trajtave të shumta gjenden enë, skifosë, kupa, tasa, hidria dhe amfora të vogla e të mëdha, lekanë dhe kraterë. Kjo llojlloshmëri e funksioneve dhe të trajtave të qeramikës është tregues që provon nevojat e zgjeruara të shoqërisë më të zhvilluar dardane në këtë periudhë.

Teknika e prodhimit të qeramikës së punuar në qarkun e poçarit i takon qeramikës me ngjyrë të kuqërremtë dhe qeramikës me ngjyrë hiri. Në grupin e qeramikës së kuqërremtë duket dhe varianti me ngjyrë okër dhe ai i murrmë.

Prania e qeramikës së punuar me qark të poçarit në lokalitetet e Kosovës, përfshirë dhe objektet prej metali, provuan se në kuadër të shoqërisë dardane nga fundi i shek. VI p.K. veçohet dhe shtresa e zejtarëve. Këta prodhuan për një treg më të gjerë, si dhe farkëtarët e ndërtimtarët, duke u bërë nismë për thellimin e proceseve diferencuese shoqërore.

Shfaqja e zejeve të caktuara varej nga zhvillimi i brendshëm, rrjedhat e përgjithshme në botën antike dhe konfliktet në kuadër të saj dhe nga natyra e zhvillimit ekonomik të antikës. Kësaj i ndihmoi fakti se teknika zejtare e antikës ishte relativisht e thjeshtë dhe veglat e punës nuk ishin të kushtueshme. Andaj është konstatuar se "përhapja e tregtisë antike në trojet barbare krijon më në fund në ato troje po ato kushte të prodhimit si dhe në metropole."³⁶

³⁶ Mandel, E. (1970) p. 90.

Nga studiues të ndryshëm është dëshmuar që më herët se numri i madh i artikujve luksoz të importit në shoqëritë parahistorike është shprehje e diferencimit brenda shoqërisë dhe e krijimit të aristokracisë fisnore. Prodhimet e mëtejme vendore në suazat e ekonomisë së thjeshtë antike shprehin dhe nevojat e zgjeruara të një shtrese më të gjerë shoqërore, pos asaj të aristokracisë fisnore, që vlen edhe për prodhimtarinë poçare dardane.

Prodhimtaria poçare dardane është e redukuar në krahasim me modelet burimore helene, në trajta dhe në motivet e pikturuara, por paraqitja e saj, krahas importit të zvogëluar, flet për dukjen e zejtarëve të rinj në këtë periudhë e që ishin poçarët e kualifikuar.

Prezenca e poçarëve dhe e zejtarëve të tjerë ndërlihet me krijimin e qendrave tregtare paraqytetare, të cilat ishin parakusht i rëndësishëm për krijimin e mëvonshëm të qendrave urbane. Kështu, periudha e shek. VI-IV p.K. është kohë kur vendbanimet kodrinore të fazave paraprake shndërrohen në qendra paraurbane dardane. Këto qendra vazhduan të jenë të fortifikuara dhe me arkopol, por vendbanimi shtrihej dhe jashtë ledheve rrethuese. Dukuria është e lidhur ngusht me zhvillimin e zejtarisë dhe të tregtisë dhe me nismën e shthurjes së organizimit fisnor. Kjo nënkupton integrimin e fiseve homogjene dhe krijimin e lidhjeve heterogjene të bashkësive territoriale (civitas). Bashkësitë territoriale edhe gjetiu zinin sipërfaqe prej rreth 10 km dhe kishin qendrën e tyre: *castellum* / *poleis* i vogël.³⁷

Arkitektura dardane e kësaj faze përbëhet nga shtëpitë me themele katërkëndëshe, të ndërtuara me gurë. Themelet e shtëpive gjenden në akropole të gradinave (Gadime e Epërme) dhe rrëzë kodrave jashtë tyre (Veletin, Hisar, Teneshdoll). Te vendbanimi i Veletinit janë zbuluar edhe tulla në trajtë elipsoide, të përbëra nga përzierja e baltës dhe e kashtës. Janë gjetur dhe bazat e shtyllave të drurit të krijuara nga gurë të vendosur me kujdes, si një element më i avansuar arkitektonik (Gadime e Epërme, Bellaçec).

Në Gradinën e Gadimes së Epërme është konstatuar dhe rrafshimi masiv i Tarracës II, si një ndërmarrje që ka kërkuar punë të mundimshme dhe numër të madh të punëtorëve. Ndërmarrja e tillë tregon se ka ekzistuar një qendër e vendosjes dhe diferencim brenda shoqërisë (urdhërdhënës, organizatorë, punëtorë), gjë që dëshmon organizim më të lartë shoqëror.

Diferencimin shoqëror të dardanëve gjatë shek. VI-IV p.K. e dëshmon edhe qarkullimi i monedhave. Monedhat më të hershme të

³⁷ Suić, M. (1976) p. 360; Vasić, R. (1987) p. 684.

zbuluara në Kosovë janë monedhat e Tasosit të shek. V-IV p.K. dhe këto dëshmojnë lidhjet e dardaneve me Halkidikun dhe me rrethin jonik.³⁸ Gjatë shek. IV p.K. e më pas paraqiten monedhat e Tebës (400-390 p.K.),³⁹ të Damastionit, të Histrisë (viti 350 p.K.) dhe të Apollonisë së Trakisë.⁴⁰ Monedhat e Dyrrahut e të Apollonisë dominojnë nga shek. III p.K., gjë që shpreh kontaktet më të ngushta të Dardanisë me kolonitë e Adriatikut dhe me trojet ilire. Ekonomia monetare po aq provon zhvillimin urban dardan nga ekonomia jomonetare paraprake para shek. V p.K..

Mbështetur në faktet e parashtruara mund të përfundohet se gjatë shek. VI-IV p.K. u krijuan bazat për zhvillimin urban në fazat vijuese të shoqërisë dardane. Përderisa zhvillimi paraurban dardan në Kosovë dëshmohet përmes rezultateve arkeologjike, për zhvillimin urban nuk mund të flitet nga aspekti arkeologjik. Më parë ekzistonte mendimi i gabuar se dardanët e njohën qarkun e poçarit përmes keltëve nga shek. IV p.K. dhe jo përmes helenëve nga shek. VI p.K., që si rrjedhojë kishte konkludimet se vendbanimet kodrinore kanë qenë të banuara deri në kohën e pushtimeve të Perandorisë Romake të shek. I. Këto qasje, të kuptueshme për kohën kur ende nuk kishte hulumtime të mjaftueshme arkeologjike, vazhduan nga disa arkeologë serbë, të cilët nuk përmendin faktin se jeta në vendbanimet kodrinore u shua rreth mesit të shek. IV p.K..⁴¹

Rivlerësimi i materialit arkeologjik të hulumtuar në vendbanimet kodrinore dëshmoi se ky material i takon shek. VI-IV p.K. dhe jo periudhës helenistike (shek. IV – I p.K.).⁴² Këtë e dëshmon dhe mungesa e objekteve të periudhës helenistike në shtresat e këtyre vendbanimeve kodrinore, të cilat kryesisht nuk u banuan pas shek. IV p.K.. Fenomeni i ngjashëm i ndërprerjes së jetës gjatë shek. IV-III p.K. është konstatuar edhe në vendbanimet kodrinore të rrethit të Shkupit, si janë Nerezi, Varvara, Studençani apo Kalaja e Shkupit.⁴³

Mungesë për përfundime në aspektin arkeologjik rreth zhvillimeve gjatë shek. IV - I p.K. është fakti se deri me sot nuk u zbulua asnjë lokalitet, vendbanim apo nekropol, që i përket kësaj periudhe. Sipas të

³⁸ Të dhëna nga F. Peja, ish kustos në Muzeun e Kosovës.

³⁹ Jenkins, G. (1972) p. 84, Fot. 170-171.

⁴⁰ Kraljević, G. (1979) p. 8.

⁴¹ Tasić, N. (1998) pp. 147-225; Petrović, V.P. (2007) p. 16. Disa autorë është dashur t'i kenë parasysh të dhënat e doktoraturës së mbrojtur në Universitetin e Beogradit: Shukriu, E. (1991) Helenizovana keramika starijeg gvozdenog doba u SAP Kosova, Filozofski Fakultet, Beograd; Shukriu, E. (1996).

⁴² Shukriu, E. (1996).

⁴³ Mikulčić, I. (1982) p. 31.

dhënave të E. Čerškov, në vitin 1947 janë zbuluar te Artana - Novobërda "varre të shumta, në të cilat, si thuhet, janë zbuluar terrakota, qeramikë greke dhe enë metalike, që janë zhdukur".⁴⁴ Këto të dhëna, bashkë me objektet e zbuluara në tumat e Romajës të shek. III-II p.K. janë ndër të vetmet dëshmi për këtë periudhë të rëndësishme për historinë dardane.

Ndonëse lokalitetet e fazës urbane dardane nuk janë dëshmuar ende në aspektin arkeologjik, dëshmi për ekzistimin e fazës urbane, rrjedhimisht të qyteteve dardane, gjenden në burimet e shkruara të autorëve antikë. Përmendja e Strabonit të termit "qyteti i vjetër": *πολις αρχαία* (Strab.VII 5 12) tregon se pos tij ka pasur dhe qytete të tjera, madje dhe të reja.

Livi, autori tjetër antik, përmend qytetet dardane, duke i shënuar si "urbs" dhe i njëjti shënon dhe qytetin dardan Sintia (Liv. XLI 19, 7; XLI 19, 9). Në favor të urbanizimit dardan flet dhe ekzistimi i Damastionit, i cili farkonte monedhat e veta që në shek. IV p.K. dhe i cili, nëse nuk gjendej në Dardani, ka qenë jo shumë larg saj.

Si *argumentum ex silentio* për fazën urbane dardane nxirret përfundimi se pas mesit të shek. IV p.K. qendrat urbane u ngrehën në hapësira të rrafshita. Në këtë përfundim sjell zhvillimi paraurban dardan i shek. VI-IV p.K., shtrirja e vendbanimeve të kësaj faze edhe në rrëzët e kodrave e në drejtim të rrafshit. Përfundimi mbështetet dhe në faktin se ka mungesë të plotë të objekteve tipike helenistike në vendbanimet paraqytetare, siç janë urgentariumet, enët e Megarës, Gnatia apo ato me trajta të tjera helenistike.

Vendosja e vendbanimeve në rrafsh lidhet me zhvillimin e marrëdhënieve të reja shoqërore dhe ekonomike, si dhe me sigurinë e shoqërisë dardane, të cilën e ndjenin pas fuqizimit ushtarak dhe krijimit të shtetit. Për këtë duhet pasur parasysh fakti se dardanët ishin forca më e madhe politike në pjesën qendrore të Europës Juglindore, sidomos nga mesi i shek. III p.K..

Dukuri e ngjashme e sigurisë është konstatuar dhe pas instalimit të Perandorisë Romake, kur shumica e vendbanimeve kryesore dhe lokale janë vendosur në rrafsh dhe pranë rrugëve, siç ka ngjarë dhe në hapësira të ndryshme dhe në kohë të pastajme. Andaj është çështje kohe e rastësie zbulimi i qendrave urbane dardane, si dhe i vendvarrimeve, të cilat, si edhe në territoret fqinje, ishin nekropole të dysta. Indikacione në këtë drejtim sjell lotorja e zbuluar në Vojnovc (Zotaj) të Ferizajt (Foto 15a) apo gjetjet nga Gjincoci, që duket të jenë lokalitete rrafshinore të periudhës helenistike.

⁴⁴ Čerškov, E. (1969) pp. 79-80, note 28.

Kërkimet e deritashme arkeologjike janë përqendruar në shtresat kulturore brenda vendbanimeve e mureve rrethuese, gjë që nuk ka mundësuar krijimin e një pasqyre të plotë të strukturës së përgjithshme arkitekturore të vendbanimeve kodrinore. Andaj kërkimet e mëtejme të fazës paraqytetare dardane duhet të orientohen në këtë drejtim, që nënkupton përfshirjen edhe të hapësirave jashtë mureve rrethuese dhe në afërsi të rrëzëve të kodrës. Rasti i gërmimeve në Veletin e sugjeron këtë, pasi që në rrëzët jugor të kodrës janë zbuluar themele të shtëpive të shek. VI -IV p.K..

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet dhe çdo gjetjeje të rastit të objekteve të periudhës helenistike, pasi që mund të shpiejnë në zbulimin e vendbanimeve dhe të nekropoleve të periudhës helenistike, përkatësisht të fazës qytetare - fazës dardane helenistike. Zbulimi i lokaliteteve të periudhës helenistike në Kosovë, si dhe në trojet e tjera dardane të shek. IV-I p.K. ka rëndësi të posaçme për njohjen e historisë dhe të kulturës dardane dhe të rajonit.

Rezultatet e reja shkencore dëshmojnë se dardanët ishin në kontakt intensiv me botën mesdhetare në fazën paraqytetare dhe se falë zhvillimit të brendshëm dhe teknikës së thjeshtë prodhuese antike, sidomos të qeramikës, kishin mundësi t'i përvetësonin arritjet e botës antike dhe t'i zhvillonin ato në frymë vetanake. Në këtë drejtim dardanët u përfshinë në rrjedhat e përgjithshme të zhvillimeve antike dhe, si ilirët e jugut të shek. V p.K., të hyjnë në antikë në shek. IV p.K..



Foto 16 Veletini dhe Gradina - Kalaja e Zatriqit



Foto 17 Kalaja e Korishës dhe Gradishta e Vlashnjës



Foto 18 Gradina - Kalaja e Llapushnikut

Summary

PREURBAN DARDANIAN PHASE IN KOSOVA

Ancient authors have proved the existence of the Dardanian Kingdom before the Roman conquest called their kings “basileos” and “rex”, as they called the kings of Macedonia and the others. The main issue to be raised is the following one: Did this kingdom reached the level of state or not?

Previous studies about this and the Dardanian in general derived based on fragmented written sources and the lack of archaeological knowledge. As a result, it was concluded earlier that:

1. Wheel made ceramic belongs to Hellenistic period and not earlier, as proved later [Shukriu, E. (1996) pp. 105-107],
2. Dardanian reached merely a level of high tribal organization,
3. Urban centers were not developed, and
4. Process of state-forming was interrupted by Roman conquest [Papazoglu, F. (1988) pp. 161-162].

Archaeological researches brought new conclusions, especially based on the ceramics treated in this study, which continues to be a sure indicator of local production and traditions. They prove processes which preceded the creation of Dardanian political organization thanks to the pre-urban development as well as the inclusion of Dardanians in general developments and influences from the Mediterranean world.

Life and growth of Dardanian settlements follow the processes developed in other areas, from prehistoric pre-urban settlements to urban ones (Photo 1). Based on archaeological resources, the Dardanian development is seen through the following phases:

I	Bronze Age	Pre-Dardanian Phase
II	XII - IX B.C.	Proto-Dardanian Phase
III	VIII – mid. IV B.C. (a, b, c)	Dardanian Phase
IV	Mid. IV - I B.C.	Dardanian Hellenistic Phase

I Pre-Dardanian Phase (Bronze Age) presents the initial phase of creation and consolidation of the Dardanian tribes. It seems that in this phase, the plain and hilly settlements existed/were in place, as the new discoveries show (Hisar of Suhareka, Vlashnja, Korisha, Harilac) and tumulus necropolises (Përçeta / Përçeva, Ujz, Gllareva etc.). Late Bronze Age is more complex being represented by Lushta, Glladnica, Korisha III, Vlashnja IVc [Katalog (2013) p. 100], and Bardhi i Madh / Bellacec [Mehmetaj, H. (2014) pp. 38-39, 41-43].

In this phase, new ceramic forms appeared like dishes with inflated and inward turned lip, sometime as turban-dished, which became characteristic of Dardanian phase (Phase II). Forms of XII-XI centuries B.C. are linked to the Eastern part of modern-day Albania and group Mediana (Mediana II, III) [Garašanin, M. (1973) p. 312]. The currently available data prove that the Pre-Dardanian phase is mainly linked to the Illyrian Glasinac Bronze Age complex.

The relation with Troja Dardanians is an issue that is still being treated. The confusion created with regards to the directions of the Dardanian movements East–West or West–East can be explained by the movements in different times: Indo-European Eneolithic movements East–West, Achaean ones North–South of II millennia B.C., and Doric movements during and after the XII century B.C.

II Proto Dardanian Phase (XII-IX B.C.) is complex and it is linked to the Doric movements and Urnfield culture. Handmade ceramics has a hewed surface, gray baking and it is presented mainly by dishes with inward turned lip. They have sometime the decoration made by toothed instrument (Photo 2a, 3a), which became the distinguished ornament of the Dardanian pottery during the next phase.

III Dardanian Phase (VIII-IV B.C.) presents the phase when Dardanian appear with the formed culture, hill settlements with surrounding walls and tumulus necropolises (Gadime, Bardh i Madh/ Bellacec, Cernica, Duboc, Vlashnja, Hisar of Suhareka, Teneshdoll etc.). Its development is separated into three sub-phases.

Sub-phase III a (VIII-VII B.C.) is characterized by fine and rough ceramics. Fine ceramic, hewed and dark grey or lightly brown baked, is presented by the pots with inward turned lips, single-handled pots with outward turned lips, etc. (Photo 1a, 1b), usually decorated with toothed instrument. This decoration, being a Dardanian characteristic, is often combined with kannelures (Photo 2b, 3a, 3c, 4, 5). This kind of decoration appeared at the beginning of the Bronze Age in Slivensko-Ezero and second half of Bronze Age in Pernik, present-day Bulgaria.

Thracian influence is not noted much in Dardania, as the technique of incrustation dominated as decoration in ceramics during the Iron Age.

[Changova, J. (1983) p. 43, Photo 35 1-3, p. 46 ff.]. The rough ceramic has in general the relief track in the upper part, with finger or nail prints. At the second part of this sub-phase appears the import of transport amphora from Chios (Photo 12a).

Sub-phase III b (mid. VI-mid. V B.C.) features news form of life, by the expansion of settlements at foothills, and ceramic produced by pottery wheel. Handmade ceramic gets new forms. Among them are deep pots with handles starting from lip (Photo 5b). Quite distinguished are also the steep-lip pitchers decorated bytoothed instrument (Photo 4) [Shukriu, E. (1996) p. 32].

This sub-phase brought some valuable data on further Dardanian development, seen as a direct influence of the Hellenic world:

1. Pottery wheel ceramic, mainly following Hellenic models,
2. Paint ceramic in amphora and hydria (Photo 7),
3. Imported luxury items.

Main found imported luxury object are Attic black figure vessels, kylixes and skyphoses from Peja Spy (Photo 13a), amphora with archaic inscription from Upper Gadime (Photo 11a), which prove the intensified contacts with Hellenic world during the VI-V B.C. centuries, which is proved also by the Maenad of Prizren (Photo 13b).

Sub-phase III c (mid. V-IV B.C.) presents the continuation of dwelling on hill settlements, but also their gradual abandonment by the end of this sub-phase. The wheel done ocher backed ceramicdominates similarly to the previous one. During the end of the sub-phase, the models were taken from Attic black-glazed vessels. In mean time started to dominate gray backed ceramic, which proves the acceptance of advanced technology. Import is less present, but should be mentioned that there was the presence of the Saint Valentine group (Photo 11b).

IV Dardanian Hellenistic Phase (mid. IV-I B.C.) is not very well known due to the lack of Kosova archaeological data about four hundred years of Dardanian history. Only Megara ceramic and bronze pots from Romaja are known (Photo 14), than, lacrimarium from Zotaj (Vojnovc. Photo 15a), bronze goat figurine from Prizren (Photo 15b), machaira sword from Shiroka, and some late Laten fibulas.

In this phase, the coin circulation intensified as is proven by the coins from Damastion and a considerable amount of coins from Dyrachium and Adriatic Apollonia. This phase is associated with the urban development and the creation of the state, the time when Dardanians appear as the important political factor in the central part of the South-Eastern Europe.

*

Dardanian phase II is most investigated and it enables tracking of developments during VIII-IV centuries B.C. Since VI century B.C., significant changes occurred in social and economic life, bringing thus more advanced quality of life. Important indicators are ceramics with its polyvalent values: production techniques, different forms and functions, local spirit and the acceptance of the Hellenic models. Ceramics of this phase is composed by imported ceramic and local pottery, the last one done by pottery wheel and handmade.

By mid of phase II dominates wheel made ceramics, proving thus enhanced needs of the society. It is divided into table, kitchen, household and ceramic for transport (skyphoses, cups, kantharoses, bowls, hydrias, amphorae, kraters, etc.). The earliest import of this phase are transport amphora from Chios (Photo 12a), which were followed by those from Attica, Chalcidice and neighboring areas.

Trade routes and influences from Athena, Corinth or Chalcidice came through Vardar River, Pollog Valley as well as rivers Black Drin and White Drin, the last one mentioned less.

By the end of the VI century B.C. artisans appeared as a separated layer, deepening thus the social differentiation and proving the existence of the trade / pre-urban centers. These centers were a prerequisite for the subsequent establishment of urban centers. Even though the earliest urban centers are not discovered yet in Kosova, Strabo proves the development of urban phase mentioning old towns: *πολις αρχαία* (polis archaia) (Strabo VII 5 11). This testimony proves the existence of other towns, even including new ones too. Livy also did not hesitate to name Dardanian towns of Hellenistic period as “urbs” (Livy XLI 19, 7). Livy speaks also for Dardanian gold which comes from Dardania [Livy *Naturalis Historiae*, XXXIII xii 39: “...quod ex Dardanis venit - itaque et Dardanium vocabatur”].

Argumentum *ex silentio* therefore can be that urban centers have been developed in plane areas after the second half of IV century B.C. due to the established sense of security after the Dardanian military empowerment and creation of the state.

Finally, it can be concluded that the pre-urban Dardanians were in intensive contact with the Mediterranean world. Due to the inner development and simple antique technical production they accepted antique word achievements and developed them in own spirit. Being involved in antique flows, Dardanians entered the Antiquity from the IV century B.C. as the South Illyrians of the V century B.C. did.

Bibliografia / Bibliography

- Bürchner, C. (1901) Pauly-Wissova Realencyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft, Stuttgart.
- Ceka, N. (1985) "Kultura protoqytetare ilire", *Iliria* 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, ff. 111-150.
- Changova, Īordanka (1983) Pernik, Bŭlgarskata Akademija na Naukite, Sofija.
- Cohen, Ronald (1978) "State Origins: A Reappraisal". *The Eraly State* (By H. J. M. Claessen, Peter Skalník), Walter de Gruyter, pp. 31-76.
- Čerškov, Emil (1969) Rimljani na Kosovu i Metohiji, ADJ, Beograd.
- Jenkins, Keneth G. (1972) *Ancient Greek Coins*, Barrie & Jenkins, London.
- Katalog Arkeologjik i Kosovës (2013), MKRS, Prishtinë.
- Kraljević, Gojko (1979) "Antički novci nabavljeni u Janjevu za zbirku Zemaljskog Muzeja u Sarajevu", GMK XIV, Prishtina.
- Garašanin, Draga (1971) *Bronzano doba Srbije*, Narodni Muzej, Beograd.
- Garašanin, Milutin (1973) *Praistorija na tlu Srbije*, Srpska književna zadruga, Beograd.
- Georgiev, Z. (1984) "Elementi na ranata Antika vo Dolno Povardarie", *Godišen Zbornik* 11, Filozofski Fakultet na Universitetot vo Skopje, Skopje.
- Heurtley, W.A. (1939) *Prehistoric Macedonia*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Mandel, Ernest (1970) *Rasprava o marksističkoj ekonomiji*, Nakladnik, Sarajevo.
- Marić, Z. (1995) „Die hellenistische Stadt oberhalb Ošanići bei Stolac (Ostherzegowina)“, *Bericht der Römisch-Germanischen Kommission* 76, pp. 31-72.
- Mehmetaj, Haxhi (2014) "Kështjella dardane e Bardhit të Madh" GSAK 2000-2012, Prishtinë, ff. 35-56.
- Mikulčić, Ivan (1982) *Skopje so okolinite tvrdini*, Makedonska knjiga, Skopje.
- Papazoglu, Fanula (1988) "Ilirska i dardanska kraljevina", *Iliri i Albanci*, SANU, pp. 145-171.
- Papazoglu, Fanula (1967) "Politička organizacija ilira u vrijeme njihove samostalnosti", *CBI V / 2*, Sarajevo.

- Peja, Fatmir - Hajdari, Arben (2014) “Kalaja e Harilaqit - Vështrim i përgjithshëm arkeologjik”, GSAK 2000-2012, ASHAK, Prishtinë, ff. 35-56.
- Petrović, Vladimir P. (2007) Pre-Roman and Roman Dardania – Historical and Geographical Considerations, *Balcanica XXXVII*, Balkanološki Institut, Beograd, pp. 7-23.
- Prendi, Frano (1978) “Urbanizimi i Ilirisë së jugut”, Studime Ilire, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1996) Dardania paraurbane, Dukagjini, Pejë.
- Shukriu, Edi (1983) “Kultura materiale dardane në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë”, *Gjurmime Albanologjike XIII, IA*, Prishtinë.
- Stojić, Milorad (1986) “Gvozdeno doba u bazenu Velike Morave”, *Centar za Arheološka istraživanja 8*, Filozofski Fakultet, Beograd.
- Stojić, M. (1980) Stare kulture i narodi na tlu srednjeg Pomoravlja, Katalog, Svetozarevo.
- Suić Mate (1976) “Problemes de paleogenese et d'urbanisation des centres illyriens”, *Iliria IV*, Tirana.
- Tasić, Nikolla (1998) “Gvozdeno doba”, *Arheološko blago Kosova i Metohije*, Gallery of the Serbian Academy of Sciences and Arts, Belgrade, pp. 147-225.
- Thompson, Della, ed. (1995) "State": Concise Oxford English Dictionary (9th ed.), Oxford University Press, Oxford.
- Thrämer, Eduard (1901) *Paulys Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft anianos*, Band IV 2, Stuttgart.
- Vasić, Rastko (1987) “Centralnobalkanska regija” *PJZ V*, CBI, Sarajevo, pp. 571-736.
- Vasić, Rastko (1979) “Halštatske nekropole u dolini Vardara”, *Sahranjivanje kod Ilira*, SANU, Beograd.
- Vukmanović M.-Popović P. (1982) “Sondažna istraživanja gradinskih naselja na području Vranjskopreševske kotline”, *Godišnjak XX/18*, CBI, pp. 189-210.

KULTI I DIELLIT TE DARDANËT

Rëndësia e diellit për jetën e njeriut bëri që të përfytyrohen hyj diellor dhe të zhvillohen kulte të diellit në kohë dhe hapësira të ndryshme të rruzullit tokësor. Ndonëse ka mendime se njerëzimi nisi të spekulojë rreth natyrës së diellit nga epoka e paleolitit të mesëm dhe e mezolitit,¹ është e njohur se në epokën e neolitit u paraqit imazhi i tij, i cili përcillte dukjen fizike të diellit dhe pastaj dhe rrugëtimin e tij.

Në kohët historike zuri vend konceptualizimi i diellit, që shënon kalimin nga kulti animistik në atë antropomorf. Faza të ngjashme u zhvilluan dhe në territorin ku jetuan dardanët parahistorikë dhe historikë, andaj përmes kësaj trajtесе mëtohet që të ofrohen disa të dhëna për studime të mëtejme.

Në kuadër të adhurimit të diellit kulti i tij e arriti dhe shkallën e heliocentrizmit në epokën e bronzit në Europë, por modeli astronomik, sipas të cilit toka sillet rreth diellit, u propozua në shek. III p.K. nga Aristarhu i Samosit dhe u ripërtëri tek në shek. XVI nga Nikola Koperniku, i cili solli modelin gjeometrik matematikor të sistemit heliocentrik.²

Diellit, i cili duket si hy te shumë popuj, i jepeshin funksione të llojllojshme. U pa mbarsës dhe jetëdhënës, për t'u parë më pas si hierofant iniciacistik, psikopomp (drejtues i shpirtit) e deri te vetëdija kozmike. Mendohet se ndriçimi i tij shprehte dhe intelektin e njohurive.³ U pa herët dhe me rol dualistik, si mbrojtës i të gjallëve, por edhe i të vdekurve. Simbolet më të shpeshta të diellit janë paraqitur rrethi, disku, kryqi, shenja X, romboidet apo kryqi i thyer (svastika).⁴ Rrethi dhe disku bëhej më i dukshëm kur shoqërohej edhe me rrezet e diellit.⁵

Paraqitjet e skematizuara të diellit u shpeshtuan nga fillimi i kohës së metaleve dhe gjatë epokës së bronzit në Europë dominoi heliolatria (adhurim i diellit). Në këtë periudhë u krijua dhe miti mbi Qerren Diellorë dhe Hyjin Diellor, të personifikuar në terrakota ose metal, si figura të veçanta apo të vendosura në qerre dhe të drejtuara nga shpezët ose shtazët (Foto 1).

¹ Campbell, J. (1969) p. 343.

² Dreyer, J. L. E. (1906) pp. 134-135.

³ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 656.

⁴ Në Eddat nordike dielli quhet si "disk i ndriçuar": Stipçeviq, A. (1983) f. 17.

⁵ Cirlot, J. (1971) p. 47.

Në Europën Juglindore kulti i diellit u manifestua sidomos në kulturën e Vuçedollit,⁶ ndërsa ekzemplari më i njohur është “Qerrja e Dupljajës”, e cila i takon epokës së bronzit të mesëm.⁷ Mendohet se në Europën e epokës së bronzit qerret nuk kanë shërbyer aq shumë për transport sa në ceremoniale dhe varrime. Gjatë shek. XIII-XII p.K. në kulturën e fushave me urna (Urnfield Culture) të vdekurit madje janë djegur me karrocet e tyre, ndërsa nga shek. VII p.K. janë varrosur me qerre.⁸ Nekropoli i Sindosit, me objekte të pasura prej ari, përfshirë dhe maskat dhe përkrenaret ilire, janë shembulli më i mirë për këtë.⁹

Refleksion i kultit të diellit është plastika e imët e epokës së hekurit, me paraqitjen e diskut diellor, të objekteve në trajtë kryqi apo të shpezëve. Objektet u vendosën në varre dhe funksioni i tyre ishte që ta ndihmonin shpirtin e të vdekurit në udhëtimin në botën e përtejme.

Zhvillimi dhe kompleksiteti i kultit të diellit në përgjithësi bënë që trajtimi i tij në suazat dardane të duket jo aq i lehtë, aq më tepër kur kulti nënkupton dhe tërësinë e riteve përcjellëse, të lutjeve dhe të flijimeve. Trajtimi i prezencës së kultit të diellit te dardanët e bënë të domosdoshme që të kihet parasysh se:

1. kulti ka karakter universal,
2. kulti evoluoi nga dardanët e parahistorisë deri te të antikës,
3. specifikat e shprehjes së kultit nuk përcaktohen lehtë,
4. mungojnë burimet e shkruara.

Studimi i kultit të diellit te dardanët mundësohet vetëm përmes shfaqjes së simboleve të diellit në kuadër të kulturës materiale. Burimet e shkruara antike nuk bëjnë fare fjalë për besimin dardan, madje as për Hyjneshën Dardane dhe Hyun Andin, që të dy të njohur më vonë nga monumentet epigrafike. Ndër të dhënat e rralla që lidhen me kulturën shpirtërore të autorëve antikë është përcjellë “larja e dardanëve tri herë në jetë”, e shënuar me kuptim negativ nga Nicolaus Damascenus (Fragmenta, 145 2). Studiuesit e mëvonshëm këtë e panë si larje rituale, si ngjan me shumë tradita të tjera, me rastin e lindjes, martesës dhe vdekjes. Në mungesë të të dhënave të shkruara antike, do të merren në konsideratë të dhënat të cilat flasin për kultin e diellit në fqinjësinë e territorit dardan.

⁶ Stipčević, A. (1981) p. 158; Tasić, N. - Dimitrijević, S. - Jović, B. (1979) p. 458.

⁷ Čović, B. (1983) p. 820; Garašanin, M. (1983) p. 798, T. LXXXIII 1.

⁸ Pare, C. (1989) pp. 80-100.

⁹ Sindos (1985). Shih punimin: Përkrenarja e Denjit dhe zhvillimi i përkrenareve ilire.

Përmes studimeve arkeologjike u konstatua se nga shek. VIII p.K. dardanët zhvilluan një kulturë me tipare të formuara, me baza në fazat paradardane të epokës së bronzit, të cilat kulturi diellit zinte vend të veçantë. Gjurmë të hershme të kultit të diellit gjenden në monumentet e kulturës së Vinçës, me varëse të qafores me simbol rrethor të diellit. I tillë gjendet në figurën e “Hyjneshës në fron” (Foto 2 1), në terrakotat të ulura nga Bardhoshi, si dhe të tjerave të ngjashme.¹⁰ Këtij grupi mund t’i takojë dhe figura e hyjit nga Poneshi, e cila në gjoks e ka të gdhendur diellin me gjashtë rrema. Me këtë simbol, si dhe me gojën e hapur, figura përmban elemente të rëndësishme, por edhe të panjohura, nëse dëshmohet autenticiteti i saj (Foto 2 2). Ndonëse jo identike, figura mbase mund të krahasohet me figurën e Rocher des Doms (Avignon), të kapërcyellit të epokës së eneolitit në të bronzit. Enë e kultit të diellit shihet dhe pjata e sheshtë e epokës së neolitit të vonë nga Gradishta e Vlashnjës dhe¹¹ tasi me katër këmbë të brimuarë i epokës eneolitike nga Hisari (Foto 3).¹²

Të dhënat për prezencën e kultit të diellit gjenden më së shumti në varrezat tumulare dardane, ku kujdesi ndaj të vdekurve përcillet me qartësi arkeologjike, pikësëpari përmes tumave të shumta e formave të varrimit, bashkë me objektet e vendosura në varre.

Tumat janë dhe shprehje e botës shpirtërore, e cila me vështirësi i nënshtrohet ndikimeve dhe ndryshimeve. Këto janë evidentuar në Kosovë që nga epoka e bronzit, mbase dhe pak më herët (Ujzë, Rogovë, Përçevë), në epokën e hekurit (Romajë, Dibiçak, Rogovë, Ujzë, Banjë e Pejës Përçetë/Përçevë, Neprebishtë, Llashticë Moglicë, Kërlicë etj.). Ndonëse më rrallë, varrimi në tuma u evidentua edhe gjatë periudhës së sundimit romak, si refleksion i traditave të mëhershme (“Ara e Çerkezit” dhe “Cernica” te Ulpiana, “Fusha e Madhe” te Komorani).

Trajta gjysmësferike e tumave dhe unazat rreth tyre janë indikacione për lidhmërinë me kultin e diellit, ku varri qendror, arsyeja e ngrehjes së tumës, i përket personit më të respektuar të komunitetit. Varret e individëve të tjerë, të kohës apo të mëvonshëm, janë vendosur rreth varrit qendror dhe në brendi të unazës rrethore. Unaza rrethore e tumës është ndërtuar prej gurëve të lumenjve, të cilët janë bartur dhe nga largësitë më të mëdha, në raste kur nuk gjendeshin në afërsi, për shkak të trajtave të rumbullakuara nga rrjedha e ujit (Foto 4).

Gurët e rumbullakësuar, bashkë me ujin, simbolizonin jetën dhe të vendosur në tuma lidhen me mëtimet për ta ndihmuar arritjen në përjetësi.

¹⁰ Katalog (2013) Fot. 37, 38, 44.

¹¹ Katalog (2005) f. 54, Fot. 57.

¹² Katalog (2005) f. 83, Fot. 99.



a



b

Foto 1 a. Qerrja e Duplajës (Garašanin 1983);

b. Qerrja e Trundholm-it (Denmarke Nationalmuseet)

Një numër i madh i unazave rrethore, por edhe i tumave të vendosura në toka pjellore, janë dëmtuar me përdorimin teknologjisë së re. Kështu, në Tumën e Luftëtarëve të Romajës është ruajtur mjaft, pasi që banorët ruajtën traditën për mikropotezin “Sakra” si vend të shenjtë (lat. sacrum). Në tumat e Porodimes është ruajtur në tërësi unaza rrethore vetëm në tumën IV,¹³ përderisa në tumën II të Shirokës është ruajtur vetëm një pjesë e konstruksionit të unazës rrethore dhe në të tjerat jo,¹⁴ ngjashëm me tumat e hulumtuara më pas.

Në kuadër të objekteve të vendosura në varre veçohet plastika e imët e epokës së hekurit, me paraqitjet e diskut diellor, të disqeve solare (pjesë të qerres diellore) apo të shpezëve, të cilat shihen si simbole të diellit.




Foto 2 a. Hyjnesha në fron (Muzeu i Kosovës);
b. Hyu gojëhapur, Ponesh (Muzeu i Gjilanit)

¹³ Hulumtimet e E. Shukriu në Porodime afër Shtimes në vitin 1975. Konstruksionet ishin dëmtuar gjatë lërimit të tokës.

¹⁴ Slavković-Djurić, N. (1965) p. 538.



Foto 3 a. Ena neolitike nga Vlashnja; b. Tas eneolitik nga Hisari (Suharekë) (Muzeu i Kosovës)




Foto 4 Tumat e gërmuara dhe unazat rrethore



Foto 5 Disku diellor, Shirokë: Tuma 2, varri 3 (Muzeu i Kosovës)




Foto 6 Disqet diellore: a. Brazda, varr i shek. VII-VI (Mikulčić 1982);
b. Vertishta (Vasić 1987); c. Maqedonci (Vasić 1981)



Foto 7 a. Varëse dhe aplikacion me simbol dielli - Grupi Dolenjska (Gabrovec 1983); b. Aplikacione, Grupi Glasinac (Čović 1987).

Një varg i objekteve të tjera të zbuluara në varre, vend ky ku kultura shpirtërore manifestohet me simbolizmin që e sjellin, dëshmojnë mjaft qartë për prezencën e kultit të diellit edhe në trojet dardane. Si simbole të drejtpëdrejta të kultit të diellit veçohen pllakëzat në trajtë disku apo disqet diellore, të cilat janë vendosur në varret e epokës së hekurit. Të lakuara pak nga brenda këto përshkohen në mes nga një rreth i relievuar, brenda të cilit gjendet kryqi, me gjysmësferë të theksuar në qendër. Jashtë rrethit të relievuar gjenden dhe ornamente të gërrisura në trajtë të rrezeve të diellit. Ekzemplarët janë punuar nga bronzi, me diametër prej 2.5 - 5.8 cm. Duket se numri më i madh i tyre prej 9 ekzemplarësh është zbuluar në tumat I dhe II të Shirokës (shek. VIII - VII p.K. Foto 5).¹⁵

Të tilla disqe ishin të pranishme dhe në varret e tumave të Përçetës / Përçevës dhe në tumën 1 të Llashticës,¹⁶ në Bergallë e në varrin e shek. VII-VI të Brazdës në rrethin e Shkupit (Foto 6 1).¹⁷ Të tilla janë gjetur dhe në Vranjë dhe në lokalitetin Maqedonci të Serbisë Jugore, ku janë shprehje e kultit postdiellor.¹⁸ Këto janë konstatuar dhe në Vertishtë të grupit kulturor të Zllotit të Serbisë Lindore (Foto 6 2).¹⁹ Disku diellor nga thesari i Maqedoncit duket më i përparuar nga ekzemplarët e tjerë (Foto 6 3) dhe më pak se ai i kompozicionit qendror të labirintit dardan nga monumenti epigrafik i Hyjneshës Dardane nga Smira.

Numër i madh i disqeve është gjetur në kulturën e Gllasinacit, sidomos nga faza II e epokës së hekurit (shek. X - VIII p.K.), në nekroplet në Taline, Brezje, Vërlazija apo Planj, në të cilat kanë zbulurime të pasura të rrathëve të bërë nga trekëndësha të shrafiuar, me pjesë të theksuar qendrore. Ekzemplari nga Taline përmban dhe simbolin e diellit me rreze (Taline).²⁰

Funksioni i disqeve të vendosura në varre nuk ishte i qartë deri vonë, aq më tepër se janë gjetur dhe ekzemplarë që mbi apo nën kanë elemente të tjera, për dallim nga ekzemplarët për të cilët diskutohet. Kështu, disa kanë rreth të vogël mbi, që e bën të qartë se kanë shërbyer si varëse dhe te disa elementi kapës është vendosur prapa, duke i bërë këto aplikacione për mburoja e objekte të tjera, gjithnjë në funksion të mbrojtjes solare (Foto 7).²¹ Madje, S. Gabrovec i sheh vetëm si pajisje kuajsh të tipit trako-kimer,²² si i kanë parë dhe studiuesit e mëhershëm.

¹⁵ Slavković-Djurić, N. (1968) pp. 539, 544, T. II 8; T. III 1, 2.

¹⁶ Luci, K. - Islami, S. (2014) ff. 58-77, Tab. I 6.

¹⁷ Kilian, K. (1975) p. 95, T. 58, 59; Mikulčić, I. (1982) p. 24, Fot. 6.

¹⁸ Vasić, N. (1981) p. 684, T. LXX, 10.

¹⁹ Vasić, R. (1987) pp. 651-672, Fot. 37 10.

²⁰ Benac, A. - Čović, B. (1957) p. 33; Benac, A. (2012) p. 39.

²¹ Čović, B. (1987) T. LXI 7-9.

²² Gabrovec, S. (1987) p. 25-232, T II 5, T. VIII 3.

Disqet, për shkak të katër vrimave në mes, u quajtën gabimisht “pulla”, ndonëse pullat nuk ishin në funksion të veshjeve të atëhershme. Kështu, N. Slavković-Gjuriq i konsideroi pulla në trajtë kallote,²³ konstatim ky që shtron çështjen e arsyes së vendosjes në varre dhe të funksionit të tyre. U quajtën dhe “pllakëza rrethore”,²⁴ ndërsa në literaturën e re të Kosovës i ndryshoi emri nga “pulla” në “kopsa”.²⁵ Numër i madh i tyre është zbuluar dhe në territorin kelt dhe M. Green i quan “rrota”, duke theksuar se të gjithë perënditë diellorë keltë zakonisht mbanin talismane solare, në trajtë rrote apo trajtash të tjera (diam. 2 - 4cm).²⁶

Analiza e disqeve me ornamente diellore të Shirokës, Brazdës, Banjës së Kumanovës, Radanjës te Shtipi, Vranjës dhe Maqedoncit, të cilat nuk kanë elemente që i përcaktojnë si varëse apo aplikacione sollën në përfundim se të tilla janë krijuar dhe vendosur në varre vetëm në territorin dardan. Është kjo arsye që ta sjell përfundimin se disqet e tilla duhet të konsiderohen si veçori dardane, të cilat dëshmojnë njëkohësisht praktikimin e fuqishëm dardan të kultit të diellit dhe mund të quhen disqe dardane. Se mund të konsiderohen karakteristike për territorin dardan e ka pohuar kohë më parë dhe R. Vasiq, por pa cekur se është fjala për dardanët.²⁷ Disqe prej argjendi, por pa ornamentime, janë gjetur dhe në tumën princore të Banjës së Pejës, që mbase kanë pasur të njëjtin funksion, por me interes janë dhe disqet e ngjashme prej bronzi të zbuluara në vendbanimin e Bardhit të Madh - Bellaçecit dhe sidomos disqet që janë identike me trajtën e rrotës së qerres, të datuara në shek. VI–V p.K. dhe që paraqiten si të tilla për herë të parë në territorin dardan.²⁸ Funksioni i disqeve dardane të gjetura në varre duket mjaft i qartë, por edhe gjetja e tyre në një vendbanim lidhet me adhurimin e diellit në jetën e zakonshme.

Funksioni i vërtetë i disqeve del sheshit kur kihen parasysh rrezet e dukshme të diellit në shembujt nga tuma e Shirokës, të punuara me shumë kujdes dhe të gërricura në trajtë trekëndëshi të zgjatur në kornizat e gjera. Si të tilla ato e simbolizojnë diellin, ndërsa përmes kryqit prezantohet rrugëtimi i tij.

Vendosja e disqeve në varre si objekte të veçanta shpjegohet si ndihmesë apo pagesë për shpirtin e të vdekurit në udhëtimin e tij në botën e

²³ Slavković-Djurić, N. (1965) pp. 583-539.

²⁴ Vasić, R. (1987) p. 679, Fot. 38 17, T. LXX.

²⁵ Katalog (2013) f. 145.

²⁶ Green, M. (1981), p. 104; Green, M. (1984).

²⁷ Vasić, R. (1987) p. 679, Fot. 38 17, T. LXX.

²⁸ Mehmetaj, H. (2014), f. 54, Tab. VII 7.

amshueshme²⁹ dhe dëshmojnë dhe për konceptin e zhvilluar edhe te dardanët parahistorikë mbi jetën e tejbotshme. Këto dallojnë nga objektet e tjera të vendosura në varre e që kishin funksione dhe në jetën e përditshme, siç ishin enët, armët e stolitë. Ndonëse edhe M. Green këto objekte i quajti “irrotë”, i sheh si simbole të diellit, përkatësisht të hyut të diellit, që mori trajtë antropomorfe në epokën e vonë të hekurit dhe në epokën kelto-romake.³⁰ I njëjti proces u zhvillua dhe te dardanët, kur hyu i diellit mori trajtë antropomorfe dhe u personifikua përmes Hyjneshës Dardane, për ç’gjë do të flitet më tej.

Objekt solar konsiderohet dhe kryqi me tre rema (triquetrum),³¹ andaj zgjon vëmendje objekti në trajtë kryqi nga tuma e Shirokës, i cili u pa si varëse,³² ndonëse objekti nuk ka vrimë apo ndonjë element tjetër që mund ta klasifikonte si të tillë. Është kjo arsye pse mendoj se edhe me këtë rast është fjala për simbolin e drejtpërdrejtë të diellit, si në rastin e disqeve solare të diskutuara më lart. Po nga Shiroka është dhe ekzemplari i varësës në trajtë kryqi me maja të trashëzuara të rremave dhe me mes të theksuar të kryqit.³³

Prezencën e mëhershme të kultit të diellit nga epoka e eneolitit e dëshmon edhe dukja e svastikës në Hisar të Suharekës,³⁴ në afërsi të tumave të epokës së hekurit të Shirokës dhe të Dibiçakut. Trajtë kryqi triquetrum ka edhe objekti nga varri i Brazdës pranë Shkupit,³⁵ si dhe ai i periudhës romake nga varri nr. 6 i Nekropolit Verior të Ulpianës (3 x 3 cm), që duket e mban të njëjtën simbolikë si ato të epokës së hekurit.

Karakterin solar duhet parë edhe në motivet e rrathëve koncentrikë që duken në bylyzykët e deposë së Janjevës (shek. VIII p.K.), shpesh të kombinuar me shenjën X, simbol i diellit.³⁶ Motive të ngjashme ndeshen edhe në bylyzykët e argjendit nga Banja e Pejës (shek. VI p.K.), si dhe të kryqit të thyer (svastika). Svastika paraqitet si simbol i hershëm parahistorik te shumë popuj dhe këto gjenden dhe në shumë objekte ilire, sidomos në reliktet e shek. VI-V p.K., përfshirë dhe ato të tumës së Atenicës te Çaçaku dhe të Kishës së Shën Pjetrit në Pazarin e Ri (Novi Pazar. Foto 81).³⁷

²⁹ Mjete të tilla pagese janë dëshmuar dhe në varret e zbuluara në Slloveni, Gjermani, Francë, varret etrure të shek. VIII-VII p.K.: Joseph Dechelette, J. (1927) pp. 287-292.

³⁰ Green, M. (1989) p. 116.

³¹ Shih: Stipčević, A. (1983) f. 18.

³² Slavković-Djurić, N. (1968) T. II 5.

³³ Slavković-Djurić, N. (1965) T. II 6.

³⁴ Todorović, J. (1968) T. II 12.

³⁵ Mikulčić, I. (1982) p. 24, Fot. 6.

³⁶ Galović, R. (1960) pp. 256-266, T. I 1-4, T. II 5, 6.

³⁷ Djuknić, M. - Jovanović, B. (1965) pp. 8, 13, 24, T. IX, Fot. 2; T. XV, Fot. 2; Vasić, R. (1987) pp. 646-560, T. LIX 14, 15.

Svastika (kryqi i thyer) gjendet në kompozicionin e labirintit rrethor të hyjneshës nga Smira, ku janë paraqitur gjashtë (6) svastika, tri prej tyre me drejtim lindje–perëndim dhe tri të tjera me drejtim të kundërt perëndim–lindje (Foto 13). Këto janë trajtësuar përmes kombinimit të harqeve të labirintit.

Të njëjtin karakter ka dhe skeptri (?) me dy shpezë të vendosur në pozitë heraldike nga tuma II e Llashticës,³⁸ kur kihet parasysh roli i shpezëve moçalikë në kultin e diellit.³⁹ Në mesin e objekteve me shpezë vlerë të veçantë ka Qerrja e Kultit të Diellit nga Gllasinaci (mesi ose fundi i shek. VII. Foto 8 2).⁴⁰

Simbole të diellit janë dhe sëpatat dytehëshe (labriset), të cilat janë vendosur në varre tumulare, siç janë dy sëpatat e vendosura në varret 1 dhe 17 të Tumës së Luftëtarëve në Romajë (Foto 9) Disa prej tyre kanë shërbyer edhe si varrëse, me funksion apotropeik, si është varësja nga Gradina e Gadimes së Epërme.⁴¹ Sëpata dytehëshe ishte dhe simbol përcjellës i Hyjneshës Dardane në shtatoren e Medianës, të krijuar rreth vitit 320.⁴²

Sëpatat dytehëshe janë mjaft të shpeshta në epokën e bronzit në territorin ilir, sidomos të bronzit të mesëm. Si varëse është gjetur në varr femre të epokës së hekurit në Slloveni (Foto 10 4),⁴³ ndërsa nga Ballkani Qendror të veçantë janë tre ekzemplarët nga tuma e supozuar e Vojnikut të Kumanova, e epokës së hekurit I.⁴⁴ Këto janë zbukuruar në skaje me vija të pandërprera, të plotësuar me incizime vijash të shkurta (Foto 10 1), të cilat përkujtojnë zbukurimet me rrotëz të qeramikës paraurbane dardane.

Pak më të hershme janë sëpatat dytehëshe nga lokaliteti Visoi i Pellagonisë,⁴⁵ të zbukuruara në gjithë sipërfaqen me romboidë të gërricur (Foto 10 2) dhe duket qartë se këto me të zbuluarat në Vojnik nuk kanë shërbyer si varëse, por kanë pasur funksion të veçantë, ngjashëm me disqet dardane. Për dallim prej këtyre, varëse sëpatë është gjetur në varrin 37 të lokalitetit Visoi të grupit të Pellagonisë të epokës së hekurit I (Foto 10 3). Varësja lidhet po ashtu me kultin e diellit dhe ka zbukurim tremolo, me rombe me incizime zik-zake, të kufizuara në skaje me vija harkore. Të tilla

³⁸ Vasić, R. (1987) p. 685. Hulumtimet e K. Luci (Muzeu i Kosovës).

³⁹ Për këtë shih: Stipčević, A. (1983) ff. 24-30.

⁴⁰ Benac, A. (2012) p. 39, Fot. 20.

⁴¹ Katalog arkeologjik (2013) f. 153, Fot. 202.

⁴² Shukriu, E. (2014) ff. 43-44, Fot. 16; Jovanović, A. (1980) pp. 53-60.

⁴³ Gabrovec, S. (1983) p. 56, T. VIII 5, 6, 7.

⁴⁴ Garašanin, M. (1983) p. 798, T. CXI 1-3.

⁴⁵ Garašanin (1983) p. 797, 10-12.

gjenden dhe në Verginë (faza IIIC), që sipas Kilian vendosen në kapërcyell të periudhës së mesme gjeometrike në të vonë⁴⁶ apo sipas Reinecke në kapërcyell të fazës B2 në B3 të kulturës së fushave me urna.

Byzylykët e stolitë e tjera kanë pasur pikë së pari karakter apotropeik solar. Kështu rrathët koncentrikë dhe kryqi i thyer (svastika), si në byzylykun e Pazarit të Ri - Novi Pazar (Foto 8 1)⁴⁷ duken si simbole solare e mbrojtëse në mburojën e monedhave të Scodrës e Lissit,⁴⁸ te luftëtari me mburojë nga Nini,⁴⁹ në mburojat e luftëtarëve në paftën e brezit nga varri monumental i Selcës së Poshtme⁵⁰ e të tjera. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe fibulat në trajtë të syzave (2 dhe 4 disqe spiraloide) nga tumat e Shirokës,⁵¹ por edhe nga trojet e tjera ilire. Duke analizuar simbolet ilire në objektet arkeologjike, A. Stipçeviq konkludoi se rrathët e tillë koncentrikë i mbijetuan proceset e romanizmit, si motive të stërlashta parahistorike të të gjithë ilirët.⁵²

Në vendbanimet e epokës së hekurit (shek. VIII-IV p.K.) vazhduan të paraqiten dhe peshojat, tani më kryesisht me trajta piramidale. Peshojat kanë shërbyer si pjesë funksionale të vegjeve vertikale, në hapësirat e ndryshimeve klimatike. Karakterin jo gjithnjë vetëm praktik të peshojave e dëshmon fakti se këto janë zbuluar në varreza, si p.sh. në Brezje dhe Bled⁵³ apo dhe në vatra të shtëpive.⁵⁴

Funksioni simbolik religjioz i peshojave në trajtë piramidale, si simbol i diellit dhe i zjarrit, është konstatuar kaherë. Simbolizmi solar i tyre është paraqitur në shumë ekzemplarë parahistorikë dhe antikë të trevave ilire,⁵⁵ përmes paraqitjes së kryqit, shenjës X, kryqit të thyer (svastikës) diskun diellor me rreze. Edhe ekzemplarë nga Kosova kanë shenja të tilla, për dallim nga peshojat pa shenja, me karakter thjesht funksional. Në këtë kuptim është me interes dukja e peshojës me shenjen X nga Gradina e Gadimes së Epërme.

⁴⁶ Kilian, K. (1975) p. 82, T. 1 43, 1-13.

⁴⁷ Etimologjia e svastikës rrjedh nga sanskrishtja 'svasti' - shëndet dhe është simbol i "Diellit në lëvizje", i zhvilluar prej një rrethi të thjeshtë me kryq: Stipçeviq, A. (1983) f. 18.

⁴⁸ Ceka, H. (1965) f. 182, T XIX 1.

⁴⁹ Batović, S. (1955) p. 253, Fot.1

⁵⁰ Shqipëria arkeologjike (1971) f. 2, Fot. 47. Artikulli në libër: Përkrenarja ilire e Denjit dhe zhvillimi i përkrenareve ilire, Foto 13.

⁵¹ Slavković-Djurić, N. (1965) T. I 7. 8.

⁵² Stipçeviq, A. (1983) f. 169.

⁵³ Gabrovec, S. (1960) p. 60; Stipçeviq, A. (1983) f. 32.

⁵⁴ Korošec, J. (1951) p. 146.

⁵⁵ Stipçeviq, A. (1983) f. 32; Stipçeviq, A. (1983) f. 17, T. III 3, 5, 10, 12.

Në sipërfaqen midis qytezës së Hisarit dhe tumave të Shirokës, u gjet një enëz konike me buzë të përvjelura nga brenda e punuar në çark (shek.V - IV p.K.), e cila në pjesën e jashtme të fundit e kishte të gërricur shenjën X dhe po aty janë gjetur dhe dy rrathë bronzi me katër dekorime sferike.⁵⁶ L. Dashiç supozoi se shenja X nënkuptonte shenjën e punishtes,⁵⁷ por më parë mund të thuhet se enëza është përdorur në ritualet e kultit të diellit, si dhe rrathët prej bronzi.

Për përhapjen e kultit të diellit te ilirët është dëshmi e rëndësishme zbulimi i tempullit të shek. VII - VI p.K. në Pod të Bosnjës, dikur qendër e bashkësisë fisnore të Desidiatëve. Në të janë gjetur shtylla me ornamentime të simbolit të diellit me koka të stilizuara njerëzore, ndërsa në shtyllën qendrore është vënë disku diellor, në vend të kokës (Foto 11).⁵⁸ Hapësira e adhurimit të kultit të diellit është konstatuar dhe në shtresën e epokës së hershme të hekurit në qytezën e Gajtanit te Shkodra.⁵⁹

Kosova dardane mund të ketë dhe objekte të tjera që ndërlidhen me kultin e diellit, ndonëse shprehjes së këtij kulturi nuk i është kushtuar vëmendje më analitike dhe se një sasi e madhe e materialit të gërmuar nuk është publikuar ende. Gjithsesi, në gjithë territorin dardan ishte i përhapur kulturi i diellit dhe se disqet diellore të vendosura në varre paraqesin dukuri të veçantë të trevave dardane. Arsyet dhe rrethanat shoqërore dhe ekonomike mund të kërkohen më tej, por me këtë rast duhet përqendruar vëmendjen dhe te observatori megalitik parahistorik i Kokinos te Kumanova, i konstatuar në dekadën e fundit. Në të gjatë gërmimeve arkeologjike (2001) është gjetur dhe dekorimi në enë të diellit me rreze dhe me vija të valëzuara nën të (Foto 12).⁶⁰

⁵⁶ Slavković-Djurić, N. (1965) p. 253, T, VIII 1, 2.

⁵⁷ Dašić, Lj. (1957) p. 251, T. III 3. në rrafshin në juglindje të Hisarit u gjetën gjurmë nga epoka e bronzit e deri në periudhën romake dhe u mblodhën vetëm fragmentet e ngelura pas punimit të tokës.

⁵⁸ Benac, A. (2012) pp. 35-38, Fot. 19.


⁵⁹ Jubani, B. (1967) ff. 41-70; Instituti i Arkeologjisë - Tiranë:

http://www.akti.gov.al/kerkimishkencor/institucione_ash/ia.html (1.2.2016)

⁶⁰ Kuzmanovska-Barandovska, O. - Stankovski J. (2011) pp. 221-229, Fig 1.



a



b

Foto 8 a. Varri princor, Novi Pazar (Vasić 1987);
b. Qerrja me shpezë, Gllasinac (Benac 2012)




Foto 9 Labriset nga tuma e Romajës




Foto 10 Sëpatat dytehëshe: a. Vojnik (Garašanin 1983);
 b. Visoi (Garašanin 1983); c. Varëse labris, Visoi
 ç. Varëse labrise, Slloveni (Gabrovec 1983)



Foto 11 Shtyllat e stilizuara nga tempulli i Podit (Benac 2012)



Foto 12 Observatori parahistorik i Kokinos dhe motive dielli në qeramikë
(Kuzmanovska-Stankovski 2011)



Foto 13 Labirinti dardan, Smirë (viz. M. Ademi)

Observatori parahistorik në territorin dardan dëshmon se qysh herët janë përcjellë dhe shënuar lëvizjet astrale, sidomos përmes vrojtimit të pozitive të diellit gjatë solsticit veror dhe dimëror, si dhe të ekuinoksit vjeshtor dhe të atij pranveror. Ky po ashtu dëshmon traditën e hershme të kultit dhe të ritualeve të zhvilluara rreth tij. Ky lokalitet arkeoastronomik gjendet në majë të kodrës shkëmbore neovullkanike, në lartësi prej 1013 m. Ka dy nivele (rreth 90 x50 m) dhe frone të skalitura në shkëmb, të drejtuara kah lindja.⁶¹ Ky ka qenë një vend i shenjtë, ku janë bërë qiellvrojtime të organizuara dhe po ashtu rituale kulti të organizuara. Kjo flet dhe për ekzistimin e qiellvrojtuesve dhe të priftërinjve. Observatori ka shërbyer për përcaktimin e kohës së të korrave dhe të datave të tjera të rëndësishme për jetën e njeriut.

Observatori i hershëm megalitik, pos që flet për jetëgjatësinë e kultit të diellit, mundësoi dhe shpjegimin e paraqitjes së labirintit dardan nga monumenti epigrafik i Smirës përkushtuar Hyjneshës Dardane, rrethor dhe i qarkut të mbyllur.⁶² Si në rastin e përkrenareve ilire, për të cilat është menduar më parë se nuk kanë qenë ilire,⁶³ edhe për këtë labirint kishte fillimisht dyshime se nuk ka mund të jetë krijim dardan (viti 211).⁶⁴

Monumenti epigrafik i Smirës paraqet risi se për herë të parë gjendet paraqitja e labirintit në brendi të Europës Juglindore dhe risi tjetër është se në të gjenden të relievuara dy labirinte, në dy faqe të kundërta, labirinti rrethor (Foto 13) dhe ai katërkëndësh. Në Kretë dhe në Greqinë antike labirinti katërkëndësh nuk është i rrallë, por risi sjell labirinti rrethor dhe atë i qarkut të mbyllur për të cilin nuk ka ende analogji të imazhit dhe të polisemantikës së veçantë.

Në qendër të labirintit gjendet gjysmësfera e vogël, si ajo në mesin pllakëzave nga Shiroka, por kjo bërthamë ndahet në tri pjesë përmes tri harqeve dhe hyrja në qendër gjendet nga lindja. Krijimi i kompleksitetit të labirintit ka kërkuar njohuri astrale, matematikore dhe arkitekturore, për ta paraqitur ciklin e jetës dhe universin e përfytyruar. Andaj labirinti dardan nga Smira shpalos njohuri të thella të kohës përmes “Gjeometrisë së Shenjtë” që e sjell, aq më tepër që tek në shek. XVI u soll modeli

⁶¹ Shukriu, E. (2014) ff. 131-135; Kuzmanovska-Barandovska, O. - Stankovski, J. (2011) pp. 221-229; Cenev, Gj. (2006) pp. 313-317.

⁶² Monumenti epigrafik u zbulua bashkë me pesë të tjerë në Smirë të Vitisë (Janar 1988).

⁶³ Shih artikullin: “Përkrenarja e Denjit dhe zhvillimi i përkrenareve ilire”.

⁶⁴ Shukriu, E. (2014) ff. 24-29, ff. 172-273. Me të dëshmohej se nuk është fjala për Dea Dardania vetëm si hyjneshë e territorit, si pretendohet nga autorët Z. Mirdita apo N. Ferri. Shih: Ferri, N. (2012) pp. 135-158.

gjeometrik matematikor i sistemit heliocentrik i Nikola Kopernikut, i inicuar në shek. III p.K..⁶⁵ Kompleksitetit të njohurive duhet shtuar dhe ato medicinale anatomike, rrjedhimisht njohuritë për përbërësit thelbësorë të funksionimit të trupit të njeriut, kur kihet parasysh sfera e ndarë në tresh në qendër të labirintit, e ngjashme me valvulat e zemrës.⁶⁶

Labirinti rrethor i Smirës, si dhe labirintët e tjerë, lidhet drejtpërdrejt me diellin, por dhe me ciklin e jetës dhe kozmosin. Në qendër të tij mendohej se arrihet përmes provave të iniciacionit dhe se në të ndodhet fuqia, ndritshmëria dhe pavdekshmëria.⁶⁷

Dielli i thjeshtëzuar, prej një apo dy rathësh, është i përhapur dhe gjatë periudhës romake. I tillë duket në monumentet epigrafike të përkushtuara Jupiterit e, më rrallë, Cererës në Panoninë e Epërme (Panonia Superior).⁶⁸

Gjurmët e kulti të diellit janë prezente te hyjtë femërorë, siç ishte edhe hyjnesha histo-liburne Eia. Sipas mbishkrimit të zbuluar në Caska, Eia identifikohet me Bona Dea, patrone e femrës dhe e plleshmërisë së fushave dhe të kafshëve sipas religjionit të lashtë italik.⁶⁹ Hyjnesha Eia dëshmohet në shumë monumente edhe si Histria Terra, Terra Histria apo vetëm Histria.⁷⁰ Simbolet që e përcjellin Hyjneshën Dardane shpalosin funksionet e shumta të saj, të fituara gjatë zhvillimeve kohore dhe jo të kufizuara vetëm në lidhje me plleshmërinë apo territorin.

Hyjnesha Dardane ka mund të jetë hyjneshë e plleshmërisë dhe e tokës në fazat e hershme, si Terra Mater apo Magna Mater, por lidhmëria e saj më pas me kultin e diellit e ngrit në nivel tjetër. Fakti se etimologjia e fjalës diell në gjuhët e vjetra indoeuropiane ishte e gjinisë femërore, atëherë edhe më fiton kuptimin lidhshmëria e hyut femëror me diellin, me ç'gjë nënkuptohet edhe stërlashtësia e kultit të diellit në trevat dardane. Gjinia femërore e hyut të diellit, si në rastin dardan, dëshmohet në shumë qytetërimi të hershme, përfshirë dhe atë hetite⁷¹ dhe kelte.⁷²

Lidhmëria e Hyjneshës Dardane me kultin e diellit dhe funksionet e tij dëshmohet dhe nga monumenti i Romula Malvës, por të dhëna tejet të

⁶⁵ Shih: Dreyer, J. L. Emil (1906) pp. 134-135.

⁶⁶ Shih: Shukriu, E. (2014) ff. 168-169.

⁶⁷ Kanlif, B. (1980) p. 222; Enciklopedija likovnih umetnosti (1964) p. 237; Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 337.

⁶⁸ Hofflier, V. - Saria, B. (1938) p. 22, nr. 125, 146 11 ect..

⁶⁹ Stipçeviq, A. (1983) f. 170.

⁷⁰ Degrassi, A. (1970) pp. 161-167.

⁷¹ Leeming, D. (2005) p. 187.

⁷² Koch, T. J. (2006) p. 387.

rëndësishme gjenden në patellën prej argjendi nga Branetiqi i Poshtëm. Në të, pos paraqitjes së hyjneshës me elemente të tjera përcjellëse në dorëz,⁷³ në të dy anët e buzëve të patellës pranë dorëzës janë paraqitur dy trajtime të veçanta të diellit. Në fillim gjendet simboli i diellit me një thellim në mes dhe gjashtë rreth tij. Në vazhdim është paraqitur dielli në lëvizje, sipas solisticit dimëror në anën e djathtë dhe solisticit veror në anën e majtë, që bën që prezantimi të shihet dhe si kalendar (Foto 14). Trajtimi më i thellë multidisiplinar mund të shërbejë më tej lidhur me domethënien e plotë të kësaj paraqitjeje. Por edhe me këtë rast mund të konstatohet zhvillimi i mëtejshëm i vrojtimit astral dardane, të cilat i tejkalojnë që më herët paraqitjet e dikurshme skematike të diellit.

Në cilën kohë Hyjnesha Dardane fitoi trajtë antropomorfe është vështirë të konstatohet. Antropomorfizmi i diellit është arritur në shumë qytetërime të lashta të Egjiptit, të Mesopotamisë etj. Kështu, dielli në trajtë antropomorfe është paraqitur përmes hyjve Agni, Atum, Oziris, Baal, Helios, Mitra e të tjerë. Kulti i diellit ishte kult zyrtar që nga koha e shtetit të vjetër në ON (Heliopolis), ku hyu i diellit Ra mori pamjen e hyut më të vjetër Atum. Faraoni Eknaton (dinastia XVIII) themeloi një lloj të monoteizmit solar, i cili mbështetej në adhurimin e Atonit - diskut diellor.⁷⁴

Me gjasë rrënjët e këtij zhvillimi duhet kërkuar në përparimin e madh të shoqërisë dhe të besimit dardan, sidomos nga shek. IV p.K., kur duket dardanët hapëruan në antikë. Pos monumentit mortor nga shpirtërore, dëshmi të tjera arkeologjike në Kosovë ende nuk ka.

Deri më sot janë zbuluar monumentet gurore të Hyjneshës Dardane vetëm të periudhës romake dhe në trajtë antropomorfe është prezantuar vetëm në dy arat e zbuluara në Ruman⁷⁵ dhe mbase vetëm koka e saj në monumentin e Hyjneshës Dardane nga Gllamniku.⁷⁶ Se kulti i diellit ishte i përhapur edhe në periudhën romake dëshmojnë shtatorët me medaljone me varrëse rrethore të zbuluara në Kosovë, si është Busti i Hyjneshës Dardane nga Banja e Klllokotit (b-1) e shtatorja nga Theranda - Suhareka (b-2).

⁷³ Shukriu, E. (2014) ff. 46-49, Fot. 17, 18, 56; Popović, I. (2008) pp. 34-35, Fot. 4.

⁷⁴ Cavendish, R. - Ling, T.O. (1982) p. 98; Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 99.

⁷⁵ Shukriu, E. (2014) ff. 30-35; ff. 36-37, Foto 10; Tudor, D. - Vladescu, C. (1972) pp. 183-190, fig. 1, 2; Inscriptiile Daciei Romane II (1977).

⁷⁶ Shukriu, E. (2014) ff. 38-39, Foto 14.





Foto 14 Patela nga Branetiqi i Poshtëm (Popović 2008; viz. Shukriu)



a



b-1



b-2

Foto 15 a. Hyjnesha Dardane, Banja e Kllokotit (Viz. M. Ademi);
b. Shtatorja e Therandës - Suharekës

Autorët antik nuk ofrojnë të dhëna për prezencën e kultit të diellit te dardanët, por të dhënat e tyre për adhurimi i diellit në fqinjësinë dardane vlera që duhet pasur parasysh. Sipas Herodotit, jashtë Apollonisë në shpellë mbahej tufa e dhenëve të shenjta kushtuar diellit, të cilat i ruanin qytetarë të veçantë, secili duke shërbyer për një vit (Herodot. IX 93 5).

Herodoti shkruan dhe se Perdika, themelues i mbretërisë maqedonase, pak para dëbimit nga Argosi, “me thikë e vizatoi rrezet e diellit... tri herë i morri në gji rrezet e diellit”. Këtë e bëri kur mbreti i Argosit u tha se për shërbimet si çoban i kishin rrogë rrezet e diellit që depërtonin nga oxhaku (Herodot. 137 5). Perdika, bashkë me vëllezërit Gauan dhe Temen, shkuan në Iliri dhe më pas kaluan malet e Maqedonisë derisa erdhën në qytetin Lebaea dhe pastaj themeloi mbretërinë e vet (Herodot. 137 1).

Platoni dëshmon se grekët nuk e praktikonin më kultin e diellit dhe se fqinjët barbarë e adhuronin diellin. Ai përmend se në ishullin Rodos dielli adhurohej, andaj thotë se ujdhesa banohej me njerëz të origjinës së huaj (Plato 379). Maksimi nga Tiri përmend se peonët e përfytyronin diellin në trajtë të diskut të vogël, të ngritur mbi një purtekë (Maximus 2.8 6). Ky motiv gjendet edhe në monedhat e Peonisë, pastaj të Scodrës, të Lissit dhe të Damastionit.⁷⁷ Livi shkruan se majë malit Haem në afërsi të Peonëve kishte altarë kushtuar diellit (v. 181 p.K., Livius 40 22), ndërsa Eskili, dramaturg antik, përmend se Orfeu, jo grek, ngjitej para agimit në majen e Pangeut që t’i falej diellit.

Kulti i diellit ka mbijetuar në pjesë të ndryshme të Kosovës, por edhe në trevat e tjera. Për këto kanë shkruar autorë të ndryshëm, si F. Nopsca, E. Durham, Sh. Gjeçovi, Vaso Pasha, M. Tirtja etj.. Në kuadër të kultit janë zhvilluar manifestime që përfundonin në majat më të larta të rrethinës së ngushtë apo më të gjerë. Pos ceremonive të tjera, lutjeve dhe nderzjeve të zjarreve të mëdha, djemtë bartnin dhe vendosnin gurë të rëndë majë malit, si veprim simbolik për të aritur sa më afër diellit në lindje. Mbi traditën e ruajtur të kultit të diellit janë dhe betimet e derivonshme të shqiptarëve: “Për këtë diell!”, “Pasha dritë e diell”, “Për këtë rreze dielli!”, “Qofsh i bardhë si drita e diellit!” dhe betime të tjera.

Majat e nderimit të diellit dhe pelegrinazhet në Kosovë ishin Pashtriku e Korritniku (njihet si Mali i Nemun nga lumjanët) në Rrafshin e

⁷⁷ May, J.M.F. (1939) gif. 78b, 79, 80a etc.

Dukagjinit, Luboteni në Malin e Sharrit, mbi Glllogovicë të Gollakut etj., ndërsa në territoret e tjera të banuara me shqiptarë në Gjallicë të Lumës, Shkëlzen të Tropojës, Çukën e Tomorrit, Maja e Shëlbuemit te Lezha, Sarisalltëku te Kruja, Maja e Sukajt në Grudë dhe Maja e Rumisë (Mal i Zi) etj..

Kulti i diellit ishte majft i fuqishëm te dardanët dhe imazhi i diellit u përcoll në parahistori nga dukja fizike dhe rrugëtimi i tij deri te konceptualizimi i tij në antikë, duke kaluar nga kulti animistik në atë antropomorf. Gjurmë të hershme të këtij kulti gjenden në figurinat e kulturës së Vinçës, në varrezat tumulare dhe sidomos në disqet diellore të epokës së hekurit, karakteristike vetëm për territorin dardan.

Konstatimi i observatorit parahistorik megalitik në Kokino të Kumanovës dëshmon për përparimin e këtij kulti dhe paralajmëron ekzistimin e të tjerëve. Po ashtu dëshmohet se vrojtimet janë bërë nga qiellvështruesit – priftërinjtë, dhe se dardanët zhvilluan njohuri kozmologjike dhe kozmogonike. Në antikën dardane, e cila nis më parë se dominimi romak, kulti i diellit e arriti nivelin e paraqitjes antropomorfe, të manifestuar përmes Hyjneshës Dardane, e cila bëhet dhe psikopompe (drejtuese e shpirtit), hierofante iniciacistike e deri te vetëdija kozmike.

Summary

DARDANIAN CULT OF SUN

The importance of the sun for human life made to conceive and develop solar deity of the sun cults in different time and space. Although there are opinions that mankind began to speculate about the nature of the sun from the middle Paleolithic Age and Mesolithic Age, it is known that in Neolithic Age his image appeared, presenting thus its physical appearance, but also its journey. In historical times conceptualization of the sun took place, marking the transition from animistic cult to the anthropomorphic. Similar stages were held in the territory where lived prehistoric and historic Dardanians that for this paper aim to provide some data for further studies.

Within sun worship its cult reached level of heliocentrism in Europe in the Bronze Age. Astronomical model, whereby the earth revolves around the sun, was nominated in III B.C. century by Aristarchus of Samos and it was renewed in the XVI century by Nicolas Copernicus, who brought geometric mathematical heliocentric system [Dreyer, E. (1906) pp. 134-135].

Schematized sun appearances became more frequent since the beginning of the Metallic Ages and in the Bronze Age Europe dominated heliolatry together with the myth of Solar God and Solar Chariot (Photo 1). In South-Eastern Europe the most famous example is “Dupljaja Chariot” [Čović, B. (1983) p. 820; Garašanin, M. (1983) p. 798, T. LXXXIII 1].

Treatment of the Dardanian sun cult is complex, so we have to keep in mind that:

1. Cult has the universal character,
2. It is evolved from prehistoric to antique Dardanians,
3. Specificity of expression of worship cannot be easily defined,
4. Lack of written sources.

The study of the Dardanian sun cult is possible through the emergence of the sun symbols only in the context of material culture. Early traces are present at the Vinca culture, especially at the figurines with pendant necklace with circular symbol of the sun as it is a case with

“Throne Goddess” from Prishtina (Photo 2 a), Bardhosh etc. [Katalog (2013) Phot. 37, 38, 44]. To this group may belong the clay figurine from Ponesh, holding on chest the sun (Photo 2 b) as well as Neolithic Age dish from Vlashnja and Eneolithic Age pot from Hisar of Suhareka (Photo 3). The shape of tumuli and their circular rings are seen as a linkage to the cult of the sun (Photo 4).

As the direct symbols of the sun can be considered the sun discs found in graves only in Dardanian area that for they should be named as “Dardanian sun discs”. Such items has been found in VIII - VII century B.C. tumuli in Shiroka (Photo 5) [Slavković-Djurić, N. (1968) pp. 539, 544, T. II 8; T. III 1, 2], Perçeta / Perceva, Bergalla, Brazda (Photo 6 1) [Kilian, K. (1975) p. 95; Mikulčić, I. (1982) p. 24], Vranja, Maqedonci and Vertista (Photo 6 2) [Vasić, N. (1981) p. 684; Vasić, R. (1987) pp. 651-672] etc. No one of them was in use as pendant or application like in other areas (Photo 6) [Čović (1987) T. LXI 7-9].

Solar character has swastika and concentric circles of bracelets from Janjeva (VIII century B.C.) [Galović, R. (1960) pp. 256-266], Banja e Pejës and Novi Pazar (VI century B.C., Photo 8)[Vasić, R. (1987) pp. 646-560; Djuknić, M.-Jovanović, B. (1965) pp. 8, 13, 24] ect. They also appear as solar symbols on the shields of coins of Scodra and Lissus [Ceka, H. (1965) p. 182], shield of warrior from Nin [Batović, S. (1955) p. 253] and Selca e Poshtme [Shqipëria arkeologjike (1971) p. 2] etc.[See also article in this book: Helmet from Denj and Development of the Illyrian Helmets, Photo 13].Six swastika hold also the circular labyrinth from Smira (Photo 13).The same character has the scepter with two birds from tumulus II from Llashtica [Vasić, R. (1987) p. 685], labryses from Romaja (Photo 9), pendant labryses from Slovenia (Photo 10 4) [Gabrovec, S. (1983) p. 56], Vojnik (Photo 10 1) [Garašanin, M. (1983) p. 798] etc. Earlier are the labryses from Visoi (Photo 10 2) and Vojnik [Garašanin (1983) p. 797], having the same function as the mentioned Dardanian solar discs.

The spread of the sun cult in the region is proved by the discovery VII - VI centuries B.C. temple in Pod of Bosnja, with pillars with sun symbol and stylized human heads (Photo 11) [Benac, A. (2012) pp. 35-38]. Sun worship space is found and the layer of the Early Iron Age in Gajtan near Skodra [Jubani, B. (1967) ff. 41-70].

However, throughout the Dardanian territory the sun cult was widespread and there the sun discs – Dardanian sun disc became the particular phenomenon. Reasons may be required further, but in this case it should be noted the presence of the prehistoric megalithic observatory

Kokino near Kumanova (Photo 12) [Kuzmanovska-Barandovska - Stankovski (2011) pp. 221-229]. Observatory testimonies longevity of sun worship as well as the appearance of the Dardanian closed circuit labyrinth from Smira at the epigraphy monument dedicated to Dea Dardanicae, in the center of which lies the core divided into three parts, similar to the heart valves. The creation of the labyrinths complexity demanded astral, medical, mathematical and architectural knowledge to represent the cycle of life and the imagined universe [Shukriu, E. (2014) pp. 24-29, 172-273, 168-169].

According to the Dea Dardanicae connectivity with the cult of sun and sun movements is of the very importance the patella from Lower Branetic [Shukriu, E. (2014) ff. 46-49; Popović, I. (2008) pp. 34-35]. In it, besides the presented goddess associated with other elements on the handle, the two special treatments of sun are presented on both sides near lips of the handle.

At the beginning of both sides the sun is presented, with a deepening in the middle and six of them around it (Photo 14). It follows the sun in motion, by the winter solstice on the right and summer solstice on the left, which makes the presentation to be seen as a calendar. Deeper multidisciplinary treatment may serve to realize the full significance of this presentation. At this moment can be said the further development of the Dardanian astral observations, which exceeded earlier the former schematic representations of the sun.

The cult of the sun was quite strong among the pre-Roman Dardanians and its image was transmitted in prehistory from the physical appearance and solar journey (animistic phase) till the conceptualization in antique period (anthropomorphic phase). This was manifested through the Dardanian Goddess, which became initiatic hierophant, psychopomp as well as she reached the area of cosmic consciousness.

Kokino observatory demonstrates progress of this cult and warns of the existence of others and it also shows that observations are made by sky watchers / priests and that the Dardanians developed cosmological knowledge and cosmogony.

Bibliografia / Bibliography

- Batović, Šime (1955) “Sépultures de la peuplade illyrienne des Liburnes“, *Arheološki Vestnik* 6, Ljubljana.
- Benac, Alojz (2012) *Religijske predstave prastanovnika južnoslovenskih zemalja*, GCBI 10, Sarajevo.
- Benac, A. - Čović, B. (1957) *Glasinac*, Zemaljski muzej, Sarajevo.
- Campbell, Joseph (1969) *The Masks of God: Primitive mythology*, Penguin Books.
- Cavendish, R. - Ling, T.O. (1982) *Mitologija*, Ljubljana.
- Ceka, Hasan (1965) *Probleme të numiztikës ilire*, Tiranë.
- Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) *Rječnik simbola*, Zagreb.
- Cirlot, J. (1971) *A Dictionary of Symbols*, Philosophical Library, New York.
- Čović, Borivoj (1983) “Jadransko-zapadnobalkanska regija”, *PJZ* IV, ANUBH, Sarajevo, pp. 99-190.
- Čović, Borivoj (1987) “Srednjobosanska grupa”, *PJZ* V, ANUBH, Sarajevo, pp. 481-528.
- Dašić, Ljubomir (1957) “Praistorijsko naselja na Široku”, *GMKM* II, Priština.
- Dechelette, Joseph (1927) *Premier Âge du Fer ou époque du halsstatt*, Éditions Eduard Picard, Paris.
- Degrassi, A. (1970) *Culti dell ‘Histria preromana et romana*, Zagreb.
- Dreyer, J. L. Emil (1906) *History of the planetary systems from Thales to Kepler*, Cambridge University Press.
- Ferri, Naser (2012) “Vjerovanja i štovanje bogova u predkršćanskoj Dardaniji“, *GCBI* 41, pp. 135-158.
- Enciklopedija likovnih umetnosti* 3, Zagreb.
- Inscripțiile Daciei Romane II* (1977) *Oltenia și Muntenia*, eds. Florescu, G. - Petolescu, C. C., București.
- Jovanović, Aleksandar (1980) “Prilog proučavanju skulptura sa Medijane“, *Niški Zbornik* 9, Niš, pp. 53-60.
- Hofflier, V. - Saria, B. (1938) *Antike inschriften aus Jugoslawien – Noricum und Pannonia Superior*, Zagreb.
- Kanlif, B. (1980) *Rimsko carstvo*, Beograd.
- Katalog Arkeologjik i Kosovës* (2013) *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*, Prishtinë.

- Kilian, Klaus (1975) *Trachtzubehör der Eisenzeit zwischen Ägäis und Adria*, De Gruyter, Berlin.
- Koch, T. John (2006) *Celtic Culture: A Historical Encyclopedia*, Vol. I, ABC-CLIO, Santa Barbara.
- Korošec, J. (1951) *Predgotovinsko naselje na Ptujskem gradu*, Ljubljana.
- Kuzmanovska-Barandovska, O. – Stankovski J. (2011) "The Role of Astronomical Alignments in the rituals on the peac sanctuary at Kokino, Macedonia", *Journal of Astronomical History and Heritage* 14(3), Oxford, pp. 221-229.
- Gabrovec, Stane (1987) "Jugoistočnoalpska regija sa zapadnom Panonijom", *PJZ V*, ANUBH, Sarajevo, pp. 25-232.
- Gabrovec, S. (1960) *Predgotovinski Bled*, SAZU, Ljubljana.
- Galović, Radoslav (1960) "Halštatski depo iz Janjeva", *GMKM IV-V*, Priština.
- Garašanin, Milutin (1983) "Centralno Balkanska Regija", *PJZ - IV*, ANUBH, Sarajevo.
- Green, Miranda (1989) *Symbol and Image in Celtic Religious Art*, Routledge, London - New York.
- Green, Miranda (1984) "The Wheel as a Cult-Symbol in the Romano-Celtic World", *Latomus Revue d'études latines*, Buxelles.
- Green, Miranda (1991) *The Sun-Gods of Ancient Europe*, B.T. Batsford Ltd, London.
- Luci, Kemajl – Islami, Selim (2014) "Tuma 1 e Llashticës (Gjilan)", *GSAK 2000-2012*, ff. 58-77, ASHAK, Prishtinë.
- May, J.M.F. (1939) *The coinage of Damastion and the lesser Coinage of the Illyro Paeonian Region*, London.
- Mehmetaj, Haxhi (2014) "Kështjella dardane e Bardhit të Madh" *GSAK 2000-2012*, ASHAK, Prishtinë, ff. 35-56.
- Mikulčić, I. (1982) *Skopje so okolnité tvrdini*, Makedonska knjiga, Skopje.
- Pare, Christopher (1989) "From Dupljaja to Delphi: the ceremonial use of the wagon in later prehistory", *Antiquity* Vol. 63, Nr. 238, pp. 80-100.
- Shukriu, Edi (2014) *Hyjnesha Dardane*, ASHAK, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1990) "Kulti i diellit te Dardanët", *Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën e popullit shqiptar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, ff. 103-112.

- Sindos (1985) Archaeological Museum of Thessaloniki, Thessaloniki.
- Slavković-Djurić, N. (1965) "Ilirski tumuli kod Suve Reke", GMKM IX, Priština.
- Stipçeviq, Aleksandër (1983) Simbolet e kultit te ilirët, Rilindja, Prishtinë.
- Shqipëria arkeologjike (1971) Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Tiranë.
- Tirtja, Mark (1974) "Elemente të kulteve ilire te shqiptarët- kultit i diellit", Etnografia shqiptare V, Tiranë.
- Tudor, D. - Vladescu, C. (1972) "Dardanii la Romula-Malva, Apulum X, Alba Iulia, pp. 183-190.
- Vasić, Rastko (1987) "Oblast istočnog Kosova, južne Srbije i sjeverne Makedonije", PJZ V, ANUBH, Sarajevo, pp. 673-689.
- Vasić, Rastko (1987) "Moravsko-Timočka oblast", PJZ V, ANUBH, Sarajevo, pp. 651-672.
- Vasić, Rastko (1987) "Kneževski grobovi iz Novog Pazara i Atenice", PJZ V, ANUBH, Sarajevo, pp. 646-560.

TRAJTESË ARKEOLOGJIKE E TOPONIMIT GRADINË

Toponimi Gradinë/a dëshmon ekzistimin e një vendbanimi të fortifikuar parahistorik, të ngrehur në pozita gjeostrategjike, të volitshme për mbrojtje dhe vrojtim. Vendbanimet kodrinore u ngrehën në vise të ndryshme dhe në periudha të veçanta parahistorike dhe historike, varësisht nga rrethanat ekonomike, shoqërore dhe politike.

Mbështetur në kornizën teorike, gradinat interpretohen nga arkeologët si monumente ku njerëzit janë strehuar prapa mureve të tyre.¹ Disa Gradina janë të dukshme vetëm për syrin e ekspertit apo ato përbëjnë rrënoja pak a shumë të ruajtura të disa periudhave. Prezenca e tyre dëshmohet me siguri përmes toponimit, si burim i shkruar apo i mbajtur gjallë në kujtesën e popullatës.

Toponimi Gradinë/a është i përhapur në Kosovë, si dhe në hapësirat e tjera dhe deri më sot janë parë si toponime me prejardhje sllave. Krahas tyre paraqiten edhe toponimet e vendbanimeve të tjera kodrinore që rrjedhin nga ky toponim, si Gradishë / Gadishë, por edhe toponimet e tjera si Çukë, Qytetëz, Gjytet dhe Kala. Llojlloshmëria e emërtimeve të vendbanimeve kodrinore është rezultat e përkatësisë së ndryshme kohore të tyre nga këndvështrimi arkeologjik, rrjedhmisht të shtresave kulturore që janë konstatuar në to. Kështu, lokalitetet arkeologjike që mbajnë toponimin Gradinë i përkasin periudhave parahistorike, ndërsa toponimet e tjera lidhen me periudhën antike dhe mesjetare.

Vendbanimet me toponimin Gradinë janë dëshmuar si më të hershme në aspektin arkeologjik, andaj me këtë rast u kushtohet vëmendje e posaçme për të sjell qasje të re të ndërlidhjeve të etimologjisë së këtij toponimi dhe të dhënave nga gërmimet arkeologjike të zhvilluara në vendbanimet kodrinore me toponimin Gradinë të Kosovës.

Përnjohjet - rekognoscimet arkeologjike, në përgjithësi, dhe gërmimet sistematike, në veçanti, kanë dëshmuar se në çdo rast të paraqitjes së toponimit Gradinë kanë qenë të pranishme dhe shtresat më të hershme parahistorike. Këto janë vendbanime me pozitë të volitshme gjeostrategjike, dominuese mbi rrethinën. Të vendosura dhe në kodra të larta ishin ngusht të lidhura me ekonominë blegtorale, por edhe xehetare të banorëve të saj. Ndonëse xehetaria parahistorike e Kosovës nuk është

¹ Batović, Š. (1987) pp. 339–390; Batović, Š. (1983) pp. 271–373.

trajtuar sa është e nevojshme, mbeturinat e xehes së bakrit dhe të fragmenteve amorfe të bakrit në Vallaç të Mitrovicës e në gjithë Kosovën janë tregues i veprimtarisë xehetare që nga epoka e eneolitit.²

Toponimin Gradinë e mbajnë edhe disa vendbanime të mëdha rrafshinore, por të gjitha këto i përkasin periudhës romake, për dallim prej vendbanimeve kodrinore parahistorike me të njëjtin toponim. E tillë është Gradina te Graçanica (Gradina e Madhe, Gradina e Vogël), pastaj Gradina te Dërrsniku, Gradina te Gushica e Vitisë apo Gradina te Peja.

Që herët E. Çershkov supozoi se vendbanimet kodrinore, ndonëse në kohën e veprimit të tij jo aq të hulumtuara, janë ndërtuar në epokë të mëhershme, kanë vazhduar të zhvillohen gjatë gjithë epokës së bronzit për t'u bërë vendbanime dominante njerëzore gjatë periudhës së Halshtatit,³ të epokës së hekurit.

Sipas të dhënave që janë fituar nga gërmimet arkeologjike në Kosovë, përfundohet se vendbanimet kodrinore u banuan gjatë fazave vijuese:

- Faza I - Epoka e eneolitit
- Faza II - Epoka e bronzit
- Faza III - Epoka e hekurit
- Faza IV - Antika e vonë – mesjeta

Faza I - Epoka e eneolitit

Faza I karakterizohet me vendosjet e para të vendbanimeve në kodra gjatë epokës së eneolitit (mesi mijëvjeç. IV - fundi i mijëvjeç. III p.K.). Ndërtimi i këtyre vendbanimeve në kodra u bë për shkaqe ekonomike, por edhe të mbrojtjes. Shkak fillestar ishte nisma e xehetarisë dhe pastaj edhe pasiguria e krijuar edhe me dyndjet e fiseve indoeuropiane.

Në Kosovë janë evidentuar tri grupe të ndryshme kulturore gjatë epokës së eneolitit: 1. Vinça-Ploçnik, 2. Bujanj-Hum dhe 3. Baden. Grupi Vinça-Ploçnik është vazhdimësi e traditave neolitike të kulturës së Vinçës, në trajtat më kryesore të saj. Lokaliteti më i rëndësishëm i këtij grupi është “Kërshi i Vallaçit” te Mitrovica, ku është konstatuar nisma e vendosjes së banorëve vendës në kodër.

² Vasić, N. (1979) p. 33.

³ Čerškov, E. (1969), p. 15: “Može se pretpostaviti da su ova utvrđenja, nastala jos u ranijoj epohi, nastavila svoj razvoj kroz čitavo bronzano doba da bi u halštatu postala dominantna vrsta ljudskih staništa.”; Garašanin, M. (1973) pp. 164–215.

Grupin e dytë e përfaqëson grupi kulturor Bubanj-Hum,⁴ i dëshmuar në Gradinën e Gadimes së Epërme, Veletin dhe Hisar të Suharekës, ndërsa grupin e tretë e përfaqëson kultura e Badenit, e dëshmuar në Hisar të Suharekës.⁵ Prejardhja e grupit kulturor Bubanj-Hum dhe pjesërisht e atij të Badenit lidhet me dyndjet e fiseve indoeuropiane.

Lokaliteti Hisar i Suharekës dëshmon më së shumti për krizat e krijuara për shkak të dyndjeve gjatë epokës së eneolitit dhe për nevojën e mbrojtjes më të sigurt lidhur me këto kriza. Në të janë vendosur bartësit e kulturës së Badenit, që vinin nga veriu, por vendbanimi i tyre është shkatërruar dhe djegur nga bartësit e kulturës Bubanj-Hum, të cilët arritën nga lindja. Në rastin vendbanimeve kodrinore të Gradinës së Gadimes së Epërme dhe të Veletinit mbi Janjevë është konstatuar se banorët e parë ishin krijuesit e grupit Bubanj-Hum (Foto 1, 2).⁶

Për trajtimin e temës mbi vendbanimet kodrinore që mbajnë toponimin Gradina është me mjaft rëndësi të ceket se vendbanimet e të gjitha grupeve të epokës së eneolitit kishin mure mbrojtëse prej dheu, mbi të cilat është thurrur gardhi. Kështu dëshmohet se këto vendbanime janë rrethuar me gardh, si pjesë e njërit nga sistemet më të hershme të mbrojtjes. Përfundime të tilla janë nxjerrë nga gërmimet arkeologjike në Gradinën e Gadimes së Epërme, Kërshin e Vallaçit të Mitrovicës, si dhe në lokalitetin Bubanj të Serbisë Lindore dhe në Kalanë e Shkupit.⁷



Foto 1 Figurina indoeuropiane eneolitike Bubanj-Hum, Gadime e Epërme (Muzeu i Kosovës)

⁴ Tasić, N. (1979) pp. 87-144, 440.

⁵ Tasić, N. (1979) p. 440 ff.

⁶ Shukriu, E. (1990) ff. 117-119.

⁷ Tasić, N. (1979) pp. 445 ff.



Foto 2 Enë eneolitike Bubanj-Hum me grafit dhe kanelyra,
Gadime e Epërme (Katalog 2013)



Foto 3 Vazo dhe dyvegjake eneolitike, Hisar i Suharekës (Katalog 2013)



Foto 4 Enë të epokës së hershme të bronzit: a, b: Vlashnjë, c. Korishë, ç. Glladnicë (Katalog 2013)



Foto 5 Enë të epokës së mesme të bronzit: a. Korishë, b. Vlashnjë (Katalog 2013)



Foto 6 Urnë e epokës së vonë të bronzit, Bërnicë e Poshtme
(Katalog 2013)

Faza II - Epoka e bronzit

Zhvillimet e vendbanimeve kodrinore gjatë epokës së bronzit në Kosovë janë ende jo shumë të qarta, por ka indikacione se disa prej tyre ishin të banuara gjatë kësaj epoke. Periudha e bronzit të hershëm është konstatuar në vendbanimet e Karagaçit dhe të Vallaçit të Mitrovicës, Deiq të Klinës, Hisar të Suharekës, Vlashnjë dhe Korishë të Prizrenit, Glladnicë II të Prishtinës apo dhe Gadime të Epërme III (Foto 4). Kultura e bronzit të hershëm e Kosovës është e ngjashme me kulturën e bronzit të hershëm Bubanj-Hum III, me atë pelagonian të Maqedonisë (kultura Armenohori) dhe të Shqipërisë Juglindore (Maliq IIIa-b), këto të fundit të konstatuara në Hisari IIIa dhe Korisha I.⁸

Bronzi i mesëm njihet nga Korisha II, Hisari IIIb dhe Vlashnja IVb (Foto 5), ndërsa ai i vonshëm nga vendbanimi i Lushtës (Mitrovicë), Glladnicës (Graçanicë), Korishës III dhe Vlashnjës IVc (Foto 6). Kultura e bronzit të vonë e Kosovës lidhet me fazën Mediana III të Serbisë Lindore, por edhe me kulturat e Shqipërisë Lindore (Kukës, Dibër, Korçë).⁹

Faza III - Epoka e hekurit

Faza III u zhvillua gjatë epokës së hekurit, kryesisht nga shek. VIII p.K. deri në shek. IV p.K.. Ka indikacione se disa vendbanime të Kosovës kanë qenë të banuara edhe në këtë epokë, por në këtë fazë mund të thuhet

⁸ Katalog (2013) f. 101.

⁹ Katalog (2013) f. 101.

se jeta në këto vendbanime vazhdoi nga shek. VIII p.K.. Gjendja e tillë është provuar në Gradinën e Gadimes së Epërme, Gradinën / Gradishën e Cernicës, Gradinën / Kalanë e Bardhit të Madh / Bellaçecit, Veletin, Hisar të Kastercit, Kalanë e Teneshdollit dhe të tjera.

Nga shek. VI p.K. është dëshmuar zhvillimi i procesit paraqytetar në gjirin dardan dhe zgjerimi i qendrave paraqytetare rrëzë kodrave, si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe të shtimit të popullsisë. Si në fazën paraprake, në fillim të kësaj faze vendbanimet kodrinore ishin të mbrojtura me ledhe dheu, mbi të cilat është thurur gardhi. Ndërkohë përparoi dhe teknika e fortifikimit me ngritjen e ledheve prej gurësh të palatuar, të renditur pa material ndërlidhës ose për këtë ka shërbyer balta.

Pas mesit të shek. IV p.K. është konstatuar ndërprerja e jetës në vendbanimet e larta kodrinore me toponim Gradina, të cilit i parapriu lënia e Gradinës së Bardhit të Madh / Bellaçecit në shek. V p.K.. Në këtë pikë qëndron dallimi me vendbanimet që mbajnë toponimin Gradishë apo Gradishtë, të vendosura në kodra të ulëta, me pozitë dominuese mbi rrafshet pjellore dhe me gjurmë të vazhdimësisë së jetës dhe gjatë periudhës romake në afërsi.

Nga kjo periudhë ka vazhduar jeta në vendbanimet e rajoneve xehetare, si në rastin e fortifikatës Lama e Artë te Artana / Novobërda. Në afërsi, te Kolonia e Xehetarëve, E. Çerškov ka konstatuar dhe varre të periudhës helenistike, bashkë me figurinën e Kibelës.¹⁰

Gjetjet te Kolonia e Xehetarëve të periudhës helenistike, ato të tumës II të Romajës, Cjapit nga Prizreni, monedhave të Damastionit dhe më pas të Apollonisë së Ilirisë dhe të Lissus dëshmojnë për jetën e zhvilluar dhe gjatë shek. IV–I p.K., përfshirë dhe burimet antike, të cilat e provojnë fuqizimin dardan. Duket të jetë rastësi moszbulimi i ndonjë vendbanim apo nekropoli të kësaj periudhe deri më sot në Kosovë, megjithkëtë të dhënat relevante shpiejnë në përfundim se në këtë periudhë vendbanimet gjendeshin kryesisht në hapësira të rrafshita, jo larg vendbanimeve të dikurshme kodrinore.¹¹

Vendosja në rrafsh e vendbanimeve dardane mund të lidhet me transformimet brenda shoqërisë dardane, me krijimin e shtetit dardan dhe me ndjenjën e sigurisë për shkak të fuqizimit politik, ekonomik dhe ushtarak, për të cilat gjenden dëshmitë në burimet antike dhe studimet bashkëkohore.¹²

¹⁰ Čerškov E. (1969) pp. 79-80, note 28.

¹¹ Shukriu, E. (1996) ff. 106-107.

¹² Shih artikullin në këtë libër: Aspekte të zhvillimeve etnolitike në Kosovë.

Faza IV - Antika e vonë - mesjeta

Numrin më të madh të vendbanimeve kodrinore e përbëjnë ato që i përkasin periudhës së antikës së vonë dhe mesjetës. Këto i përkasin kryesisht periudhës që nis nga shek. IV, kur nis sërish ngrehja e vendbanimeve në kodra, për shkak të krizës në botën antike dhe të pasigurisë së shkaktuar me dyndjet e fiseve barbare.

Periodha e antikës së vonë dhe e mesjetës karakterizohet me fortifikimin e vendbanimeve në përgjithësi, të atyre në rrafsh (Ulpiana / Justiniana Secunda te Prishtina, Gradina e Dërsnikut te Klina, Gradina te Peja apo Gushica te Vitia) dhe të atyre në kodra (Veletini, Gradishat e Vlashnjës dhe Gexhes, Gjytetet e Vërbocit dhe të Vuçakut, Kalatë e Strezovcit, Balloçit, Teneshdollit, Prizrenit, Poneshit, Llapushnikut, Çukat e Brainës dhe të Drazhnjës, Qyteza e Madhe dhe e Vogël te Batusha, Gorica e Madhe dhe Gorica e Vogël te Vlashnja etj.).

Vendbanimet e kësaj faze janë rrethuar me ledhe prej gurësh, të trajtësuar në një apo më shumë faqe. Ledhi rrethues përbëhej nga dy mure paralele, të mbushura në mes me gurë të vegjël. Materiali ndërlidhës i gurëve ishte gëlqerja.

Në të shumtën e rasteve vendbanimet e fazës IV kanë edhe shtresa kulturore parahistorike. Për shkak të këtyre shtresimeve kohore për të njëjtin vendbanim shpesh ekzistojnë toponimet e ndryshme: Gradinë, Qytet, Gjytet, Çukë apo Kala. Kjo shpjegohet me faktin se zhvillimi i vendbanimit, ngrehja e ledheve rrethuese prej gurësh në vend të atyre prej dheu me gardh mbi to e ka mënjeluar emërtimin e mëhershëm Gradinë.

Nga të dhënat arkeologjike dhe realiteti në terren rrjedh se emërtimet e vendbanimeve të lashta kodrinore janë ruajtur në traditën gojore dhe se kjo traditë njih dallimin kohor të ndërtimit të tyre. Se sa e rëndësishme është përcjellja e traditës gojore flet fakti se banorët e vjetër dallojnë shumë mirë shtresat e hershme kur e përcjellin të dhënë se lokaliteti apo objekti i takon “kohës së rimit” apo “italianit të vjetër”. Me shumë rëndësi është dhe fakti se emërtimet e ndryshme të traditës gojore përputhen plotësisht me diferencimin kronologjik që rezultojnë nga hulumtimet arkeologjike në këto vendbanime.

Sipas analizës paraprahe emërtimi Gradinë është toponimi më i hershëm i vendbanimeve kodrinore dhe lidhet me periudhat parahistorike që nga epoka e eneolitit. Toponimi Gradishë / Gradishtë / Gadishë paraqitet më vonë, vendbanimet me toponimet Gjytet, Qytetëz dhe Çukë përkrijnë me antikën e vonë, ndërsa vendbanimet me toponimin Kalai takojnë periudhës mesjetare. Kjo nuk do të thotë se në to nuk gjenden shtresime arkeologjike të periudhave të ndryshme, por se toponimi u trashëgova nga periudha kur vendbanimi kishte rëndësi të veçantë.

Parashtrimi i zhvillimit të vendbanimeve kodrinore nga aspekti arkeologjik dhe toponimet e tyre shtron çështjen e etimologjisë së vetë toponimit Gradinë. Pyetja kryesore është se nga cila gurrë është ruajtur toponimi Gradinë? Ky toponim ndeshet në shumë gjuhë dhe gjithëherë e ka kuptimin e “një vendi apo vendbanimi të rrethuar”: indoevrop. ghordo, hetisht gurtas (kështjellë), gotisht gards (shtëpi), lituanisht gardas (gardh, vath i dheneve), në nordishten e vjetër gardr (gardh), sllavisht gradj, shqip garda / gardh.¹³

Qëndrimet e linguistëve rreth etimologjisë së toponimit Gradinë janë të ndryshme, disa ballkanistë dhe sllavistë janë të mendimit se “gradj” e sllavishtes së vjetër apo trajta e saj e vjetër, para metatezës së likuideve “gard” është gurrë, prej nga del termi “gardh” e shqipes dhe e rumanishtes.¹⁴ Jokli gjen verbën e tipit arkaik sgardh (hap, çel) në pluralët gardhiqe (gjerde e gardhinjë) dhe si të tillë fjalën gradh e nxjerr si fjalë “kentum” të shqipes, si dhe studiuesit e tjerë.¹⁵

Nëse kihet parasysh se vendbanimet kodrinore me toponimin Gradinë përmbajnë shtresa kulturore parahistorike dhe se në parahistori ishin të mbrojtura me ledhe dheu mbi të cilat ishte i thurur gardhi për mbrojtje më të sigurt, atëherë është e kuptueshme që toponimi ta ketë gurrë fjalën gardh: vend i rrethuar apo gardh, e cila e ka bazën në gjuhën indoeuropiane.

Fakti se vendbanimet, të cilat sot mbajnë toponimin Gradinë nuk janë banuar më pas shek. IV p.K. dhe mbi to nuk kanë ngelur gjurmë të dukshme të banimit, del si aspekt mjaft vendimtar për përcaktimin e prejardhjes së toponimit Gradinë. Nëse emri i këtyre vendbanimeve shihet ende vetëm me prejardhje sllave, atëherë shtrohet pyetja se si kanë mund të emërtohen si të tilla nga sllavët, të cilën erdhën mbi 1000 vjet pas shuarjes së jetës në to dhe pa gjurmë të dukshme të jetës së mëparme? Përgjigjja e thjeshtë lidhur me këtë pyetje është se kjo ka qenë e pamundur dhe se toponimi është trashëguar nga banorët e mëhershëm.

E njëjta pyetje mund të zgjerohet lidhur me toponimet Gjytet e Qytetëz, me trajta të gjuhës shqipe, për vendbanimet të cilat në kohën e dyndjeve sllave ishin të parrënuara apo me rrënoja të dukshme. Andaj është më afër të vërtetës të mendohet se sllavët t’i kenë mësuar këto, si dhe toponimin më të lashtë Gradinë për vendbanimet parahistorike, të cilat nuk i kanë ndeshur. Aq më pak është afër mendsh t’i kenë parë rrethojat e tyre të dikurshme prej gardhi. Është çështje linguistike diskutimi i çështjes së prapashtesave – ina dhe – ishte të toponimeve për të cilat u bë fjalë dhe në

¹³ Në gjuhën frigishte ekziston toponimi Manegordum: Çabej, E. (1976) f. 205.

¹⁴ Çabej, E. (1976) f. 205.

¹⁵ Shih për këtë: Çabej, E. (1976) f. 205.

kuadër të kësaj duhet cekur se E. Çabej e provon mundësinë e zhvillimit të brendshëm të prapashtesës –ina.

Nga trajtimi i mësipërm mund të konstatohet se toponimi Gradinë, me të cilin lidhen dhe toponimet Gradishtë / Gradishë / Gadishë të fazave të mëvonshme emërtonte vendbanimet e hershme kodrinore, të cilat fillimisht ishin të rrethuara me gardhe dhe se ky toponim e ka gurrën në indoeuropianishte dhe se u trashëgua në gjuhën ilire - shqipe. Natyrisht, aspektet paleolinguistike janë çështje të ekspertëve të fushës, andaj shtruarjen e çështjes nga aspekti arkeologjik duhet parë si kontribut për trajtesa më të thelluara multidisiplinare.



Foto 7 Gralishta e Korishës



Foto 8 Kalaja e Prizrenit




Foto 9 Kalaja e Zveçanit (Mitrovicë)

Summary

ARCHAEOLOGICAL ASPECT OF THE TOPONYMY GRADINA

This paper addresses the relationship between the etymology of the toponym Gradina –hillside settlements proven to be the earliest ones – and archaeological records of Kosova. Toponymy Gradina proves the existence of a prehistoric fortified settlement, being dragged into the dominant geo-strategic position and inhabited according to the economic and social circumstances.

Based on the theoretical framework, Gradina is interpreted by archaeologists as a monument where people are sheltered behind their walls [Batović, Š. (1987) pp. 339–390; Batović, Š. (1983) pp. 271–373]. While some of them are visible only to the eyes of experts and some are multilayer sites containing remains from different periods, the presence of Gradina's is certainly evidenced by their toponym, be it a written source or having survived in the memory of the population.

Apart from Gradina there are other toponymies which derive from this toponym: Gradishta, Gradisha, Gadisha. But, there are also the other toponymies of fortified settlements which have not the same foundation: Çuka, Qyteza, Gjyteti and Kalaja. The diversity of names is a result of having emerged in different historic periods. Undoubtedly, Gradina sites were settled in early prehistoric periods, while many are also linked with Antique Period and Middle Age.

Toponymy Gradina have also some plain settlements, but they belong to the Roman period, unlike the hilly prehistoric settlements with the same toponymy. Of this kind are Gradina e Madhe / Velika Gradina and Gradina e Vogël / Mala Gradina near Gracanica, Gradina near Derrsnik, Gradina near Gushica of Vitia or Gradina near Peja.

The results of archaeological researches on the hilly dwellings of Kosova enable the division of the following phases:

Phase I Eneolithic / Chalcolithic Age

Phase II Bronze Age

Phase III Iron Age

Phase IV Late Antique - Middle Age

Phase I: Eneolithic / Chalcolithic Age

Eneolithic or Chalcolithic Age is characterized by the first deployments of the hilly settlements (mid. IV – end III millennia B.C.). The initial reason was the mining activity as well as insecurity created by the Indo-European tribes invasions. Eneolithic settlements had defensive earthen walls and wooden enclosure as found in Upper Gadime, Kërsh of Vallac near Mitrovica, and in the site of Bubanj in Serbia, or Fortress of Shkupi / Skopje [Tasić, N. (1979) pp. 445 ff.].

Throughout Phase I, three cultural groups are identified: 1. Vinca-Plocnik, 2. Bubanj-Hum and 3. Baden. Vinca-Plocnik presents the continuance of the Neolithic tradition, the second group presents Bubanj-Hum culture [Tasić, N. (1979) pp. 87-144, 440], linked to Indo-European invasion (Upper Gadime Gradina, Veletin, Hisar of Suhareka. Photo 1, 2) which is the case with the third group Baden in general (Hisar of Suhareka) [Tasić, N. (1979) p. 440 ff.]. Site Hisar of Suhareka evidences Indo-European invasion crises; in its archaeological layer is evidenced the destruction of the Baden culture settlement and its replacement by Bubanj-Hum dwellers.

Phase II: Bronze Age

Development of hilly settlements during the Bronze Age in Kosova is still not very clear (note: need further research), but (note: yet) there are indications that they were inhabited during the Bronze Age. These settlements are found in sites of Karagac and Vallac near Mitrovica, Deic of Klina, Hisar of Suhareka, Vlashnja and Korisha near Prizren, Glladnica II near Prishtina or Upper Gadime III. They are linked to the Bubanj-Hum III, Armenohori of Pelagonia and Maliq III a-b of South-Eastern Albania [Katalog (2013) p. 101].

Middle Bronze Age settlements are recently known from Korisha II, Hisar III b and Vlashnja IV b. Late Bronze Age are known from Glladnica, Lushta, Korisha III and Vlashnja IV c (Photo 5, 6), being linked to the Mediana III group of Eastern Serbia and cultures of Eastern Albania (Kukës, Dibra, Korca) [Katalog (2013) p. 101].

Phase III: Iron Age

Phase III was developed through the Iron Age, mainly from VIII - IV centuries B.C. (Upper Gadime Gradina, Veletin, Cernica Gradina, Bardhi i Madh / Bellaçec Gradina, Hisar of Kasterc, Fortress of Teneshdoll ect.). From the VI century B.C. the development of the pre-urban centers is concluded as well as their extension at foothills. Settlements were protected by earthen walls and wooden fences, replaced later by unhewn stone walls, free courier or connected with mud.

In the second half of the IV century B.C. hilly settlements were abandoned, being preceded by the left of Bardhi i Madh settlement in V century B.C.. The developed life during the IV - I centuries B.C. is proven by helenistic period graves near the Mining Colony in Artana / Novobërda [Čerškov E. (1969) pp. 79-80, note 28], Romaja Tumulus II, Goat from Prizren, coins from Damastion, Apollonia of Ilyria and Lissus. Despite of the lack of discoveries of these settlements and necropolis of this period in Kosova, relevant data lead to the conclusion that the Iron Age settlements were mainly in flat areas [Shukriu, E. (1996) pp. 106-107]. Those may be established as a result of transformations of the Dardanian society, establishment of the state, and the safety it reached by strengthening its political, economic and military aspects.

Phase IV: Late Antique – Middle Age

Hilly settlements have been reinforced from the IV century onwards, due to the crises in antique world and insecurity caused by the invasions of barbarian tribes. This phase is characterized by re-fortification of hilly settlements (Veletin, Vërboc, Vuçak, Strezoc, Balloc, Teneshdoll, Prizren, Braina, Drazhnja, Batusha etc.) as well as those in flat areas (Ulpiana / Justiniana Secunda, Dërsnik near Klina or Gushica near Vitia). They were surrounded by stone walls with lime mortar.

Majority of hilly settlements of the phase IV have also prehistoric cultural layers, which is why they preserved toponyms Qytet, Gjytet, Çuka or Kalaja. This may be explained by the fact that the construction of the surrounding stone walls replaced the earthen ones and covered up the prehistoric toponym Gradina.

Archaeological data and the reality on the ground provide argumentation for the names preservation in oral tradition of the ancient hilly settlements, which are in accordance with the chronological data of

the archaeological researches. This raises the question of etymology of the toponym Gradina, which occurs in many languages. This toponym means “a surrounded place or a residence”: Indo-Europ.: ghordo, Hittit: gurtas (fortress), Got: gards (house), Lithuanian: gardas (fence, sheep ring), Old Nordic: gardr (fence), Slavic: gradj, Albanian: garda / gardh (fence) [Çabej, E. (1976) p. 205. In Phrygian language existed the toponym Manegordum].

There are different statements by linguists; some concluded that “gradj” of Old Slavic language is the source from which derived the Albanian and Rumanian “gardh”, before the metatheses of liquids “gard” [Çabej, E. (1976) p. 205]. Despite of this, the name “gradh” is seen as the Albanian centum word from the arkaik verb “sgardh” (to open) and plurals “gardhiqe” [Çabej, E. (1976) p. 205].

If we consider the fact that the Gradina hillside settlements had defensive earthen walls enforced by woven fences, it is understood that the toponym derives from the word gard(h) - fence, thus having Indo-European base. Also, since the hilly settlements were not inhabited after the IV century B.C. and no visible traces of dwelling exist, the following question arises: How could they be designated as such by the Slavs, which came 1000 years after the termination of life in them? The same question can be extended to the toponyms Gjytet and Qytetëz, having the Albanian language forms. It is closer to the truth to conclude that Slavs have learned them by the local inhabitants.

In conclusion, it can be said that the toponym Gradina presents the early hilly settlements, from which Gradishta, Gradisha and Gadisha originates, and that it is based on Indo-European language, inherited in Illyrian / Albanian language. Even though the treatment of Paleo-Linguistic aspects is the expert field, this paper done from the archaeological point of view should be seen as a contribution to profound knowledge by the multi-disciplinary approaches.

Bibliografia / Bibliography

- Batović, Šime (1983) Kasnobrončano doba na istočnom Jadranskom primorju, PJZ IV - Bronzano doba, Sarajevo, pp. 271–373.
- Batović, Šime 1987, Liburnska grupa, PJZ V - Željezno doba, Sarajevo, pp. 339–390.
- Çabej, Eqrem (1976) Studime gjuhësore I, Rilindja, Prishtinë.
- Čerškov, Emil (1969), Rimljanina Kosovu i Metohiji, ADJ, Beograd.
- Garašanin, Milutin (1973) Praistorija natlu Srbije, Srpska Književna Zadruga, Beograd.
- Katalog Arkeologjik i Kosovës (2013) MKRS, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1996) Dardania paraurbane, Dukagjini, Pejë.
- Shukriu, Edi (1990) “Fortifikata e Veletinit” / “Fortress of Veletin”, Arheološki Pregled, Ljubljana, pp. 117-119.
- Tasić, Nikolla (1979) “Bubanj - Salkuca - Krivodol kompleks” – Eneolit, PJZ, Sarajevo.

PËRKRENARJA ILIRE E DENJIT (KOSOVË) DHE ZHVILLIMI I PËRKRENAREVE ILIRE

Përkrenaret si pajisje ushtarake parahistorike janë gjetje jo aq të shpeshta, andaj zbulimi i tyre nxit interesimin e studiuesëve të fushave përkatëse. I tillë ishte dhe zbulimi i përkrenares ilire në Denj të Rrahavecit. Përkrenarja u gjet në vitin 2003, gjatë nxjerrjes së rërës nga shtrati i Drinit të Bardhë (Foto 2, 3, 18).¹ Është kjo përkrenare e vetme ilire e cila sot gjendet në Kosovë, ndonëse janë zbuluar dhe gjashtë të tjera.

Tre ekzemplarë të përkrenareve ilire, dy të plotë, u gjetën në tumën princore të Banjës së Pejës (Foto 4 1, 2).² Dy të tjera janë zbuluar rastësisht në Korishë të Prizrenit, ekzemplari i parë u gjet në vitin 1999 dhe i humbën gjurmët (Foto 5, 19), si ndodhi dhe me përkrenaren e dytë nga Korisha të vitit 2003. Duket se një ekzemplar është zbuluar në varrin me skelet në jugperëndim të Suharekës, kur ushtarët austro-hungarezë bënë gërmime të tumës gjatë Luftës I Botërore (Foto 1).³

Pos përkrenareve të evidentuara, është me interes paraqitja e pesë përkrenareve në monumentin relievor mortor të Dardanës - Kamenicës. Në kuadër të ikonografisë së këtij monumenti gjendet përkrenarja e relievuar në kokën e komandantit të vdekurit dhe te katër doriforët ushtarë, të cilët e bartin arkën e të vdekurit (Foto 16).⁴ Paraqitja e këtyre përkrenareve ilire në kuadër të gjithë kompozicionit ikonografik të monumentit mortor dardan bëhet me shumë interes për njohjen e riteve funerale dhe po aq për përkatësinë ilire të dardanëve, kur është e njohur se bartja e përkrenareve të caktuara janë dhe determinante kulturore dhe se përcaktojnë edhe përkatësinë etnike.⁵

Përkrenarja e Denjit është punuar në bronz, me dimensione 23 x 18

¹ Shukriu, E. (2004) ff. 51, 67, Foto 73. Ishte përpjekje e jashtëzakonshme që përkrenarja të mos zhvendoset nga Kosova.

² Gjenden në Beograd.

³ Dašić, Lj. (1957) p. 249; Teržan, B. (1995) p. 121; Vasić, R. (2010) p. 43. R. Vasić duhet t'i përfshijë në regjistër dhe përkrenaret nga Denji dhe Korisha, krahas atyre të regjistruara nga Banja e Pejës dhe Shiroka.

⁴ Shukriu, E. (2014) ff. 151-157.

⁵ Shih artikullin: Monumenti mortor pararomak i Dardanës.

cm. Ka kalotë gati gjysmësferike dhe hapje katërkëndëshe për fytyrë, pa mbrojtje nazale. Midis paragnatideve (llapave të faqeve) dhe mbrojtjes së qafës ka prerje të thellë trekëndëshe. Paragnatidet ngushtohen në drejtim të qafës dhe mbrojtëses së saj. Mbrojtësja e qafës është e shkurt, e kthyer lehtë nga jashtë dhe e rrumbullakuar. Dy brinjë të profiluar me prerje trekëndëshe përshkojnë kalotën vertikalisht nga pjesa e përparme e ballit deri në pjesën e prapme që e mbulon qafën. Në pjesën ballore gjendej pyka për ngjitjen e jelës, e cila vendosej midis dy brinjëve, si karakteristikë e përkrenareve ilire. Midis gjatësisë së brinjëve janë gërricur tri vija paralele. Skajet e përkrenares janë kornizuar me vijë të gërricur dhe janë dekoruar me sfera. Përkrenarja i takon tipit III A1a (fundi i shek. VI - fill. shek. V p.K.) dhe është tipi më i përhapur ndër ilirë.

Përkrenaret ilire të Kosovës parahistorike, si dhe gjetit, janë pjesë e pajisjeve ushtarake komanduese dhe emblemë e statusit. Këto reflektojnë fuqizimin ushtarak krahas pasurimit të aristokracisë fisnore, e cila solli nismën e diferencimit të dukshëm shoqëror dhe krijimin e mëpastajmë të shtetit të fuqishëm dardan. Përkrenaret janë vendosur në varret e të ndjerëve, por edhe u janë blatur hyjnive,⁶ duke bërë dhe dhurata votive hyjnive të ujërave, të lumenjve apo të detit.⁷ Kështu, zbulimi i rastësishëm i përkrenares në Drinin e Bardhë te Denji paralajmëron se ka mund të jetë hedhur në lumë si objekt blatimi. Përkrenare të tilla janë evidentuar dhe në lumin Sava (midis Zhupanjës e Orashjes), në rrethin e Stocit, Podstinjë, Kiseljak, Jabllanac të Cresit e Sisak,⁸ Trilj te Veliki Driniq dhe Mali Driniq⁹ dhe Zhupanjë-Orashje.¹⁰

⁶ Një numër i madh i tipeve I, II, III A1, II IA2, II IA3, III B janë gjetur në Olimpi: Teržan, B. (1995) pp. 81 - 159.

⁷ Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 45.

⁸ Tipi III A1a: Burkowsky, Z. (2001) Cat. 5; Burkowsky, Z. (2004) Cat. 1.

⁹ Tipi III A2a dhe III2-b: Milošević, A. (1999) Fig. 4-5.

¹⁰ Tipi III A2a: Vasić, R. (1982) p. 8, Fig. 1. Lidhur me përkrenaren ilire nga shtrati i lumit Alfeios te Olimpia mendohet se nuk është blatim në ujë - ekzemplarit i është bërë dhe analiza laboratorike: Hockey, M. (1992) pp. 281-291, 283-285.



Foto 1 Përkrenaret ilire të gjetura në Kosovë

1 Denji; 2, 3, 4 Banja e Pejës; 5, 6 Korisha; 7 Shiroka (?); 8 Dardana



Foto 2 Përkrenarja ilire e Denjtit




Foto 3 Përkrenarja ilire e Denjit (Viz. 1, 2 M. Ademi)



Foto 4 Përkrenarja ilire 1 dhe 2: Banjë e Pejës (Vasić 2010)



Foto 5 Përkrenarja ilire 1, Korishë (Foto U. Ukimeri)

Prejardhja dhe emërtimi i përkrenareve ilire

Historia e studimit të përkrenareve ilire është e gjatë, duke u nisur nga B. Shreder, E. Kukahn, A. Mozoliq, E. Kunce dhe H. Pflug,¹¹ si dhe arkeologët e Ballkanit F. Fiala, Q. Truhelka, P. Lisiçar, H. Ceka, M. Garašanin, D. Berciu, M. Nikolanci, V. Lahtov, I. Maroviq, M. Guma, B. Terzhan, M. Bleçiq, E. Teleaga, R. Vasiq etj..¹² Në historinë e studimit të tyre, varësisht nga periudha kur janë publikuar artikujt dhe librat, gjenden emërtime të ndryshme përcaktuese të këtyre pajisjeve ushtarake të veçanta prej bronzit. B. Shreder i pari i pa këto si përkrenare “karakteristike të Ballkanit Verior”¹³: “përkrenare greke”, “përkrenare greko-ilire”,¹⁴ “përkrenare iliro-greke”,¹⁵ “përkrenare maqedono-ilire” dhe “përkrenare ilire”.¹⁶

¹¹ Schroeder, B. (1912), Kukahn, E. (1936), Mozsolics, A. (1955); Kunze, E. (1958), Pflug, H (1988).

¹² Shih: Fiala, F. (1897); Truhelka, Č. (1902); Lisiçar, P. (1951); Garašanin, M. (1957); Berciu, D. (1958); Nikolanci, M. (1959); Lahtov, V. (1965); Ceka, H. (1972); Marović, I. (1972); Vasić, R. (1982); Guma, M. (1991); Teržan, B. (1995); Blečić, M. (2007), Teleaga, E. (2008).

¹³ Schroeder, B. (1912) p. 343.

¹⁴ Berciu, D. (1958) p. 443 ff.

¹⁵ Garašanin, M. (1957) pp. 37 ff.

Në studimet e hershme përkrenaret ilire u quajtën “përkrenare greke”, pasi që mendohej se ilirët nuk kishin zhvillim teknologjik të mjaftueshëm për të prodhuar përkrenare të tilla. Arsye për këtë ishte dhe gjetja fillestare e një numri të këtyre përkrenareve në hapësirat e kultit të Greqisë antike, sidomos në Olimp të Peloponezit (Moresë). Në të janë gjetur dhe trajtat më të hershme (shek. VIII-VII p.K.), andaj dhe, mbështetur në vazot korintase, mendohet se ky tip u zhvillua para shek. VI p.K..¹⁷ Prejardhja greke e përkrenares u kërkua edhe në figurat e vazove greke në të cilat kryesisht mungojnë, pos në vazon e Ruvos (Muzeu i Bolonjës), ku ruan kokën e amazonës, e cila përfaqëson entitetin “barbar” (jogrek) dhe jo të një ushtari grek.¹⁸

Pasi që Varianti I dhe II A, pos në Ungrej te Shkodra,¹⁹ dhe Donja Dolina²⁰ nuk janë gjetur në hapësirat ilire më në veri, mendohej se prejardhjen e kanë nga Greqia. Q. Truhelka ishte i pari që shprehu mendimin se këto përkrenare janë punuar nga vetë ilirët dhe i quajti përkrenare ilire, duke u mbështetur në faktin se ato shtriheshin në krahina të Ilirisë.²¹

Prejardhja ilire e përkrenareve u vu në dyshim kur këto u gjetën dhe në Olimp, andaj nisi të kërkohet prototipi në Greqi. E. Kukahn e quajti “përkrenare ishullore - ilire”, duke menduar se prototipi gjendej në përkrenaren e kohës arkaike të gjetur në ishullin e Qipros.²² E. Kunze e hodhi poshtë prejardhjen ishullore dhe duke dashur ta provonte prejardhjen greke të përkrenares ilire e pa prototipin në përkrenaren e zbuluar në Argo të Peloponezit të periudhës gjeometrike në formë koni, por dhe pranoi se përkrenarja ilire paraqiste risi.²³ Studiuesit e tjerë e quajtën “përkrenare greko-ilire”²⁴ dhe “përkrenare iliro-greke”.²⁵ A. Snodgrass e sheh ende përkrenaren ilire si “tip i pastër grek, i cili ka origjinë diku në Peloponez në fillim të shek. VII p.K. dhe se vetëm shekuj më pas e gjeti rrugën në Iliri dhe në tokat e tjera barbare”.²⁶

¹⁶ Kunze, E. (1955) pp. 125 ff.; Snodgrass, A.M. (1964) pp. 18 ff.; Vasić, R. (1982) pp. 5 - 10.

¹⁷ Sondgrass, A. (1964), p. 20.

¹⁸ Filow, B. - Welkow, I. (1930) p. 288.

¹⁹ Nopcsa, F. (1907) Phot. 2, 3; Lahtov, V. (1965) Phot 2, 1.

²⁰ Vasić, R. (2010) p. 38; Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 45.

²¹ Truhelka, Č. (1902) vol. VIII, p. 8.

²² Kukahn, E. (1936) pp. 53-55.

²³ Kunze, K. (1958) pp. 118-125.

²⁴ Berciu, L. (1958) pp. 437-450.

²⁵ Garašanin, M. (1957) p. 37.

²⁶ Snodgrass, A. (1999) p. 52: "Another common form, superficially similar to the 'Insular', is the so-called 'Illyrian' helmet, in fact a purely Greek type which perhaps

Në studimet më të reja supozohet se përkrenaret ilire janë importuar nga qendra prodhuese e tyre në Maqedoninë antike, në hapësirën midis Aianit dhe Kozanës e deri në Selanik.²⁷ Pa marrë parasysh interpretimet, përkrenaret e tipit III A janë dëshmuar me përkatësi ilire, andaj studiuesit kanë arritur në përfundim se këto meritojnë të quhen përkrenare ilire,²⁸ si janë quajtur fillimisht nga Q. Truhelka dhe ridëshmuar nga H. Ceka.

Kur kihet parasysh se më parë mendohej edhe se përkrenaret ilire kanë origjinë nga ato korintase, nga të cilat ndryshojnë, edhe evoluimi i tyre kërkoi një rishikim thelbësor (Foto 6). Këtë e imponoi dhe paraqitja e maskave prej ari dhe të përkrenareve ilire në Trebenishtë te Ohri (Foto 8-10) dhe Sindosi te Selaniku (Foto 11), të ngjashme për nga forma dhe tradita me ato të Mikenës në More (Peloponez), të krijuara shumë shekuj më parë.

Cilat janë lidhjet dhe pse u ringjall tradita e kulturës mikenase e epokës së bronzit në tokat jogreke në shek. VI p.K. është pyetje që kërkon studim të mirëfilltë, gjithnjë duke mbajtur parasysh se një dukuri e tillë nuk ishte e rastësishme dhe se krijimin e saj duhet kërkuar në bazat parailire e parahelene.



Foto 6 Përkrenarja ilire dhe korintase e hershme

Historia e studimit të përkrenareve ilire

Studimet për përkrenaret ilire përfshinë tri faza kryesore dhe fazën e parë e përbëjnë punimet e botuara para Luftës I Botërore. Në vitin 1897 F. Fiala botoi përkrenaret e para nga Bosnja e Hercegovina (Donja Dolina, Hercegovačke Grude, Putiçeva, Travnik).²⁹ Në vitin 1899 pasoi vepra e Q.

originated somewhere in the Peloponnese in the earlier seventh century, and only centuries later found its way to Illyria and other barbarian lands."

²⁷ Vasić, R. (2010) p. 38; Kavur, M.- Pravidur, A. (2012) p. 42.

²⁸ Shih: Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 45; Vasić, R. (1982) pp. 5 ff, f.n. 1.

²⁹ Fiala, F. (1897).

Truhelka, i cili ofroi sintezën e interpretimeve të përkrenareve nga Gorica, Plana, Drinovaci, Radishiçi, Podstinja dhe Donja Dolina.³⁰ Për përkrenaret e zbuluara në Shqipëri studimet fillestare i ofroi H. Ceka,³¹ për të vazhduar me të dhënat e S. Anamalit, F. Prendit etj..³²

Faza e dytë nis pas Luftës II Botërore dhe përfundon në vitet e 80-ta të shek. XX. Kjo periudhë nis me botimin e artikujve të Z. Mariçit (Kaçanj, Oshaniq)³³ dhe analizat e B.Çoviçit, i cili solli interpretime kronologjike dhe kulturore të përkrenareve.³⁴ I. Maroviç bëri sintezë të gjetjeve nga gjithë territori i Ballkanit, siç bëri më pas dhe R.Vasiç.³⁵ H. Pflug ofroi një tipologji, e cila u pranua dhe u plotësua me studimet e B. Terzhan-it.³⁶

Faza e tretë nis në fillim të shek.XXI, pas luftërave të zhvilluara në Ballkanin Perëndimor, kur dolën në shesh dhe gjetje të reja dhe u intensifikuan studimet mbi përkrenaret ilire.

Përkrenaret ilire ishin pjesë e pajisjes ushtarake dhe u përdorën edhe si emblemë e statusit. Mendohet se u krijuan në bazë të modifikimit të modelit të përkrenares korintike, si tipe të ndryshme me disa variante. Nisën të përdoren nga shek. VII p.K., por si ilire u njohën ato të shek.VI-IV p.K., të shfrytëzuara dhe më vonë. Ndonëse vitet 650-550 p.K. shënojnë zhvillim më të hovshëm të kulturës materiale në brendi të Europës Juglindore,³⁷ kjo karakterizohet me njohjen e mangët të përpunimit të përkrenareve dhe lëvizjen e tregtarëve nga jugu, të cilët i sillnin këto bashkë me objektet e tjera luksoze.

Vitet 550-450 p.K. shënojnë fuqizimin e aristokracisë fisnore, ndërsa deri në shek. IV p.K. e tutje supozohet se ekzistonin dhe punëtori të veçanta, siç ishin dhe ato për përpunimin e armëve. Numri relativisht i madh i gjetjeve të përkrenareve ilire në brendi të Ballkanit tregon se këto u bënë pajisje ushtarake edhe të ushtarëve të tjerë me grada të caktuara dhe jo vetëm të parisë fisnore të mëparme.

³⁰ Truhelka, Ć. (1899).

³¹ Ceka, H. (1972) ff. 165-177: Trajtohen dhe përkrenaret e zbuluara në Shkodër dhe Lezhë; Ceka, H. (1998) ff. 162-174.

³² Anamali, S. (1956) ff. 3-39; Anamali, S. (1957) f. 59; Prendi, F. (1958) f. 252, Fig. 3. Osmani, Y. (1988), ff. 209-210, Fig. 1-2.

³³ Marić, Z. (1959).

³⁴ Čović, B. (1987) pp. 575-643.

³⁵ Marović, I. (1976) pp. 287-300; Vasić, R. (1982) pp. 5-10; Vasić, R. (2010) pp. 37-55.

³⁶ Pflug, H. (1988) pp. 42-64; Teržan, B. (1995) pp. 81-159.

³⁷ Garašanin, M. (1973) p. 401.

Tipet e përkrenareve ilire

Tipet e përkrenareve ilire janë të llojllojshme, varësisht nga koha kur janë krijuar dhe këto kanë prerje katërkëndëshe për fytyrën dhe nuk kanë mbrojtëse të hundës. Tipi I, me qafë të pambrojtur dhe veshë të mbuluar, me dëgjim të vështirësuar (shek. VIII – mes. VII p.K.) nuk është konstatuar në territorin ilir. Ekzemplarët e tipit II A (mes. shek. VII - mes. shek. VI p.K.) janë gjetur në Ungrej te Shkodra³⁸ dhe Donja Dolina.³⁹

Tipi II A ka paragnatide të zgjatura të rrumbullaksuara dhe risi sjell mbrojtësja e qafës, e gjerë dhe e lakuar lehtë, por veshët vazhdojnë të jenë të mbuluar, duke e bërë dëgjimin e vështirësuar. Dy brinj paralel shtrihen përgjatë gati gjithë kalotës, duke krijuar kështu shtrat për jelë. Brinjët janë profiluar në trajtë trekëndëshi të theksuar dhe janë zbukuruar nga jashtë me dy kanelura. Një bri i profiluar dekorativ gjendet edhe në pjesën frontale, mbi hapjen e fytyrës.

Tipi II B nuk ka shtrirje të gjerë dhe është paraqitur më shumë në hapësirat më veriore të Maqedonisë dhe të Ilirisë së jugut. Tre ekzemplarë janë zbuluar në Trebenishtë te Ohri.⁴⁰

Tipi III A ka mbrojtëse të qafës dhe lejon dëgjim më të mirë (mes. shek. VI-V p.K.). Ky tip është më i përhapur dhe në kuadër të tij janë zhvilluar variantet III A 1a, III A 1b, III A 2a dhe III A 2b. Te tipi III A 1 janë vërjetur mjaft dallime në nivelin e statusit ushtarak, por dhe ato kohore. U përhap te shtresa ushtarake e rajonit të Ohrit, Ballkanit Qendror dhe të prapavisë së mesme dhe jugore të Adriatikut Lindor.

Përkrenarja e tipit III A1 ka kallotë gjysmësferike, paragnatide me prerje pak të theksuara anësore, të ngushtuara në drejtim të qafës dhe mbrojtëse më të shkurtë që del lehtë. Brinjët, shtretër të jelës, i ka të profiluara në trajtë trekëndëshi dhe këto shkojnë paralelisht përgjatë kalotës dhe në mes kanë tri vija të gërricura.

Në pjesën balllore gjendet bartësi për vendosjen e jelës dhe përkrenarja ka zbukurim me sfera të derdhura skajeve. Ky nënvariant i tipit IIIA i takon fundit të shek. VI - fill. V p.K. dhe është e përhapur në territoret jugore dhe perëndimore të Ballkanit. Tipi III A1a është konstatuar në Kosovë me ekzemplarët nga Denji (1), Banja e Pejës (3)⁴¹ dhe Korisha (2).⁴²

³⁸ Nopcsa, F. (1907) Phot. 2, 3; Lahtov, V. (1965) Phot. 2, 1.

³⁹ Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) pp. 39-40, Phot. 2; Kilian, K. (1975) p. 136.

⁴⁰ Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 45.

⁴¹ Teržan, B. (1995) p. 115, Pl. V 1, 2; Vasić, R. (2010) p. 43; Shukriu, E. (2004) f. 51, Foto 52; Krstić, V. (2007) pp. 94, 98-99.

Përkrenaret e tipit III A1b paraqiten edhe me zbulurime të llojllojshme, në shumicën e rasteve me figurë derri të egër apo të kalorësit. Mendohet se si të tilla ishin simbol reprezentativ i udhëheqësve me përgjegjësi të larta dhe konstatohet se nuk janë importe nga Greqia, ngjashëm me variantin III A1a, aq më tepër që janë gjetur vetëm si dhurata të hyjnive në tempujt e Olimpisë, të Dodonës dhe të Isthmisë.⁴³

Tipi III A2 ka përphapje edhe më të gjerë në Ballkanin Perëndimor se tipi IIIA1,⁴⁴ ndërsa morfologjia e përkrenareve të pastajme ndryshon dhe tipet III A3 dhe III B paraqiten më rrallë. Pasi që këto kanë dhe elemente dalluese dhe mund të kenë edhe dy deri në tre brinj, supozohet se numri i tyre mund të jetë tregues i ndryshimeve të statusit të bartësve të tyre.⁴⁵ Tipi IV është i ngjashëm me tipin III dhe dëgjimi nuk është përmirësuar (rr. 500 p.K.).

Përkrenaret ilire, për shkak të rëndësisë dhe mëvetësisë ilire, janë paraqitur dhe në monedhat e prera nga “dinastitë e qyteteve maqedone ose ilire”⁴⁶ (Foto 12, 15) dhe dallojnë nga ato të poliseve helene, siç pohon H. Ceka.⁴⁷ Përkrenarja gjendet në monedhën e shek. V p.K. të Bastareut nga Kustendili (Foto14)⁴⁸ dhe në monedhat e periudhës qytetare ilire të Lezhës e të Shkodrës, si dhe në varret 34 dhe 59 nga Gostilji (Foto12 2). Kjo gjendet dhe te këmbësori ushtar ilir në paften prej bronzi nga Gostili nga varri 126 (Foto12 1), pjesë e brezit labeat. Edhe në paften e Selcës së Poshtme të shek. III–II p.K. ushtarët mbajnë përkrenare ilire (Foto 13), andaj kjo është edhe një dëshmi se përkrenarja ilire u përdor nga ilirët edhe në shek. III-II p.K..

Përkrenarja ilire është paraqitur dhe në monumentin mortor të Dardanës - Kamenicës (Kosovë). Ajo gjendet në kokën e komandatit të vdekur dhe në kokat e katër doriforëve ushtarë, të cilët e bartin arkën e të vdekurit (Foto 16). Pasi që nga fundi i shek V p.K. rumbullaksohet hapësira midis paragnatideve dhe mbrojtjes së qafës në përkrenaret simotra dhe për dallim nga monedha e Bastareut nga Kustendili e shek. V p.K. (Foto 14), monumenti mund të datohet rreth fundit të shek. V- III p.K..

⁴² Shukriu, E. (2004) ff. 51, 67, Foto 73.

⁴³ Pflug, H. (1988) p. 58; Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 73.

⁴⁴ Pflug, H. (1988) pp. 52 ff.

⁴⁵ Vasić, R. (2010) p. 38.

⁴⁶ Kunze, E. (1958) p. 137; Hockey, M. (1992) Tab. 24d.

⁴⁷ Ceka, H. (1998) f. 169.

⁴⁸ Sokolovska, V. (1997).




Foto 7 Tipologjia e përkrenareve (Kravur-Pravadur 2012)



Foto 8 Përkrenarja ilire III A 1, Trebenishtë (Narodni Muzej, Beograd)




Foto 9 Përkrenarja ilire III A1b, Trebenishtë



Foto 10 Maskat prej ari të shoqëruara me përkrenare ilire
(Trebenishtë, VI-V p.K.)



Foto 11 Përkrenarja ilire me maskë: Sindos
(Varri 115, Muzeu Arkeologjik, Selanik)



a



b

Foto 12 Velje Ledine, Gostilj:
a. Pafta e varrit 126; b. monedhat e varreve 34, 59 (Basler 1969)



Foto 13 Pafta me ushtarë me përkrenare ilire, Selcë e Poshtme (Ceka 1971)⁴⁹



Foto 14 Monedhë e Bastareut, Kustendil (shek. V p.K.: Sokolovska 1997)



Foto 15 Monedha nga Maqedonia antike me përkrenare ilire (Hockey 1992)⁵⁰

⁴⁹ Shih dhe: Ceka, N. (1976) pp. 367-369.



Foto 16 Personat me përkrenare ilire në monumentin mortor të Dardanës

*

Interesimi i studiuesëve për përkrenaret ilire daton para Luftës II Botërore dhe varësisht nga periudha kur janë publikuar, gjenden emërtime të ndryshme përcaktuese të këtyre pajisjeve ushtarake të veçanta prej bronzi: “përkrenare greke”, “përkrenare greko-ilire”, “përkrenare iliro-greke”, “përkrenare maqedono-ilire” dhe së fundi “përkrenare ilire”. Numri më i madh i përkrenareve ilire i takon shek. VI-IV, kur këto kanë përhapje të gjerë në Bosnje, Mat, Epir dhe Thesali.

Jashtë Ilirisë përkrenaret ilire janë zbuluar në numër të madh në Olimpia, bashkë me armë, por këto shihen si ex-voto, ku janë lënë dhe përkushtime nga pjesë të ndryshme të botës antike. Aty kishin godinën e vet (thesauros) dhe kolonistët e Epidamnit-Dyrrahut, të cilët, bashkë me kolonistët e Apollonisë ishin në luftë të vazhdueshme me ilirët. Siç pohon H. Ceka, një pjesë e plaçkës së zënë nga ilirët janë depozituar aty në shenjë falënderimi për fitoret.⁵¹

Në Olimpia u gjet dhe përkrenarja ex-voto me mbishkrim "Jam i Verzanit të Grabos", që lidhet me kolonistët e brigjeve ilire dhe me emrin e

⁵⁰ Hockey, M.(1992) Tab. 24d

⁵¹ Ceka, H. (1972) ff. 165-177; Ceka, H. (1998) f. 163.

dëshmuar ilir.⁵²Përkrenare të zbuluara ilire në territorin e Greqisë antike janë dhe ajo e zbuluar në Akropolin e Athinës (grafiti Αθηναία) dhe ajo në Lindos të Rodit,⁵³ ex-voto Athinës për fitore kundër ilirëve ose maqedonasve.

Përkrenaret e Kosovës, si dhe gjetiu, ishin pjesë e pajisjeve ushtarake komanduese dhe emblemë e statusit, të cilat reflektojnë fuqizimin ushtarak krahas pasurimit të aristokracisë fisnore dhe që sollën diferencimin shoqëror dhe krijimin e shtetit të fuqishëm dardan. Këto të ngjashme dhe të ruajtura relativisht mirë duket se i takojnë të njëjtës punëtori, vendndodhja e së cilës duhet të jetë objekt studimi i mëtejme.

Numri i madh përkrenareve ilire të shek. VI-V p.K. në hapësirën jo aq të madhe të Kosovës është dukuri jo e shpeshtë në kuadër të gjetjeve arkeologjike, andaj studimi i tyre dhe i rrethanave shoqërore dhe politike kur paraqiten duhet po ashtu të jetë objekt i mëtejme hulumtimi. Në këtë kuadër është e nevojshme të studiohet në mënyrë të veçantë forca ushtarake dardane, që solli përvojë ushtarake të dardanëve edhe në legjionet romake, por edhe te mercenarët dardanë që vepruan në kohë dhe hapësira të ndryshme.

Për përfundim duhet të theksohet se tipet identike të përkrenareve ilire të zbuluara në Kosovë me ato nga hapësira e gjerë ilire janë dhe një dëshmi se kultura materiale dhe shpirtërore dardane mbështetet në kulturën ilire. Këtyre duhet shtuar dhe pesë përkrenaret ilire të relievuara në monumentin unik mortar të Dardanës - Kamenicës. Kështu, mund të konstatohet se numri i përgjithshëm i paraqitjes së përkrenareve ilire deri më sot në Kosovë përbëhet nga dymbëdhjetë sosh.

⁵² Krahe, H. (1929) pp. 75, 126.

⁵³ Blinkenberg, Ch. (1919) Tab. 22, 570.

<i>n.</i>	<i>Lokaliteti / Site</i>	<i>Tipi / Type</i>	<i>Konteksti Context</i>	<i>Bibliografia Bibliography</i>
1	Denjë	III A1a	Lum River find	Shukriu 2004: f. 68, fig. 73
2	Banjë e Pejës	III A1a	Varr / grave	Teržan 1995: Pl. V 1.2; Shukriu 2004: f. 51, fig. 52; Vasić 2010: T. V 2
3	Banjë e Pejës	III A1a	Varr / grave	Teržan 1995:p. 115; Vasić 2010: T. V 1
4	Banjë e Pejës	III A1a	Varr / grave	Teržan 1995:p. 115.
5	Korishë	III A 1a	Gjetje rasti Random find	
6	Korishë	III A 1a	Gjetje rasti Random find	
7	Shirokë	?	Varr / grave	Teržan 1995: p.121

Foto 17 Lokalitetet ku janë gjetur përkrenaret ilire në Kosovë



Foto 18 Përkrenarja e Denjit



Foto 19 Përkrenarja e Korishës 1



Foto 20 Përkrenarja e Kalasë së Ohrit 2002 (Porta e Epërme, varri 1)
(Marazov 2015)

Summary

HELMET FROM DENJ (KOSOVA) AND DEVELOPMENT OF THE ILLYRIAN HELMETS

Illyrian helmets, the prehistoric military equipment, are not so frequent finds, so their discovery boosts researchers' interest in relevant fields. Such was the discovery of the Illyrian helmet near Denj in Municipality of Rrahovec. The helmet was found in 2003, during the extraction of sand from the White Drin riverbed (Photo 2, 3, 18).

This is the only helmet which is present in Kosova, despite of the fact that six other helmets were likewise discovered there. Three of them, two complete, were found in the tumuli of Banja e Pejës (Photo 4 1, 2). The other two were discovered by chance in Korisha of Prizren: which unfortunately disappeared (Photo 5, 19), and again, the same happened with the second one found in 2003. One example was probably discovered near Suhareka when Austro-Hungarian soldiers excavated a tumulus during the I World War [Teržan, B. (1995) p. 121; Vasić, R. (2010) p. 43]. Five Illyrian helmets are present at funeral relief from Dardana / Kamenica, one at the head of the dead commander and four other on the heads of doryphor soldiers (Photo 1, Photo 16) [Shukriu, E. (2014) f. 151-157].

The helmet from Denj is made of bronze (23 x 18 cm) and it has almost hemispherical crown and rectangular face opening, without nasal protection. It has a deep triangular cutting between cheek guards (paragnatidi) and neck guard. Cheek guards are long and they each with a fastening hole at its tip. The neck guard is short, rounded and turned easily outside. Two profiled ribs with a triangle cutting traverse vertically the helmet, serving thus for the insertion of the crest. Three parallel lines are placed between the ribs. The helmet edges are framed in line row, and decorated with small spheres. Helmet belongs to the Type III A1a (VI-V B.C.).

Illyrian helmets mirror the strengthening of the military and the fostering of the tribal aristocracy too, which brought significant social differentiation and initiated the latter creation of the powerful Dardanian state. Helmets were placed on the graves, but they have been offered also to deities [Teržan, B. (1995) pp. 81 - 159] as well as left as votive gifts to the water deities [Kavur, M. - Pravidur, A. (2012) p. 45].

Drawing from this, the discovery of helmet in the White Drin River indicates that it might have been let in the river as an offering object. Such cases are identified in river Sava, then in Stoc, Podstinje, Kiseljak, Jabllanac of Cres and Sisak, Trilj in Veliki Drinic and Mali Drinic, as well as in Zhupanja-Orashje [Burkowsky, Z. (2004) Cat. 1; Milošević, A. (1999) Fig. 4-5; Vasić, R. (1982) p. 8].

The history of Illyrian helmet studies is long and their names have changed in time from “Greek helmet” into “Greek-Illyrian helmet” [Berciu, D. (1958) p. 443 ff], “Illyrian-Greek helmet” [Garašanin, M. (1957) pp. 37], “Macedonian-Illyrian helmet” and “Illyrian helmet” [Kunze, E. (1955) pp. 125 ff.; Snodgrass, A.M. (1964) pp. 18 ff.; Vasić, R. (1982) pp. 5 - 10].

“Greek helmet” were called in early studies based on supposition that technological development of Illyrians was not sufficient to produce such a helmet. The reason for this was the initial finding of a number of helmets in ancient Greece cult areas, especially in Olympia of Peloponnese (old name: Morea).

C. Truhelka was the first to express the opinion state that they were done by Illyrians, thus naming them “Illyrian helmets”, by relying on the fact that they were mainly found in the Illyrian territories [Truhelka, C. (1902) p. 8]. E. Kukahn named them “Island - Illyrian helmet”, thinking that its prototype was the archaic period helmet from Cyprus [Kukahn, E. (1936) pp. 53-55]. E. Kunze saw the helmets’ prototype in the cone-shaped helmet of the geometric period from Argo (Peloponnese), but he acknowledged that Illyrian helmet represented an innovation [Kunze, K. (1958) pp. 118-125]. A. Snodgrass sees Illyrian helmet still as “pure Greek type which centuries later found its way into Illyria and other barbarian lands” [Snodgrass, A. (1999) p. 52]. New studies assumed that these were imported from their production center in ancient Macedonia [Vasić, R. (2010) p. 38; Kavur, M.- Pravidur, A. (2012) p. 42]. Regardless of interpretations, helmet of type III A is proved to be Illyrian, therefore researchers had finally concluded that these should be called Illyrian helmet.

Studies on helmets include three main phases: Phase I: Before the I World War (F. Fiala, C. Truhelka, H. Ceka ect.), Phase II: After the II World War - 1980 (Z. Marić, B. Čović, R. Vasić, H. Pflug, B. Teržan) and Phase III: Beginning of the XXI century.

Helmet types vary depending on the time of their creation. Type I, with unprotected neck and covered ears, (VIII – middle VII B.C.) is not found in Illyrian territory. Type II A which continue to be with covered ears (middle VII - middle VI B.C.) was found in Ungrej near Shkodra [Nopcsa, F. (1907) Phot. 2, 3; Lahtov, V. (1965) Phot. 2, 1] and Donja Dolina [Kilian, K. (1975) p. 136]. Type II B is not widespread and is present more in northern areas of Macedonia and southern Illyrian territories. Type III A (end VI - beginning V B.C.) is more prevalent among the Illyrians, with variants III A 1a, III A 1b, III A 2a and III A 2b.

Sub-type III A1a is present in Kosova by samples from Denj (1), Banja e Pejës (3) [Teržan, B. (1995) p. 115; Vasić, R. (2010) p. 43; Shukriu, E. (2004) p. 51; Krstić, V. (2007) pp. 94, 98-99] and Korisha (2) [Shukriu, E. (2004) pp. 51, 67]. Type III A1b holds decoration, of wild boars or knights. Type III A2 has wider extension in Western Balkans then type III A1 [Pflug, H. (1988) pp. 52]. Later helmet morphology changed and then types III A3

and III B appear less. Type IV is similar with Type III (circa 500 B.C.).

Illyrian helmets are presented also on the city coins of the Macedonian or Illyrian dynasties (Photo 12, 15) [Kunze, E. (1958) p. 137; Hockey, M. (1992) Tab. 24d], being different from those of the Hellenic poleis [Čeka, H. (1998) p. 169]. They are present in coin of Bastareus from Kustendil of V century B.C. (Photo 14) [Sokolovska (1997)] and on coins from the urban period of Lissus and Scodra, Gostilj (Photo 12 2), at Illyrian soldier from Gostilj (Photo 12 1) and that from Selca e Poshtme of the III – II century B.C. (Photo 13). They prove also that the Illyrian helmet was used by the Illyrians during the III – II centuries B.C.

The Illyrian helmets were found in large numbers outside Illyria, mainly in Olympia, but these are seen as ex-voto, namely, left as dedications from various parts of the ancient world. In Olympia the colonists from Epidamnus (Dyrrachium) had their own building (thesauros), who, along with Apollonia colonists, were in constant war with the Illyrians. It is natural that some of the plunder taken from the Illyrians was deposited there in gratitude for victories [Čeka, H. (1998) p. 163].

The Illyrian helmet placed ex-voto in Olympia bore the inscription “I am of Versan of the Grabos”, which is related to the Illyrian coast colonists and has a proven Illyrian name [Krahe, H. (1929) pp. 75, 126]. The Illyrian helmet discovered in the Acropolis of Athens holds a graphite Αθηναία, and that one of Lindos in Rhodes, is also an ex-voto to the Athena deity for the victory against Illyrians or Macedonians [Blinkenberg, Ch. (1919) Tab. 22, 570].

Kosova helmets, as elsewhere, were part of military equipment and emblems of status command, which reflect the strengthening of the military and the fostering of the tribal aristocracy that brought social differentiation and the creation of the state of Dardania. Being similar and relatively well preserved, they seem to belong to the same workshop, the location of which should be subject to further studies.

The large number of Illyrian helmets of the VI-V centuries B.C. is otherwise not reflected sufficiently in the territory of Kosova as their discovering is limited to a few, therefore, comprehensive study of social and political circumstances of their appearance should also be subject to further research. In this context, it is necessary to specifically focus in studies on military Dardanian force that brought the military experience of Dardanians, later serving in Roman legions, but also the Dardanian mercenaries who acted in different time and space.

Finally it should be noted that Illyrian helmets discovered in Kosova, identical with those found in the Illyrian wide spaces, proof that the Dardanian material and spiritual culture is linked to the Illyrian culture. In addition to these, there are another five Illyrian helmets presented in unique funeral monument of Dardana / Kamenica. Thus it can be concluded that in total, there are twelve Illyrian helmets found in the territory of Kosova.

Bibliografia / Bibliography

- Anamali, Skender (1956) "Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apoloni", Buletin për Shkencat Shoqërore 1, Tiranë, ff. 3-39.
- Anamali, Skender (1957) "Nekropoli helenistik i Epidamnit", Buletin për Shkencat Shoqërore 2, Tiranë.
- Berciu, Dumitru. (1958) "Le casque gréco-illyrien de Gostavat", Dacia n.s. II, Bucarest.
- Blečić, Martina (2007) "Status, Symbols, Sacrifices, Offerings the Diverse Meanings of Illyrian Helmets", Vjesnik Arheološkog Muzeja Zagreb, 3, s. XL, Zagreb, pp. 73-116.
- Blečić-Kavur, Martina - Pravidur, Andrijana (2012) "Illyrian helmets from Bosnia and Herzegovina", GZMBH - Arheologija NS 53, Sarajevo, pp. 35-136.
- Blinkenberg, Christian (1919) Lindos I, Copenhagen.
- Burkowsky, Zdenko. (2001) "Ilirska kaciga K 5, Kacige u Hrvatskoj", Ministarstvo obrane Republike Hrvatske, Zagreb, pp. 28-29.
- Burkowsky, Zdenko. (2004) "The Iron Age in Sisak and the Moslavina Region", Gradski muzej Sisak.
- Cabanes, Pierre (1988) Les Illyriens de Bardulis à Genthios IV^e-II^e siècles avant J.-C., Cedes, Paris.
- Ceka, Hasan (1972) Questions de numismatique illyrienne (Chapter: L'origine illyrienne du bouclieret du casque sur les bronzes de Skodra et de Lissus), Tirana, pp. 165-177.
- Ceka, Hasan (1998) Në kërkim të historisë ilire, Instituti Arkeologjik, Tiranë.
- Ceka, Neritan (2002) Ilirët, Ilar, Tiranë.
- Ceka, Neritan (1976) "Les tombes monumentales de la Basse Selce", Iliria IV, Tirana, pp. 367-369.
- Čović, Borivoje (1987) "Glasinačka kultura", PJZ V, Sarajevo.
- Dašić, Ljubomir (1957) "Praistorisko naselje na Širokom", Glasnik Muzeja Kosova i Metohije II, Priština, pp. 249-254.
- Fiala, Franz (1897) "Griechische Bronzehelme aus Bosnien und der Herzegowina", WMBH, 6, pp. 148-153.
- Filow, Bogdan - Welkow, Ivan (1930) Grabhügelfunde aus Duvanlii in Südbulgarien, Jahrbuch des Deutschen Archäologischen Instituts 45, pp. 281-322.

- Krahe, H. (1929) *Lexion altillyrischer Prsonennamen*, Heidelberg.
- Krstić, Vlada (2007) "Le tombe principesche: Pečka banja, Antiche civiltà tra il Danubio e l'Adriatico", *Adria Museo Archeologico Nazionale*, Silvana Editoriale Spa. Milano, pp. 95-101.
- Kukahh, E. (1936) *Der griechische Helm*, Marburg.
- Kunze, E. (1967) "Der sogenannte illyrische Helm", VIII Bericht aus Olympia, pp. 116-133.
- Kunze, E. (1958) "Der sogenannte illyrische Helm", VI Bericht aus Olympia, pp. 125-155.
- Garašanin, Milutin (1957) "Ilirsko-grčki šlem iz Ražane", *Vesnik Vojnog muzeja* 4, Beograd.
- Garašanin, Milutin (1973) *Praistorija na tlu SR Srbije*, Srpska književna zadruga, Beograd.
- Gumă, Marian (1991) Citeva precizari asupra unor tipuri de coifuri de la sfișitul primei epoci a fieruluiși inceputul celei de a doua descoperite in sud-vestul Romaniei, *Thraco-Dacica* XII, 1-2, pp. 85-103.
- Hockey, Marilyn et al. (1992) *An Illyrian Helmet in the British Museum*, *The Annual of the British School at Athens*, Vol. 87, Athens, pp. 281-291.
- Lahtov, V. (1965) "Ilirskiot borečki grob od seloto Rečica-Ohridsko i problemot na grčko-ilirskiot šlem", *Situla*, 8/1965, Ljubljana, pp. 47-78.
- Lisičar, Petar (1951) *Crna Korkira i kolonijeantičkih Grka na Jadranu*, Filozofski Fakultet, Skopje.
- Marazov, Ivan & others (2015) *The Balkans – A Shared Heritage*, Stichting Horizon, Naarden.
- Marić, Zdravko (1959) "Grobovi ilirskih ratnika iz Kačnja", *GZMBH* 14, pp. 87-102.
- Marović, Ivan (1972) "L'elmo greco-ilirico", *Jadranska obala u protoistoriji, Kulturni i etnički problemi*, Zagreb, pp. 287-300.
- Milošević, Ante (1999) "Archäologische Probenuntersuchungen im Flussbet der Cetina (Kroatien)zwischen 1990 und 1994", *Arch. Korrespondenzblatt* 29, pp. 203-211.
- Mozsolics, Amália (1955) "Neuere hallstattische Helmfunde aus Ungarn", *AAASH* V, pp. 49-50.
- Nikolanci, Mladen (1959) "Nove grčke kacige i knemide u Dalmaciji", *Vjesnik za arheologiju i historiju Dalmatinsku* 61, pp. 81-93.
- Nikolanci, Mladen (1960) "Dodatak grčko-ilirskim kacigama u

- Dalmaciji”, *Vjesnik za arheologiju i historiju dalmatinsku* 52, pp. 31-35.
- Nopcsa, B. Franz (1907) “Arheološke crtice iz Albanije”, *GZMBH XIV*, Sarajevo, pp. 1-8.
- Osmani, Ylber (1988) “Një përkrenare ilire nga Durrësi”, ff. 209-210.
- Pflug, Hermann (1988) “Illyrische Helme”, *Antike Helme*, Mainz, pp. 42-64.
- Prendi, Frano (1958) “Sopata të pabotueme t'epokës së bronxit të zbulueme në Shqipni” *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Ser. Shkencat Shoqërore 1, Tiranë, ff. 207-217.
- Schroeder, B. (1912) “Thrakische Helme“, *Jahr. d. Deutsch. Arch. Inst.* 27, pp. 317-342.
- Sindos (1985) *Catalogue of the exhibition, Thessaloniki*.
- Shukriu, Edi (2014) *Hyjnesha Dardane*, ASHAK, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (2004) *Kosova antike*, MASHT, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (2004) *Ancient Kosova*, Ministry of Education, Science and Technology, Prishtina.
- Snodgrass, Anthony (1964) *Early Greek Armour and Weapons*, Edinburgh.
- Snodgrass, Anthony (1999) *Arms and Armor of the Greeks*, Johns Hopkins University Press, Baltimore.
- Sokolovska, Viktorija (1997) “Etničkite nositeli na Trebeniškata nekropola”, *Muzej na Makedonija*, Skopje.
- Vasić, Rastko (1982) “Prilog Proučavanju grčkog oružja u Jugoslaviji”, *Godišnjak XX*, CBI 18, ANUBH, Sarajevo, pp. 5-10.
- Vasić, Rastko (2010) “Reflecting on Illyrian Helmets”, *Starinar LX*, Institute of Archaeology, Belgrade, pp. 37-55.
- Teržan, Biba (1995) “Handel und soziale Oberschichten im früheisenzeitlichen Südosteuropa”, *Handel, Tausch und Verkehr im bronze- und früheisenzeitlichen Südosteuropa*, Berlin, pp. 81-159.
- Truhelka, Čiro (1914) “Prehistoričke brončane kacige”, *GZMBH*, Sarajevo, pp. 116-119.
- Truhelka, Čiro (1899) “Dva Prehistorijska nalaza iz Gorice (Ljubuškog kotara)”, *GZMBH XI*, Sarajevo, pp. 339-395.
- Wilkes, John J. (1995) *The Illyrians*, Blackwell Publishing Ltd., London.
- Teleaga, Emilian (2008) “Griechische Importe in den Nekropolen an derunteren Donau 6 Jhr-Anfang 3. Jh v. Chr.”, *Marburg*, pp. 232-234.

MONUMENTI MORTOR PARAROMAK I DARDANËS - KAMENICËS

Treva e Dardanisë, si një trevë e udhëkryqeve kulturore dhe e krijimit të identitetit dardan, vazhdon të ofrojë thesare të reja arkeologjike, të vlefshme për njohjen e një shkalle të lartë të zhvillimit kulturor dardan, përfshirë dhe periudhën pararomake. Kështu, në afërsi të Dardanës - Kamenicës janë gjetur tri monumente të vlefshme gurore në vitin 1994, por që të trija, duke mos ua njohur vlerën, janë lënë në harresë. Vizatimi i monumentit me ritual mortor duket ka ngelur rastësisht në ish-Entin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, pasi që dokumentacioni nga ky Ent është marrë në Serbi gjatë luftës në Kosovë.¹

Gjatë vizitës së parë në janar të vitit 2000 me përfaqësuesin e KFOR-it gjerman dhe të atij të SHBA-së monumenti u pa i mbuluar me borë dhe i vendosur si mbulesë mbi bunarin e ndërmarrjes komunale “Napredak”, ndërsa dy monumentet e tjera ishin të mbështetura në muret e jashtme të bunarit. Sipas informatave, monumentet janë gjetur më herët të “Ura e Çemerëve” apo “Ura e Kollarëve”, në rrëzët jug-lindor të kështjellës me toponimin “Kulina”, 1 km në jugperëndim të Dardanës - Kamenicës. Kështjella është vendosur në hyrje të luginës që shpie kah Krileva, si pararojë e Kalasë parahistorike dhe antike të Strezovcit (Foto 7 - 9), të vendosur në rajon të pasur me xehe.

Monumentet lidhen me kultin e të vdekurve, njëri paraqet ritualin mortor dhe nuk ka mbishkrim, ndërsa dy të tjerat janë monumente mbivarrore (stela). Njëra stellë përmban të njëjtat dimensione të mëdha në gjithë sipërfaqen: burrin që pi nga ritoni, kraterin, sandallet dhe shkronjat OEI, ndërsa tjetra është ngritur për Mucasa Dydie, e shkruar në gjuhën latine vullgare.

Monumenti me kompozicion të ritualit mortor figurativ është i pari i këtij lloji i zbuluar në Kosovë (Foto 1) dhe mungesa e analogjive në rajon e më gjerë e bën të vështirë studimin dhe, në veçanti, përcaktimin kronologjik të tij. E njëjta situatë ishte dhe me labirintin unik rrethor të

¹ Informatat e para u fituan nga artikujt e H. Matoshi në të gazetata “Kosova Sot” të dt. 28.8.1999 dhe G. Klaiqi në “Koha ditore” të dt. 31.12.2000. Pas kërkesës së autores, autoritetet komunale i vendosën monumentet në hollin e Komunës, dhe më pas monumenti me ritual mortor u transferua në Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës. Sot gjendet në Muzeun e Kosovës.

qarkut të mbyllur të Smirës, i cili u paraqit me përcaktim kronologjik të saktë të vitit 211, por shpalosi dhe një varg elementesh të panjohura të kulturës dardane.² Ndonëse kohësisht të ndara, të dy monumentet shpalosin një botë të zhvilluar shpirtërore, për të cilën burimet e shkruara antike nuk flasin. Ç'është e vërteta, historianët antikë nuk lanë shumë shënime për ritet në përgjithësi, përderisa për to dihet më shumë nga veprat e tragjedianëve apo nga disa gjurmë të legjislacionit funeral athinas.³

Në relievin monumental me motive të ritit mortor është paraqitur varrimi i ushtarakut me përkrenare ilire dhe rituali përcjellës. Është punuar në gur vendor, në teknikë relativisht të thellë relievi. Ka trajtë katërkëndëshi, me pjesë të epërme gjysmëharkore (0.82 m x 1.27 m x 0.13 m). I mungon gati tërësisht ana e djathtë, pos pjesës së epërme dhe skaji i poshtëm i majtë. Pjesa e ruajtur është ndarë në tri pjesë. Kompozicioni është vendosur në korniza të theksuara dhe pa zbukurime. Ka pjesë vazhduese nën kornizën e poshtme që, pos tjerash, sjell në përfundim se monumenti ka qëndruar në pozitë vertikale.

Përmbajtja e relievit është shprehur me gjuhë figurative përmes trajtimit skematik dydimensional. Në të janë paraqitur femra që prek arkën, i ndjeri i vendosur në arkë, katër doriforë, tri valltare mortore, tre gjëmëtarë dhe dy shtazë kulti (Foto 1). Kompozicioni ndahet në tri horizonte vijuese:

Horizonti I: Femra që prek arkën, i ndjeri i vendosur në arkë dhe dy valltare mortore.

Horizonti II: Katër doriforë, një valltare mortore dhe një gjëmëtar.

Horizonti III: Dy shtazë dhe dy gjëmëtarë.

Mesazhi religjioz-filozofik është shprehur në aspektin semantik përmes gjashtë tërësive:

1. Femra që prek arkën,
2. I ndjeri në arkë,
3. Katër doriforë,
4. Tri valltare mortore,
5. Tre gjëmëtarë,
6. Dy shtazë kulti.

Figura e të ndjerit dhe arka kanë pozitë horizontale, ndërsa figurat e tjera janë vendosë në pozitë vertikale. Koka e të ndjerit është e kthyer në të

² Shih më në detaje: Shukriu, E. (2014).

³ Kurtz, D.C. - Boardman, J. (1971) pp. 142-143.

djathhtë dhe vetëm te kjo figurë duket qartë trajtimi i kujdesshëm i gishtërinjve (Foto 2). I ndjeri dhe doriforët mbajnë përkrenare ilire, që dëshmon se është fjala për varrimin e një luftëtari udhëheqës dhe të një përfaqësuesi të lartë të shoqërisë dardane, të denjë për ngritjen e një monumenti të tillë. I ndjeri mban pantallona, si edhe doriforët dhe gjëmëtarët.

Femra që prek arkën është vendosur para arkës, në drejtim të njëjtë si i ndjeri dhe të kundërt nga të gjitha figurat e tjera. Me elegancë gati hyjnore prek skajin e djathhtë të arkës së të ndjerit me dorën e djathhtë, ndërsa të majtën e mban tek brezi (Foto 2). Mbi kokë ka shaminë që i bie mbi supe dhe fustan të gjerë dhe të gjatë deri tek pulpat e këmbëve, me prerje në trajtë trekëndëshi tek qafa. Në bel kishte brezore, ndonëse të paparaqitur nga mjeshtri, si duket në bazë të paraqitjes së belit dhe të trajtës trekëndëshe të pjesës së poshtme të fustanit.

Personazhet e tjera të ritualit mortor janë tri femra që hedhin vallen mortore. Rëndësinë e tyre në ritual e shpreh dhe madhësia e figurave, dy herë më të mëdha se të gjëmëtarëve. Dy prej valltareve mortore gjenden në Horizontin I, ku është dhe i ndjeri, dhe e treta në Horizontin II. Kanë fustane të gjera dhe të gjata deri tek pulpat e këmbëve, me prerje në trajtë trekëndëshi tek qafa (Foto 3).

Valltaret mortore janë prezantuar me dorën e majtë mbi bark dhe të djathhtën te koka, por duket se gjatë vallëzimit duart ndrojnë pozitën. Po ashtu duket se vallëzimi i tri valltareve bëhet në trajtë rrethi, nga fakti se mjeshtri artist e ka vendosur valltaren e tretë (Horizonti II) nën dy të parat (Horizonti I). Trajtimi artistik duket i vrazhdë, por pozita e duarve dhe përfytyrimi i lëvizjeve të valles mortore duken mjaft elegante, duke krijuar përshtypjen se valltaret gjenden në një hapësirë ndërlihdëse midis botës reale dhe të asaj hyjnore.

Në horizontin II, pos valltares së tretë mortore, gjenden katër doriforë, figura meshkujsh ushtarë me përkrenare ilire. Doriforët bartin arkën e të ndjerit përmes katër trarëve të paraqitur në pozitë vertikale (Foto 3). Tri figurat e tjera të meshkujve paraqesin gjëmëtarët, të cilët kanë duar të vendosur mbi kokë (Foto 5). Këta, si dhe figurat e tjera të meshkujve në kompozicion, kanë të veshur pantallona (Horizonti I, II).



Foto 1 Monumenti mortor i Dardanës



Foto 2 I ndjeri dhe femra që prek arkën



Foto 3 Tri valltare mortore



Foto 4 Doriforët ushtarë me përkrenare ilire



Foto 5 Tre gjëmëtarët



Foto 6 Shtazët e kultit: dreri dhe kali

Dy figura të shtazëve të kultit, të vendosura në pozitë heraldike zënë hapësirën qendrore të pjesës së poshtme të relievit: dreri dhe kali (Horizonti III. Foto 6). Që të dytë janë shtazë htonike dhe duket se lidhen me sakrifikimin e tyre për shpirtin e të vdekurit. Në anën e djathtë të shtazëve janë skalitur dy gjëmëtarë. Mungesa e anës së majtë të relievit nuk lejon supozime për përmbajtjen e plotë të relievit.

Kompozicioni mban frymë të artit naiv, ka gjuhë të qartë dhe elemente të fazës gjeometrike të zhvillimit të artit, përkatësisht të trajtimit antropomorf përmes disa formulave gjeometrike. Elementet gjeometrike vijjnë më në shprehje te trajtimi i fustanave të femrave, në veçanti me fundin trekëndësh të tyre. Element tjetër shprehës është pamundësia e paraqitjes së perspektivës, karakteristikë e fazave të hershme të zhvillimit të artit tek qytetërimet e lashta. Kështu, të gjitha figurat e kanë të paraqitur kokën në profil, ndërsa trupin “en face”.

Mjeshtri artist, i vetëdijshëm për nevojën e paraqitjes së perspektivës dhe i paaftë që ta realizojë këtë, ka mëtuar arritjen e tridimensionalitetit përmes relievit dydimenzional dhe përmes paraqitjes horizontale të të ndjerit dhe arkës funerale dhe të paraqitjes vertikale të figurave të tjera në kompozicion. Mungesa e paraqitjes së perspektivës shprehet edhe te bartësit e arkës funerale, të cilët janë paraqitur në rend të njëjtë, ndonëse dy prej tyre e kanë bartur arkën në anën e djathtë dhe dy të tjerët në të mjetën.

Për ta paraqitur perspektivën, mjeshtri ka gjetur solucion të përshtatshëm me vënien e vijës ndarëse midis skajit të arkës dhe dy trarëve që gjenden në mes, duke paralajmëruar se doriforët 2 dhe 3 gjenden në anën e kundërt të arkës, për dadhim nga doriforët 1 dhe 4. Solucion për çështjen e perspektivës është gjetur edhe me vendosjen e dy valltareve më lart (Horizonti I) dhe të tretës nën to (Horizonti II).

Gjuha e shprehjes në reliev është mjaft e qartë, por trajtimi i kompozicionit nuk është subtil dhe i mungojnë detajet dhe dekorimi. Me këtë krijohet përshtypja se mjeshtri artist është kënaqur me shprehjen e tërësisë kompozicionale dhe jo edhe të detajeve të veçanta.

Detajet janë skalitur vetëm në raste kur mjeshtri artist i ka parë si më të nevojshme, si është paraqitja e syve, hundës, shamive apo të përkrenareve ilire. Në rastet e tjera detajet mungojnë, madje edhe atëherë kur ka qenë e nevojshme, si është rasti me brezat apo palët e fustanave të figurave të femrave. Këto të fundit bëjnë që figurat e femrave të kenë pamje të ngurtë, përkundër lëvizjeve rituale në valle. Duket se monumenti ka përmbajtur dhe disa detaje, të cilat janë dëmtuar ndërkohë për shkak të strukturës gurore.

Përderisa prezenca e figurave ushtarake (i ndjeri, doriforët),

valltareve mortore, gjëmëtarëve e shtazëve të kultit është mjaft e qartë, dilemë shtron figura e femrës që prek arkën e të ndjerit: Kë e paraqet kjo figurë femre, e cila i paraprinë gjithë kortezhit funeral dhe vetë ritualit mortor? Për shkak të pozitës së saj në të njëjtin drejtim me të vdekurin kundruall pozitës së figurave të tjera dhe prekja e arkës së të vdekurit, bëhet e qartë se nuk është fjala për një njeri të zakonshëm, qoftë ajo nënë apo grua, aq më tepër se monumenti është krijuar në kuadër të një shoqërie patriarkale.

Kjo figurë e veçantë femre duket se prek dhe nivele të tjera, pos atyre të dukshme, andaj ka mundësi të jetë një femër me profesion të caktuar, mbase priftëreshë nëse jo dhe nimfë, si ndërlidhje me sunduesin/sunduesen e botës së të vdekurve dhe të përjetësisë. Kështu merr kuptim dhe prekja e arkës, si ndihmesë për bartjen e shpirtit në botën tjetër. Kur kihet parasysh roli i dëshmuar i Hyjneshës Dardane në periudhën romake si hijerofont iniciastik dhe bartëse e shpirtit në sferat e amshueshme,⁴ mund të supozohet lidhmëria me vetë Hyjneshës Dardane, njërën nga priftëreshat e saj, ndonjë nimfë, nëse jo vetë atë.

Roli i tri valltareve mortore është mjaft i qartë, pasi që këto zhvillojnë vallëzimin hyjnor, si formë e krijimit të relacioneve të ndërsjella midis tokës dhe qiellit (Foto 4). Në kultura të ndryshme vallja kozmike dhe vallja fetare u bënë ritual i identifikimit me krijuesin dhe krijimin.

Prototip i valles kozmike budiste është e ashtuquajtura “*tandava Shiva-nataraje*”, e cila zhvillohej në rrethin e zjarrtë, ndërsa “*Vallja e Uzumës*”, e cila realizohej para shpellës dhe ndillte daljen e hyjneshës së diellit, Amaterasu është prototipi i të gjitha valleve të shenjta japoneze.⁵ Edhe në Kinën e lashtë zhvilloheshin vallet e vajtimit, të cilat evokonin kthimin e shpirtit të të vdekurit në burimin hyjnor, ndërsa në kulturat antike mesdhetare, duke pasur si bazë simbolizmin kozmologjik dhe iniciastik, ndeshet dhe vallja që luhej pas daljes nga labirinti i Kretës.⁶

Valle rituale realizoi edhe Arianda, e bija e mbretit kretas Minosit, valle kjo që kishte koreografi labirintine.⁷ Në këtë kuptim, në hapësira të ndryshme është konstatuar edhe lidhja midis lëvizjeve të valltarëve dhe lëvizjes së yjeve dhe të sferave planetare sa në antikën greke, aq edhe në “*Vallen e diellit*” tek indianët Sijuks apo te dervishët.⁸ Vallet mortore janë prezente edhe në monumentet ilire, siç janë urnat japode. Këto i gjejmë në

⁴ Shukriu, E. (2014) dhe literatura.

⁵ Roberts, J. (2010) pp. 5, 120.

⁶ Lavedan, P. (1931) pp. 317 - 318; Devambez, P. (1966) p. 142.

⁷ Wright, C. (2001) p. 9.

⁸ Dervish: <http://www.britannica.com/topic/dervish> (dt. 12.07.2015)

monumentin e Karakishicës te Sinji, në relievin e Silvanit me nimfa nga Klisi te Spliti, në monumentin e Gradunit në Cetinë (Tiluriumi antik)⁹ apo në arën nga Ribiqi te Bihaçi.¹⁰

Relievi përmban konceptin e treshit, si edhe labirinti rrethor i Smirës dhe mozaiku i Gamzigradit, që të dyja të periudhës romake. Simbolika e numrit tre shprehet edhe përmes ndarjes së gjithë kompozicionit në tri horizonte, por edhe përmes paraqitjes së tri valltareve mortore dhe tre gjëmëtarëve. Kur kihet parasysh se numri tre lidhet me konceptet kozmologjike të relacioneve qiell - tokë - nëntokë, Horizonti I i relievit del se lidhet me sferat qiellore apo ndërlihdje me to (femra që prek arkën, i ndjeri, valltaret mortore), Horizonti II paraqet tokën / botën reale (doriforët, gjëmëtarët), ndërsa Horizonti III botën nëntokësore (shtazët e kultit).

Analogji e largët, duke përjashtuar nivelin e shprehjes artistike, mund të gjendet te vazoja e Dipilonit e fazës gjeometrike të artit arkaik grek, ku i ndjeri është paraqitur në të njëjtën pozitë si edhe ai nga relievi i Dardanës - Kamenicës, përkundraill figurave të tjera.¹¹

Përkundër analogjive të mundshme, ndryshimi me traditën greke shprehet me figurat e meshkujve gjëmëtarë që shkulin flokët në relievin e Dardanës, ndërsa në ritet socioreligjioze të grekëve të vjetër flokët i shkulin femrat.¹² Përderisa janë dhënë mendime se tradita e shkuljes së flokëve në Greqinë antike nis në periudhën arkaike, duket se tradita ka rrënjë paleobalkanike, i mbijetuar deri vonë në trojet shqiptare. Mihal Apostoli e krahason këtë traditë me ato kretase, pasi që e sheh ceremonialin e vitit 1467 në Shkodër, ndërsa misionari Rodin shkruan se tradita e shqiptarëve ishte më e fortë se vajtimet për patriarkun Jakob në Hanaan (1637).¹³ Ndonëse tradita e shkuljes së flokëve nga burrat është ruajtur deri vonë te shqiptarët,¹⁴ sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit këtë e bënin gratë, ndërsa burrat e grithnin fytyrë e kraharor dhe ritmikisht rrahnin gjoksin duke u sjell në gjysmë harku para të vdekurit.¹⁵

Përcaktimi kohor i ngritjes së monumentit është i ndërlikuar, aq më

⁹ Rendić - Miočević, D. (1989) T. LXXXIV 1, T. LXXXV 1; Olujić, B. (2007); Balen-Letunić, D. (2006); Dzino, D. (2008) pp. 371-380.

¹⁰ Stipčević, A. (1981) p. 200.

¹¹ Janson, H. W. (1969) p. 77, Fig. 116.

¹² Kurtz, D.C. - Boardman, J. (1971) pp. 122, 144.

¹³ Pjetër Budi i kritikon si zakone pagane në "Rituali roman"(1621): Tirtja, M. (2004) pp. 323, 325-326.

¹⁴ Sokoli, R. (1971).

¹⁵ Kanuni i Lekë Dukagjinit (1972) Libri XII 24. Lidhur me ritet mortore paragrafet 1235-1245.

tepër për shkak të mungesës së analogjive. Përmbajtja e tërësishme ikonografike e relievit mban frymë autoktone dhe është punuar me gjuhën e njohur artistike vendëse, si shprehje e botës së popullatës indogjene. Monumenti është vepër e një mjeshtri artist vendor, i cili veproi në një fazë transitore të shoqërisë dardane, të kalimit nga faza gjeometrike e shprehjes artistike të një shoqërie blegtorale-bujqësore në fazën e trajtimit antropomorf real të shoqërisë pararomake urbane dardane.

Element i rëndësishëm për këtë dhe për përcaktimin e nivelit artistik dhe mjesh tërësor është mosnjohja e paraqitjes së perspektivës, karakteristikë e fazave të hershme të artit të qytetërimeve të lashta. Përcjellja e teknikës së drugdhendjes në krijimin e relievit guror, mungesa e njohurive për paraqitjen e perspektivës dhe analogjitë me vallet mortore nga urnat japode, sjellin në përfundim se relievi është krijuar gjatë periudhës pararomake. Pa dyshim, gjëma e gjëmtarëve ka qenë e zëshme, por nuk mund të përcaktohet se a ishte vallëzimi i valltareve i përcjellë me instrument/e apo ishte një “Valle e thatë” (“Valle e heshtur”).

Relievi me ritin mortor zë dhe sferat transhendentale dhe përcjell qasjet kozmogonike dardane, botë kjo e panjohur deri vonë dhe që duhet shpalosur ende. Këtë e sugjeron bartja e shpirtit të të ndjerit përmes prekjes së arkës, valles mortore dhe veprimeve të tjera përcjellëse, si dhe monumentet e mëvonshme të periudhës romake, të cilat shprehin vazhdimësinë dhe zhvillimin e botëkuptimeve kozmogonike dardane.¹⁶

E. Dobruna-Salihu ka shprehur mendimin se ky monument mortor, ai me mashkullin me riton dhe stellën e ngritur për Mucasa Dydie paraqesin një monument të vetëm dhe se janë krijuar kah mesi apo fundi i shek. III.¹⁷ Për një përfundim të tillë duhet të kihet parasysh përbërja strukturore e të gjithë gurëve të përpunuar, që është e ndryshme, si dhe trashësia e tyre, e cila nuk përputhet. Në veçanti duhet të kihet parasysh përkrenaret ilire në kokën e të vdekurit dhe të doriforëve të relievit me ritual mortor, të cilat nuk janë shënuar nga studiuesja. Janë këto arsye pse relievin me ritual mortor vazhdoj ta shoh si krijim pararomak, aq më tepër se përkrenaret ilire nuk janë paraqitur pas pushtimeve romake. Mbase i tillë mund të jetë dhe fragmenti me mashkullin që pi nga ritoni e që gjason me figurat e meshkujve të relievit me ritual mortor, por këto janë çështje që duhen studiuar më tej. Kjo nënkupton që duhet të kihet parasysh dhe ndryshimi i stilit gjeometrik në paraqitjet e figurave pararomake me atë të periudhës romake. Kjo nuk e përjashton mundësinë që monumenti mortor

¹⁶ Lidhur me këtë: Shukriu, E. (2014) ff. 137-164.

¹⁷ Dobruna-Salihu, E. (2005) f. 205.

të ketë qenë në funksion sekundar apo terciar edhe shekuj më vonë.

Në fazat preliminare të studimit monumenti mortor është vendosur në shek. III–I p.K.¹⁸ dhe me këtë rast mendoj se datimi duhet të zhvendoset në shek. V–III p.K., siç sugjeron dhe paraqitja e përkrenareve ilire, prodhimi i të cilave limitohet rreth shek. IV p.K., por janë në përdorim dhe më pas. Element mjaft i rëndësishëm për këtë rishikim kronologjik ishte hapësira e rumbullakuar midis paragnatideve dhe mbrojtjes së qafës të përkrenareve ilire në këtë monument.

Si përfundim mund të thuhet se monumenti mortor figurativ i Dardanës është i pari i këtij lloji i zbuluar në Dardani, unik deri më sot dhe se i takon periudhës pararomake. I punuar në relief të thellë dhe me teknikë skalitjeje në gur, ky përcjell traditën e drugdhendjes, që është traditë e hershme edhe ilire.¹⁹ Nga kjo mund të vihet në përfundim se janë krijuar edhe monumente të tjera të ngjashme të kohës të punuara në dru, por që nuk i kanë përballuar kohës. Po ashtu, prezenca e tij paralajmëron edhe dukjen e monumenteve të ngjashme gurore pararomake në hapësirën dardane.



Foto 7 Kulina e Dardanës - Kamenicës

¹⁸ Shukriu, E. (2004) ff. 84-85.

¹⁹ Rendić-Miočević, D. (1989).




Foto 8 Skica e Kulinës së Dardanës (2000)

Summary

PRE-ROMAN MORTAR MONUMENT FROM DARDANA / KAMENICA

Dardania often brings unique archaeological evidences for which is quite difficult to find adequate analogies. Of a particular kind are prehistoric open rock paintings in Vlashnja [Shukriu, E. (2010) 59 - 62; Shukriu, E. (2014) 158 - 163], the closed-circuit labyrinth from Smira [Shukriu, E. (2014) 24 - 29, 143 - 146; Shukriu, E. (2010) 571 - 575], and the pre-Roman mortal monument in Dardana / Kamenica, presented in this paper.

The mortal monument was found at the South-Eastern foot of the multilayer prehistoric and antique castle Kulina. It was placed near Bridge of Chemers / Kollars (Alb. Ura e Çemerëve / Kollarëve), 1km South-East of Dardana /Kamenica (Photo 7 - 9) together with funeral relieve with figurative motives (man playing trumpet, huge pot, sandals, letters COI) and epigraphic monument in Latin dedicated from Pirustia to Dydie Mucasa. According to the sketch found at the Institute for Protection of Monuments of Kosova, it was recorded in 1994. Author found the monument covered in snow over a well of a local enterprise “Napredak” during her first visit with representatives of the German and American KFOR in January 2000.

The rectangular shape relief with a semi-circular end in the upper part (0.82m x 1.27m x 0.13m) presents the burial of a military holding an Illyrian helmet, being accompanying by figures in the ritual. It is realized on stone in relatively deep relief technique. The preserved monument is damaged and fragmented into three parts. The composition is places into an undecorated frame and it has a continuing part under the bottom frame, which proves that the monument had stood in the vertical position.

The content of the relief is expressed by figurative language through a two-dimensional schematic elaboration. It features a female touching the ark, the deceased placed in the open ark, four male pallbearers, three female dancers, three male lamenters and two animals (Photo 1). The whole composition is separated into three horizons:

Horizon I: Female touching the ark, deceased placed in ark and two female dancers.

Horizon II: Four pallbearers, female dancer and male lamenter.

Horizon III: Two male lamenters and two animals.

Religious-philosophical message is semantically expressed through six units: 1. female touching the ark, 2. deceased in ark, 3. three female mortal dancers, 4. four pallbearers, 5. three male lamenters and 6. two cult animals. The figure of the deceased and ark is placed in horizontal position whilst other figures are placed in vertical position. The head of the deceased is turned to the right; only in this figure is evident the special treatment of fingers (Photo 2). The deceased and pallbearers hold Illyrian helmet, which proves that the relief depicts a funeral of a military leader and a senior representative of the Dardanian high society.

The female touching the ark is set in the front of the ark, in the same direction as the deceased, and opposite of all other figures (Photo 2). Supposedly, she was the priestess of a funeral cult, an intermediary with divinity. Three other females perform a mortal dance having their right hands behind their heads and left ones on abdomens, two of them are placed at the Horizon I and the third one at Horizon II (Photo 3). Horizon II contains four male pallbearers with Illyrian helmets. They carry the ark of the deceased by four vertical beams, standing in the same line, yet they carry the ark on two opposite sides (Photo 4).

Three other male figures present lamenters; their hands are placed on their heads, respectively, they tear hairs. They wear trousers as well as other male figures do. Two animal figures, a deer and a horse, occupy the central space of the bottom part of the monument. On their right side are placed two other lamenters (Horizon III) (Photo 5). The absence of relief's left part allows no assumptions for the full relief's content.

Figurative mortal monument is the first of its kind discovered in Dardania and is unique in Balkans in general. Figurative composition in deep relief and with stone carving technique follows the tradition of woodcarving. It suggests that there are also other similar monuments created in wood, which did not survive to date, yet its presence notifies on the appearance of similar monuments in Dardanian space and beyond.

The composition holds a spirit of naive art; it has a clear language and elements of geometric phase in art development, respectively, anthropomorphic treatment through some geometric formulas. Geometric elements come into play through treatment of women's dresses, in particular in their triangular ends. Another important element is the impossibility to express perspective, especially presenting heads in profile and bodies en face, which is seen at the early art development stages of ancient civilizations.

Aware of the necessity of perspective presentation while unable to achieve it, the master artist sought three-dimensionality through a depiction of the deceased and the ark in horizontal position, while vertically

depicting the other figures. Absence of perspective is also noted in pallbearers being presented in the same line although they carry the ark on opposite sides. The master found an appropriate solution to the perspective presentation by putting the dividing line between ark's left edge and two carrier beams in the midst, thus notifying that pallbearers 2 and 3 are located on the opposite side of that of pallbearers 1 and 4. A solution in perspective presentation was likewise found by placing mortal dancers at different horizons: first two dancers at Horizon I and the third one at Horizon II.

The treatment of composition is barely subtle and short of details and decoration, which creates the impression that the master was carrying more for the expression of the composition as a whole. Details such as eyes, nose, scarves, Illyrian helmets, were inscribed only in cases when master considered it necessary. The monument might have contained some other details damaged over time.

While the presence of all figures is quite evident, the main dilemma is posed in the case of the female figure touching the ark. This figure precedes the funeral procession and the ritual itself, and it looks as if she is touching other levels except for the visible ones. Most likely she presents a female with a certain profession that helps the transference the soul of the dead in the hereafter, by touching the ark. Perhaps she was a priestess, or a nymph - an intermediary with the master of the world of death [Shukriu, E. (2014) and literature]. It can be assumed her relation with Dardanian Goddess; she presents thus one of her priestesses or a nymph, if not the Dardanian Goddess herself.

The role of three dancers is quite clear as they develop a divine dance to establish relations between earth and heaven. The cosmic / religious dance became a ritual of identification with the creator and creation in so-called tandava Shiva - nataraje Buddhist cosmic dance; Usma Dance for the Sun Goddess Amaterasu in Japanese sacred dances [Roberts, J. (2010) pp. 5, 120], in ancient China evoking the return of the spirit of the dead in the divine source, in Mediterranean cultures in Crete [Lavedan, P. (1931) pp. 317-318; Devambež, P. (1966) p. 142; Wright, C. M. (2001) p. 9], in Sioux Indians' Sun Dance or in that of the Dervishes [Dervish: <http://www.britannica.com/topic/dervish> (12.07.2015)]. Mortal dances are also present in Illyrian monuments, such as Japodic urns from Karakisica (Sinj), Klis (Split), Gradun (Cetina) [Dzino, D. (2008) pp. 371-380; Balen-Letunić, D. (2006); Rendić-Miočević, D. (1989) T. LXXXIV 1; T. LXXXV 1] or Ribic (Bihac) [Stipčević, A. (1981) p. 200].

The relief contains the concept of trinity, as it does the Roman period circuit labyrinth of Smira (Kosova), and the mosaic from Gamzigrad

(Serbia). The symbolism of the number three comes by the separation of the composition into three horizons, as well as by the presence of three dancers and three lamenters.

The dating of the monument is a complex issue as no analogies were found so far. An important element for dating and for determining the level of artistic and masterful relief is the absence of perspective presentation. In general, its iconographic content bears autochthon spirit created with a known local artistic language, and as expression of the native population's spiritual world. So, the monument is seen as the work of a local artist master, who acted during the transition phase of Dardanian society, from geometric phase of livestock-farming society, into the phase of anthropomorphic treatment of the pre-Roman urban Dardanian society.

The transposition of woodcarving technique in creating stone monuments, the lack of knowledge in perspective presentation, the presence of Illyrian helmets, and analogies with mortal dances at Japodic urns, leads to the conclusion that the relief was created during the pre-Roman period. In the preliminary stages, the monument was dated between III-I centuries [Shukriu, E. (2004) 84-85]. I think that dating should be placed between V-III centuries B.C., being suggested by the presence of Illyrian helmets whose production is limited around IV century B.C., but was being still in use in III century B.C.

Except for the fact that the mortal relief presents a new and unique representation, it also conveys the transcendental spheres and Dardanian cosmogony views, which were unknown until recently, and which need to be further revealed. This is suggested by the transference of the deceased's soul by touching the ark, or mortal dance and other associated actions, as well as the later monuments from the Roman period, which express the continuity and development of Dardanian cosmogony / cosmologic views.

Pre-Roman mortal figurative monument is the first of its kind discovered in Kosova; absence of analogies in the region and beyond makes it difficult to study, and in particular, to determine its chronological setting. Similar situation was found with the unique closed-circuit labyrinth, which was presented with the correct chronological designation in year 211, and which also revealed an array of unknown elements of Dardanian culture.

Although belonging to different periods, both monuments prove a developed spiritual world about which the ancient written sources do not refer. Indeed, ancient authors left no substantial records on rites at all; they are mostly known through tragedian works, or some traces of the Athenian funeral legislation [Kurtz, D.C. - Boardam, J. (1971) pp. 142-143].

Bibliografia / Bibliografy

- Anamali, Skënder (1957) “Një monument varri i zbuluar rishtaz në Apolloni”, Buletini Shtetëror i Tiranës, Tiranë, nr.1, ff. 201-205.
- Balen-Letunić, Dubravka (2006), Japodi. Arheološka svjedočanstva o japodskoj kulturi u posljednjem pretpovijesnom tisućljeću, Ogulin.
- Devambež, Pierre et al. (1966) Dictionnaire de la Civilisation Grecque, Fernand Hazan, Paris.
- Dobruna-Salihi, Exhlale (2005) “Newly discovered funerary monument in Kosova presenting the funeral ritual among the Dardanians in Roman period”, *Illyrica Antiqua*, Arheološki Muzej u Zagrebu, Zagreb, pp. 199-208.
- Dobruna-Salihi, Exhlale (2001) “Dy monumente sepulklare nga koha romake të zbuluara tash vonë në Kosovë”, GJA, Instituti Albanologjik, Prishtinë, ff. 217-234.
- Dzino, Daniel (2008) The people who are Illyrians and Celts: Strabo and the identities of the ‘barbarians’ from Illyricum, *Arheološki Vestnik* 59, pp. 371-380.
- Janson, Horst W. (1969) *Istorija umetnosti*, Prosveta, Beograd.
- Komata, Damjan (1989) “Veprat e artit ilir në ekspozitën e Hildeshajmit, Iliria 2, Instituti Arkeologjik, Tiranë, ff. 221-222.
- Kurtz, Donna C. - Boardman, John (1971) *Greek Burial Customs*, Thames & Hadson, New York-London.
- Lavedan, Pierre (1931) *Dictionnaire illustré de la Mythologie et des Antiquités grecques et romaines*, Librairie Hachette, Paris.
- Rendić-Miočević, Duje (1989) *Iliri i antički svijet*, Književni krug, Split.
- Roberts, Jeremy (2010) *Japanese Mythology A to Z* (2nd ed.), Chelsea House Publishers, New York.
- Salis, Arnold von (1937) “Neue Darstellungen griechischer Sagen, 2. Picenum”, *Sitzungsberichte der Heidelberg Akadmeie der Wissenschaften Philosophie - Historie Klasse 1*, Hedielberg.
- Sergejevski, Dimitrije (1950) “Japodske urne”, *GZMBH IV-V*, Sarajevo, pp. 44-94.
- Sokoli, Ramadan (1971) *Vallet dhe muzika e të parëve tanë*, Tiranë.
- Shukriu, Edi (2014) *Hyjnesha Dardane*, ASHAK, Prishtinë.
- Stipčević, Aleksandar (1981) *Kultni simboli kod Ilira*, Balkanološki Institut, Sarajevo.

- Tirtja, Mark (2004) *Mitologjia ndër shqiptarë*, Shkenca, Tiranë.
- Toynbee, J.N.C. (1971) *Death and Burial in the Roman World*, Thames & Hadson, New York-London.
- Xhemaj, Ukë (2003) *Etnokultura shqiptare në Podgurë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Wright, Craig M. (2001) *The Maze and the Warrior: Symbols in Architecture, Theology and Music*, Harvard University Press, Cambridge.

PESË MONUMENTE EPIGRAFIKE NGA SMIRA

Në Smirë (Komuna e Vitisë, Kosovë) janë zbuluar monumente të vlefshme epigrafike, të cilat janë shfrytëzuar si material ndërtimor në xhaminë e vjetër të Smirësdheu gjetën pas rrënimit të saj. Këto monumente zënë vend të posaçëm në epigrafinë dardane dhe më gjerë, si ngapërmbajtja e teksteve, onomastika, simbolet e paraqitura dhe arkitektura e tyre. Monumentet e evidentuara vijuese sjellin të dhëna të vlefshme për thellimin e njohurive rreth zhvillimeve në Dardani dhe në rajon:

1. Monumenti votiv (ara) përkushtuar Hyjneshës Dardane është monument i parë i zbuluar në Kosovë me përkushtim Hyjneshës Dardane dhe i pari i trajtuar në katër faqe, me dy tekste identike dhe me dy labirinte. Labirintet lidhen drejtpërdrejt me ciklin e jetës dhe me përfytyrimin dardan të universit të përjetshëm. Sipas konsujve romak Gentiano dhe Basso, monumenti epigrafik datohet në vitin 211, kur nis ringjallja e kulturës shpirtërore edhe në gjithë territorin ilir;¹

2. Monumenti votiv (ara) përkushtuar Jupiterit (IOM) sjell për herë të parë nomenin Asclepiades, i cili është njohur më parë vetëm si kognomen grek;

3. Monumenti votiv (ara) përkushtuar Jupiterit (IOMN) është monument i rrallë, i cili në formulën dedikuese përmban katër shkronja, në vend të tri, si përmbajnë dedikimet e tjera. Veçanti tjetër është ngritja e monumentit nga përfaqësuesit e tribës Quirinius të Romës;

4. Monumenti mbivarror i C. Valerius Valensit, monument që sjell emra të rinj dhe po aq si risi sjell aklamacionin “tauta”;

5. Monumenti mbivarror i So(?) Aemiliano, i ngritur nga dekurioni i municipiumit të Smira.

1. MONUMENTI VOTIV PËRKUSHTUAR HYJNESHËS DARDANE

Monumenti votiv i përkushtuar Hyjneshës Dardane është monumenti më i vlefshëm epigrafik i zbuluar deri më sot në Kosovë (Foto 1- 3). Vlera e monumentit qëndron në teonominë prezente (përkushtimi një hyjneshe dardane) dhe në paraqitjet simbolike unike, të trajtuara në relief. Me

¹ Stipçeviq, A. (1983) f. 168.

arkitekturën katërfaqësore për t'u parë nga katër anë, monumenti po ashtu paraqet një raritet.²

Monumenti është punuar mbi kuadrant mermeri të bardhë, të përshkuar me ngjyrë të përhimtë (78 x 36 x 37 cm). Skalitja e bërë në të katër faqet e monumentit, me dy fusha të mbishkrimit dhe dy fusha simbolike – ornamentale (34,5 x 22,5 cm). Fushat e mbishkrimeve dhe të simboleve janë vendosur në korniza të theksuara (a, b, c, ç). Kapiteli dhe bazamenti i monumentit janë dëmtuar gati tërësisht. Në pjesën e poshtme të kapitelit duken gjurmët e gjetheve të lerthit, ndërsa nën to një brez me vija reliefore. Kapiteli kishte në pjesën e epërme edhe elemente të tjera, të cilat nuk mund të definohen për shkak të dëmtimeve.

Tekstet janë skalitur në kornizat e theksuara të fushës së mbishkrimit dhe përkushtimi hyjnisë (rreshti 1-2) dhe formula e përkushtimit (rreshti 7) janë skalitur pak më larg se nisma e tekstit. Shkronjat kanë module më të mëdha deri në rreshtin 7, pos shkronjës së zvogëluar I në rreshtat 3-4, shkronjës S në rreshtin 3 dhe shkronjës O në rreshtin 8. Në tekstin e parë (a) shkronja e zvogëluar I e rreshtit 3 është vendosur pas shkronjës V, ndërsa në tekstin e dytë (c) shkronja I është vendosur në brendi të shkronjës V. Emrat e konsujve janë skalitur me madhësi të përgjysmuar nga shkronjat e tjera (rreshti 8). Të gjitha shkronjat kanë skalitje të thellë dhe të rregullt. Teksti përmban serifë të theksuar horizontal dhe trekëndësh.




Foto 1 Monument përkushtuar Hyjneshës Dardane (Smirë)


Dy faqet ballore kanë të skalitura dy tekste identike, njëri i ruajtur plotësisht, ndërsa tjetri i dëmtuar nga gjysma e rreshtit 5 (Foto 2). Tekstet e monumentit:

² Shukriu, E. (1989) ff. 15-21.

Faqja a	Faqja c
DEAE	DEAE
DARD	DARD
ARTORVS	ARTORV↓
HERACL	HERA
5 TVS SPEC	5 TV
LEC III FL	
V S LM	
GENTIANoTBASSo	

Leximi i teksteve:

- a. Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tus spec(ulator) / leg(ionis) III Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) / Gentiano et Basso
- c. Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tu[s spec(ulator) / leg(ionis) III Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) / Gentiano et Basso]



a

c

Foto 2 Tekstet në monumentin përkushtuar Hyjneshës Dardane

Formula e plotë e përkushtimit Deae Dard(anicae) në monumentin e Smirës është i pari i këtij lloji i zbuluar në Kosovë (janar 1988). Më parë njiheshin dy monumente nga kolonia romake Romula-Malva e Rumunisë,³ ndërsa pas vitit 1999 janë gjetur në Kosovë edhe dy të tjera në Gllamnik të Podujevës (Vendenisi antik).⁴ Këtë hyjneshë e paraqet dhe shtatorja nga Mediana te Nishi (Serbi),⁵ monumentet votive nga Baja e Kurshumlisë⁶ dhe Kamenica (Serbi) dhe dorëza e paterës nga Branetiçi i Ulët.⁷ Me të lidhet dhe busti i njohur si Busti i Gruas nga Vërboci, figura e hyjneshës në monedhat me mbishkrim DARDANICI, monumenti votiv në kishën e Lypjanit (Kosovë)⁸ dhe mbase dhe shtatorja e gruas nga Suhareka - Theranda.

Monumenti votiv u ngrit nga Artorius Heraclitus, vëzhgues (speculator)⁹ i legjionit IV të Flavëve. Artorius është nomen joperandorak gentil, i përhapur në Itali, Afrikë, Galinë Jugore dhe në Dalmaci.¹⁰ Ky nomen, i pidentifikuar në pjesën qendrore të Europës Juglindore, duket për herë të parë në monumentin votiv të Smirës, ndërsa kognomeni Heraclitus ka prejardhje helene dhe si i tillë është identifikuar edhe në arën përkushtuar Asklepit, Telesforit dhe Higisë, të gjetur në Prizren.¹¹ Mbështetur në emrat e konzujve romak, Gentiano dhe Basso (rreshti 8), monumenti është ngritur në vitin 211.¹²

Përderisa në faqet me mbishkrime është përdorë teknika e skalitjes, në dy faqet e tjera të monumentit gjenden dy labirinte të realizuar me teknikë relievi (Foto 3). Njëra faqe përban labirintin rrethor të qarkut të mbyllur (Faqeja b) dhe faqeja e kundërt labirintin në trajtë katërkëndëshi (Faqeja ç). Simbolet janë vendosur në korniza të theksuara, ngjashëm me ato të fushave të mbishkrimit.

Faqja b me labrint rrethor është mjaft komplekse, se tërësia e saj

³ Tudor, D. - Vladescu, C. (1977) pp. 183-189; Tudor, D. (1978); Tudor, D. (1973), pp. 115-126; Shukriu, E. (2014) ff. 30-35.

⁴ Shukriu, E. (2014) ff. 30-35, 38-40, 41-42. Për monumentin e parë nga Vendenisi shih: Dobruna-Saliu, E. (2012) pp. 217-224, ndërsa për foton e monumentit të dytë: Dobruna-Saliu, E. (2005) Tab. 163, Fig. 304 - N. 355 (51).

⁵ Jovanović, A. (1980) pp. 53-59.

⁶ Mirdita, Z. (1981) f. 252, nr.239; Vulić, N. (1948) nr. 22.1.

⁷ Popović, I. (2007) p. 35.

⁸ Mirdita, Z. (1981) f. 254, nr. 250.

⁹ Titullin "speculator", pjesë e "res militaris", e mban dedikanti i arës nga Graçanica (shek. II) dhe Batusha: Mirdita, Z. (1981), 248 nr.217; 252 nr. 241.

¹⁰ Alföldy, G. (1969) p. 62.

¹¹ Šašel, A. et J. (1986) p. 261.

¹² Shukriu, E. (2004) pp. 9-32; Shukriu, E. (2001) ff. 17-37; E. Shukriu (1991) ff. 33-39.

kompozicionale është e ndarë në tri nënkompozicione: I. Hardhia e rrushit, II. Rrethi i qarkut të mbyllur dhe III. Lerthi (Foto 3a). Hardhia e rrushit është relievuar në pjesën e epërme të kompozicionit dhe përbëhet nga kalaveshi i rrushit (në të djathtë) dhe gjethi i hardhisë (në të majtë). Përmes një ripi harkor hardhia e rrushit lidhet me degë të lerthit me dy gjethe në pjesën e poshtme të kompozicionit. Degët e lerthit janë ndërlidhur me një nyjë të theksuar profilaktike, e cila mbron hyrjen në pjesën qendrore me rreth të mbyllur.

Në brendinë e rrethit të mbyllur gjenden shtigjet në trajtë harku, përmes të cilave janë realizuar dhe gjashtë kryqe të thyera (svastika), tri në drejtim lindje - perëndim (lindje) dhe tri në drejtim të perëndim - lindje (vdekje/ringjallje). Në qendër gjendet gjysmësfera e theksuar, si qendër dhe cak i rrugëtimit nëpër labirint. Sfera e paramenduar është ndarë në tri pjesë përmes tri gjysmëharqeve.

Ndonëse në dukje të parë Faqja b ka renditje vertikale: rrushi - rrethi i mbyllur - lerthi, nga analiza e plotë e kompozicionit kuptohet se cikli i paramenduar nis nga hardhia e rrushit (I), vazhdon me lerthin dhe nyjen profilaktike (II), pastaj vijnë shtigjet në brendi të rrethit të mbyllur dhe përfundon me arritjen në qendër (III). Kështu, cikli i rrugëtimit është si vijon: rrushi - lerthi - rrethi i mbyllur dhe arritja në qendër, e cila gjendet në mesin e gjithë kompozicionit të Faqes b.

Paraqitja e simbolit të diellit është e shpeshtë në kohë e kultura të ndryshme. Dielli me një apo dy rrethe gjendet dhe në monumentet epigrafike të periudhës romake të përkushtuara Jupiterit e, më rrallë, Cererës, si janë ato të Panonisë së Epërme (Panonia Superior).¹³ Por labirinti rrethor i Smirës është shumë më kompleks, si tërësi më vete, por dhe si i shoqëruar me rrushin (lëng i jetës), lerthin (gjithëherë i gjelbër dhe simbol i vdekjes - ringjalljes). Në religjionet e vjetra të Lindjes së Afërme hardhia është konsideruar bimë e shenjtë, ndërsa vera pije hyjnore dhe frut i jetës, sepse identifikohet me gjakun, ndërsa në kultin e Dionisit hardhia paraqitet si simbol sakral, i ringjalljes dhe i pavdeksisë.¹⁴ Rrushi dhe lerthi, veç e veç apo të kombinuar, janë veçori të monumenteve mbivarrore dardane të periudhës romake, duket të përcjella nga monumentet prej druri të periudhave para-prake.

Faqja ç me labirint katërkëndësh është po ashtu simbol i paidentifikuar në pjesën qendrore të Europës Juglindore (Foto 3b). Ky lloj i labirinteve duket si simbol apo si element dekorues në Knosos,¹⁵ Egjipt, Samos dhe Itali,¹⁶ si

¹³ Hofflier, V. - Saria, B. (1938) p. 22, nr. 125, 146 11 etc..

¹⁴ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 337.

¹⁵ Kanlif, B. (1964) p. 273.

¹⁶ Enciklopedija (1964) p. 273.

dhe në urnat etruce në trajtë të shtëpive.¹⁷ Labirinti është vendosur në portat e qyteteve të fortifikuara dhe në maketat e shtëpive të vjetra helene, ndërsa sipas Virgjilit, ishte i skalitur në dyert e Shpellës së Sibilës në Kumë.¹⁸

Monumenti i Hyjneshës Dardane i Smirës sjell si risi dhe trajtimin katërfaqësor, i cili paraqitet për herë të parë në territorin e Kosovës. Paraqitja katërfaqësore nënkupton se monumenti është vendosur në një hapësirë ku mund të shihej nga të gjitha anët.

Analogji më të afërta të trajtimit në katër faqe gjenden te monumentet epigrafike të rrethit të Prijepoljes të Malit të Zi. Të tilla janë arat nga Kolovrati, të cilat i përkasin rrethit kulturor ilir dhe në të cilat, si në Dardani, dominojnë si elemente simbolike dhe dekoruese hardhia e rrushit dhe lërthi.¹⁹ Përpunime në tri faqe të monumenteve gjenden në territorin e Norikut, ku paraqiten dhe hyjtë në trajtë antropomorfe.²⁰ E tillë është ara përkushtuar Minervës nga Celeia, ajo e Jupiterit nga Petovia, e Mitrës dhe Silvanit, ndërsa ato me paraqitje simbolike të hyjve duken më rrallë.²¹



Foto 3 a: Labirinti dardan rrethor i qarkut të mbyllur (Faqja b)
b: Labirinti helen katërkëndësh (Faqja ç)

¹⁷ Kanlif, B. (1964) p. 11.

¹⁸ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 655.

¹⁹ Zotović, M. (1975) pp. 179-183, Photo 1, 2 ff.

²⁰ Zotović, M. (1975) pp. 179-183.

²¹ Hoffiller, V. - Saria, S. (1938) pp. 22, 125, 146.

2. MONUMENTI VOTIV PËRKUSHUTAR JUPITERIT: IOM

Monumenti votiv (ara) përkushtuar Jupiterit është ruajtur mirë dhe është skalitur në mermer të bardhë, i cili ka degëzime të kuqërremta të xeheve së hekurit (105 x 48 x 40 cm. Foto 4).

Bazamenti monumentit nuk ka dekorim, por në kapitël gjendet ornament i relievor, përcaktimi i të cilit është e pamundur të bëhet për shkak të dëmtimeve. Megjithatë, duket se në mes kishte një simbol, nën të cilin gjendet i trajtuar brezi relievor horizontal. Ky brez përfundon në pjesët e skajshme me nga një rreth, në mes të cilit gjendet bukranioni (?). Edhe skajet e fundme të kapitëlit kanë paraqitje relievore, sot jo të qarta për zbërthim.

Fusha e mbishkrimit nuk është vënë në korniza (57 x 39 cm) dhe teksti është i plotë, pos dëmtimit në mesin e rreshtit 6. Teksti i monumentit:

I O M
 PROSA_VT
 DOMINOR
 NNAVGG
 5 IMPPASCL
 PIA SSEP
 VILPOSVIT
 ALBINO ET
 AEMILIANO
 10 CO S

Leximi i tekstit:

I(ovi) O(ptimo) M(aximo) / prosalut[e] / dominor(um) / nn(ostrum) avg(ustorum) / impp(eratorum duorum)²² Ascl[e] / pia[de]s Sep(timius) / vil(icus) posuit / Albino et Aemiliano / co(n)s(ulibus)

Formula e përkushtimit zë gjithë gjërësinë e fushës së mbishkrimit dhe shkronjat kanë lartësi prej 5,5-6 cm. Nga rreshti 2-4 shkronjat kanë lartësi prej 5 cm, ndërsa nga rreshti 5 prej 4 cm.

²² Është fjala për dy perandorë: Septim Severin dhe Antoninin.

Teksti ka shkurtesa të krijuara me suspenzion (rreshti 4 dhe 5), me kontrakcion (rreshti 10) dhe ka vetëm një hederë (rreshti 4). Teksti përmban dhe serifetë theksuara, të cilat janë vënë horizontalisht apo në trajtë trekëndëshi.

Nomen Asclepiades paraqitet për herë të parë si nomen në arën e Smirës. Deri më tash u njoh vetëm si kognomen grek,²³ i dëshmuar shumë rrallë, si në tri raste në Salona²⁴ dhe në monumentin e Graçanicës (shek.III).²⁵

Kognomen Septimius duket si nomen dhe kognomen perandorak gjatë sundimit të Septim Severit dhe është mjaft i përhapur në Itali, Afrikë, Norik dhe, ndonëse më pak, në Dalmaci.²⁶ Ky gentilic perandorak duket më pak në Mezinë e Epërme, ndërsa si kognomen paraqitet vetëm në arën e Smirës. Termi vilicus, pos në këtë monument, është dëshmuar në monumentin nga Timacus Minus (Serbi), Llapasella dhe Ulpiana te Graçanica.²⁷ Ara datohet në vitin 206, sipas palës konsulare Albino dhe Aemiliano.

²³ Alföldy, G. (1969) p. 157.

²⁴ Šašel, A. et J. (1986) p. 242 nr. 2309.

²⁵ Mirdita, Z. (1981) p. 85.

²⁶ Mirdita, Z. (1981) pp. 478-479.

²⁷ Mirdita, Z. (1981) p. 24.



Foto 4 Monumenti votiv i përkushtuar Jupiterit: IOM

3. MONUMENTI VOTIV PËRKUSHTUAR JUPITERIT: IOMN

Monumenti përkushtuar Jupiterit ka të ruajtur vetëm pjesën e epërme, të përbërë nga kapiteli dhe katër rreshtat e parë të mbishkrimit (Foto 5).²⁸ Monumenti është skalitur në trajtë kuadranti në mermer të bardhë, të përshtuar me ngjyrë të kuqërremtë (46 x 48 x 65 cm). Kapiteli ka trajtë katrori të theksuar dhe një kupolë, në mesin e së cilës gjendet vrima e vogël e libacionit, me diametër prej 7 cm. Teksti i monumentit:

I O M N

TF_L Q VIRINVS

TSTAT_OL CRES

NTILLAE

Leximi i tekstit:

I(ovi) O(ptimo) M(aximo) N(oster) / T(itius) Fl(avius) Quirinus / T(riba) statio L(abut?) Cres[ce]ntillae [...]

Formula e përkushtimit gjendet në kapitel, ndërsa teksti është skalitur në gjithë sipërfaqen ballore të monumentit, pa korniza të fushës së mbishkrimit (40 x 33 cm). Teksti ka një hederë trekëndëshe, midis shkronjave L dhe C (rreshti 3), ndërsa nuk është i sigurt ekzistimi i hederës midis shkronjave L dhe A (rreshti 4). Në rreshtin 3 ekziston ligatura e shkronjave T, I dhe O.

Formula e dedikimit huyt Jupiter duket jo aq e zakonshme, andaj dhe e rrit vlerën e monumentit. Në të janë skalitur katër shkronja, në vend të tri shkronjave, të rëndomta në shumicën e monumenteve votive të përkushtuara Jupiterit (IOM).

Tri shkronjat e para të formulës së dedikimit janë lehtë të lexueshme, por shkronja pak e dëmtuar e fundit shtron dilemën e ekzistimit të shkronjës N apo të shkronjës M. Përderisa shkurtesa OM nënkupton epitelin e hyut Jupiter si Optimus Maximus, ky mban dhe epitete të tjera të shumta, të cilat nisin me shkronja të tjera, por pak prej tyre fillojnë me shkronjën N ose M.

²⁸ Ara u gjet në shtëpinë e Mustafë Durmishit, për dallim nga monumentet e tjera nga rrënojat e xhamisë së vjetër.

Me shkronjën N, përkatësisht me formulën e përkushtimit IOMN duket dhe epiteti Numerius, ndërsa paraqitja me shkronjën M mund të nënkuptojë dhe M(arcus). Përkushtimi Jupiterit mund të jetë i shoqëruar dhe me hyjneshën Minervë, andaj dhe shkurtesa M në këtë rast mund të jetë M(inervae). Por, duhet pasur parasysh se kjo e fundit paraqitet me emër të plotë: IOMMINERVE, si paraqitet dhe Mel(ano): IOMMEL.

Analiza e hollësishme e formulës së përkushtimit sjell në përfundim se më parë është fjala për shkronjën N. Në këtë përfundim sjell fakti se largësia nga shkronja N deri te skaji i djathtë, ku është vendosur formula e përkushtimit, është e njëjtë me largësinë e skajit të majtë deri te nisma e dedikimit, përkatësisht shkronja e parë I.

Elementi i dytë është se fundi i djathtë i shkronjës N është i thelluar dhe asesi nuk mund të jetë shkronja M, aq më tepër që nuk është skalitur njëjtë si shkronja M para saj dhe kjo nuk mund të jetë rastësi. Për këto arsye dhe nga fakti se monumentin e ngritën anëtarët e tribës Quirinius nga Roma, mendoj se shkronjën N duhet lexuar si shkurtesë e përemrit N(oster), me ç'gjë kanë bërë dallim midis Jupiterit të tyre romak nga ai i popullatës vendore, që paraqitej si interpretim romak i hyut vendor (interpretatio romana).

Prenomen Titius është gentilic joperandorak, i përhapur në provincat romake,²⁹ ndërsa nomeni Flavius është emër perandorak po ashtu mjaft i përhapur.³⁰ Nomen Crescentilla dëshmohej për herë të parë në Kosovë, por si kognomen është prezent në territorin dardan³¹ dhe, ndonëse i rrallë dhe i veçantë, është i përhapur dhe në vende të tjera.³² Monumenti datohet në kapërcyell të shek. II-III.

Vlera e monumentit rritet edhe me prezencën e tribës Quirinus, e cila ishte me prejardhje nga Roma dhe e cila nuk është paraqitur më parë në monumentet epigrafike të Kosovës antike. Paraqitja e saj dhe e formulës së rrallë të dedikimit, e cila nuk duket në monumentet e tjera përkushtuar Jupiterit është dëshmi se dedikantët nuk ishin vendës.

²⁹ Alföldy, G. (1969) p.127.

³⁰ Alföldy, G. (1969) pp. 38, 205.

³¹ Mirdita, Z. (1981) f. 220.

³² Alföldy, G. (1969) p. 182.



Foto 5 Monumenti votiv i përkushtuar Jupiterit: IOMN

4. MONUMENTI MBIVARROR I C. VALERIUS VALENS

Monumenti mbivarror (stella) i ngritur për C.Valerius Valens³³ është mjaft e ruajtur (Foto 6). Është skalitur mbi një pllakë mermeri të bardhë, të përshkuar me kokërza të gjelbëra, me trajtë katërkëndëshi (108 x 87 x 12 cm).

Në faqen ballore gjendet fusha e mbishkrimit (Foto 6a), ndërsa në të prapmen rozeta-yll me gjashtë rrema, e përshkuar në brendi me vija

³³ Shukriu, E. (1991) ff. 33-38.

harkore (Foto 6b). Stella është dëmtuar në pjesën e majtë dhe në të poshtmen, ndërsa gjatë rrënimt të xhamisë është ndarë në tri pjesë. Fusha e mbishkrimit, e ruajtur në tërësi, është e thelluar dhe e rrethuar me kornizë relievore, pa zbukurime. Teksti i monumentit:

C VAL VALENS VIXITAN
 NIS XXVII H S E
 C VAL VIATOR FRATRI
 PIINTI S S I M OATQVE
 5 C ONSERVANTIS SIMO
 B M P
 ET SIBI SI BOSVO
 ETIVLIAEMARCELLINAE
 M ATRICARISSIME E
 10 LERIAE FLAVIAE CO
 NAIAE VIVIS FECIT

T A V T A

Leximi i tekstit:

C(aius) Val(erius) Valens vixit an / nis XXVII h(ic) s(itus) e(st) / C(aius)
 Val(erius) Viator fratri / piintissimo atque / conservantissimo / b(ene)
 m(erenti) p(osuit) / et sibi suo / et Iuliae Marcellinae / matri carissime elI /
 Leriae Flaviae Co /naiae(?) vivis fecit / tauta

Modulet e shkronjave të skalitura kanë lartësi prej 4 cm, ndërsa gjerësia e tyre ndryshon. Ligatura dhe shkurtesa nuk ka, por ka serifë të shumta, si vija horizontale dhe vertikale. Pika është e vetnja hederë dhe kjo është vendosur gabimisht (rreshti 4) ose nuk është vënë fare kur është dashur (rreshti 1, 9).

Stella është ngritur në fund të shek. I ose fillimi i shek. II. Përcaktimin e tillë kohor e mundëson mungesa e ligaturave, veçori e monumenteve të shek. I dhe fillimit të shek. II; prezenca e pikave si shenja të ndarjes (hedera), veçori e monumenteve të shek. I-II,³⁴ mungesa e

³⁴ Petrović, P. (1975) pp. 83, 96, 102.

formulës DM, që nuk duket para shek. II; prezenca e formulës HSE, e cila nuk është dokumentuar para shek. II dhe prezenca e formulës BMP, e cila është përdorur nga fillimi i shek. II në punëtoritë e Mezisë së Epërme.

Onomastika e monumentit përmban rregullat e tria nomina latine, duke dëshmuar kështu përkatësinë latine të bartësve të saj. Në monument përmenden Caius Valerius Valens i ndjerë, Caius Valerius Viator (vëllai që ngriti monumentin), Iulia Marcellina (nëna) dhe Valeria Flavia Conaia(?). Prenomen Caius (rreshti 1 dhe 3) është latin dhe si prenamen duket për herë të parë në Dardani, ku më parë është dëshmuar vetëm si kognomen dhe të cilin e mbajnë personat me gentilic Iulius.³⁵ Praenomen Leria (rreshti 10) nuk është dëshmuar deri më tash në Dardani, por gjendet si gentilic jo shumë i përhapur.³⁶ Si nomen joperandorak ndeshet në trajta të ndryshme në Itali, ndërsa në monumentin nga Salona gjendet në trajtën Lereia.³⁷

Nomen Valerius (rreshti 1 dhe 3) është gentilic joperandorak dhe si kognomen, me bartës prejardhjesh të ndryshme, duket në Italinë veriore, Gali, Panoni dhe Daki.³⁸ Nomen Iulia (rreshti 8) është gentilic perandorak, mjaft i përhapur në shek. II, por ishte në përdorim prej kohës së Cezarit e deri në shek. V.³⁹ Ky nomen duket shumë shpesh në territorin e Shkupit, ku ishin të vendosur “milites deducti” me prejardhje të huaj, ndërsa në Kosovë është dëshmuar në monumentin e Prizrenit dhe atë të Dërsnikut.⁴⁰ Nomen Flavia (rreshti 10) është po ashtu emër i përhapur, sidomos në provincat danubiane dhe në Afrikë.⁴¹ Si nomen perandorak është i shpeshtë te individët me prejardhje latine në monumentet e shek. II të Mezisë së Epër.

³⁵ Mirdita, Z. (1981) pp. 39-40.

³⁶ Schulze, W. (1904) p. 273.

³⁷ Schulze, W. (1904) p. 93.

³⁸ Alföldy, G. (1969) pp. 131, 321.

³⁹ Alföldy, G. (1969) pp. 31-32.

⁴⁰ Mirdita, Z. (1981) ff. 40-41.

⁴¹ Schulze, W. (1904) pp. 38, 205.



a



b

Foto 6 Stella e C.

Valerius Valens (a); Rozeta në anën e pasme të stellës (b).

Kognomen Valens (rreshti 1) ka përhapje të gjerë⁴² dhe duket shpesh edhe në Mezinë e Epërme dhe në Maqedoni.⁴³ Është i përhapur dhe kognomeni Viator (rreshti 3),⁴⁴ të cilin e mban dedikanti. Pasi që C.Valerius Valens paraqitet si beneficiar konsular i legjionit IV të Flavëve në arën e Mitrovicës të shek. II, duket se është fjala për të njëjtin person, i cili vdiq në moshën 27-vjeçare. Kognomeni Marcellina (rreshti 8) është mjaft i përhapur⁴⁵ dhe paraqitet si deminutiv i emrit latin Marcella (Marcellus), duke u konsideruar si nomen i venetëve.⁴⁶

Emri Conaia(?) (rreshti 10-11) nuk duket mjaft i qartë. Si gentilic joperandorak në trajtën Conia duket shpesh në territoret kelte.⁴⁷ Kur kihet parasysh se monumenti iu ngrit dhe nënës Iuliae Marcellinae, e paraqitur me “duo nomina”, atëherë dhe Leriae Flaviae ka “duo nomina” dhe mund të interpretohet si gruaja e tij: con(iugi), por ngelin shkronjat AIA, që është çështje që duhet shqyrtuar më tej.

Nocioni “tauta” (rreshti 12) është i rrallë dhe me origjinë jo latine, andaj dhe krijon vështirësi për t’u zbrëthyer, pos konstatimit të mëhershëm se është fjala për një aklamacion që ka kuptim në gjuhën greke. Në monumentet sepulklare greke zakonisht është përdorë termi χαῖρε (haire) – lamtumirë. Ndër monumentet e pakta me nocionin është ai nga Museo Archeologico di Aquileia e gjysmës së shek. III, i shkruar në gjuhën greke: ΤΑΥΤΑ (rreshti 17).⁴⁸

Në mesin e analogjive të pakta të gjetura është mbishkrimi latin i sarkofagut të ngritur vajzës trivjeçare Secundilla, i cili përfundon me formulën bilingvistike (latine dhe greke) dhe me alfabet grek: Απομᾶτι - ταῦτα.⁴⁹ Kjo shpie në përfundim së dedikuesit kanë qenë me prejardhje helene. Andaj, përkundër tekstit të shkruar në gjuhën latine, përdorimi i nocionit të gjuhës greke “tauta” në monumentin epigrafik të Smirës mund të flet për të njëjtën prejardhje apo për ndikimet helene. Duke qenë e shkruar në monumentin mbivarror kuptimi i nocionit “tauta” zbrëthet si arritje - hyrje në derën e jetës tjetër.

⁴² Alföldy, G. (1969) pp. 318-319.

⁴³ Šašel, A. et J. (1986) p. 497.

⁴⁴ Šašel, A. et J. (1986) p. 52; Alföldy, G. (1969) p. 326; Mirdita, Z. (1981) p. 116.

⁴⁵ Alföldy, G. (1969) p. 224; Šašel, A. et S. (1986) p. 218.

⁴⁶ Alföldy, G. (1969) pp. 236-237.

⁴⁷ Schulze, W. (1904) p. 77.

⁴⁸ *Scrinari, V. S. M. (1972) Inv. no. 260; University of Cologne, Archaeological Institute Köln* [http://arachne.uni-koeln.de/arachne/index.php?view\[section\]=uebersicht&view\[layout\]=inschrift_item&search\[constraints\]\(dt. 10.09.2016\).](http://arachne.uni-koeln.de/arachne/index.php?view[section]=uebersicht&view[layout]=inschrift_item&search[constraints](dt. 10.09.2016).)

⁴⁹ Mullen, A. (2013) p. 206.

Termi “tauta”: ταῦτα paraqitet te shumë shkrimtarë e filozof grekë në kuptime të ndryshme. Te Platoni idea është identike me diç tjetër: “tauton”, e kundërt nga gjërat e tjera: “thateron”, dhe lidhet me konceptin e Zotit. Është përdorur disa herë dhe në komedinë e Menandrit “Samia” (Gruaja nga Samia), që mendohet se është përcjellë me gestikulime dhe që ka nënkuptuar vizionin, ehon dhe aromën e Athenës apo jetën e Athenës.⁵⁰

5. MONUMENTI MBIVARROR I SO (?) AEMILIANO

Pllaka mbivarore (stella), e ngritur nga një dekurion, është ruajtur në tërësinë arkitektonike (70 x 2,23 cm), por e ka mjaft të dëmtuar fushën e mbishkrimit (66 x 32 cm). Edikula ka trajtë gjysmëharkore (66 x 32 cm). Kjo dhe fusha e mbishkrimit janë vendosur në korniza të relievuara. Në edikulë është paraqitur simboli i diellit me rreze të zgjatura, ndërsa anët e fushës së mbishkrimit janë përshkuar me hardhi të rrushit. Hardhia e rrushit del nga një enë dyvegjake, e vendosur në fund të stellës, ikonografi kjo tipike për trojet darane. Teksti i monumentit:

D M
SO EM
VI
NNI XXX
5 EST
VS
DECM TA
REX NIPO

Leximi i tekstit:

D(iis) M(anibus) / So[...] IAEm(iliano) / vi[xit] / [a]nni[s] XXX / [hic situs] est / [...]us / dec(urio) m(unicipii) [...]ta / rex nipo[te]

Sipas hapësirës në tekstin e dëmtuar duket se i ndjeri kishte tria nomina. Emri që nis me shkronjat SO mund të lexohet si So(Ilius) apo So(da), të cilat nuk duken shpesh në trojet dardane. Sollius është gentilic

⁵⁰ Sommerstein, A. (2013) pp. 133, 134

joperandorak,⁵¹ ndërsa Soda duket si kognomen latin, i dëshmuar në monumentin e shek. II në lokalitetin Çuçer.⁵² Kognomen Aemillianus është një kognomen mjaft i shpeshtë joperandorak.⁵³ Stella datohet në shek. II apo në fillim të shek. III.

Përfundime nga analiza e monumenteve epigrafike të Smirës

Monumentet epigrafike të zbuluara në Smirë, me shumësinë e tyre dhe me të dhënat që ofrojnë, sjellin një varg elementesh të reja dhe të rëndësishme për arkitekturën e monumenteve epigrafike të Dardanisë, teogoninë, onomastikën, zhvillimin filozofik-religjioz, çështjet e prejardhjes dhe identitetit, si dhe për prezencën e municipiumit në afërsi, me banorë vendës dhe të huaj.

Në mesin e monumenteve epigrafike ai përkushtuar Hyjneshës Dardane ka rëndësi të veçantë, pasi që është monument i parë i tillë i zbuluar në Kosovë me përkushtim kësaj hyjneshe; është monument i parë i punuar në të katër faqet; është i vetmi monument në pjesën qendrore të Europës Juglindore dhe në veri të saj ku paraqitet labirinti dhe është i vetmi që përmban kompozicion të simboleve të kombinuara, që në kuptimin sublim paraqesin ciklin e jetës dhe përfytyrimin dardan të universit të përjetshëm.

Vendosja e dy labirinteve në arën Hyjneshës Dardane, në veçanti e labirintit rrethor të qarkut të mbyllur, shpreh njohuritë e kohës me kuptim të thellë filozofik-religjioz. Përfundimi nxirret kur kihet parasysh se vetëm më të urtit që i përballojnë sprovat e iniciacionit arrijnë në qendër të labirintit, ku gjenden ndriçimi i të njohurit sublim, fuqia dhe përjetësia.⁵⁴ Pasi që labirinti (pallat i sëpatës dytehëshe), i paraqitur përmes sëpatës dytehëshe (labrys) është simbol i Zeusit rrufehjellës dhe simbolizon Diellin, simbolet e paraqitura në faqet anësore të kësaj are përputhen në simbolizmin e tyre, duke dhënë paraqitjen autoktone të diellit - universit (labirinti rrethor) dhe paraqitjen jo vendëse të labirintit (labirinti katërkëndësh). Ky gërshetim i simboleve vendëse dhe jo vendëse është rezultat i prejardhjes helene të dedikantit (mbase dhe jo), i cili shërbeu si ushtar – vëzhgues në Dardani.

Labirinti rrethor paraqet një shkallë më të lartë të besimit dhe të

⁵¹ Alföldy, G. (1969) p. 121.

⁵² Mirdita, Z. (1981) ff. 135, 223 nr. 61. Cognomen Sodali paraqitet te libertinët: Kajanto, I. (1969) p. 306.

⁵³ Alföldy, G. (1969) p. 55.

⁵⁴ Mircea, E. (1964) p. 312.

njohurive, që rrjedh nga zhvillimi i kultit solar. Ky kult është dëshmuar te dardanët mjaft shumë në objektet e epokës së hekurit në arkitekturën dhe trajtat e tumave dhe sidomos me vendosjen e dy simboleve të rrugës diellore në varret e tumës në Shirokë të Suharekës.⁵⁵ Kontinuiteti i kultit solar është dëshmuar nga burimet e shkruara tek peonët fqinj edhe në shekullin II.⁵⁶

Paraqitja e diellit duket edhe në arat përkushtuar Jupiterit dhe, më rrallë, Cererës, por tek këto simboli i diellit është tejet i thjeshtë. Simboli i diellit në arën e Smirës është kompleks dhe deri më sot unik, kur kihet parasysh edhe kombinimi me svastikat, hardhinë, lerthin e nyjen profilaktike. I gjithë kompozicioni, bashkë me rrahët që krijojnë gjashtë (6) svastika, pos simbolit të diellit dhe rrugëtimit diellor, paraqet ciklin e përhershëm të jetës dhe përfytyrimin dardan të universit. Paraqitja e tillë paralajmëron dhe klerarkinë e krijuar të religjionit dardan, si dhe zhvillimin e kosmogonisë dhe të kosmologjisë dardane.

Edhe sfera në qendër të kompozicionit, e ndarë në tri pjesë, paraqet tërësinë qiell-tokë, përkatësisht relacionet tokë - qiell - nëndhe. Simbolet e tjera, hardhia dhe lerthi e përforcojnë këtë relacion, ndërsa nyja që lidh dy degët e lerthit, të lidhura dhe me degët e hardhisë, del si mbrojtëse e hyrjes. Ndonëse paraqitja e nyjes profilaktike është e shpeshtë dhe bart traditat totemike e kultet bujqësore të epokës së neolitit, më vonë u konsiderua si vetë nyje e jetës apo një labirint përmes të cilit duhet kaluar për të arritur deri tek qendra (zgjidhja dhe çlirimi).⁵⁷ Në këtë drejtim shihet dhe nyja në arën e Smirës, pra si një hyrje imagjinative në jetë e në misteret e saj.

Lerthi e hardhia e rrushit, veçmas apo të dyja bashkë, që dalin nga një enë, janë elemente karakteristike të monumenteve mbivarrore (sepulkrale) të Dardanisë të periudhës romake dhe këto janë simbole të trashëguara nga periudha parahistorike. Lerthi duket si ornament dhe në enët dardane të punuara në çark të shekujve V-IV p.K., ndërsa dëshmi për paraqitjen e hardhisë te dardanët para periudhës romake nuk ka, por kjo nuk e mohon prezencën e saj edhe me parë.

Sipas dëshmimeve të derisotme dedikanti Artorius Heraclitus ishte me prejardhje greke dhe fakti se ai e ngriti monumentin përkushtuar Hyjneshës Dardane flet për rolin dhe rëndësinë e kësaj hyjneshe, ndërsa kompozicioni i tërësishëm i simbolit të diellit-universit, hardhisë dhe lerthit flet për shumësinë e funksioneve të Hyjneshës Dardane, të përvetësuar në

⁵⁵ Shukriu, E. (1990) ff. 103-112; Këto janë konsideruar gabimisht si pulla: N. Djurić (1965) pp. 537-539.

⁵⁶ Stipčević, A. (1981) pp. 17, 33, fn. 2.

⁵⁷ Chevalier, J. – Gheerbrant, A. (1983) pp 99-100.

ecejaket kohore⁵⁸dhe kryesinë e saj të panteonit dardan. Kufizimi i funksionit të Hyjneshës Dardane vetëm në suazat e plleshmërisë apo të territorit do të thotë thjeshtëzim dhe zbehje e funksioneve të saj.

Ndonëse dielli konsiderohet edhe si mbarsës,⁵⁹ kjo hyjneshë nuk duket më vetëm hyjneshë e plleshmërisë, e territorit apo vetëm si psihopomp mortal dhe hierofont iniciacistik (dy funksione të mëvonshme të diellit), por, sipas arës së Smirës ajo zë vendin e hyut më të rëndësishëm të panteonit dardan, duke u bërë hyjneshë e ringjalljes së përgjithshme dhe e përjetshmërisë.

Elemente krahasuese mund të gjenden dhe te hyjneshat kelte Nehalennia dhe Epona, për të cilat M. Green konstanton se përfshinin shumë aspekte të jetës: lindjen, zhvillimin, plleshmërinë, rigjenerimin, mbrojtjen nga demonët e deri tek fati i njerëzimit pas vdekjes.⁶⁰

Labirinti rrethor me qarkun e mbyllur paraqet një shkallë më të lartë të besimit dhe të njohurive dardane, përkatësisht të një shkalle të lartë filozofike-religjioze, që rrjedh nga zhvillimi i mëtejme i kultit solar dhe vrojtimit e analizat e qiellvrojtuesve - priftërinjve dardanë. Analiza e këtij labirinti sjell si përfundim se koncepti i trinisë kishte zënë rrënjë në kohën e ngritjes së monumentit, pasi që çdo element përmbajtësor i kompozicionit ndahet në tri pjesë: 1) a. hardhia e rrushit, b. labirinti rrethor, c. dega e lërthit; 2) tre kryqe të thyera me rrema në të majtë (lindja); 3) tre kryqe të thyera me rrema në të djathtë; (vdekja); 4) ndarja në tri pjesë e sferës qendrore. Natyrisht, kjo është çështje për studime të mëtejme.

Çështje për studime të mëtejme është dhe formula tauta, e shkruar në tekstin e pllakës mbivarrore të C. Valerius Valens (Monumenti 4. Foto 8). Tauta trajtohet si fjalë greke: ταῦτα⁶¹ dhe është përdorur në Greqinë antike me kuptime të ndryshme. Platoni (“Etika”) e përdor nocionin në kuptimin se ideja është identike me “diç tjetër” (tauton) dhe se në të njëjtën kohë është e ndryshme nga “gjërat e tjera”: thateron. Nëse “tauton” kupton “diç tjetër”, formula “tauta” do ta kishte kuptimin qendër / ide / perëndi.

Në aspektin onomastik monumentet përmbajnë onomastikë dhe formula të llojllojshme. Në to mbase paraqitet për herë të parë formula dedikuese IOMN (Monumenti 3); prenomenet Caius dhe Leria (Monumenti 4);⁶² nomenet Artorius (Monumenti 1), Asclepiades (Monumenti 2) dhe Crescentilla (Monumenti 3); kognomeni Conaia (?)

⁵⁸ Shukriu, E. (2010a) pp. 571-575; Shukriu, E. (2010b) pp. 160-164.

⁵⁹ Chevalier, J. – Gheerbrant, A. (1983) p. 655.

⁶⁰ Green, M. (1989) p. 9.

⁶¹ Greek Word Study Tool:

<http://www.perseus.tufts.edu/hopper/morph?l=tau%3Dta&la=greek> (dt. 11.01.2015).

⁶² Në Dardani është dëshmuar vetëm si kognomen.

(Monumenti 4); triba romake Quirinus (Monumenti 3) dhe formula TAUTA (Monumenti 4). Formula TAUTA shtron dhe çështjen e prejardhjes së familjes së Caius Valerius Viatorapo të përafërsive të tyre me gjuhën - kulturën helene.

Sipas dy monumenteve të Smirës mund të dëshmohet dhe prezenca e një vendbanimi më të madh në afërsi (monumentet 2, 5). Nga emri i vendbanimit janë ruajtur vetëm dy shkronjat e fundit: ...TA, ndërsa hapësira e dëmtuar lë mundësi të prezencës së katër shkronjave paraprake, që mund të lexohet si Labutza e Prokopit apo vetëm si Labuta.

Vendbanimi gjen relevancën arkeologjike në Gradinën e gjerë të fshatit Gushicë pranë Smirës. Në të gjenden objekte të shumta të periudhës romake dhe i vazhdimi të jetës gjatë periudhës së hershme bizantine, sië dëshmojnë dhe mikrotoponimet Kisha e Rimit në Gushicë e Ledenci te Kisha, Kisha apo Qeremidana në Smirë.

Në përgjithësi të gjitha të dhënat që i ofrojnë monumentet epigrafike nga Smira e shtrojnë nevojën për studime edhe më të thelluara shumëdimensionale për sferat e kulturës materiale, shpirtërore dhe filozofike të vetë Dardanisë, por edhe më gjerë.

Tabela onomastike

	<i>monum.</i>	<i>p.nomen</i>	<i>nomen</i>	<i>kognomen</i>	<i>aklamacia</i>	<i>tribë</i>
1	DEAE DARD		Artorius	Heraclitus		
2	IOM		Asclepiades	Septimius		
3	IOMN	Titius	Crescentilla			Quirinus noster?
4	DM - Valens	Caius Caius	Valerius Valerius Iulia Leria	Valens Viator Marcellina Flavia	Tauta	
5	DM - So...		Sollius / Soda (?)	Aemillianus		





Foto 9 Edikulë e monumentit epigrafik



Foto 10 Fragment stele



a

b

c

Foto 11 Elemente arkitektonike prej mermeri nga Smira:

a. Kapitël i stilit jonik; b. Kapitël; c. Shtyllëza

Summary

EPIGRAPHY MONUMENTS FROM SMIRA (KOSOVA)

At the Smira village (Municipality of Vitia, Kosova) in 1988 were discovered epigraphy monuments which were used as spolia in the old mosque. Monuments present a great interest due to their text content, onomastics, symbols and architecture and they are important finds of the Dardanian epigraphy and wider. Discovered following epigraphy monuments bring important data for deepening knowledge on developments in Dardania and in the region:

1. Votive monument (ara) dedicated to Dea Dardanicae is the first discovered monument dedicated to this deity and the first one treated in four faces, with two identical texts and two labyrinths;

2. Votive monument (ara) dedicated to Jupiter (IOM), which brings for the first time nomen Asclepiades, known before only as a Greek cognomen;

3. Votive monument (ara) dedicated to Jupiter (IOMN) is rare monument holding four letters at dedicative formula and it is built by representatives of triba Quirinius of Rome;

4. Sepulchral monument of C. Valerius Valensit, which bring new names and notion "tauta";

5. Sepulchral monument of So (?) Aemiliano, built by decurion of municipium.

1. VOTIVE MONUMENT DEDICATED TO DEAE DARDANICAE

The monument is done in quadrant white marble overwhelmed with gray color (78 x 36 x 37 cm) on its four sides (two inscription fields and two symbolic fields), to be seen from all sides [Shukriu, E. (1989) pp. 15-21]. Inscriptions and symbols fields are placed in emphasized frames (34,5 x 22,5 cm).

The capitel and the base are almost completely damaged. In the bottom of the capitel hold the traces of ivy leaves stay, while beneath them a track of relief lines. The other elements of the capitel's upper part are missing.

Two front sides hold engraved two identical texts, one of them is damaged from half of the line 4 (Photo 1- 3). Dedication (lines 1-2) and formula (line 7) are engraved a little farther than the text beginning. Letters

have large modules up to line 7, except the reduced letter I (lines 3, 4), the letter S (line 3) and the letter O (line 8). In the first text (a) reduced letters I decided after the letter V (line 3), while in the second text (b) the letter I is placed inside the letter V (line 3). The names of the consuls are engraved in half sizes (line 8). The text contains emphasized horizontal and triangle serifs.

The dedication formula *Deae Dard(anicae)* holds the full text and it is the first one discovered in Kosova. Previously two monuments from Romula-Malva (Romania) were known [Tudor, D. - Vladescu, C. (1977) pp. 183-189; Shukriu, E. (2014) pp. 30-35] and after 1999 two other have been found in Gllamnik of Podujeva (ancient Vendenis) [Shukriu, E. (2014) pp. 38-40, 41-42].

Dardanian Goddess is presented at the statue from Mediana (Serbia) [Jovanović, A. (1980) pp. 53-59], monuments from Kurshumlia Spy and Kamenica (Serbia) and in the handle of patera from the Low Branetic [Popović, I. (2007) p. 35]. In relation to this deity the known may be linked Bust of Woman from Verboc, coins with Goddess figure and inscription DARDANICI, the votive monument in Lipjan church (Kosova) and even a statue of a woman from Suva Reka / Theranda (Kosova) [Shukriu, E. (2004) pp. 52-64].

Epigraphy monument was dedicated by Artorius Heraclitus, speculator of the Legion IV Flavia. Artorius is non imperial nomen which appears in Kosova for the first time, but is known in Italy, Afrika, Southern Galia and Dalmatia [Alföldy, G. (1969) p. 62]. Cognomen Heraclitus has a Greek provenience and it was identified at monument dedicated to Asclepius, Hygeia and Telesphoros (Prizren). Monument is dated in the year 211 according to consuls names Gentiano and Basso (line 8) [E. Shukriu (1991) ff. 33-39 etc.].

In the two lateral sides of the monument two relieve labyrinths are placed, close circle (c) and quadrant (d) (Photo 3). Circle labyrinth consists of composition of the "sun", grape vine and ivy branches linked by prophylactic knot (Photo 3a). Even though Face b seems to have vertical appearance (grape vine – close circle – ivy brunch), the journey starts from grape vine (I), continues through the ivy brunch and prophylactic knot (II), follows the paths forming 6 swasticas inside the close circuit and ends by arriving in the center (III). In the center stays emphasized semi sphere, divided by three arches.

Quadrant labyrinth's side is also an unidentified symbol in the central part of Eastern Europe (Photo 3b). The form appears as a symbol or decorative element in Knossos [Kanlif, B. (1964) p. 273], Egypt, Samos and Italy [Enciklopedija (1964) p. 273] as well as at the early Etruria urns in the shape of houses [Kanlif, B. (1964) p. 11]. Labyrinth was located at

the gates of fortified cities as well as at the molds of Hellenistic old houses. According to Virgil, was sculpted at the Sybil's Cave doors in Kuma [Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 655].

2. MONUMENT DEDICATED TO IUPITER: IOM

Monument dedicated to Jupiter is sculpted in white marble with reddish iron oreramikation (105 x 48 x 40 cm) and it is well saved (Photo 4). Unclear relieve ornament stays on the capitel while the foundation it is not decorated. The inscription field (57 x 39 cm) is with no frames and it is damaged from the middle of the line 6. The dedication formula takes the whole width of the inscription field with 5.5 - 6 cm height letters. Lines 2-4 have 5 cm height letters and 4 cm from the line 5. Text has one hedera (line 4), abbreviations are done by suspension (line 4, 5) and contraction (line 10). Serifs are horizontal and triangular.

Nomen Asclepiades appears for the first time as nomen, but is known as Greek cognomen [Alföldy, G. (1969) p. 157] which appears very rare as in Salona [Šašel, A. et J. (1986) p. 242 nr. 2309] and one in Gračanica [Mirdita, Z. (1981) p. 85]. Cognomen Septimius appear as imperial nomen and cognomen during the rule of Septimius Severus. This gentilicium appears less in Upper Moesia, while as cognomen is present only at Smira's ara. Monument dates in the year 206 according to the consuls Albino and Aemiliano.

3. MONUMENT DEDICATED TO IUPITER: IOMN

Dedication to Iupiter is stored at the upper part, capitel and the first four lines of the inscription (Photo 5). The monument is sculpted in quadrant shape white marble, overwhelmed with reddish tint (46 x 48 x 65 cm). Square form capitel has highlighted dome in which center stay a small libation hole (diam. 7 cm). The dedication formula engraved on the front side of capitel and the following text at all frontal surface of the monument without field frames of inscription (40 cm x 33 cm). Text has one triangle hedera, between letters L and C (line 3), while the existence of hedera between letters L and A (line 4) is not sure. It also has one ligature of letters T, I and O (line 3). Monument dates at the turns of the II-III centuries.

Dedication formula to Jupiter seems unusual as it has four letters and its last letter raise dilemma if it is letter N or M. Two main elements lead to conclusion that letter N was in place: 1. Right end of letter N is deeper and

it is not similar to the previous letter M and 2. Same distance between the left side of capitel, respectively the beginning of dedication formula and between letter N and the right end of capitel. For this and as monument was done by the tribe Quirinius from Rome I suppose that letter N should be read as N(oster), separating thus their Roman Jupiter from local one.

Praenomen Titius is non imperial gentilicium and it is spread at all Roman provincës [Alföldy, G. (1969) p. 127] as well as imperial nomen Flavius [Alföldy, G. (1969) pp. 38, 205]. Nomen Crescentilla appears for the first time in Kosova, but as cognomen is present in the Dardanian territory [Mirdita, Z. (1981) p. 220] and, although rare and special, is widespread in other countries [Alföldy, G. (1969) p. 182].

4. SEPULCHLAR MONUMENT OF C. VALERIUS VALENS

Sepulchral monument built to C. Valerius Valens is almost saved at all (Photo 6) [Shukriu, E. (1991) ff. 33-38]. It is done on a white marble rectangle slab with green grains (108 x 87 x 12 cm). On the front is the inscription field; while at the back is engraved rosette-star (Photo 6b). Stella is damaged on the left side and below. Inscription field is deepened and placed on undecorated relieved frame.

Modules of engraved letters are 4 cm height, while width varies. It has not ligature and shortcuts, but there are numerous horizontal and vertical line serifs. The point is the only hedera set incorrectly (line 4) or not set at all when it was needed (lines 1, 9). Monument date at the end of I or beginning of II century. Onomastics contain tria nomina, indicating Latin affiliation of the carriers.

Praenomen Caius (lines 1, 3) is Latin and it appears for the first time as such in Dardania, proven before as cognomen [Mirdita, Z. (1981) pp. 39-40]. Leria (line 10) is proven as rare gentilicium [Schulze, W. (1904) p. 273], since in Salona is proven as Lereia [Schulze, W. (1904) p. 93]. Nomen Valerius (lines 1, 3) is non-imperial gentilicium and often appears as cognomen [Alföldy, G. (1969) pp. 131, 321]. Nomen Iulia (line 8) is imperial gentilicium [Alföldy, G. (1969) pp. 31-32] and appears in ancient Scupi and today's Prizren and Dërsnik (Kosova) [Mirdita, Z. (1981) ff. 40-41]. Nomen Flavia (line 10) is imperial one [W. Schulze (1904) pp. 38, 205] and it appear at the monuments of the II century in Upper Moesia, being linked to the Latin origin individuals.

Cognomens Valens (line 1) and Viator (line 3) are widespread in Moesia Superior and Macedonia [Schulze, W. (1904) pp. 38, 205; Alföldy, G. (1969) pp. 318-319]. Cognomen Marcellina (line 8) is wide spread [Šašel, A. et J. (1986) p. 52; Alföldy, G. (1969) p. 326]. Cognomen

Conaia(?) (lines 10-11) is not very clear. Being non-imperial gentilicium Conia appears often in celt territories [Schulze, W. (1904) p. 77]. Having in mind that monument was raised also to mother Flaviae Leriae with duo nomina, Leriae Flaviae can be interpreted as its wife: con(iugi), but remain letters AIA, which should be further interpreted.

Notion “tauta” (line 12) is rare and of non-Latin origin that for is not so easy to decipher, except the earlier statement that is an acclamation in Greek language. Greek funeral monuments usually hold the term χαῖρε (haire). Between rare monuments with this notion is that from Museo Archeologico di Aquileia of the second half of the III century written in Greek: TAYTA (line 17) [*Scrinari, V. S. M. (1972) Inv. no. 260*]. The bilingual Latin and Greek formula written in Greek alphabet holds also the sarcophagus with Latin inscription: apomōti - ταῦτα [Mullen, A. (2013) p. 206]. The use of the notion “tauta” in the Smira case could also indicate the origine or helen influence as the entrance to the other life.

5. SEPULCHLAR MONUMENT OF SO... AEMILIANO

Sepulchral monument is well preserved in its architectural integrity (70 x 2.23 cm), but its field inscription is damaged (66 x 32 cm). It has semi arc aedicule (66 x 32 cm) which together with field inscription are placed into the relieved frame. In aedicule stays the sun symbol, while the inscription field frames are overwhelmed with grape vine that comes from the two-handed pot placed at the end of monument.

It seems that the deceased had tria nomina. Praenomen starting with letters SO can be read as So(Ilius) [Alföldy, G. (1969) p. 121] or So (da) from site Cucer in Macedonia [Mirdita, Z. (1981) pp. 135, 223], infrequent in Dardania, while non imperial cognomen Aemilianus is frequent. Monument dates at the II century or the beginning of the III century.

*

Conclusions

Epigraphy monuments from Smira bring new and important elements concerning the architecture of the Dardanian epigraphic monuments, their theogony, onomastic, philosophical-religious development and origin, identity issues as well as on the presence of a municipium. Among them the monument dedicated to the Dea Dardanae has a special significance as it contains the combined composition of symbols presenting the circle of life and image of eternal universe; is the

first one treated at four sides; is the first one holding two labyrinths and it proves the Dardanian philosophical - religious development and the denied presence of cosmogony and cosmology.

Two different labyrinths overlap in their symbolism, one with Dardanian origin (Photo 3a) and that of non-domestic origin (Photo 3b). They express the deep philosophical - religious Dardanian knowledge of the times and lead to the conclusion that the Dardanian Goddess was a goddess of the general resurrection and eternity. That for the limitation of her functions only in frames of fertility or territory means simplification and paleness of her developed functions in mean time.

The symbol of the sun at the Smira monument is far complex and unique as it is combined with grape wine, ivy, prophylactic knot, six swastikas and sphere in the centre. Such presentation warns created Dardanian religious hierarchy and development of the Dardanian cosmogony and cosmology as the result of the surveys of Dardanian sky-watchers / priests.

Epigraphic monuments contain multiple names and formulas (see: Tabela onomastike) as are praenomina Titius (Monum. 3) and Caius (Monum. 4), nomina Artorius (Monum. 1), Asclepiades (Monum. 2), Crescentilla (Monum. 3) and Valerius, Iulia and Leria (Monum. 4), cognomina Heraclitus (Monum. 1), Septimius (Monum. 2), Valens, Viator, Marcellina and Flavia (Monument 4), Roman tribe Quirinus (Monument 2) and formula TAUTA (Monument 4).

Issue for further studies presents formula TAUTA (Photo 8), which is of the Greek origin: ταῦτα and it was used in ancient Greece with different meanings. Plato uses it in "Ethics" in the sense that the idea is identical with "something else" (tauton) and that at the same time is different from "other things" (thateron). If tauton is understood as something else, tauta would have the following meaning: center / idea / god. This formula raises also the issue of the origin of C. Valerius Viator family or their links with Greek language / culture.

After the monuments 2 and 5 can be proven the presence of the settlement ending with letters...TA. Damaged space allows the presence of four previous letters, that for is possible to recognize the name as Labutza of Procopius. The archaeological relevance can be seen at Gradina of Gushica, which holds a lot of Roman period and Early Byzantine remains as well as micro-toponyms Kisha e Rimit (Roman Church), Kisha (Church), Qeremidana ect. In general, all the data provided by epigraphic monuments from Smira call for deeper multi disciplinary researches concerning Dardanian and other cultures.

Bibliografia / Bibliography

- Alföldy, Géza (1969) Die personennamen in der römische Provinz Dalmatia, Carl Winter universitat, Heidelberg.
- Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) Riječnik simbola, Nakladni zavod Hrvatske, Zagreb.
- Enciklopedija likovne umjetnosti 3 (1964) Leksikografski zavod Federativne Narodne Republike Jugoslavije, Zagreb.
- Djurić-Slavković, Natalija (1968) "Ilirski tumuli kod S. Reke", GMKM IX, Priština.
- Dobruna-Salih, Exhlale (2012) "Votivna ara *deae dardanicae* i beneficijarna postaja iz Vendenisa", Vjesnik Arheološkog Muzeja u Zagrebu 3, Zagreb, pp. 217-224.
- Dobruna-Salih, Exhlale (2005) Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake, IA, Prishtinë.
- Green, Miranda (1989) Symbol and Image in Celtic Religious Art, Routledge, London - New York.
- Hoffiller, Victor - Saria, Balduin (1938) Antike inschriften aus Jugoslavien, Noricum und Pannonia Supperior, Zagreb.
- Inscripțiile Daciei Romane, vol. II, Oltenia și Muntenia, eds. Gr. Florescu, C. C. Petolescu, București.
- Jovanović, Aleksandar (1980) "Prilog proučavanju skulptura sa Medijane", Niški Zbornik 9, Niš.
- Kajanto, Iiro (1965) The latin cognomina, Societas Scientiarum Fennica, Commentationes Humanorum Litterarum XXXVI 2, Helsinki - Helsingfors.
- Kanlif, Bari (1964) Rimsko carstvo, Vuk Karadžić - Jugoslovenska Revija, Beograd.
- Mircea, Eliade (1964) Traite d'histoire des religions, Payot, Paris.
- Mirdita, Zef (1981) Antroponomia e Dardanisë në kohën romake, Rilindja, Prishtinë.
- Mullen, Alex (2013) Southern Gaul and Mediterranean – Multilingualism and Multiple Identities in the Iron Age and Roman Period, Cambridge University Press.
- Petrović, Petar (1975) Paleografija rimskih natpisa u Gornjoj Meziji, Arheološki institut, Beograd.
- Popović, Ivana (2007) "Dea Dardanica iz Mediane i srodni spomenici iz balkanskih provincija carstva", Niš i Vizantija - Simpozium 6, Niš.

- Schulze, Wilhelm (1904) *Zur geschichte lateinischer Eigennamen*, Weidmannsche Buchhandlung, Berlin.
- Scrinari, V. S. M. (1972) *Museo Archeologico di Aquileia. Catalogo delle sculture romane*, Roma.
- Shukriu, Edi (2004) “Dea Dardane - Ikonografia e monumenteve, simbolet dhe funksionet”, Kosova 26, Instituti i Historisë, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (2010a) “Two Labirints and Dardanian, Greek and Roman Relations”, Cinquième colloque sur l'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité, Université PierreMendes France, Grenoble 2008, Volume II, CRHIPA- De Boccard, Paris.
- Shukriu, Edi (2010b) “Two labirints and two identical texts on the Dardanian goddess”, ARKOS /Scienza e reastaurò/ 19, Cosenza.
- Shukriu, Edi (2001) “Dea e Dardanisë dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira”, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, ff. 17-37.
- Shukriu, Edi (1991) “Stella nga Smira dhe Gradina e Gushicës”, GJA 20 - Seria e Shkencave Historike, Instituti Albanologjik, Prishtinë, ff. 33-39.
- Shukriu, Edi (1990) “Kulti i diellit te Dardanët”, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën e popullit shqiptar, IA, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1989) “Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut”, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, XIV/1989, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, ff. 15-21.
- Stipčević, Aleksandar (1981) *Kultni simboli kod ilira*, CBI, knj. 10, Sarajevo.
- Stipčević, Aleksandër (1983) *Simbolet e kultit te ilirët*, Rilindja, Prishtinë.
- Šašel, A. et J. (1986) *Inscriptiones latinae quae in Iugoslavia inter annos MCMII et MCMXL repertae et editae sunt*, Situla 25, Ljubljana.
- Tudor, D. - Vladescu, C. (1977) “Dardanii la Romula – Malva”, *Apulum* X, Alba Iulia, pp. 183-190.
- Tudor, Dumitru (1973) “Recentele săpături archeologice-romane de pe valea Oltulin Inferior”, *Apulum*, 11, pp. 115-126.
- Tudor, Dumitru (1978) *Oltenia romană*, Editura Academiei Republicii Socialiste România, București.
- Zotović, Miroslava (1975) “Antički spomenici i predmeti sa lokaliteta Kolovrata kod Prijepolja”, *Raška baština* 1, Kraljevo.
- University of Cologne, Archaeological Institute Köln: [http://arachne.uni-koeln.de/arachne/index.php?view\[section\]=uebersicht&view\[layout\]=inschrift_item&search](http://arachne.uni-koeln.de/arachne/index.php?view[section]=uebersicht&view[layout]=inschrift_item&search). (11.10.2015)

SHANDANET PALEOKRISTIANE ME KRYQ NGA DARDANIA

Territori i Dardanisë, hapësirë udhëkryqesh gjeografike, kulturore dhe filozofike-religjioze, trashëgoi një pasuri komplekse dhe të veçantë të trashëgimisë kulturore edhe të antikës dardane. Këtë e dëshmojnë rezultatet e gërmimeve sistematike arkeologjike të një vargu të lokaliteteve arkeologjike, siç janë Ulpiana dhe Dërrsniku në Kosovë, Skupi në Maqedoni, Naisi, Gamzigradi dhe Cariçin Grad në Serbi e të tjera, por edhe objektet e veçanta luksoze dhe përmbajtësore nga lokalitetet e gërmuara, si dhe të atyre të gjetura rastësisht në kohë të ndryshme.

Në mesin e objekteve me vlera të jashtëzakonshme si gjetje rasti janë dhe dy shandanë paleokristianë me kryq nga Gradishta - Kalaja e Tërnocit të Madh. Shandanet janë bërë nga bronzi dhe janë të vetmit ekzemplarë të këtij lloji të zbuluar në rajon. Shandani i parë (Shandani 1) bën pjesë në shandanet me dorëza në trajte volute, me trup në trajtë vezore të zgjatur (Foto 1, 3a), ndërsa i shandani i dytë (Shandani 2) ka trajtë peshku (Foto 2, 3b).

Shandanet dallojnë nga llampat e llojllojshme të zbuluara në territorin e Dardanisë të periudhës romake dhe bizantine, ato nga qeramika dhe metali, të përdorimit shtëpiak, publik apo ritual. Këto janë të një kualiteti tejet të lartë, kanë teknikë të përsosur dhe detaje të përpunuara deri në imtësi dhe si të tilla kanë shërbyer për nevoja kishtarë. Duket se janë prodhuar në një qendër të rëndësishme të prodhimit jashtë Dardanisë.

Shandanet kanë qenë të vendosura në bazamente, po ashtu prej bronzi, nga fakti se këto objekte ndriçuese nuk kanë asnjë mbajtëse për t'u varrur. Këto, duke qenë mall tejet luksoz për kohën, dëshmojnë sa për përhapjen e krishterimit të hershëm, po aq dhe për zhvillimin ekonomik në Dardani, kontaktet e gjera tregtare dhe mbase për ekzistimin e një bazilike të madhe në afërsi. Një zhvillim i tillë shpjegohet dhe me vendosjen e arqipeshkvisë në Justiniana Prima të Dardanisë, e cila u bë qendër administrative dhe shpirtërore e gjithë Ilirisë.

Shandanet u gjetën rastësisht në një pitos të madh, pranë rrënojave të një shtëpie, nën murin rrethues të akropolit të Gradishtës - Kalasë. Në kohën e përnjohjes arkeologjike pitosi ishte mjaft i dëmtuar, por kishte mundësi të konstatohen dimensionet e gjerësisë së barkut të tij prej 1m. Bashkë me shandanët, në pitos është gjetur edhe një drapër hekuri dhe një dhëmb shtaze.¹

¹ Rekognoscimi arkeologjik u bë në maj të vitit 1985, pas informatës së M. Jasharit, ish-student i historisë në Universitetin e Prishtinës: Shukriu, E. (2003) pp. 19-23; Shukriu, E. (2002) ff. 217-230.



Foto 1 Pitosi ku u gjetën shandanet

Shandani 1

Shandani i parë bën pjesë në shandanet me dorëza në trajtë volute (Foto 2, 4a). Ky ka trup në trajtë vezore të zgjatur dhe grykë të gjatë, që përfundon me vrimë rrethore të theksuar nga brenda. Shandani qëndron mbi një bazë të pjerrtë dhe të ngritur rrethore prej 1 cm, në brendi të së cilës gjendet një vrimë e thellë për vendosje mbi bazament.

Në pjesën e epërme të trupit gjendet vrima rrethore për mbushje e cila është e theksuar me kornizë. Kapaku mungon. Dorëza ka trajtë kurore me voluta të mëdha, e zhvilluar me motiv të komplikuar vegetabil. Motivi i aplikuar nis nga të dy anët e pjesës së epërme të trupit dhe zhvillohet në dy harqe të mëdha që përfundojnë të bashkura me dy voluta të vogla. Mbi këto voluta është e vendosur një sferë mbi të cilën ngrihet kryqi malltezian, me rema gjatësish të njëjta. Kryqi zë hapësirën qendrore të dorëzës. Shandani ka gjatësi prej 18,5 cm, lartësi 11 cm dhe peshë 670 gr.

Shandani me dorëza në trajtë volutash dhe me kryq duket të jetë pak më i përhapur, megjithëkëtë duhet cekur se ky lloj i shandanëve është tip më i rrallë dhe jo aq i trajtuar. Analogjia më e afërt gjendet tek shandani nga Dumbarton Oaks Collection në Washington² apo ai nga Muzeu

² Ross, M. (1962) Pl. XXVIII.

Britanik, i cili ka edhe një shpend mbi kryq.³ Një ekzemplar nga Palermo ka formë të ngjashme, por me mjaft detaje dalluese të dorëzës dhe me kryq me rrema horizontal të vendosur më lart, që del drejtpërdrejt nga volutat anësore.⁴ Identik me atë të Palermos është edhe ekzemplari nga Muzeu i Sirakuzës.⁵ Këtij grupi i takojnë edhe ekzemplarët që i ofron H. Menzel, njëri pa kryq dhe tjetri me të.⁶

Shandani 2

Shandani i dytë është figural dhe mjaft specifik se është trajtësuar në formë peshku (Foto3, 4b). Peshku ka trup të lakuar që përfundon me bishtin e lartësuar në trajtë gjethi të hapur, ku gjendet edhe vrima rrethore për mbushje. Koka e peshkut zë pjesën qendrore të shandanit dhe në relief ka të theksuar buzët dhe krahët, ndërsa sytë e rumbullaksuar me bishta anash i ka të trajtësura me teknikë gërricjeje. Nga buzët e theksuara del gryka e gjatë, e cila përfundon me vrimë të kandilit. Gryka ka dy motive anësore relievo në trajtë trekëndëshi. Në majën e kokës së peshkut, mbi një sfond trekëndësh, është vendosur kryqi maltezan. Baza e shandanit ka trajtë rrethore të thjeshtë, me lartësi prej 1.5 cm. Baza ka një vrimë në mes përmes së cilës është fiksuar mbi një bazament të lartë, si në rastin e shandanit me dorëza në trajtë volute. Gjatësia e shandanit është 18 cm, lartësia 10,5 cm, ndërsa pesha 300 gr.

Për shandanin në trajtë peshku me kryq nuk janë gjetur ende analogji. Në Muzeun Popullor të Beogradit gjendet një llampë bronzi e krishterimit të hershëm në trajtë peshku, por ky nuk ka kryq,⁷ ndërsa në Viminacium është zbuluar një llampë një trajtë delfini, po ashtu pa kryq, nga gojë e të cilit del gryka e kandilit, ngjashëm si në ekzemplarin e Tërnocit.⁸ Peshku si simbol paraqitet dhe në llampat prej qeramike, siç është rasti me dy ekzemplarët masivë nga Salona.⁹

Peshku qysh herët ka qenë simbol i krishterimit, si dhe pëllumbi, delja, pema, degët e udhirit e të palmës, anija e të tjera,¹⁰ simbole të

³ Dalton, O. M. (1901) p. 100, Pl. XXVI, 496.

⁴ Fallico, A. M. (1971) Fig. 11.

⁵ Fallico, A. M. (1971) p. 147.

⁶ Menzel, H. (1969) p. 111, Abb. 91 2, Abb. 92 5.

⁷ Narodni Muzej (1970) p. 33.

⁸ Melchart, W. (1979) p. 123, Abb. 198.

⁹ Bubić, V. (2011) pp. 227-308, Pl. 10 90; Vikić-Belančić, B. (1971) pp. 158-169; Cambi, N. (1977) p. 94.

¹⁰ British Museum (1903) pp. 16-19.

trashëguara nga traditat pagane dhe të adaptuara në frymën e krishterë. Në Greqinë antike dhe në Romë hyjnesha Afroditë dhe Venerë identifikoheshin me peshkun dhe të premtëve peshku përgatitej si ushqim për ta ndjellë pjellshmërinë.¹¹ Hebrejët e lidhnin me aspekte përjetësie, si dhe në Kinë, ku besohet se peshku hante i vdekuri dhe me të bartte simbolizmin e ringjalljes dhe të rigjenerimit.¹²

Peshku ishte simboli i parë i pavarur në artin e krishterimit të hershëm, duke u paraqitur si simbol i Krishtit nga mesi i shek. II, ndërsa si ideogram lidhet me fjalën greke *ikhthys* (peshk) - Iesoūs Khristòs Theoū Hyiòs Sotér.¹³ Jezu Kishti, Djalë i Zotit, Shpëtimtar. Peshku simbolizon edhe individin e pagëzuar.¹⁴

Përkundër faktit se shandane identike me të Tërnocit të Madh nuk janë evidentuar në rajon, duhet cekur se janë zbuluar disa llampa paleokristiane me trajtë të zgjatur vezore dhe kryq.

Ekzemplarët e zbuluar në Stobi të Maqedonisë¹⁵; Salonë të Dalmacisë, identik me atë të Stobit, por me cepe të kryqit që përfundojnë me sfera¹⁶; Agorë të Athinës¹⁷ dhe në lokalitetin e panjohur nga Maqedonia, në të cilin dorëza ka trajtë zemre.¹⁸

Vendprodhimi i shandanëve të Tërnocit ngel çështje për diskutim. Sipas O. Dalton llampat prej bronzi me kryq janë prodhuar në Lindjen e krishterë, kryesisht në Egjipt,¹⁹ por numri i madh i gjetjeve në Sirinë e krishterë flet edhe për ekzistimin e qendrave të tjera të prodhimit. Duhet pasur në konsideratë se vetë llampat, si edhe monedhat, ishin objekte që transportoheshin lehtë dhe shpërndaheshin në të gjitha pjesët e perandorisë, andaj ishin dhe mjete propaganduese, të cilat shërbenin edhe për formimin e identitetit religjioz.²⁰

¹¹ Dunnigan, A. (1987) p. 346.

¹² Dunnigan, A. (1987) p. 346-347.

¹³ Hooke, S. H. (1961) p. 537; Sauser, E. (2004) pp. 35-36.

¹⁴ Dunnigan, A. (1987) p. 347.

¹⁵ Sokolovska, V. (1980) Fig. 555.

¹⁶ Bulić, F. (1894) p.p. 243, 246, T. VII 587.

¹⁷ Perlzweig, J. (1961) p. 200, Pl, 48, 2929; Perlzweig, J. (1963) Fig.70. Rremi i epërm i kryqit është më i gjatë, përdërisa rremat në ekzemplarët e Stobit dhe të Salonës kanë gjatësi të njëjtë.

¹⁸ Sokolovska, V. (1980) Fig. 554.

¹⁹ Dalton, O.M. (1901) p. 572.


²⁰ Shih: Curta F. (2011) pp. 303-321.





Foto 2 Shandani 1 (Tërnoc i Madh)



Foto 3 Shandani 2 (Tërnoc i Madh)



a



b

Foto 4 a. Shandani 1; b. Shandani 2 (Tërnoc i Madh)

Mungesa e një studimi të veçantë për shandanet e këtij lloji dhe klasifikimi i tyre e bën të vështirë përcaktimin më detaj kohor dhe prejardhjen e tyre. Sipas H. Menzel, këtyre u paraprinë shandanet me dorëza në trajtë volutash pa kryq të shek. II nga Dura-Europos,²¹ ndërsa sipas O. M. Daltonato me kryq u paraqitën nga shek. IV.²² A. Fallico, duke i trajtuar ekzemplarët e zbuluar në Sicili, i vendos në fund të shek. IV apo në fillim të shek. V deri në shek.VI.²³ Ekzemplarët nga Tërnoci i Madh mund të datohen në shek.V, më së voni në nismë të shek.VI, duke pasur parasysh dhe datimin në shek.V të ekzemplarëve të rrallë të zbuluar në rajon.

Gradishta (Kalaja) e Tërnocit të Madh

Gjetja e shandanëve të rrallë prej bronzi në Gradishtën - Kalanë e Tërnocit të Madh shtron nevojën që të ofrohen disa të dhëna për vetë lokalitetin. Vendbanimi i fortifikuar është vendosur mbi një kodër dominante, 3 km në veriperëndim të Tërnocit të Madh dhe të kolonisë së xeherores së antimonit – plumbit (Harta 1). Gjendej në anën e djathtë të rrugës antike Naissus – Scupi (kufiri i sotëm Kosovë – Serbi. Skica 1). Shpatijet veriore, lindore dhe jugore të kodrës janë tejet të rrëpinjta dhe të rrethuara me lumin e Tërnocit, andaj qasja në fortesë ishte e mundshme vetëm nga pjesa perëndimore.

Fortesa kishte dimensione prej 65 x 75 m dhe përbëhej nga pjesa e epërme – akropoli: Tarraca I dhe pjesa e poshtme: Tarraca II. Në të janë të dukshme gjurmët e mureve rrethuese me trashësi prej 1.5 m. Tarraca I apo akropoli shtrihej në pjesën më të lartë jugore dhe ka dimensione prej 40 x 30 m (Foto 5). Në pjesën veriore të Tarracës I gjenden themele të kullës vrojtuese (3 x 4 m), ndërsa kulla tjetër gjendej në pikëtakimin e mureve rrethuese të tarraceve I dhe II (2 x 3 m). Tarracat kanë qenë të lidhura njëra me tjetrën me shkallë guri, gjurmët e të cilave janë të dukshme në pjesën veriore të fortesës. Tarraca II e mbërthen Tarracën I nga të gjitha drejtimet, pos nga ana jugore, që është tejet e rrëpinjtë.

Tarraca I është më e ruajtur dhe deri vonë kishte mure deri me 3,5 m lartësi. Bedenet e dyfishta janë ndërtuar me teknikën opus mixtum, përmes kombinimit të gurëve dhe të tullave. Gjatë germimeve sondazhe të vitit

²¹ Menzel, H. (1969) p. 106.

²² Dalton, O. M. (1901) p. 572.

²³ Fallico, A. M. (1971) pp. 142-143, 147, Fig. 11.

1985 janë konstatuar pilastra të bedenit të jashtëm në çdo 3 m.²⁴ Në vetë fortesën duken gjurmë të shtëpive të shumta në trajtë katërkëndëshi, ndërsa themele shtëpishë ka edhe jashtë mureve rrethuese, në pjesën veriperëndimore. Në bedene dhe në konstruksionet e shtëpive është përdorë malltari i bardhë si material ndërlidhës. Janë prezente gjurmët e mureve masive, të ngritura me teknikën e kombinuar gurë-tulla, ndërsa përreth gjenden pjesë të materialit ndërtimor antik: gurë të përpunuar, tjegulla dhe tulla diemzionesh të mëdha. Në afërsi është gjetur dhe një stellë e shek. II.²⁵

Në rrëzët e fortesës, pranë ndërtesës së kolonisë së xeherores së antimonit, nga ana veriore e kanalit që bashkohet me lumin e Tërnocit janë gjetur pitosa të mëdhenj dhe tjegulla e tulla të shumta. Përreth ekzistojnë disa nekropole. Kështu, rreth 200 m në jugperëndim të fortesës, gjatë hapjes së trasesë për transportin e xeheve janë gjetur varre prej tullash të mbuluara me tjegulla. Pranë shkrites së plumbit është zbuluar nekropoli tjetër me varre prej tullash në trajtë katërkëndëshi, me mbulesë në trajtë çatie.

Në trasenë e rrugës antike në drejtim të qytetit antik Ulpiana, 0.5 km nga Tërnoci, është gjetur objekti katërkëndësh me kupollë (3.7 x 2.6 m). Godina kishte tjegulla me dimensione 33 x 24 x 5 cm. Në largësi prej 50 m në veri ngrehej një objekt tjetër më i madh, në mesin e të cilit dikur gjendej një burrim.²⁶

Krishterimi i hershëm në Dardani

Shandanët e krishterizmit të hershëm me kryq në Dardani në antike duhet parë si vazhdimësi e zhvillimit të krishterizmit, i cili nisi të përhapet në Dardani që në kohën e apostujve. Simbolet e hershme të krishtera janë evidentuar në llampat e zbuluara në nekropolin lindor të Scupit,²⁷ njërit nga qytetet më të rëndësishme të Dardanisë, ndërsa në shek. II u bënë martirë të krishterizmit të hershëm në Ulpianën dardane gurgdhendës Flori dhe Lauri. Këta, pasi i thyen idolet dhe tempullin e porositur pagan, ia përkushtuan Krishtit.²⁸ Për rolin dhe rëndësinë e këtyre martirëve të krishterizmit të hershëm për popullatën vendëse dëshmon prania e toponimeve me emrat e

²⁴ Čerškov, T. (1985) p. 286.

²⁵ Mirdita, Z. (1981) f. 233, Nr. 120.

²⁶ Čerškov, T. (1985) p. 286.

²⁷ Mikulčić, I. (1975) pp. 128-139.

²⁸ Gjini, G. (1986) pp. 56-57.

tyre, siç ishte kisha e Shën Florit dhe Laurit në Lypjan apo rrënojat e kishës së Shën Florit, jo larg Gllgovicës se Gallapit.

Në fillim të shek. IV Dardania kishte organizim të qëndrueshëm kishtar. Kryepeshkopia gjendej në Shkup (Scupi), ndërsa Ulpiana, qyteti tjetër i rëndësishëm i Dardanisë, ishte qendër peshkopale. Peshkopët e Ulpianës ishin aktivë në të gjitha konfliktet doktrinale të krishterizmit, që nga paraqitja e tij. Në Koncilin e Nikesë, nën udhëheqjen e perandorit Konstantin (viti 325), mori pjesë edhe Dacus Dardaniae, mitropolit i provincës dhe i qytetit, me të nënshtuarin e tij Budi nga Stobi (Budios Stobiensis),²⁹ ndërsa ipeshkvi Makedoni i Ulpianës mori pjesë në koncilin e Serdikës (viti 343: “Machedonius a Dardania de Ulpianis”).³⁰

Nga përshkrimi i Shën Jeronimit për gjendjen në Dardani dhe të sulmeve të fiseve që vinin nga veriu gjatë shek. IV nxirren përfundime mbi mishërimin e popullatës me krishterimin dhe prezencën e madhe të kishave dhe të njerëzve të përkushtuar kishës. Lidhur me këtë ai shkruan:

“...sa virgjëresha kushtuar zotit... u dhunuan në këto luftëra... u shkatërruan kishat...”

(Eusebius Hieronymus, Epistolae XL 16)

Letra e Papës Simah, ku shprehet mospajtim për bashkim me kishën e Konstantinopojës, dëshmon po aq për instalimin e hershëm në Dardani të klerarkisë kishtare, e cila në përbërjen e saj kishte peshkopë, meshtarë, xhakonë, presbiterë e arkimandritë, përfshirë dhe prezencën e të dy gjinive në jetën e manastireve.³¹ Nga shek. VI perandori bizantin Justiniani, me prejardhje nga Dardania, e bëri vikariat qytetin Iustiniana Prima (Justiniana e Parë), qendër administrative dhe shpirtërore të Ilirikut. Nën juridiksionin kishtar të tij ishin provincat Dardania, Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Mysia Prima, Praevalitana, Macedonia Secunda dhe Panonia Secunda. Vikariati veproi deri në vitin 733, kur iu nënshtua patriarkut të Konstantinopojës (Iustinianus, Novela XI, anno 535).

Si rezultat i frymës së krishterë nga gjiri dardan lindi Shën Niketa (rreth vitit 340), ipeshkv në Remesianë (366-414). Niketa dardan la në trashëgimi shumë vepra teologjike dhe diskutime, përfshirë edhe himnin e

²⁹ Gjini, G. (1986) p. 27.

³⁰ Gjini, G. (1986) p. 53

³¹ Gjini, G. (1986) p. 27: Thiel, A. (1868) p. 717.

njohur “Te Deum Laudamus” (“Zot, të lutemi”).³²

Të dhënat e burimeve të shkruara për jetën e organizuar kishtare në Dardani dhe mishërimin e hershëm të popullatës dardane me krishterimin e dëshmojnë edhe gjurmët e shumta arkeologjike të kishave paleokristiane të evidentuara në Kosovë dhe në trojet e tjera dardane, si dhe një varg toponimesh me proveniencë kishtare. Në mesin e lokaliteteve arkeologjike duhet përmendur bazilikat paleokristiane me mozaiqe në Ulpianë dhe rrethin e Ferizajit,³³ bazilika në Vërmicë të Prizrenit, kishat brenda fortesave të shumta dhe pranë tyre, siç janë ato në Veletin, Çukën e Brainës, Gadishën e Halilaçit, Kalanë e Korishës, Hisarin e Kastercit, Gradinën e Bajicës etj..

Të dhënat e përgjithshme lidhur me krishterizmin e hershëm në Dardaninë antike dhe fakti se një përqindje jo aq e madhe e lokaliteteve paleokristiane janë hulumtuar, sidomos në Kosovë, duhet të jenë nxitje për hulumtime të mëtejme arkeologjike. Objektet nga Scupi, Naiss, Cariçin Grad, Gamzigrad e të tjera është e nevojshme që të plotësohen dhe me të tjera, ashtu si ofruan gjërmimet më të reja në Ulpianë, me zbulimin e Bazilikës së Madhe dhe Baptisteriumit pranë saj.

Prezenca e shandaneve të krishterizmit të hershëm me kryq nga Tërnoci i Madh kanë rëndësi për vjeljen e të dhënave të reja lidhur me krishterimin e hershëm dhe, në veçanti, për konstatimin e relacioneve dardane me territoret fqinje dhe ato më të largëta.

³² Gjini, G. (1986) p. 58.

³³ U zbulua dhe portreti i Platonit, i vendosur në medajon.






Foto 5 Muret rrethuese të Tarracës I



Skica 1 Lokaliteti arkeologjik Gradishta - Kalaja, Tërnoc i Madh



Harta 1

Summary

THE EARLY CHRISTIAN CANDLESTICKS WITH CROSS FROM DARDANIA

Two Early Christian candlesticks with a cross were found in Gradishta / Kalaja of Tërnovc i Madh. Although this kind of bronze lamps is quite rare comparing to clay lamps, they are of much greater interest. The first one belongs to the chandeliers with volute-shaped handles (Candlestick 1) while the second one is a fish-shaped (Candlestick 2). Both of them were placed on missing pedestals.

Candlestick 1

Candlestick 1 has elongated egg-shaped body, a long neck and volute-shaped handles (Photo 1, 3a). The crown-like shaped handle with large volutes developed in a complex foliage motive, with a cross in the middle. It is 18.5 cm long, 11 cm high and weighs 670 grams. The closest analogy is found in the candlesticks at the British Museum, which contains a bird over the cross, differently from that from Tërnovc.

The candlesticks from Palermo, Syracuse, and those offered by H. Menzel, are of similar shapes, but with numerous distinctive details of the handle [Menzel, H. (1969) p. 111]. Other Early Christian lanterns with a cross and elongated egg-shape are discovered at Salona in Dalmatia, Stobi, and in an unknown site in Macedonia as well as in Agora of Athens.

Candlestick 2

Candlestick 2 is a fish-shaped, with a curved body ending in an elevated open-leaf shaped tail (Photo 2, 3b). The head of the fish has protruded lips and flanks on the relief, whereas the round and tail-shaped eyes are treated by a scraping technique. A long neck comes out of the fish lips ending in a round shaped hole for the candle. On both sides of the neck top protrude two relief triangular shaped motives. On top of the fish head, on a triangular background, an oriental cross is glued. Its arms end in curved edges. The candleholder is 18 cm long, 10.5 cm high and weighs 300 grams.

Two candlesticks from Tërnoc give evidence of a relatively high level of processing in a significant production center. No similar cases of fish-shaped candlestick with a crosshave been found so far. In National Museum of Belgrade is presented the fish-shaped bronze lantern belonging to early Christianity, but this item does not have a cross, as is the case with the dolphin from Viminacium.

The lack of a particular study of this kind of candlesticks and their classification makes it difficult to determine the time and the place of their production. It seems that these were preceded by candlesticks with volute-shaped handles without a cross of the II century from Dura-Europas [Menzel, H. (1969) p. 106], to those with a cross from IV century [Dalton, O. M. (1901) p. 572]. By treating specimens discovered in Sicily, A. Fallico sets them at the end of the IV century or the beginning of the V century [Fallico, A.M. (1971) pp. 142-143, 147]. Having in mind the given data, candlesticks from Tërnoc can be dated to V - beginning of VI century.

The presence of candlesticks with a cross from Tërnoc - as luxurious and rare items of Early Christianity - can be seen as evidence for the existence of an important basilica in the area. They give evidence of a profound and organized Early Christian life in Dardania, hence justifying the establishment of the archbishopric at Iustiniana Prima in Dardania - the administrative and spiritual center for all Illyria. They also indicate the existence of contacts between Dardania and other distant production places such as Alexandria in Egypt, or the Early Christian Syria.

Both candlesticks were found inside a large pithos, near the ruins of a house under the walls of acropolis of Gradishta / Kalaja of Tërnoc i Madh. The fortress was located on the top of the hill (65 x 75 m), up to the mineral colony of antimony – lead, respectively 3 km northwest of a town and (Chart 1), near the Roman period route Naissus - Scupi.

The surrounding walls of the fortress were built by opus mixtum technique (1.5 m) and were reinforced from outside by pilasters every 3 m. Fortress consisted of Terrace I at the upper part (acropolis), which has two towers (3 x 4 m; 2 x 4 m), and Terrace II at the lower part. Terrace I surrounded the Terrace II from all directions, except the southern side. Both terraces were linked with stone staircases. Inside the fortress are found numerous rectangular shape foundations of houses, which were also placed outside the surrounding walls.

Bibliografia / Bibliography

- Bulić, Frane (1894) “Lucerne Cristiane dell' i r. Museo Archaeologico di Spalato”, *Bulletino di Archaeologia e storia Dalmata*, Anno XVII, Spalato.
- British Museum (1903) *A Guide to the Early Christian and Byzantine Antiquities*.
- Bubić, Vinka (2011) “Kasnoantičke svjetiljke s ranokršćanskim prikazima iz Arheološkog muzeja u Splitu”, *Vjesnik za arheologiju i povijest dalmatinsku* 104, pp. 227-308.
- Cabrol, F. - Leclercq, H. (1928) *Dictionnaire d'Archeologie Chetienne et de Liturgie, Judaisme-Latin*, Paris.
- Cambi, N. (1977) “Krist i njegova simbolika u likovnoj umjetnosti starokršćanskog perioda u Dalmaciji”, *VAHD* 70-71, Split, pp. 57-106.
- Curta Florin (2011) “New remarks on Christianity beyond the 6th and early 7th century frontier of the Roman Empire”, *Keszthely –Fenekpuszta im context spatantiker kontinuitatsforschung zwischen Noricum und Moesia, Castellum Panonicum Pelsonese 2*, Budapest – Leipzig, pp. 303-321.
- Čerškov, Toni (1985) *Arheološki Pregled*, Beograd.
- Dalton, O. M. (1901) *Catalogue of Early Christian Antiquities*, British Museum, London.
- Dalton, O. M. (1911) *Byzantine art and Archaeology*, Clarendon Press, Oxford.
- Dunnigan A. (1987) *Fish*, *The Encyclopedia of Religion* 5, M. Eliade (ed.), New York - London, pp. 346-347.
- Fallico, A.M. (1971) “Lucerne in bronzo del Museo di Palermo”, *Rivista di Archeologia Christiana*, Citta del Vaticano, Pontificion Institutoe di Archeologia Cristiana, Roma.
- Jovanović, M. (1966) “Arheološka istraživanja u 1965 g. Južnomoravske doline od Vranja do Bujanovca”, *Vranjski Glasnik* II, Vranje.
- Grgić, Marijan (2006) “Riba”, *Leksikon zapadnog kršćanstva*, Zagreb.
- Gjini, Gasper (1986) *Skopsko prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Biblioteka Centra za Koncilska Istraživanja, Zagreb, Hooke, Samuel H. (1961) “Fish Symbolism”, *Folklore* 72, Nr. 3, Oxfordshire, pp. 535-538.
- Melchart W. (1997) *Antike Kostbarkeiten aus Osterichische Privatbesitz, Osterreichische Gesellschaft fiir Archaeologie*, Wien.

- Mirdita, Zef (1981) *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë.
- Menzel, H. (1969) *Antiken Lampen im Romisch- Germanischen Zentralmuseum zu Mainz, Romische- Germanischen Zentralmuseum zu Mainz*, Mainz.
- Mikulčić, Ivo (1975) “Rimski lucerni od Skupi”, *Godišen Zbornik, Filozofski Fakultet na Universitetot vo Skopje*, knj.1 Skopje, pp. 127-143.
- Narodni Muzej (1970) *Vodić*, Beograd.
- Ross, Marvin (1962) *Catalogue of the Byzantine and Early Mediaeval Antiquities in the Dumbarton Oaks Collection*, vol. I, Washington.
- Perlzweig, Judith (1963) *Lamps from the Athenian Agora*, American School of Classical Studies at Athens, Princeton, New Jersey.
- Perlzweig, Judith (1961) *Lamps of the Roman Period*, The American School of Classical Studies at Athens Vol. VII, Princeton, New Jersey.
- Sausser, Ekkart (2004) „Fisch“, *LCI 2, Rome-Freiburg-Basel-Wien*, pp. 35-39.
- Sokolovska, Viktoria (1980) *Od arheološko bogatsvo na SR Makedonija*, Arheološko Društvo na SR Makedonia, Skopje.
- Shukriu, Edi (2003) “Paläochristliche Lampen aus dem antiken Dardania”, *Mitteilungen zur Christlichen Archäologie*, Osterreichische Akademie der Wissenschaften, Philosophisch-Historische Klasse, Wien, pp. 19-23.
- Shukriu, Edi (2002) *Kalaja e Tëmocit dhe shandanet paleokristiane*, Studime 8-9, ASHAK, Prishtinë, ff. 217-230.
- Tabula imperii Romani K 34* (1976) SAZU, Lubljana.
- Thiel, Andreas edit. (1868) *Epistolae Romanorum pontificum Genuinae at quae and eos scriptae sunt a s. Hilario usque ad Pelagium II*, torn I, Brinsbergae.
- Vikić-Belančić, Branka (1971) “Antičke svjetiljke u Arheološkom muzeju u Zagrebu”, *VAMZ 5, Zagreb*, pp. 97-181.

Burime nga interneti:

Early Christian Lamps, Catholic encyclopedia:

<http://www.newadvent.org/cathen/08770a.htm> (03.01.2015)

DARDANËT NË KOMEDITË ANTIKE

Dardanët e Europës dhe të Trojës janë prezent në burimet e shkruara antike në forma të ndryshme, varësisht nga rrethanat në të cilat jetuan autorët antikë. Për dardanët e Azisë së Vogël burimet e shkruara janë më të hershme për disa shekuj, ndërsa për dardanët e Europës këto datojnë kryesisht nga shek. V p.K.. Dardanët paraqiten dhe në veprat letrare antike, siç janë komedia “Grerëzat” e Aristofanit, “Dardanos” e Menandrit dhe “Dardanus” e Cecil Statit, andaj punimi shqyrton aspektin e përkatësisë territoriale të dardanëve të trajtuar, në kuptimin se a është fjala për dardanët europianë apo dardanët e Azisë së Vogël.

Emri i dardanëve paraqitet në burimet e hershme të shkruara rreth shek. XIII-XII p.K., siç janë burimet egjiptiane për dyndjet e popujve detarë apo ato që flasin për ngjarjet e shek. XII p.K. të Luftës së Trojës, siç është “Iliada” e Homerit, ndërsa emri i dardanëve dhe i Dardanit mitik është prezent në mitologji shumë më parë se shek. XII p.K.. Kështu, Dardani, i biri i hyjit Zeusi dhe Elektrës, u detyrua që ta lë Arkadinë dhe të vendoset në Frigji të Azisë së Vogël. Dardani themeloi qytetin e Trojës në brigjet e Skamandrës dhe u konsiderua stërgjysh i fiseve ilire, përfshirë dhe dardanët, të cilët jetonin në faqen e malit Ida.¹ Duke pasur parasysh se vepra e Homerit përfshinë rrjedhat historike të shek. XIII-XII p.K., vendosja e Dardanit - dardanëve në Frigji duhet të ketë ngjarë shumë gjenerata apo shumë shekuj më parë.

Të dhënat për dardanët janë vënë gjithëherë në lidhje me dardanët e Trojës, pos burimeve nga shek. V p.K., me cilat është dëshmuar qartë përkatësia europiane. Po ashtu, dardanët që përmenden në monumentet epigrafike të zbuluara në Greqi, madje edhe në ato nga shek. II p.K. e tutje, me një inercion të ngjashëm janë lidhur me dardanët e Azisë së Vogël.

Në lidhje me dardanët e Trojës janë vënë edhe dardanët që përmenden apo janë trajtesë kyçe në veprat e letërsisë antike, gjithnjë duke e abstrahuar mundësinë të kenë edhe përkatësi evropiane. Kështu ngjan me dardanen flautiste me emrin Dardanis, e cila gjendet në mesin e

¹ Thrämer, E. (1901) Dardanos: 3, 2177; Dhama, T. (1988) f. 62.

personazheve të heshtura në komedinë “Grerëzat“ të Aristofanit (Foto 2)², të shfaqur në vitin 422 p.K.. E njëjta ngjau dhe me dardanët që janë temë trajtimi në komedinë “Dardanos“ të Menandrit, komediograf po aq i njohur grek,³ si dhe komedinë “Dardanus“ të Cecil Statit romak (Foto 2).⁴

Një qasje e tillë e dedikimit të çdo të dhëne për dardanët e Azisë së Vogël, veçanërisht të atyre pozitive, është pasojë e njohurive jo aq të plota për dardanët evropianë, gjithnjë lidhur ngusht me shkallën e studimeve të dardanëve evropianë, në përgjithësi, dhe të lidhjeve midis dardanëve të Europës dhe të Azisë, në veçanti.

Ndonëse studimet për dardanët evropianë kanë arritur një shkallë të zhvillimit dhe shumë çështje lidhur me ta janë ndriçuar, siç janë përkatësia e tyre ilire⁵ dhe zhvillimi paraurban dardan,⁶ megjithatë ngel edhe një gamë çështjesh dhe aspektesh që kërkojnë trajtime të mëtejme. Në këtë drejtim duhet theksuar mungesën e provave arkeologjike për fazën urbane dardane në Kosovë të shek. IV-I p.K., përkatësisht moszbulimin e lokaliteteve në Kosovë që i përkasin rreth katërqind viteve të forcës dardane në rajon.

Njohuritë jo të plota të lokaliteteve arkeologjike të epokës së bronzit në territorin qendror dardan pamundëson përcaktimin e lidhjeve midis dardanëve evropian dhe dardanëve të Azisë së Vogël. Andaj, mungesa e studimeve dhe njohurive në këtë drejtim ka krijuar qëndrime për mosekzistencën e këtyre lidhjeve apo për një lidhje të hershme të ndërprerë, ashtu siç moszbulimi i lokaliteteve të fazës urbane dardane ka krijuar bindjen për nivelin e ulët kulturor të dardanëve evropianë, të zhvilluar në aspektin politik vetëm deri te shkalla e një formacioni mbifisnor.⁷ Një nivel të tillë të ulët të zhvillimit e konstaton dhe J. Wilkes, i cili i sheh dardanët evropianë si: “një popull i dalë nga trojanët, të cilët degjeneruan në shtëpinë e tyre të re në një shkallë të barbarizmit.”⁸

² Barrett, D. (1964) p. 39. Si shënim përmendet te Papazoglu, F. (1969) p. 171.

³ Papazoglu, F. (1969) p. 171, fn. 289: Comm. att. Fragm., ed. Kock, III, 32.

⁴ Copalle, C. (1908) p. 32.

⁵ Wilkes, J. (1992).

⁶ Shukriu, E. (1996); Shukriu, E. (2004) Shukriu, E. (2014).

⁷ Papazoglu, F. (1988) p. 162.

⁸ Wilkes, J. (1992) p. 145: “A kindred people of Trojans who had degenerated in their new home to state of barbarism.”



Foto 1 Menandri me maska të Komedisë së Re, shek. I p.K. - I
(Princeton University Art Museum)



Foto 2 Aristofani dhe Cecyl Stati

Si pasojë e hulumtimit të pamjaftueshëm, në veçanti në mungesë të provave arkeologjike, është sjellur edhe konstatimi se dardanët e përmendur në disa vepra të autorëve antikë nuk mund të shihen si dardanë europianë. Kjo është mbështetur dhe nga F. Papazoglu, e cila madje shkruan:

“Në shekullin V (p.K., v.a.) dardanët nuk u ishin të njohur grekëve.”⁹

Nga ky mendim del se nuk ka fare mundësi që të bëhet fjalë për dardanen europiane në komedinë “Grerëzat“ të Aristofanit, të shkruar në shek. V p.K.. Vetëm në komeditë e mëvonshme “Dardanos“ të Menandrit dhe “Dardanus“ të Cecil Statit F. Papazoglu e sheh një mundësi që të flitet për robërit nga territori i Dardanisë, sepse këta ishin prezentë në Greqi pas luftërave të Filipit me fqinjët verior të Maqedonisë.¹⁰ Me këtë qëndrim vërtetohet mundësia që në këto dy komedi të bëhet fjalë për dardanët europianë, por edhe lihet anash njohuria e Herodotit për dardanët europianë dhe përshkrimi i tij i territorit ku këta jetonin, kë e kishin në fqinjësi dhe sidomos fakti se dardanët europianë ishin forca më e madhe politike në Ballkanin Qendror, siç pohojnë dhe studimet e F. Papazoglut.

Dyshim për përkatësinë dardane europiane është shprehur edhe për personat me etnikum Dardanis, Dardaneys e Dardanissa, që duken në periudhën e vonë republikane në monumentet mbivarrore të Atikës në Greqi. Bartësit e tyre F. Papazoglu i sheh vetëm si dardanë të Trojës, duke i konsideruar emrat vijues me prejardhje greke: Mate(.)a Oadayou Thygater Dardanis (shek. II p.K.); Thespis Niketou Dardaneys (shek. II-I p.K.); Epafrodita Dardanis (shek. I); Dardanos Erakleonos Dardaneys dhe Dorotheos Afrodisiou Dardaneys (shek. I p.K.), dhe Biote Dardanissa, periudha romake. Këtu ajo përfshiu edhe emrin Mateia, që, siç pohon dhe vetë, me siguri nuk i takon onomastikës greke.¹¹

Me këtë rast duhet përmendur se L. Robert e konsideron emrin Mateia, që duket në një monument të zbuluar në Sard, si një paraqitje relativisht të hershme të një emri autentik dardan në monumente epigrafike.¹² Me të njëjtin paragjykim se helenët nuk i njohën dardanët e Dardanisë, F. Papazoglu nuk e përfshiu emrin Mateia në onomastikën

⁹ Papazoglu, F. (1988) p. 171.

¹⁰ Papazoglu, F. (1969) p. 171.

¹¹ Papazoglu, F. (1969) p. 170, fn. 285. Shih: IG II/III(2), 8417-8476.

¹² Robert, L. (1960) p. 53.

dardane, duke e arsyetuar këtë me mendimin se etnikoni dardanis përkon me Trojadën, dhe se, sipas saj, një dardane e përmendur nga Aristofani ishte e pamundur të gjendej në Athinë në shek. V p.K. si një grua e lirë dhe aty të vdesë. Sipas të njëjtës autore:

“Marrëdhëniet e Dardanisë me botën greke në atë kohë, posaçërisht me Athinën, nuk ishin të atilla që kjo të mund të supozohet.”¹³

Duke i mbajtur parasysh këto që u thanë më lart, shtrohet pyetja: A i njihje bota helene dardanët evropianë? Studimet e reja dardane ofrojnë mundësi për ta pohuar këtë dhe për t'i rishqyrtuar qëndrimet e deritashme. Dëshmitë për kontaktet e këtyre dardanëve me botën helene dhe anasjelltas janë mjaft prezente. Zbulimet e objekteve të kulturës së Mikenës në Kosovë (p. sh. në Gllarevë) e rreth saj provojnë lidhjet e hershme të epokës së bronzit me botën egjeane, të cilat u zhvilluan më tej.

Lidhjet dardane me botën helene u intensifikuan posaçërisht nga shek.VI-V p.K., gjë që e provojnë importet e shumta helene të zbuluara në lokalitetet e fazës paraurbane dardane. Në mënyrë të veçantë këtë e provon poçaria dardane, që në këtë kohë u punua edhe sipas trajtave helene.¹⁴ Pos burimeve arkeologjike, nga shek. IV p.K. duken edhe dëshmi të shumta të shkruara për dardanët. Këto të fundit, ndonëse shpesh me qasje negative ndaj dardanëve, provojnë njohjen e dardanëve dhe të Dardanisë.

Se dardanët evropian nuk ishin “të prapambetur”, siç kishte tentime për t'i paraqitur, po ashtu ka prova për të kundërtën. Këtë në veçanti e provojnë zhvillimi i dëshmuar paraurban dardan gjatë shekujve VI-IV p.K., pastaj fakti se Mbretëria e Dardanisë ishte një prej forcave kryesore të Ballkanit Qendror dhe përmendja e qyteteve dardane të kësaj periudhe nga autorët antikë. Andaj, nuk mund të vihet në dyshim ekzistimi i qendrave urbane tek dardanët, respektivisht të pohohet prapambeturia e tyre si një prej argumenteve kryesore që çdo gjë që paraqitet si dardane e që nuk ka të bëjë me prapambeturinë të lidhet vetëm me dardanët e Trojës.¹⁵

Duke pasur parasysh se njohja e dardanëve evropianë nga helenët, në veçanti nga shek. VI p.K. nuk mund të vihet më në dyshim, flautistja dardane, si personazh i heshtur në “Grerëzat” e Aristofanit, sa mund të jetë dardane nga Azia e Vogël, aq mund të jetë dhe një dardane evropiane.. Për këtë duhet pasur

¹³ Papazoglu, F. (1969) p. 171.

¹⁴ Shukriu, E. (1969) ff. 55-97.

¹⁵ Shukriu, E. (1996) ff. 19-24.

parasysh edhe të dhënën e mëvonshme të Strabonit, gjeograf antik, i cili shkruan për traditën muzikore të dardanëve të Ballkanit dhe thotë:

"...muzikën nuk e lënë mënjatë, por përkundrazi përdorin gjithmonë fyej e vegla me kordha."

(Strabo, Geographica, VII, 7)."

Dy komeditë e autorëve të mëvonshëm, "Dardanos" i Menandrit të famshëm helen dhe "Dardanus" i Cecil Statit, po aq të njohur romak, kanë si titull etnikumin dardan dhe si temë trajtimi personazhin dardan. Natyrisht, këto komedi lidhen me rrjedhat e caktuara historike dhe analiza e këtyre rrjedhave mund të sjellë edhe deri tek përcaktimi i përkatësisë gjeografike të këtyre dardanëve.

Përderisa te Aristofani përmendet një muziciante dardane pa asnjë konotacion thumbues etnik, pra një femër dardane, person i lirë dhe i përgatitur profesionalisht, në dy veprat e tjera jo vetëm që vetë titujt kanë emrin e etnikumit dardan, por ky etnikum vihet në thumb. Pa marrë parasysh qasjen e autorëve apo dhe falë kësaj qasjeje bëhet shumë e qartë pikë së pari për njohjen e thellë të dardanëve nga ana e helenëve dhe e romakëve, si rrjedhojë e kontakteve të dretpërdrejta me ta.

Edhe kur është fjala për veprat "Dardanos" të Menandrit dhe "Dardanus" të Cecil Statit, sërish shtrohet pyetja: I trajtojnë këta dardanët e Europës apo të Azisë së Vogël? Për t'iu afruar përgjigjes më të saktë duhet theksuar se para dhe në kohën e dukjes së këtyre dy komedive, dëshmitë historike flasin për konfliktet e shumta të dardanëve europianë me Maqedoninë (e cila përfshinte edhe territoret helene), për rezistencën e gjatë dardane ndaj pushtimit romak dhe mospranimin me shekuj të sovranitetit romak, përderisa për dardanët e Azisë së Vogël në këtë kohë bëhet shumë më pak fjalë. Duket se këto rezistenca të dardanëve europianë bënë që autorët e sferës helene dhe romake t'i përfshijnë në shqyrtimet e tyre dhe të kenë dhe qasje negative ndaj tyre.

Luftërat e zhvilluara të dardanëve me maqedonët dhe romakët mundësuan marrjen e ndërsjellë të robërve të luftës. Nga burimet antike mësohet se në vitin 209 p.K. dardanët, në aleancë me sovranin e regjionit ilir në juglindje, Aeropin, morën me vete 20.000 robër pas pushtimit të Orestidës deri tek fushat e Argeas (territori i Kosturit të sotëm në Greqi. Polyb.Historiae XXVII 33 1; Iustinus XXIX 4 5).

Robër luftime dardanë kanë marrë edhe maqedonët dhe helenët, duke i dërguar në qendra të tyre. Në to dardanët janë shfrytëzuar si sklllevër, gjë që

ka krijuar mundësi të perceptimit të tyre më të përafërt dhe të përçmimit të pozitës së tyre, duke i bërë edhe personazhe të komedive. Ka mundësi që këta të mos i kenë parë dardanët europianë të ndarë nga dardanët trojan dhe se marrja si personazhe komedie të dardanëve europianë të jetë edhe refleksion i trashëguar i Luftës së Trojës dhe i armiqësisë së hershme dardano-greke.

Në vijim shtrohet pyetja se sa autorët e komedive “Dardanos” dhe “Dardanus”, Menandri dhe Cecil Stati, kanë mundur t’i njohin dardanët europianë? Duhet thënë se që të dy autorët jetuan dhe vepruan në periudhën helenistike, pra në kohën kur dardanët europianë dhe shteti i tyre ishin të fuqishëm dhe mjaft të njohur. Koha kur jetoi Menandri (rr. 342/1-rr. 290 p.K.) ishte kohë kur dardanët u bënë komponentë e rëndësishme e skenës politike të kohës, duke e rrezikuar mjaft shtetin e Maqedonisë.

Menandri ishte një prej përfaqësuesve më të denjë të komedisë së re atike, madje, sipas Plutarkut, më i çmuar se Aristofani (Foto 1). Nga 108 apo 105 vepra i janë ruajtur vetëm 96 tituj. Fragmente të tetë veprave u zbuluan në Egjipt në vitin 1905, në mesin e të cilave janë “Herói”, “Samianja”, “Aspis” (Mbuvoja), “Perikeiromene”(Vajza që i preu flokët). Komedia “Diskolos”(Njeriu urrejtës) u gjet në vitin 1957 dhe është e vetmja vepër e ruajtur në tërësi.

Komedi të shumta janë ruajtur vetëm falë përpunimeve të autorëve romakë, posaçërisht Plautit dhe Terencit, dhe në mesin e të cilave janë “Georgos” (Bujku), “Heros” (Herói), “Karine” (Gruaja nga Karina), “Homopatrioi” (Njerëzit që kanë të njëjtin baba) “Thettale” (Gruaja nga Thesalia), “Philadelphoi” (Burrat që duhen si vëllezër) e të tjera.¹⁶ Deri më sot nuk ka njohuri për ndonjë fragment të zbuluar të komedisë “Dardanos”, pos të dhënës se vepra mbante këtë titull.

Komediografi Cecil Stati (Caecilius Statius,rr. 219 - 168 p.K.) ishte skllav gal, i cili vazhdoi ta zhvillojë në Romë komedinë e re të Atikës në kohën kur ajo u shua në Greqi, së bashku me Liv Andronikun, Gnej Nevin dhe autorët e tjerë të kohës. Shkroi komeditë “Androgynos” (Hermafroditi), “Ephesio” (Njeriu nga Efesi), “Exul” (Ekzili), “Plocium”, (Qaforja) “Portitor” (Portieri i derës), “Progamos” (Burri që martohet) e të tjera. Në të patën ndikim të madh veprat e Menandrit, pa dyshim edhe në krijimin e komedisë “Dardanus”, komedi kjo që e ka të njëjtin titull si dhe komedia e Menandrit, por në versionin latin.¹⁷

¹⁶ Konstan, D. (2010) pp. 3–6; Stefanović, B. (1968) p. 20. Mendohet se veprat e Menandrit u dogjën në Konstantinopojë në shek. XIV.

¹⁷ Beare, W. “Caecilius Statius”: www.britannica.com/biography/Statius-Caecilius (dt. 30.10.2015)

Duke i pasur parasysh rrjedhat e përmendura historike, që dëshmojnë jo vetëm njohjen por edhe kontaktet e shpeshtuara të botës helene dhe romake me dardanët europianë, hapen rrugë për t'i parë po aq dardanët europianë si personazhe të komedive të Menandrit dhe të Cecil Statitsa dhe dardanët e Azisë së Vogël. Aq më tepër që përkatësia dardane europiane e personave që përmenden në shek. I p.K., si robër apo të liruar, nuk vihet në dyshim dhe janë po aq prova se dardanët europianë u njohën dhe ishin mjaft prezent në botën antike. Është ky rasti me të liruarin Dardanus, të cilin e përmend Ciceroni në një letër të vitit 43 p.K. (Cic. ad fam. X, 25, 3). E njëjta vlen dhe për truporin Dardanos të Brutit, të cilin e përmend Plutarku (Plut. Brut, LI, 2; LII, 1).¹⁸

Fuqizimi i dardanëve europianë nuk vihet në dyshim nga studiuesë të ndryshëm dhe as që këta rrezikuan në vazhdimësi shtetin e Maqedonisë dhe gjatë i rezistuan republikës dhe, më pas, perandorisë së fuqishme romake. Kjo flet se dardanët europianë ishin faktor i rëndësishëm ushtarak dhe se kjo përvojë ushtatake ka shërbyer dhe në shumë gjenerata më pas, por edhe se një pjesë e tyre kanë mund të jenë dhe robër lufte.

Si mundësi e përkatësisë dardane europiane duhet parë edhe personat që duken në monumentet epigrafike mbivarrore të Atikës, të cilët mbajnë përkatësi etnike apo territoriale: Dardanis, Dardaneys dhe Dardanissa. Të tillë janë individët Mate(.)a Oadayou Thygater Dardanis (shek. II p.K.), Thespis Niketou Dardaneys (shek. II-I p.K.), Dardanos Erakleonos Dardaneys (shek. I p.K.), Dorotheos Afrodisiou Dardaneys (shek. I p.K.), Biote Dardanissa dhe Epafrodita Dardanis (shek. I).

Natyrisht, trajtim më të thelluar për këtë çështje duhet dhënë specialistët e fushës, të cilët duhet ta kenë parasysh edhe ekzistimin e qytetit Dardaneon, si dhe emrat "quasiteofor", të cilët rrjedhin nga emrat e heronjve.

Lidhjet dhe koha e ndarjes së dardanëve europianë dhe të Azisë së Vogël është çështje për të cilën ende diskutohet. Kjo çështje nuk është pjesë e kësaj trajtесе, por mëtimi ishte që të merren në konsideratë edhe dardanët europianë nga studiuesit e fushave të ndryshme.

¹⁸ Papazoglu, F. (1969) p. 171, fn. 289, 290, 291.

Summary

DARDANIANS AND ANTIQUE COMEDIES

Dardanians appear on ancient written sources in different forms, depending on the circumstances in which lived antique authors. For the Asia Minor Dardanians written sources are earlier for many centuries, while these on European Dardanians date from V century B.C.. Dardanians appear also in antique literary works, as are comedies "The Wasps" of Aristophanes, "Dardanos" of Menander and "Dardanus" of Caecilius Statius, therefore paper explores territorial aspects of mentioned Dardanians, in the sense if they were the European Dardanians or Asia Minor ones.

Dardanian name is present on written resources of the XIII-XII centuries B.C. regarding the invasions of the "sea people" or according to the Trojan War of the Homer's "Iliad". The mythic Dardanos, present in mythology as the son of Zeus and Electra, was forced to quit Arcadia and place in Phrygia of Asia Minor, where he founded Troy on the banks of Scamander river. Dardanos is considered as the ancestor of the Illyrian tribes, between them and Dardanians [Thrämer, E. (1901) Dardanos: 3, 2177; Dhama, T. (1988) f. 62].

The data for Dardanians were always put in relation with about Dardanians of Troy and with similar inertia Dardanians mentioned in epigraphic monuments discovered in Greece, including those of the II century B.C. and upwards, were seen as the Asia Minor Dardanians.

In this way have been seen also Dardanians mentioned in the literature works of the antiquity, excluding so the European Dardanians. It is the case with the silent character flutist named Dardanis at Aristophanes comedy "The Wasps" [Barrett, D. (1964) p. 39], comedy "Dardanos" of Menander [Papazoglu, F. (1969) p. 171] as well as "Dardanus" of Caecilius Statilius [Copalle, C. (1908) p. 32].

The linkage of all data with Troya Dardanians is a result of incomplete knowledge about European Dardanians, therefore and J. Wilkes sees the as European Dardanians as "a people out of the Trojans, who degenerated in their new home on a scale of barbarism" [Wilkes, J. (1992) p. 145]. In the absence of archaeological knowledge mentioned Dardanians in ancient literature could not be seen as European Dardanians.

This was supported also by F. Papazoglu, which concludes that in V century B.C. Dardanians were not known to Greeks and that it was not

possible the female flautist in the comedy “The Wasps” to be European one. However, she sees opportunity that in comedies “Dardanos“ and “Dardanus“ can be treated the war prisoners from Dardania, present in Greece after the wars of Philip with northern neighbors of Macedonia [Papazoglu, F. (1969) p. 171].

Doubts European Dardanian affiliation was expressed and for the people holding ethnicum Dardanis, Dardaneys e Dardanissa, that appear in the late Republican Attica epigraphy monuments in Greece. F. Papazoglu saw them as Troya Dardanians, including the name Mateia, for which as she says do not belong to the Greek onomastics [Papazoglu, F. (1969) p. 170]. L. Robert considers the name Mateia as a relatively early authentic Dardanian name [Robert, L. (1960) p. 53].

The opinion on the non-recognition of Dardanians by Hellenes oppose the European Dardanians contacts with the Hellene world and vice versa, being intensified in VI century B.C. and specifically the Dardanian pottery imitating Hellenic models [Shukriu, E. (1969) ff. 55-97]. By IV century B.C. more written evidence appear and they, even though have often negative approach, prove the knowledges about Dardanians and Dardania.

Given that the knowledge on European Dardanians by Hellenes has not doubt, Dardanian flutist of Aristophanes could be female from Asia Minor as well as from Dardania. This applies to literary works “Dardanos” of Hellenic Menander and “Dardanus” of Roman Caecilius Statius.

It should be emphasized that before and at the time of the appearance of these two comedies developed European Dardanians conflicts with Macedonia and for a long time the Roman occupation was resisted, since there are not a lot of words about Asia Minor Dardanians. Developed wars between Dardanians, Macedonians and Romans brought mutual prisoners of war [Polyb. *Historiae* XXVII 33 1; Iustinus XXIX 4 5], which has enabled the perception of Dardanian prisoners and humiliation of their position, making them the comedy characters too. As Dardanian European affiliation can be seen people of the epigraphy monuments of Attica holding ethnic or territorial affiliation: Dardanis, Dardaneys and Dardanissa.

Links and the separations of European Dardanians and those of Asia Minor is a matter which is still under the discussion and it is not a part of this paper. The real aim of the paper was to make aware scientists that they should take into the consideration the Dardanians from Dardania also.

Bibliografia / Bibliografy

- Aristophanes, *The Wasps* (1964) Penguin classics, London.
- Copalle, Siegfried (1908) *De servorum Graecorum nominibus*, Marburg.
- Dhama, Todi (1988) *Fjalor i mitologjisë, Rilindja, Prishtinë*.
- Beare, William (1911) "Caecilius Staius", *Encyclopaedia Britannica*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Konstan, David (2010) *Menander of Athens*, Oxford University Press, Oxford, pp. 3–6.
- Papazoglu, Fanula (1969) *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba*, ANUBH, Sarajevo.
- Papazoglu, Fanula (1988) *Ilirska i dardanska kraljevina, Iliri i Albanci*, SANU, Beograd.
- Robert, Louis (1960) "The inscription of the Sepulchral Stele from Sardis", *American Journal of Archaeology* 64, nr. 1, pp. 53-56.
- Shukriu, Edi (1996) *Dardania paraurbane, Dukagjini, Pejë*.
- Shukriu, Edi (2014) *Hyjnesha Dardane*, ASHAK, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1996) "Aspekte të historisë politike të Mbretërisë së Dardanisë", *Buletin i Fakultetit Filozofik XXIV, Prishtinë*, ff. 19-24.
- Stefanović, Bogdan (1968) *Istorija helenske književnosti*, Naučna knjiga, Beograd.
- Thrämer, Eduard (1901) *Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft IV*.
- Wilkes, John (1992) *The Illyrians*, Blackwell, Oxford.

ARKEOLOGJIA DHE ÇËSHTJE TË ANTROPOLOGJISË FIZIKE NË KOSOVË

Antropologjia fizike apo antropologjia biologjike është një nga faktorët e rëndësishëm për njohjen e së kaluarës, aq më tepër që është fjala për mbetjet fizike të vetë krijesëve të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të saj studiohet origjina, zhvillimi dhe diversiteti i njerëzve dhe i popujve, ndërsa në kuadër të bioarkeologjisë studiohen edhe çështjet demografike, epidemiologjike, paleonutricioni, paleopatologjia, fenomenet shoqërore e të tjera. Deri para një shekulli studiuesit ishin më shumë të përqendruar në studimin e objekteve që njerëzit lanë në trashëgimi, ndërsa tek më pas studimet për ta nisën të intensivikohen.

Studimi në kuadër të antropologjisë fizike ende ka mungesa në Europën Juglindore dhe sidomos në Kosovë. Këtë nuk e bëjnë në mënyrë specifike as ligjet e aprovuara në Kosovën e pas vitit 1999 e që lidhen me trashëgiminë kulturore, siç është Ligji për planifikim hapësinor (2003), Ligji për ndërtim (2004), Ligji për trashëgiminë kulturore (2006) me Rregulloren mbi procedurat për gërmimet - hulumtimet Arkeologjike apo Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (2009).

Në Ligjin për trashëgiminë kulturore konsiderohet se mbetjet njerëzore janë përfshirë në kuadër të tipeve të objekteve të lëvizshme të trashëgimisë arkeologjike, të definuara si gjetje të nëndheshme gjatë gërmimeve arkeologjike ose gjetje të rastit (Neni 9.1), por as në të nuk përmendet në mënyrë të veçantë.

Në vitin 2000 u krijua Zyra për Persona të Zhdukur dhe Forenzikë (OMPF) nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me laborator të pajisur plotësisht dhe antropologë fizikë dhe arkeologë të huaj. Por në të janë bërë analiza osteologjike vetëm të personave të zhdukur gjatë luftës 1998-1999.¹ Nga vitit 2009 zyra u bë pjesë e Departamentit të Mjekësisë Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë (Ligji nr. 03/L-137). Departamenti menaxhon dhe mirëmban sistemin forenzik të mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe përmban Sektorin e Antropologjisë dhe të Arkeologjisë Mjeko-Ligjore (Neni 4).

Sot Kosova ende nuk ka ligje ose rregullore të veçanta lidhur me antropologjinë fizike në përgjithësi dhe as trajtim të mirëfilltë shkencor të

¹ OMPF: <http://www.unmikonline.org/regulations/2003/RE2003-26.pdf>. (21.10.2015)

skeleteve humane dhe analiza osteologjike të kohëve të ndryshme. Krijimi i profileve të antropologëve fizikë mendohej të realizohej përmes krijimit të Departamentit të Antropologjisë, i cili do të kishte Drejtimin e Antropologjisë Fizike dhe Drejtimin e Antropologjisë Kulturore.

Për nismën e studimeve në fushën e antropologjisë fizike ishte arritur pëlqimi për bashkëpunim me Zyren për Persona të Zhdukur dhe Forenzikë, si dhe angazhim me profesorë të huaj. Gatishmëri në këtë drejtim u shpreh sidomos nga Universiteti i Ajovas (University of Iowa), me të cilin Universiteti i Prishtinës (UP) nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi (2007).²

Tek në vitin 2014 u krijua Departamenti i Antropologjisë në Fakultetin Filozofik të UP, por pa antropologji fizike. Në të aktualisht funksionojnë dy drejtime: A. Etnologji dhe Antropologji Kulturore dhe B. Arkeologji.

Si rrjedhojë e zhvillimeve kohore dhe të ndikimeve politike, studimet në fushën e antropologjisë fizike në Kosovë ende nuk kanë përparuar, përkundër numrit të madh të skeleteve humane të evidentuara në lokalitetet arkeologjike. Këto studime nuk ishin të institucionalizuara për dekada as në periudhën kur Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë.

Gërmimet e para arkeologjike në Kosovë u bënë nga ushtarët austro-hungarezë gjatë Luftës I Botërore në tumën ilire të Njeprebishtit (sot: Komuna e Suharekës / Therandës), por nuk ka njohuri për mbetjet njerëzore në to. Gërmimet sistematike arkeologjike nisën pas themelimit të Muzeut të Kosovës (1949) dhe në mesin e numrit të madh të lokaliteteve të hulumtuara arkeologjike deri në ditët e sotme është zbuluar dhe një numër i madh i mbetjeve njerëzore, krijues të kulturave të mëhershme.

Analizat osteologjike nuk kanë munguar gjatë kohës kur Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë, por këto janë përqendruar vetëm në varre mesjetare, të konsideruara si sllave.³ Ishin këto motive politike që përmes varreve mesjetare të dëshmohej prezenca serbe në Kosovë, aq më tepër se shumë më parë ishte përhapur teza e gabuar mbi prezencën shqiptare në Kosovë vetëm nga shek. XVII.⁴

² Procesi nuk vazhdoi as pas nënshkrimit të marrëveshjes së dytë, për shkak të mosgatishmërisë dhe moslargpamësisë së udhëheqjes së Universitetit të Prishtinës.

³ Mikić, Ž. (1982) pp. 134-149; (1983) 147-152; (1984a) p. 115-122; (1984b) pp. 45-53; (1992) pp. 840-850; (1994) pp. 99-109; (1997) pp. 495-500; (1997) pp. 495-500; (2006) pp. 39-50.

⁴ Shih artikullin: Aspekte të zhvillimeve etnolitike në Kosovë.




Foto 1 Gërmimet në Ulpianë 2009



Foto 2 Kafka nga Ulpiana (L. Gashi 2007)



Foto 3 Vërmicë: Bazilika e shek. V-VI dhe nekropoli mesjetar



Foto 4 Vërmicë: Varri mesjetar mbi bazilikën e shek. V-VI

Në vitin 1964 u publikuan për herë të parë analizat kranio-metrike të 50 skeleteve njerëzore mesjetare të lokalitetit “Mali i Vogël” (Mala Planina) nga Zh. Gavrilović.⁵ Lokaliteti ishte pjesë e kompleksit të gjerë të Kalasë së Artanës - Novobërdës, te katedralja e së cilës janë bërë gërmime arkeologjike midis viteve 1952 dhe 1970 dhe janë zbuluar rreth 900 varre individuale dhe familjare. 58 përbërje sepulklore me 59 skelete individuale u konstatuan në lokalitetin “Breg” të Matiçanit (Prishtinë) dhe midis viteve 1969 dhe 1973 u gërmuan 120 varre të nekropolit të shek. IX-XI nga V. Jovanović.⁶ I njëjti publikoi mbi 10 varre të shek. X-XI, por pa analiza antropologjike,⁷ siç ngelën dhe 120 varre të gërmuara në vitin 1966 te lokaliteti “Kisha” te Bellacërka (Tab. 1).⁸

Para vitit 1999 janë analizuar edhe varre të tjera, të realizuara nga antropologu serb Zh. Mikić. Më 1980 botoi analizat antropologjike të 21 varreve të shek. X - XIII, të hulumtuara në lokalitetin “Plosha” te Gjonaj e Prizrenit (1978).⁹ I njëjti botoi analizat e 70 varrevetë shek. XIII-XVIII të nekropolit “Kulina” te Banja e Kollashinit të Ibrit, të gërmuara më 1978,¹⁰ si dhe 42 varre të lokalitetit “Varrezat greke” të Rezalës të Kollashinit, të gërmuara më 1978 dhe të datuara në shek. XIII-XVII.¹¹ Studimet përfshinë dhe varret mesjetare të vendosura mbi tuma të epokës së hekurit, por jo dhe skeletet parahistorike të tumave.

Rast të veçantë paraqet nekropoli mesjetar i Vërmicës, në të cilin u zbuluan rreth 450 varre dhe për studimin e skeleteve u angazhua antropologu hungarez J. Nemeskeri. Studimi u organizua nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe të Natyrës - Komuna e Prizrenit, nën udhëheqjen e M. Shukriut (Foto 3, 4), i cili organizoi dhe hulumtimet arkeologjike në lokalitetin e Vërmicës. Gërmimet u zhvilluan në vitet 1974-1975 nga E. Shukriu dhe A. Baçkallov, nën mbikëqyrjen e këshilltarëve J. Glišiq (Muzeu i Kosovës) dhe J. Todorović (Muzeu i Beogradit).

Gjatë gërmimeve u zbulua shtresa kulturore e latenit, bazilika e shek. V-VI dhe nekropoli mesjetar i shek. IX-XI. Në raportin preliminar të antropologut Nemeskerit konstatohet se materiali osteologjik i takon një popullate joslave, mbështetur në metodat osteologjike Lengyel (1963, 1968) dhe Acsádi e Nemeskéri (1970).¹² Publikimi i planifikuar

⁵ Gavrilović, Ž. (1964) pp. 145-147.

⁶ Jovanović, V. S. (1988) p. 17.

⁷ Jovanović, V. S. (1988) p. 26.

⁸ Kovačević, J. (1996) pp. 150-151.

⁹ Mikić Ž. (1984a) pp. 115-122.

¹⁰ Mikić, Ž. (1984b) pp. 50-53.

¹¹ Mikić, Ž. (1984b) pp. 45-49.

¹² Të njëjtin konstatim e ofroi dhe antropologu fizik A. Dhima (Shqipëri).

përfundimtar i të gjitha hulumtimeve në lokalitetin e Vërmicës nuk u realizua për shkak se bashkëdrejtuesi A. Baçkallov nuk e dorëzoi një pjesë të dokumentacionit, të nevojshëm për analizat e mëtejme.¹³

Ngjarjet që pasuan në Kosovë dhe vdekja e akademikut Nemeskéri bënë që të mungojë raporti final, i cili sot duhet të jetë në mesin e dorëshkrimeve të shumta të tij në Akademinë e Shkencave të Hungarisë.¹⁴

Në vitin 2000 u ndërtua në Vërmicë ndërtesëza e veçantë për ruajtjen afatgjate dhe për studime të mëtejme të skeleteve njerëzore nga gjurmimet e nekropolit të Vermicës të vitit 1974.

Analiza antropologjike janë bërë nga antropologu Nemeskéri edhe të mbetjeve mortore të Ymer Prizrenit, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1819-1885). Varri i tij në Ulqin u hap dhe me prezencën e arkeologes nga Beogradi, G. Gabriçević, proces ky që u organizua nga i njëjti ent i Prizrenit. Rezultatet nga studimi u ofruan në disa dokumente,¹⁵ ndërsa rekonstruimi i dukjes së Ymer Prizrenit u realizua falë bashkëpunimit të antropologut Nemeskéri dhe skulptorit Agim Çavdarbasha nga Kosova (Foto 5).

Skeletet humane të shumë viteve të gjurmimeve arkeologjike janë vendosur kryesisht në Muzeun e Kosovës, Narodni Muzej (Muzeu Popullor) në Beograd, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, Qendrën Rajonale për Mbrojtjen e Monumenteve - Prizren dhe Qendrën Rajonale për Mbrojtjen e Monumenteve – Prishtinë (Tab. 1).

Në Kosovën e pas vitit 1999 janë zhvilluar mjaft gjurmime arkeologjike dhe janë gjetur shumë skeleteve humane. Këto janë dokumentuar nga arkeologët dhe presin ekspertizën e antropologëve fizikë. Ndërkohë vëmendje e veçantë duhet kushtuar rolit të antropologjisë fizike dhe realizimit të rregulloreve e protokolleve, të cilat do të krijojnë bazë që ky aspekti i trashëgimisë kulturore të bëhet pjesë integrale e hulumtimeve arkeologjike.

¹³ Nga viti 1981 dolën akuza të rrejshme ndaj M. Shukriut dhe të gjithë shqiptarëve se “kanë shkatërruar varrezat sllave” të nekropolit të Vërmicës.

¹⁴ Informatë nga M. Shukriu, pas kontakteve të realizuara në Budapest në vitin 1999.

¹⁵ Batalli, Q. (1978); Lengyel, I. (1978); Nemeskéri, J. (1978).

<i>Epoka e Bronzit</i>	<i>Epoka e Hekurit Tuma</i>	<i>Epoka e Hekurit Urna</i>	<i>Antika</i>	<i>Mesjeta</i>
Bërnice	Banjë e Pejës	Bërnice	Gjonaj – Tupec	Artanë /Novobërdë/
Grashticë	Dibiçak	Grashticë	Duboc	Badovc
Përçetë /Përçevë/	Llashticë		Gllamnik	Banjë e Kollashinit
Gllarevë /Qëndresan/	Moglicë		Karagaç	Banjë e Malishevës
Rogovë	Neprebishtë		Soçanicë - Municipium DD	Bellacërkë
Ujz /Fshej/	Përçetë /Përçevë/		Ulpianë, Nekropoli verior	Bllacë
	Porodime		Ulpianë, Fusha e Çerkezit (tumë)	Graboc
	Rogovë		Ulpianë, Cernica (tumë)	Matiçan
	Romajë			Përçetë
	Shirokë			Rezallë
				Vërmicë
				Vrellë

Tab. 1 Disa lokalitete të Kosovës me mbetje njerëzore




Foto 5 Antropologu Nemeshkeri dhe skulptori Çavdarbasha: Rikonstruim i pamjes së Ymer Prizrenit

Summary

ARCHAEOLOGY AND THE PHYSICAL ANTHROPOLOGY ASPECTS IN KOSOVA

Physical or biological anthropology is among important factors for the recognition of the past, in particular as it has to do with physical remains of the creators of cultural heritage. Physical anthropology studies are scarce in Eastern Europe and especially in Kosova. The Kosovalaws adopted after 1999 which regulate the field of cultural heritage do not make a mention of it: Law on Spatial Planning (2003), Law on Construction (2004), Law on Cultural Heritage (2006), Regulation on Procedure for Archaeological Excavations/ Investigations, Law on the Department of Forensic Medicine (2009).

As a result of the different times developments and political influences, studies in the field of physical anthropology in Kosovo have stagnated, despite of large number of human skeletons identified in archaeological sites. These studies were institutionalized for decades even in the period when Kosovo was part of the ex-Yugoslavia.

The number of human remains is quite large since the first systematic archaeological excavations in 1951 (Tab. 1). Some studies were done on the medieval human remains from Artana (Novoberda) in 1964 by Ž. Gavrilović [Gavrilović, Ž. (1964) pp. 145-147] and in alleged medieval Slav graves by Ž. Mikić [Mikić, Ž. (1982) pp. 134-149; (1983) 147-152; (1984) p. 115-122; (1992) pp. 840-850; (1994) pp. 99-109; (1997) pp. 495-500; (2006) pp. 39-50]. His studies included medieval graves located on the Illyrian tumuli, but not those of the Iron Age. Some analyses were done in medieval necropolis of Matican, excavated between 1969 and 1973 by V. Jovanović [Jovanović, V. S. (1988) p. 17].

The Hungarian anthropologist J. Nemeskéri studied the human remains of the Vermica Medieval Age cemetery in 1978. The site was excavated jointly by Albanian and Serb archaeologists in 1974-1975 (Photo 1, 2). It was used by the Serbs in 1981 to accuse Albanians as the destroyers of the "Slavs" graves even though the whole documentation was in place and artifact became part of the newly formed Archaeological Museum in Prizren.

In 2000 the special building was built near the site in Vermica for long term storage of the human remains from the Vermica necropolis. J. Nemeskéri also studied the remains of the Head of the Albanian Prizren

League, Ymer Prizreni (1819-1885. Photo 3) [Nemeskéri (1978); Batalli (1978)].

After 1999 many archaeological excavations were carried out in Kosova and a large number of human skeletons were found, documented by archaeologists, yet awaiting physical anthropologists' expertise. Meanwhile, special attention should be paid to the role of physical anthropology and implementation of the regulations and protocols, which would create the basis for this aspect of cultural heritage to become an integral part of archaeological researches.

Bibliografia / Bibliography

- Batalli, Fadil (1978) Examination of the cause of death of Ymer Prizreni, Institute of Forensics, Medicine Faculty, Prishtina, Institute for Protection of Monuments - Municipality of Prizren (Unpublished document).
- Gavrilović, Živko. (1964) “Kraniometrijska ispitivanja Srednjevekovnog čoveka sa Novog Brda u Srbiji“, Glasnik Antropološkog Društva Jugoslavije, Beograd, pp. 145-147.
- Jovanović, S. Vojislav (1988) “Arheološka istraživanja srednjovekovnih spomenika i nalazišta na Kosovu”, Zbornik okruglog stola o naučnom istraživanju Kosova XLII, SANU, Beograd, pp. 23-26.
- Kovačević, Jovan (1996) Bela Crkva u Metohiji - arhitektonski objekti VI veka i nekropola sa kraja XII veka, AP 8, ADJ, Beograd, pp. 150-151.
- Lengyel, Imre (1978) Results of the laboratory studies and biological reconstruction of the individuality of Ymer Prizreni, Institute for Protection of Monuments - Municipality of Prizren, Prizren, pp. 1-6 (Unpublished document).
- Mikić, Živko (1982) “Heiratsgrenzen und Bevölkerungsmischung zwischen Einheimischen und slawischen Zuwanderern in Jugoslawien” Homo XXXIII, Mainz-Göttingen, pp. 134-149.
- Mikić, Živko (1983) “Medieval necropolis Đonaj near Prizren and its anthropological relation to the corresponding neighbouring series”, Godišnji Zbornik Medicinskog Fakulteta 29/2, Skopje, pp. 147-152.
- Mikić, Živko (1984a) “Antropološke karakteristike srednjovekovne nekropole Djonaj kod Prizrena”, Glasnik Muzeja Kosova XIII/XIV, Priština, pp. 115-122.
- Mikić, Živko (1984b) “Beitrag zur Anthropologie spätrömischer bis zum spätmittelalterlicher Bevölkerungen Jugoslawiens”, Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja ANUBIH XXII/20, Sarajevo, pp. 45-53.
- Mikić, Živko (1992) “Antropološka struktura stanovništva Srbije”, Catena mundi II, Beograd-Kraljevo, pp. 840-850.
- Mikić, Živko (1994) ”Beitrag zur Anthropologie der Slawen aug dem mittleren und westlichen Balkan”, Balcanica XXV-I, Institute for Balkan Studies, Beograd, pp. 99-109.
- Mikić, Živko (1997) “Sloveni na Balkanu – Uperedna antropološka analiza”, Antidoron –Uzdarje D. Srejiću, Centar za arheološka istraživanja Filozofskog Fakulteta, vol. 17, Beograd, pp. 495-500.

- Mikić, Živko (2006) “Anthropological Traces of Slav Presence in Kosovo and Metochia”, *Balkanica XXXVI*, SANU – Institute for Balkan Studies, Belgrade, pp. 39-49.
- Nemeskéri, Janos (1978) Results of the studies and anthropological reconstruction of the individuality of Ymer Prizreni, Institute for Protection of Monuments - Municipality of Prizren, Prizren, 1-18 (Unpublished document).
- Schermer, Shirley - Shukriu, Edi – Deskaj, Sylvia (2010) “Kosovo /Kosova”, *The Routledge Handbook of Archaeological Human Remains and Legislation* (Edited by N. Márquez Grant and L. Fibiger), London - New York, pp. 235-246.

ARKEOLOGJIA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE: AT SHTJEFËN GJEÇOVI

At Shtjefën Konstantin Gjeçovi - Kryeziu, si emër dhe studiues poliedrik, është mjaft i njohur për shqiptarët, por vepra e tij është bërë objekt studimi edhe nga hulumtues të huaj. Duke qenë shërbyes i kishës katolike dhe në shërbim nëpër troje të ndryshme, Shtjefën Gjeçovi u shqua si lëruës i parë shqiptar në disa fusha shkencore (Foto 1, 3, 4). Pikë së pari u shqua për studimin e folklorit dhe sidomos të së drejtës zakonore shqiptare, të kurorëzuar me botimin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”¹.

Duke lënë mënjanë kontributet e tjera të Gjeçovit, me këtë rast analizohet kontributi i tij për nismën e arkeologjisë ndër shqiptarë dhe për përpjekjet që ta zgjojë interesimin në mesin e shqiptarëve dhe udhëheqësve të tyre për vlerat e trashëgimisë kulturore mijavjeçare. Këto si dhe kontributet e tjera të Gjeçovit lidhen ngusht me ecuritë e përgjithshme në Europën e fundshekullit XIX dhe nismës së shek. XX, kur nisi të zhvillohet edhe arkeologjia europiane.

Gjeçovi u lind më 3 tetor 1873² në Janjevë të Kosovës (Vilajeti i Kosovës). Prindërit Mat Gjeç - Kryeziu dhe Ana e pagëzuan me emrin Mëhill dhe shkurtimisht u quajt Hil.³ Duke qenë nxënës i shkëqyer në shkollën e Janjevës, në vitin 1884 u dërgua nga autoritetet e Kishës Katolike në Shkup në Seminarin Françeskan në Troshan, në veri të Lezhës (Vilajetin e Shkodrës). Si 14-vjeçar shkoi në Fojnicë të Bosnjës ku përfundoi mësimet më 1888, për vitin e rishtarisë shkoi në Kuvendin e Fojnicës (16 gusht) dhe pastaj vijoi studimet në Derventë, Banjallukë dhe Kreshevë. Në Kreshevë njohu epikun kroat At Gërgo Martiq dhe aty nisi punimin për studimin mbi Arqipeshkvinë e Tivarit, me titull “Metropolis Antibarensis”.

¹ Studimi krahasimtar i tij me “Kodin e Hamurabit”, e drejtë zakonore babilonase / mesopotame, do të ishte me shumë vlerë.

² Gjini, G. (1992). Në disa burime data e lindjes shënohet 12.7.1874. Jetëshkrimi, veprat dhe dorëshkrimet e Gejçovit janë përmbledhur në botimin: Shtjefën Gjeçovi - Kryeziu (1985) Vepra 1 – 4; Elsie, R. (2004) pp. 66–67.

³ Kurti, D. (1965).



Foto 1 At Shtjefën Gjeçovi

Studimet i kreu në korrik të vitit 1896 dhe u kthye në atdhe, duke meshuar për herë të parë në Troshan, ku dhe ndërroi emrin në Shtjefën-Kostandin. Shërbeu famullitar në Rubik, në Zllakuqan të Klinës (1897), në Laç-Sebastes (mesi i 1899 - 1905), në Gomsiqe (1907), në Troshan (1915), në Theth të dëmtuar nga kolera (1916), në Prekal (1917, të dominuar nga austro-hungarezët), në Vlorë (1920, të dominuar nga autoritetet italiane), sekretar i Provincës Françeskane (7.5.1923) në krahinën e Elbasanit (1924) dhe më 1926 u emërua në famullinë e Zymit të Hasit të Thatë. Në Has të Prizrenit shërbeu me po aq përkushtim të gjithanshëm deri në ditën e vrasjes të “Kodër Rrezina” nga regjimi i Mbretërisë së Jugosllavisë, më 14.10.1929.

Gjeçovi, për nga natyra i qetë, si e përshkruan F. Konica,⁴ veprimi jo vetëm si famullitar, por edhe si intelektual i kohës. Ai u përkujdes edhe për arsimimin e shqiptarëve, pa dallim feje, duke shërbyer dhe si mësues dhe duke rihapur e hapur shkolla. Kështu hapi shkollën e parë në Zllokuqan (korrik 1897); rihapi shkollën shqipe në Laç dhe shërbeu si mësues (gusht 1901 - 1905), duke siguruar materialet e para përmes Faik Konicës; shërbeu si mësues në Arbnesh të Zarës të bregdetit kroat (Borgo Erizzo),

⁴ Konitza, F. (1930) ff. 227-230.

ku zëvendësoi Pashk Bardhin (1905); udhëhoqi kolegjet françeskane në Shkodër deri në fërkimet me Imzot P. Guerinin dhe konsullin austro-hungarez (vjeshtë 1906 - 1907); hapi shkollën në Gomsiqe (1907) dhe në Prekal nisi t'u japë mësim fëmijëve në dhomën ku banonte nga 17.9.1917. Për këtë njoftoi dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Arsimit në Shkodër dhe tregon edhe se mbante mësim dy herë në ditë, para dite 26 djemve dhe pas dite 11 vajzave. Tentimet për ndihma materiale iu kushtëzuan me vendosjen e shkollës në objektin fetar dhe pastaj u shndërruan në kërcënime për ndalim të veprimtarisë si mësues. Gjeçovi veptoi si mësues edhe në Has të Zymit, duke iu mësuar shkrim-lexim shqiptarëve të të dy besimeve.⁵

Veprimet e shumanshme të Gjeçovit kanë gurrë atdhedashurinë, andaj dhe angazhimi politik nuk i mungoi. Mori pjesë në Kuvendin e Bajrakut të Kurbinit (1901), vazhdoi përpjekjet me Dom Nikollë Kaçorin për mbarëvajtjen e kuvendeve të kurbinasve, madje dhe për futjen e armëve nga tregjet e huaja,⁶ mori pjesë në Kuvendin e Lezhës (7.6.1913) me krerët e Mirditës, Pukës, Lezhës, Zadrimës dhe Bregmatës në përpjekje për ta shpallur Prenkë pashë Bibdodën mbret etj.. Por intelektual i guximtar dhe Doktor nderi i Universitetit të Lajpcigut mori dhe pushkën ndër duar kur paraqitej nevoja.

Vendlindja si inspirim arkeologjik

Janjeva dhe rrethina e saj përplot me pasuri arkeologjike, duket të jetë frymëzimi i parë për trashëgiminë arkeologjike të At Shtjefën Gjeçovit apo Mëhillin e vogël, siç e quanin në fëmijëri. Kalanë e Veletinit mbi Janjevë duhet parë si inspiruese fillestare dhe të veçantë, gjithnjë duke pasur parasysh se Gjeçovi e kaloi pjesën e fëmijërisë dhjetëvjeçare pranë saj dhe në të (Foto 2).

Kodra e Veletinit (969 m), e cila dominon mbi Rrafshin e Kosovës, sipas gërmimeve të Universitetit të Prishtinës (1988), u banua për herë të parë në epokën e eneolitit (kultura Bubanj-Hum) dhe në të jeta vazhdoi gjatë gjithë epokës së hekurit, në antikë dhe në mesjetë. Ka trajtë poligonale të parregullt, me tri tarraca dhe mure rrethuese (2.40 m), të cilat e ndajnë fortifikatën në atë të epërm, të mesme dhe të poshtme.

⁵ Intervistë me Ibrahim Gashin (1919) nga Krajkju.

⁶ Gjeçovi, Sh. (1922) "Parradija e popullit ase Kryengritja e Dheut të rrethit të Krues me 54 pleq në krye, kundra urdhënve e dokeve të reja t'osmanllive: 1903-1904-1905-1906" (dorëshkrim), Laç-Sebaste.



Foto 2 Fortifikata e Veletinit

Shtresat kulturore në rrëzat jugore dëshmojnë zgjerimin e vendbanimit edhe në drejtim të rrafshit (shek. VI-V p.K.: faza paraurbane dardane). Qeramika e stilit me figura të zeza, fibula harkohe prej bronzi me kokë në trajtë palmete të stilizuar e aplikacione diskoide dëshmojnë kontaktet e kohës me Atikën e Greqisë antike (VI p.K.) dhe po aq nivelin më të lartë jetësor në të. Në Veletin janë gjetur monedha të periudhave të ndryshme, nga ato të Damastionit (shek. IV p.K.) dhe të Durrahun e deri te monedhat e perandorëve bizantinë Teodosit (shek. IV), Vasilit II (shek. X-XI) e më pas.⁷

Fortifikata është shënuar si gërmadhë qysh në vitin 1689, në Atlasin e V. M. Coronelli, dhe nga ajo kohë nëndheu i saj ka sjell në sipërfaqe artefakte të shumta deri në ditët e sotme. I tillë ishte dhe në kohën e fëmijërisë së Gjeçovit. Ekzistimin e pasurive arkeologjike dhe të gjurmëve të shumta të kishave në Janjevë e rrethinë e konstatoi Marin Bici qysh në vitin 1610, për të cilat thotë se ishin “të madhnueshme e të kushtueshme”.⁸ Në po këtë hapësirë duhet të jetë zbuluar edhe “Depoja e Janjevës”, depo e pasur e epokës së hershme të hekurit.⁹

Zhvillimi i kulturës materiale dhe i vendbanimeve të lashta përreth Janjevës është rezultat i pasurisë me xehe të rajonit dhe i eksploatimit të hershëm të minierave. Dëshmi të shkruara për shfrytëzimin e arit dhe të argjendit nga ana e dardanëve gjejmë tek autori antik Plini, i cili veçon prodhimin vendës të stolive, posaçërisht të rrathëve prej ari, të njohur edhe jashtë Dardanisë (Plini Naturalis Historia XXXIII 3 12). Marin Bicie

⁷ Mendoj se fortifikata e Veletinit ishte qyteti Justinopol, mbështetur në madhësinë dhe pozitën e saj në afërsi të Ulpianës antike. Qytetin e forcoi Justiniani dhe ia dha emrin sipas xhaxhait të tij, Justinin.

⁸ Shukriu, E. (2003) ff. 106-108.

⁹ Shukriu, E. (1988) ff. 106-108. Hulumentimet i zhvilloi autorja në vitin 1988 me Grupin e Arkeologëve të Rinj “Shtjefën Gjeçovi” të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

përshkruan pozitën e Janjevës në fillim të shek. XVII dhe thotë se ishte e vendosur:

“...midis disa kodrinave të zgavërrueme prej minierave t'argjantit që aty nxiret me sasi të madhe”.¹⁰

Konstatimi se Janjeva luajti një rol inspirues për interesimin e mëtejshëm të Gjeçovit për arkeologjinë dhe për veprimtarinë e tij në këtë drejtim e mbështet pasuria arkeologjike e Janjevës dhe e rrethinës së saj, ndeshja në çdo hap në fëmijëri me gjurmët e lashtësisë dhe vetë kërkuesia e dëshmuar hulumtuese e Gjeçovit.

Koha - nxitje për veprimtari arkeologjike

Koha në të cilën jetoi Gjeçovi, gjysma e dytë e shek. XIX dhe më pas, paraqet një komponentë të rëndësishme për interesimin dhe veprimtarinë arkeologjike të tij. Në këtë kohë mori hov zhvillimi i arkeologjive nacionale në Europë, pas zbulimit të kulturave të Mesopotamisë dhe të Egjiptit, si qytetërime më të hershme se ato romake e greke. Zhvillimi i arkeologjive nacionale dhe zhvillimi i arkeologjisë parahistorike, e lidhur me zhvillimin e shkencave natyrore, sollën deri te zbulimi i kulturave europiane, të asaj etruce, kelte, ibere, të fiseve gjermane e nordike. Lërimi arkeologjik në Europën Perëndimore kishte si rezultat edhe rinjohjen dhe studimin e kulturave të popujve të vjetër të Ballkanit, siç ishin ilirët dhe trakët.

Gjeçovi ishte ndër shqiptarët e parë që nisi hulumtimin arkeologjik të trojeve shqiptare. Rrethanat historike nuk u kishin mundësuar shqiptarëve që t'i hulumtojnë edhe shfaqjet e jetës së tyre kulturore, ndonëse gjenden dëshmi për interesimin e hershëm të tyre për trashëgiminë e lashtë. Kështu, humanisti i shquar shqiptar Marin Barleti (shek. XV) shkruan se

“...në Durrës ndodhet një arenë ose amfiteatër, i ndërtuar me zgjuarësi dhe me mjeshtri të admirueshme”.¹¹

¹⁰ Kamsi, V. (1966) f. 408.

¹¹ Barleti, M. (1964) f. 482.

Pjetër Bogdani, një shekull e gjysmë më vonë, jep shënime për mbishkrime antike dhe për kishën e Shën Shirqit dhe Bahtit në afërsi të Bunës.¹²

Me nismën e veprimtarisë së Gjeçovin nis dhe faza e përkujdesjes së shqiptarëve për arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore në përgjithësi. Hulumtimet arkeologjike në trojet shqiptare, të intensifikuara nga mesi i shekullit XIX në Europë, u zhvilluan fillimisht nga studiues të huaj.

Tëhuajëzimi i thesarit arkeologjik, të zbuluar në Apolloni, Durrës, Krujë, Lezhë, Shkodër, Koplík, Koman e në lokalitetet e tjera, u bënë edhe një motiv nxitës për intelektualin me erudicion të rrallë që vet të ndërmerre hapa konkret, së pari për ruajtjen e trashëgimisë së lashtë dhe, më pas, për zbulimin e thesarit, i cili, siç thotë: "...gjendej në gji të dheut." Kështu, ndonëse nuk ishte arkeolog për nga profesioni, Gjeçovi u bë arkeologu i parë shqiptar autodidakt, nismëtar i një shkence të re, e cila te shqiptarët mori hov pas Luftës II Botërore.

Kontributi për zhvillimin e arkeologjisë

Kontributi i Gjeçovit për zhvillimin e arkeologjisë shqiptare zë dy aspekte të rëndësishme dhe këto mund të përmbledhen në dy përcaktimet vijuese: 1. Qëndrimi ndaj trashëgimisë kulturore dhe 2. Veprimtaria arkeologjike.

Qëndrimi ndaj trashëgimisë përfshinë qëndrimet e Gjeçovit ndaj trashëgimisë së lashtë dhe ruajtjes së saj, që nënkupton popullarizimin e arkeologjisë dhe kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes së popullit për vlerat e trashëgimisë së lashtë. Veprimtaria arkeologjike përfshinë hulumtimet arkeologjike, evidentimin e lokaliteteve dhe gjermimin e tyre. Të dy këto aspekte ndeshen në artikujt e botuar me një titull të përbashkët "Nji argetim Arheologjik", të botuar në "Zani i Shna Ndout" VIII / 1920 (numrat 4, 6, 7, 8, 9).

Gjeçovi iu dha titull të përbashkët të gjithë artikujve me temë arkeologjike: "Nji argetim Arheologjik" dhe kjo imponon te lexuesi bindjen se ai e konsideron veprimtarinë arkeologjike si një argëtim, i cili ka për qëllim sjelljen e kënaqësive shpirtërore që arrihen duke gjermuar, si thotë ai: "sendet e vjetra." Mirëpo përmbajtja e vetë artikujve, shtrimi i nevojës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, propozimet konkrete që i ofron dhe veprimet e ndërmarra për hulumtimin e saj, dëshmojnë se për të arkeologjia nuk ishte "nji

¹² Kamsi, V. (1966) f. 407.

argëtim” dhe se kënaqësia e zbulimit ishte kënaqësia shpirtërore dhe mendore e një intelektualit, i cili, edhe pse jo arkeolog, i pari dha kontributin vetanak për zhvillimin e një shkence të re ndër shqiptarë.

1. Qëndrimet ndaj arkeologjisë

Qëndrimet e Gjeçovit ndaj arkeologjisë gjenden gati në të gjithë artikujt e tij. Në artikullin e parë shkruan për rolin e arkeologjisë si ndjenjë dhe si vlerë:

“Arheologjia asht një argëtim aq i kandshëm, sa së kallxohet me gojë, e sa asht i kandshëm aq ve ma asht i vjefshëm... jeta, e një Arheologut asht gjith herë e kandshme, e sa ma me zell të jepet mbas ksajë jetese, aq e ma e thellohet ne palc.”¹³

Me këtë Gjeçovi dëshmon për një fushë të preokupimit të tij jetësor dhe, njëkohësisht, bën bashkëdyzimin e dy aspekteve të rëndësishme të jetës së njeriut, të së këndshmes dhe të vlefshmes. Ftesën bashkëkombësve “qi te nepen mbas kti argtimi”¹⁴ për zbulimin e historisë së hershme të kombit e arsyeton me faktin se:

“...visari i jonë, historia e jonë gjinden të mblueme nën dhe kush e din sa pash' a pllambë, e ne s'i biem mrapa.”¹⁵

Si detyrë prioritare të arkeologjisë Gjeçovi e sheh nxjerrjen në pah të thesarit arkeologjik kombëtar, përkatësisht shtimin e pasurisë së “hambarit kombëtar apo Muzeumit.”¹⁶ Ai, me të drejtë, e vëren rrezikun që i kanosej këtij “Muzeumi me sende qi gjen në gji te tokës” mu për shkak të mungesës së kujdesit ndaj trashëgimisë kulturore dhe të veprimtarisë arkeologjike të të huajve në trojet shqiptare.

Nxjerrjen e objekteve arkeologjike jashtë vendit, të cilat me të drejt i sheh si vlera të historisë së lashtë, i konsideron si shumë të rrezikshme, andaj konstaton se mjafton:

¹³ Gjeçovi, Sh.(1920) Nr. 4, f. 112.

¹⁴ Gjeçovi, Sh.(1920) Nr. 6, f. 112.

¹⁵ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 158.

¹⁶ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 158.

“nji kulete e mbushun me sende të vjetra te gjetura në tokë tonë prej nji te huejit, per me na lane në terr ndo'i pikë historijet.”¹⁷

Te nismëtari i arkeologjisë shqiptare e ndeshim të rrënjosur parimin themelor të arkeologjisë bashkëkohore se çdo objekt i punuar nga dorë e njeriut ka vlerë, pa marrë parasysh funksionin e tij, trajtën që ka, materialin prej të cilit është punuar dhe posedimin apo jo të elementeve estetike. Në këtë drejtim ai shkruan:

“Per ne kan çënim të madh sende të vjetra qi mund të gjinden në gji të tokës s'onë, në daç të jenë te hekurta a të rembta, të arta a të rrgjanta.”¹⁸



Foto 3 At Shtjefën Gjeçovi (Kolë Idromeno, vaj)

Gjeçovi, duke e kuptuar arkeologjinë në thelb të saj dhe duke u bërë edhe më preciz në vlerësimin e objekteve, konkludon se për historinë e popullit shqiptar mund të jenë më të vlefshme “sende të hekurta e të rrembta se ata të arta e të rrgjanta.”¹⁹

¹⁷ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 158.

¹⁸ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 158.

¹⁹ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 183.

Qëndrimi i tillë i Gjeçovite bën që të ngrihet mbi synimet e shumta koleksionuese të bashkëkohanikëve të huaj ndaj veprave luksoze të lashtësisë dhe, njëkohësisht, shtron nevojën për hulumtimin e kulturës materiale të të gjitha shtresave të shoqërisë në lashtësi.

Shtytja që e ndjen Gjeçovi për veprimtarinë arkeologjike vë nga vetëdija se për historinë e lashtë mungojnë burimet e shkruara dhe se vetëm përmes hulumtimeve arkeologjike, përmes objekteve të cilat i kanë lënë të parët, mund të flasë e kaluara e lashtë. Kjo mundësi mund të realizohet sipas tij vetëm përmes hulumtimit të trashëgimisë së lashtësisë:

“Pra visari jon, historija e jonë gjinden të mbuleme nen dhe kush e din sa pash e pllambë, e na s'i bim mbrapa historis se jone e shka a ma zi, edhe ne paçim gjete gja nen dhe ndo'i herë, për një fitim te veçanët e kena shitë at gja send, e me te kena vorfnue kombin t'onë me ndo'i pikë historijet e per një çëmim të faqes së zezë.”²⁰

Nga kjo del përfundimi se Gjeçovi e dinte shumë mirë se ç' do të thotë ngritja e vetëdijes së popullit për ta ruajtur trashëgiminë për të cilën luftoi edhe vetë në të gjitha sferat e veprimtarisë.

Një veçori dalluese e Gjeçovit është qasja e drejtë dhe serioze ndaj lashtësisë, të papërfshirë nga euforia nacionale, romantizmi i verbër dhe zmadhimi i fakteve. Si shkencëtar i përmbajtur, ka tingëllime emocionale vetëm kur mëton ngritjen e vetëdijes tek populli për vlerat e trashëgimisë së lashtë. Kështu, bëhej shumë kategorik, madje edhe emocional kur vërente se trashëgimia humbte para sysh apo pa u zbuluar dhe pa u mbrojtur në muze. Për të, si dhe për të gjithë arkeologët, ajo nuk fliste dhe ishte e vdekur përgjithmonë. Andaj apelon edhe me tingëllime emocionale:

“Duhet të na mbushet koka një herë, e të kuptojm se, një komb qi së ka histori të veten, xehet si i deket.”²¹

Gjeçovi është ndër të parët që ngriti zërin për ngeljen e objekteve në vendet ku ishin zbuluar, mëtim ky bashkëkohor i arkeologjisë dhe i muzeologjisë në përgjithësi. Ai akuzoi sa fenomenin e shitjes së vlerave të lashtësisë nga ana e fshatarëve, aq edhe bartjen e tyre jashtë vendit. Në këtë

²⁰ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 158.

²¹ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 182.

kuptim akuzoi edhe arkeologët e huaj të cilët gërmonin në lokalitetet e trevave shqiptare dhe i merrnin me vete reliktet e së kaluarës. Për këtë shkruan:

“Me pa at Pojanën (Apollonien) aq të përmendun... visare të vjetra të sajë janë bajtë ndër vende të hueja me qerre e vagona... Kah Durrësi, kah Tirana e Krueja, kah Lezhja e Shkodra, kah Kopluku e Vuksanlekaj, kah Komani e Dushmani... sa visare janë nxjerrë e bajtë prej të huejsh”.²²

Për ta ngritur vetëdijen te populli për përkujdesje ndaj vlerave arkeologjike ai përdori mjete të ndryshme, madje edhe duke prekur sedrën e bashkëkombësve dhe duke shkruar:

...“të huajt hapnin vorre të vjetra a suka (t u m u l i), tuj na ba dy dame me një shtek: tuj na i marrun neper kame eshtent e hijet e të parve, e tuj na vorfnue prej sendeve qi gjejshin të mblueme me eshten te tyne”.²³

Gjeçovi këmbënguli dhe për themelimin e Muzeut dhe të Bibliotekës. Lidhur me këtë thekson:

“Museum e Bibliotheka janë dy ndërtesa permbas së cillash mund te nepet gjygyji i vjeftësisë së një kombit / e na për fat të keqe se kena asnjenën.”²⁴

Fjalinë e fundit nuk e ka thënë si një vajtim për të paqenën, sa do që tingëllon si e tillë. I vetëdijshëm se koleksionet janë veprim paraprak dhe institucion bazë prej nga zhvillohen muzetë, koleksionoi materialin e zbuluar arkeologjik, të cilin e mendtonte si bazë për muzeun e ardhshëm. Këtë koleksion ia prezantoi shumë vizitorëve, andaj dhe F. Konica i la dëshmi përshtypjet për këtë koleksion:

²² Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 183.

²³ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 8, f. 182.

²⁴ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 183.

“Në kat të sipër të famullisë, permi një tryezë të madhe, ishin shtruar një tok vjetërsirash greko-romane të zbuluara e të mbledhura një nga një, me një fatbardhësi të rrallë dhe me një shie të mbaruar, nga dora vetë e At Gjeçovit!”²⁵

Koleksion, i cili më vonë u njoh me emrin “Koleksioni i Shtjefën Gjeçovit”, u ekspozua për një kohë në Muzeun Françeskan të Shkodrës dhe në vitin 1948 u bë pjesë e Muzeut Arkeologjik dhe Etnologjik në Tiranë.

Përkujdesjen institucionale për trashëgiminë kulturore Gjeçovi e shihte me shumë interes, andaj zhvilloi më tej, gjithnjë duke qenë i vetëdijshëm se veprimtaria arkeologjike është mjaft e kushtueshme. Për këtë kërkoi përkrahjen institucionale për veprimtarinë arkeologjike dhe i propozoi administratës shtetërore marrjen nën përkujdesje të kësaj veprimtarie:

“Kishte me kene (nder) per Qeveri Shqyptare ra mbrapa ktyneve visare të mshefta..., me u dhanë shkas atyneve atdhetarve qi epen mbas hetimeve e kërkimeve të kti visarit, tuj u dhanë edhe mjete të nevojshme.”²⁶

Kërkesat e Gjeçovit bëhen më komplete dhe në përputhshmëri me kërkesat bashkëkohore kur kërkon që ruajtja e trashëgimisë kulturore të sanksionohet me ligje, ndërsa veprimet e kundërta, si dhe shitja e tyre, të ndëshkohen. Lidhur me këtë ai shkruan:

“Me kto tregje, çëdo Shqyptar e difton vedin, a se së din çëmimin e madhin historijet së vet, a se e ban asgja. Me kene e para asht marre e faqe e zezë; me kene e dyta, asht nji faj aq i randë, qi lypë të ndeshkohet prej Qeverijet te vendit.”²⁷

Gjeçovi ndeshi në shumë pengesa gjatë veprimtarisë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, madje u ballafaqua dhe me injorancën e fshatarëve, të cilët i drejtoheshin me fjalët vijuese:

²⁵ Konitza, F. (1930) f. 228.

²⁶ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr.6, f. 184.

²⁷ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 184.

“Shko me gropue në vend t'and, or Zotni, e jo në vend t'onë.”²⁸

I mllfosur nga këto qëndrime të paditurish dhe përmes përvojës arkeologjike në terren, ai konstaton një të vërtetë të dhembshme të poltronizmit ndaj të huajve:

“Të huajt i kapshin për qafë, i shtinin me dynd suka a male, pa bukë e pa ujët e pa rrogë, e të vetin, qi s'e nep kurrfar trazimit, s'e lan shnosh në punë të vet.”²⁹

Qëndrimi i Gjeçovit ndaj arkeologjisë dhe ndaj trashëgimisë së lashtë kulturore përmbledh në përgjithësi parimet themelore të kujdesit bashkëkohor ndaj trashëgimisë kulturore. Me këtë nënkuptohet:

1. Evidentimi i lokaliteteve arkeologjike.
2. Procesi i gërmimit si rrugë për të arritur deri te objektet e
3. pazbuluara.
4. Koleksionimi i objekteve, përcaktimi i vendgjetjes dhe
5. përshkrimi i tyre.
6. Vendosja dhe prezantimi i artefakteve në muze
7. Botimi i rezultateve.

Botimi i rezultateve të hulumtimeve, si dhe proceset paraprake, ishte po aq kërkesë bashkëkohore dhe Gjeçovi këtë e ofroi përmes artikujve të botuar në “Zani i Shna Ndout”. Artikuj të veçantë botoi dhe në revistat “Albania”, “Hylli i Dritës” dhe në fletoren “Populli” të Shkodrës. Në këto dy të fundit nisi ta botojë serinë e studimit “Trashëgimi thrako-iliriane”, me pseudonimin Komen Kanina, ndërsa në të tjerat edhe me pseudonimin Lkeni i Hasit.

Përkundër trazirave të vazhdueshme politike, Gjeçovi kërkoi me ngulm përkrahjen institucionale për hulumtime arkeologjike dhe përcaktimin e normativave ligjore për trashëgiminë kulturore. Kërkesat e ngjashme theksohen në Konventën Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike (Konventa e Valletës, 1992), në të cilën potencohet se mbrojtja e trashëgimisë arkeologjike sigurohet nga shteti dhe

²⁸ Gjeçovi, Sh.(1920) Nr. 9, f. 232.

²⁹ Gjeçovi, Sh.(1920) Nr. 9, f. 232.

se shtetet obligohen të vendosin sistem legal për mbrojtjen e saj.³⁰ Këto janë kontribute të veçanta dhe shumë të rëndësishme të eruditit të guximshëm, përfshirë dhe kërkesën për themelimin e një muzeu kombëtar, ku do të prezantoheshin vlerat dhe kontributi i popullit shqiptar për zhvillimin e kulturës europiane dhe botërore.

2. Hulumtimet arkeologjike

Gjeçovi veproi si arkeolog amator në terren dhe ky është një kontribut i drejtpëdrejtë i tij për vënien në pah të thesarit të lashtë në kohën kur ende nuk ishin krijuar kuadrot arkeologjike shqiptare. Në bashkëkohësi, veprimtaria amatore dhe arkeologjia klandestine janë të ndaluara me ligj dhe me të gjitha konventat ndërkombëtare.³¹ Megjithëkëtë, kontributi i tij ka vlerat e patjetërsueshme, ndonëse trajtohet nga këndvështrimi i sotëm i arkeologjisë, sepse vetëm numërimi i lokaliteteve arkeologjike që ai i shënoi apo i gërmoi do ta bënte të njëanshme veprimtarinë e tij në këtë fushë. Andaj mund të konstatohet se hulumtimet arkeologjike të Gjeçovit janë më gjithëpërfshirëse dhe se zënë tri aspekte kryesore të hulumtimeve arkeologjike e që janë: a. Rinjohja e terrenit, b. Gërmimi arkeologjik dhe c. Përpunimi i të dhënave nga gërmimet.

a) Rinjohja e terrenit

Gërmimeve arkeologjike i paraprinë rinjohja e terrenit (përnjohja, rekognoscimi), që nënkupton evidentimin e lokaliteteve arkeologjike, komponentë kjo që është prezente edhe te veprimtaria arkeologjike e Gjeçovit. Ky pikë së pari mori informata nga fshatarët për objektet e gjetura të lashtësisë,³² rinjohu terrenin, bëri evidentimin e lokaliteteve dhe i përshkroi në detaje. Këtë e bëri duke vizituar territoret e famullive ku shërbeu, perceptoi rrethin dhe kur i ra ndër duar ndonjë objekt i gjetur rastësisht e pa atë si një udhërrëfyes që do ta shpiente deri tek një lokalitet i lashtësisë. Kështu, pasi që në Kolëmarkaj i zbuloi disa rruaza të blerta shkrojtji:

³⁰ ECPAH (1992) Art. 2.

³¹ ECPAH (1992): Shtetet obligohen që të zbatojnë procedura të kontrollimit të veprimtarive arkeologjike, me qëllim të parandalimit të “çdo gërmimi ilegal ose zhvendosje të elementeve të trashëgimisë arkeologjike” (Neni 3 etj.).

³² Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 9, f. 232.

“U knaqa, jo pse gjeta ato pak rruza, por pse më mate shpresa se ato ishin një shej se aty do t'u gjete ndo'i vorr i vjeter.”³³

Gjeçovi përshkruan dhe hapësirën ku gjenden lokalitetet arkeologjike, duke ndjerë ekzistimin e ndërlidhjeve midis ambientit dhe vetë lokaliteteve që i vizitonte:

“Ky vend pra (maja e kandshme e quejtun "Shkrepi i Troshanit" ku qe vendosun Kuvendi i Franciskajvet të Troshanit 1882) qi rrin ndermjet dy gjytetzave, njena e "Capës" a e Neushatit, larg një orë e pak ma teper, e tjetra "Koder Gjytetëza" e Troshanit, larg një katertore prej kuvendit, do të ket pasë një randsi të madhe në kohë të lashta... Ktu, si edhe per të gjatë të rrazave te malit, tuj fillue në Ujët e Bardhë te Kurbinit e mje në Va te Dejës e përtej, gjinden vorre të vjetra, kodra e suka (T u m u l i) mbi nen të cillat i kishin pasë shti në dhe të dekunit.”³⁴

Me këtë dhe përshkrimet e tjera ai i përafrohet konceptit dhe përbërjes së trashëgimisë arkeologjike bashkëkohore, e cila merr parasysh marrëdhëniet e lokaliteteve me ambientin natyror,³⁵ të njohura sot me nocionin “peizazhe kulturore”.

Në kuadër të rinjohjeve arkeologjike të Gjeçovit, meritë e veçantë i takon për evidentimin e qytezës së fortifikuar të Gajtanit afër Shkodrës. Këtë lokalitet me vlera të veçanta e rinjohu në vitin 1923 (Foto 7) dhe për këtë la dëshmi në hyrje të shpellës së afërt, ku shënoi vitin e vizitës, emrin e tij dhe të dy shoqëruesve.³⁶ Pas hulumtimeve të viteve 1961-1963, lokaliteti i Gajtanit u dëshmuar si qyteza e parë e njohur e epokës së hershme të hekurit, që kishte konstruksion ndërtimor të ledheve rrethuese pa material lidhës (“mure qiklopikë”), punëtori të qeramikës së punuar me dorë, hapësirë të kultit të diellit etj..³⁷

Gjeçovi ofroi shënime edhe për lokalitetet arkeologjike në rrethin e Laçit, në shqyrtimin me titull: “Sebaste n' Armeni apo n' Arbëri?” Në të ai përmend muranat e ruajtura nga shek. IV në “Shpellën e Shën Vllashit” në

³³ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 110.

³⁴ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 109.

³⁵ ECPAH (1992) Art. 1.i etc..

³⁶ Islami, S.-Cekaj, H. (1969) ff. 185-196.

³⁷ Jubani, B. (1967) ff. 41-70; Instituti i Arkeologjisë.

Sebaste të Arbënisë, “Kishën e 40 Dëshmorëve” në Ujë të Bardhë³⁸ dhe dy kështjella, atë të quajtur “Kulla e Kolë Pashk Gjeçit” dhe kështjellën më të madhe me emrin “Kështjella e Shna Ndout”. Kjo e fundit gjendej në Malin e Shna Ndout dhe për të shkruan se kishte gjurmë parahistorike dhe romake, duke e identifikuar me qytetin Basaneja, si kishte konstatuar dhe hulumtuesi Kieper, dhe jo me qytetin Pistum, si mendonte studiuesi Miller.³⁹ Në Daullë të Kurbinit gjeti edhe rrënojat e gjytetit me toponim “Kalaja e Skenderbeut”.

Rinjohja arkeologjike e terrenit nuk përfundoi vetëm me evidentimin e lokaliteteve arkeologjike nga Gjeçovi, por ai u morr edhe me identifikimin e rrugëve antike që lidhnin territore më të gjera. Kështu, për pjesët e rrugës së njohur Lissus - Naissus shkruan:

“...si edhe sot ka pasë kalue dikur rruga e ushtris Rromane, e cila vijote per Lezha, Hajmel, e në grykë të Gjadrit dahej dy krahësh, i djathti vijote për në Kaster (Vig), Pukë (Epikarja) e delte Iballe (Imiacium), nëpër Gralisht, Kul, Kisha e Ançit e kalote në Gjakovë.”

Vrojtimet arkeologjike që i bëri i ndihmuan për përcaktimet për gjurmime në lokalitetet e caktuara dhe, njëkohësisht, u bënë bazë të përnjohjes dhe të gjurmëve arkeologjike të gjeneratave në vijim. Në kuadër të përnjohjeve dhe të kontributit për njohjen e trashëgimisë kulturore të Gjeçovit duhet përmendur dhe këmbanën e Sopotit të Bërzeshit të kohës së Gjergj Arianitit, të cilën e zbuloi në kishën e Shënkollit në Elbasan, duke hulumtuar bashkë me Simon Shuteriqin (1924).⁴⁰

b) Gërmimet arkeologjike

Gërmimi i lokalitetit, si fazë vijuese, u zhvillua nga Gjeçovi në lokalitete të shumta arkeologjike, siç janë tumat, vendbanimet dhe tempujt. Gjatë vitit 1920 gërmoi në rrethinën e Kuvendit françeskan të Troshanit, në dy tuma në “Kodër të Kolëmarkajve”, një në “Kodër Kuveth” dhe një në

³⁸ Shtjefën Gj. (1985) Vepra 3, f. 20.

³⁹ Gjeçovi, Sh. (1920) ff. 10-11.

⁴⁰ Shënuar në ditarin e Dhimitër Shuteriqit të dt. 7.5.1972: “Shtjefën Gjeçovi dhe kambana e Sopotit”.

Qarre.⁴¹ Sipas të dhënave që i ofron L.Ugolini, të cilat i mori nga vetë Gjeçovi, gërmoi në tumat në Kodër Bogëz-Laç Sebaste, Koman, Peshkash, Shalë dhe Kalivaç.⁴²

Shërbesa në Koman të Pukës i krijoi mundësi që të bënte përnjohje arkeologjike të rrethinës dhe, mbi të gjitha, të gërmonte varret e hershme mesjetare shqiptare. Hulumtimet e mëvona treguan se ishte fjala për kulturën e hershme mesjetare shqiptare të shek. VI-VIII, me elemente të vazhdimësisë ilire dhe elementeve të reja që lidhen me periudhën e hershme bizantine. Kjo kulturë, e njohur me emrin Kultura e Komanit, ishte e përhapur në Shqipëri, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Greqi.⁴³ Kështu, duke i prirë gërmimeve në varret e Komanit, u bë nismëtar edhe i studimeve të arkeologjisë mesjetare shqiptare.

Një prej zbulimeve të rëndësishme të tij në Koman është unaza me mbishkrim, e njohur më pas si “Unaza e Shtjefën Gjeçovit”. Unaza zgjoi interesim dhe diskutime në mesin e studiuesve të ndryshëm. Së pari Ippen e pastaj edhe dijetarë të tjerë shprehën mendimin se mbishkrimi ishte shkruar në gjuhën ilire. Më vonë, dijetarët shqiptarë konstatuan se mbishkrimi ishte një formulë e krishterë bizantine, prezente edhe në unazat e tjera të kulturës së Komanit.⁴⁴

Megjithëse ende mungojnë të dhënat e plota për lërimet arkeologjike të Gjeçovit, është e ditur se ai ndërmori gërmime në të gjitha territoret shqiptare ku shërbeu si meshtar. Rinjohjen arkeologjike dhe gërmimet i vazhdoi edhe duke shërbyer në famullinë e Zymit, ku i kaloi vitet e fundit të jetës, para se të vritej në vitin 1929.

Fati i shënimeve të Gjeçovit nga koha e shërbimit në Zym dhe të objekteve të zbuluara në Has ende nuk dihet. Megjithëkëtë, disponohet me disa të dhëna për veprimtarinë arkeologjike të Gjeçovit edhe në Hasin e Thatë të Zymit, falë dëshmive të bashkëkohësve të tij dhe shoqëruesve në gërmime. Nga këto dëshmi kuptohet se gërmoi themelet e kishës në fshatin Milaj të Hasit. Sipas dëshmisë së Ibrahim Gashit (1919) nga Krajku, gërmimet i bëri gjatë orëve të vona të natës, i shoqëruar nga Zejnel Cahani dhe Ymer Syla. Shoqërues në gërmime në lokalitetet e tjera ishin Zef Lazër Kajtazi nga Karashëngjergji dhe Leonard Kajzogaj nga Zymi.⁴⁵

Gjeçovi gërmoi në Has të Zymit lokalitetet “Kishëza” të Planejës,

⁴¹ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, ff. 100-111; Nr. 8, ff. 207-208; Nr. 9, f. 231.

⁴² Kamsi, V. (1966) f.n. 18; Ugolini, L.M. (1966) pp. 405-413.

⁴³ Anamali, S. (1966) ff. 185-196.

⁴⁴ Ceka, H. (1965) ff. 36-46; Çabej, E. (1975) ff. 5-8.

⁴⁵ Për dy të fundit shih: Shtjefën Gjeçovi - Kryeziu (1985) Vepra 4, f. 164.

“Kolëm” mes Gjonajt dhe Karashëngjergjit, Kishën e Shën Kollit në fshatin Lukinjë dhe Kishën e Shën Gjergjit mbi Lukinjë. Sipas dëshmimeve, në kishën e Shën Kollit zbuloi një gur me mbishkrim.⁴⁶ Hulumtoi edhe te Lukuni (Likeni i Hasit) dhe në “Kalanë e Fregnit”, fortifikatë që gjendet mbi Karashëngjergj dhe që dominon mbi Rrafshin e Dukagjinit.⁴⁷

Kur flitet për gërmimet arkeologjike të Gjeçovit, gjithnjë duhet pasur parasysh se këto u bënë me entuziazmin e një arkeologu autodidakt dhe me intuitën e një dijetari që veproi edhe në fusha të tjera. Andaj mungesa e njohurive për metodologjinë e gërmimeve arkeologjike konsiderohet se është e meta kryesore, siç është rasti edhe me shumë nismëtarë të tjerë në këtë fushë, duke përfshirë edhe zbuluesin e njohur të Trojës e Mikenës, H. Schlieman. Kështu, "gropimi" dhe jo hulumtimi stratigrafik dhe gërmimi adekuat i tërësive të mbyllyra bëhet mënyrë e gabuar e gërmimeve arkeologjike. Se Gjeçovi gërmoi në këtë mënyrë flasin vetë shënimet e tij:

“E valova kodrën tuj ngulë thiken herë ktu herë atje... Si e kthelltova gropën nja 15 cm, dukne dy heshta... përmbasi gropova pak në një vend, ndesha në tulla...”⁴⁸

Përderisa gërmimin arkeologjik Gjeçovi e bënte në mënyrë të gabuar, përkatësisht duke gropuar dhe pa metodologji adekuate, ishte konsekuent në përshkrimin e lokaliteteve, të objekteve, të situatave dhe të detajeve në të cilat ndeshte gjatë gërmimeve. Duke bërë përshkrime të detajuara, shpesh solli dhe përfundime të drejta:

“Tuj vijue në rrimim, filloj me dalë dhe i djegë e rruza të gjata nja 1 cm. Tuj e kthelltue vorrin, filloj me da çiltas se të dekunin e kishin pasë djegë mbas dokes së hershme e turshë n'at gropë. Vorri së kishtë pasë ndo'i sbukurim; n krah te rrmihët - date se i djeguni ishte kenë me krye kah mjesdita - gjeta nja dy gur të vum ball per ball në trajte të kulmit, nën të cillët gjeta një kupës (u r n a) pa gja nën te, edhe të bamë copë e grimë...”⁴⁹

⁴⁶ Banorët thonë se guri me mbishkrim është dërguar në muzeun e Shkodrës. Ka gjasë që dhe koleksioni arkeologjik nga Hasi të jetë dërguar në Muzeun Françeskan të Shkodrës, pas vrasjes së Gjeçovit.

⁴⁷ Për lokalitetet Milaj dhe Karashëngjergj: Shukriu, E. (1975) ff. 179-180.

⁴⁸ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, ff. 110-111.

⁴⁹ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, ff. 110-111.

Nga përshkrimi i dhënë në detaje të përimëta, ndonëse Gjeçovi si gërmues amator nuk e konstaton kohën, leht nxirret përfundimi se është fjala për varr me mbulesë në trajtë çatie e shek. IV.



Foto 4 Monumenti i Shtjefën Gjeçovit, Zym (Kosovë)

c) Përpunimi i të dhënave nga gërmimet

Qëllimi i Gjeçovi nuk ishte vetëm evidentimi i lokaliteteve arkeologjike dhe gërmimi i tyre, por edhe analiza e tyre, siç mund të nxirret përfundimi nga artikujt që i la pas. Ndonëse kjo analizë e Gjeçovit del mjaft e mangët, e përciptë dhe me konkluzione të përgjithësuara, meritë e tij është se parashtrori nevojën për të dhe vetë iu ças analizave, sipas mundësive me të cilat dispononte. Në këtë fazë të studimit, si edhe arkeologët e tjerë amatorë, aplikoi vetëm njerën prej metodave të arkeologjisë, atë krahasuese apo të analogjive. Kjo metodë, e përhapur me nismat e arkeologjisë parahistorike, te Gjeçovi ndeshet kryesisht në relacion me objektet dhe traditat etnologjike shqiptare.

Gjeçovi, duke qenë dhe njohës i thellë i etnologjisë shqiptare, bëri krahasimin e dokeve të popullit me objektet dhe dukuritë që i ndeshi gjatë gërmimeve. Përmes këtyre krahasimeve, duke gjetur në varre vorba të ndryshme, vuri në pah kontinuitetin e etnosit shqiptar që nga parahistoria:

“Mendja më ve se edhe te paret tonë, do ta kenë pasë në doke me i shti ne dhe të dekunit e vet, me tulla, vegsha e vorba, tuj ju pshtetë fjalës së kombit tonë, i cilli per nierz të dekun thotë: "Ka shkue me ba vorba - vegsha - qerepa.”⁵⁰

Metodën krahasuese nuk e përkufizoi vetëm në krahasimin kontinuitiv kohor të gjetjeve në trevat shqiptare, por ngjashmëri kërkoi edhe në një hapësirë më të gjerë dhe gjeti analogji edhe tek popujt e tjerë të lashtë të mesdheut. Një krahasim i tillë del dhe nga kërkimi i ngjashmërive të varrimit ilir në tuma me ato etrurë.⁵¹

Një prej determinantave për rikonstruimin më të afërt të jetës në lashtësi, por jo dhe qëllim më vete, është përcaktimi kohor (determinimi kronologjik) dhe përcaktimi kulturor i lokaliteteve apo i objekteve të caktuara, si dhe i gjenezës së tyre. Këto, ndonëse janë prezente edhe në shkrimet e Gjeçovit, gjithnjë janë të përgjithësuara. Kështu, duke mos pasur mundësi që ta bëjë përcaktimin kronologjik të lokaliteteve të caktuara, për kohën dhe krijuesit e kulturës së lashtësisë që e gërmonte, sjell përfundime të përgjithësuara se u takonin “Pellazgu a Hylliri tash ma se 4000 vjet”.⁵²

Gjeçovi e shtriu veprimtarinë edhe në fushën e terminologjisë arkeologjike. Ai e kishte të qartë se ngritja e vetëdijes së popullit për këtë lloj trashëgimie mund të arrihet vetëm me përdorimin e terminologjisë së qartë dhe të kuptueshme, andaj në artikujt e shumtë, krahas termeve të huaja, vë në përdorim fjalët e gjuhës shqipe. Kështu, termat me përdorim të gjerë, siç është ai i gjuhës latine “tumulus”, i zëvendëson me termat: “sumbullore” dhe “sukë”. Fillimisht, për termin “urna” përdori nocione të shumta, si vegsh, vorbë, kupëz dhe enë, ndërsa në artikujt e mëvonshëm e zëvendësoi me fjalën “kuç”.⁵³

Trajtat e caktuara të enëve te Gjeçovi nuk kanë terminologji të definuar, pos kur bëhet fjalë për “kupën” dhe “kuçin”. Enët e tjera prej balte i quan në kuptimin e përgjithshëm: “vegsh”, “enë” dhe “vorbë”. Andaj nga

⁵⁰ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 109.

⁵¹ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 9, f. 232.

⁵² Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, f. 158. Kronologjia e sotme arkeologjike e vendos këtë në mijëvjeçarin IV p.K..

⁵³ Kuçi është i njohur si enë e madhe balte për zierjen e gjellës dhe ujit, andaj nuk mund të paramendohet se në një enë të tillë është vendosur hiri i kufomës së djegur.

termat që i përdor për enët e zbuluara në varre nuk mund të kuptohet se a është fjala për ndonjë urnë, përkatësisht për rritin e djegies së kufomës, apo për një enë si pjesë e inventarit të zakonshëm të varrit. Përkundër kësaj, nuk zvogëlohet rëndësia e përshkrimit të varreve dhe të dhënave që i ofron.

Pos interesimit ndaj vlerave të kulturës materiale, Gjeçovi ruajti edhe skeletet që i zbuloi. Kështu, ai dëshmoi vetëdije për nevojën e studimeve antropologjike fizike, rrjedhimisht për një qasje interdisciplinare shkencore ndaj trashëgimisë kulturore.

Veprim final të studimit, edhe të atij arkeologjik, Gjeçovi me të drejtë e konsideron botimin e rezultateve të hulumtimeve. Në këtë drejtim shkruan:

“...ai (arkeologu, v.a.) s'duhet të ndjë në pritesë; aj, a do të perlaje shatin e me shkue me rnrue ndo'i vend a vorr të veter, a se do të ulet në karrigë per me shkruë mbi sende të gjetuna,e me botue ndo'i send te posaçem per to.”⁵⁴

Duke iu përmbajtur kësaj, Gjeçovi botoi artikuj me materiale përcjellëse dokumentuese, të cilat, ndonëse jo të plota, përfshinë përshkrimin e lokalitetit, të terrenit përreth, procesin e gërmimeve dhe objektet e zbuluara.⁵⁵ Artikujt e tij përmbajnë dhe aparaturën shkencore dhe referencat, sa herë që e sheh të nevojshme. Kështu, për disa lokalitete arkeologjike i referohet sidomos botimit të Konrad Millerit rreth itinerareve të periudhës romake (Tabulla Peutingeriana, 1888).

Gjeçovi konstaton edhe mbeturina të forta të besimit në diell, të shprehura në të falurit e diellit e në të dhëna të tjera religjioze, duke i lidhur këto me kultin e diellit dhe elementë të tjerë të mitologjisë në lliri dhe Thraki.

*

Arkeologjia e preokupoi Gjeçovin me gjithë qenien e tij, ndonëse për nga natyra e saj është përplot mund fizik e mendor dhe kërkon shpenzime të konsiderueshme. Përkundër të gjitha vështirësive dhe obligimeve fetare dhe kombëtare, ai u bë lëruesi i parë shqiptar i lashtësisë, duke vënë kështu gurthemelin e arkeologjisë shqiptare. Jetoj dhe vepror në rrethana të rënda dhe të mëvetësishme dhe ishte i sulmuar dhe i kufizuar në veprim nga shumë anë. Andaj, kur kihen parasysh të gjitha rrethanat, del më shumë në shesh entuziazmi i një vigani të palodhur dhe fuqia e pashtershme e një dietari si ai.

⁵⁴ Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, f. 112.

⁵⁵ Dokumentacioni më i plotë i objekteve të zbuluara nga Gjeçovi u botuan me fotodokumentacion nga studiuesi Ugolini: Ugolini, L. M. (1927) pp. 18-59, fig.16-22, 26-27, 41, 45.

Ndërrimi i shpeshhtë i vendit të shërbesës së Gjeçovit nga ana e kishës dhe dërgimi i tij në famullitë katolike malore dhe të izoluara dëshmon qartë se disa qarqe kishtarë dhe politike e shihnin si të rrezikshme veprimtarinë e tij, përfshirë edhe atë arkeologjike. Gjeçovi ishte ndër klerikët shqiptarë, siç shkruan K.K. Buhberger:

“...të paguar keq, që kryenin shërbimin fetar në famullitë e izoluara ndër fiset katolike të Malësisë dhe që kanë bërë jo vetëm një punë të dalluar nacionale shqiptare.”⁵⁶

Përmbledhja e meritave të Gjeçovit në fushën e arkeologjisë përfshinë aspektin e mëtimeve për ndriçimin e së kaluarës shqiptare aq sa synon dhe ngritjen e vetëdijes për nevojën e njohjes së trashëgimisë kulturore dhe për ruajtjen e visareve të saj. Ndaj kësaj trashëgimie ai mbajti qëndrim shkencor, pa nuanca glorifikimi. Hulumentimet e ndërmarra arkeologjike, ndonëse me shumë të meta dhe përcjellëse të zakonshme të autodidaktëve në arkeologji, u bënë mbi disa ravijëzime themelore shkencore, duke u nisur nga rinjohja e terrenit, gërmimi, përpunimi i të dhënave nga gërmimet, prezantimi dhe botimi i rezultateve.

Në suazat e synimeve për përkujdesjen ndaj trashëgimisë kulturore, Gjeçovi parashtrroi nevojën për përkrahjen institucionale të hulumentimeve arkeologjike, si dhe për kujdesin dhe prezentimin e objekteve të zbuluara arkeologjike në muze, për themelimin e të cilave u angazhua. Kështu, ai vetë themeloi një koleksion, të njohur si “Koleksioni i Shtjefën Gjeçovit”, të cilin duket e kishte parë si bazë për një muze të ardhshëm kombëtar.

Gjeçovi veproi si humanist dhe dijetar për njohjen e kombit shqiptar edhe përmes kulturës së çmueshme materiale të lashtësisë iliro-shqiptare. Veproi për njohjen dhe për vendin e merituar të kontributit të shqiptarëve të trojeve etnike në tumirë të zhvillimit të kulturës europiane dhe të asaj të gjithëmbarshme të njerëzimit. Vrasja e tij nga ana e regjimit të Mbretërisë së Jugosllavisë në Has të Zymit më 14 tetor 1929, është një dëshmi më shumë për vlerat e çmueshme të tij si dijetar dhe si njeri i guximit.

⁵⁶ Buhberger, K.(1972) p. 145.

Summary

ARCHAEOLOGY AND CULTURAL HERITAGE: FATHER SHTJEFËN GJEÇOVI

Multifaceted scholar Father Shtjefën Konstantin Gjeçovi-Kryeziu is known to Albanians (Photo 1, 3, 4), but his work became also the subject of study by foreign researchers. Being servants of the Catholic Church and in service in different sites, he distinguished himself in several scientific fields, especially for the study of folklore and Albanian customary law, crowned with the publication “Code of Lek Dukagjini”. In this paper is analyzed its contribution to the initiative of the Albanian archeology and attempts to awaken interest in cultural heritage values, which are linked to trends in Europe at the turn of XIX-XX centuries, when European archeology began to develop.

Gjeçovi was born in Janjeva in 1873 (Kosova Vilayet). He was schooled at the Franciscan Seminary in Troshan (Scodra Vilayet) then in Fojnica, Derventa, Banja Luka and Kreshevo of Bosnia and he became Honorary Doctor of the University of Leipzig. He completed his studies in 1896 and served in different regions at his homeland till the time when was killed by the regime Kingdom of Yugoslavia (1929) in Has of Prizren.

Gjeçovi acted as vicar, but also as an intellectual of the time taking care of the education of Albanians, regardless of their religion, even by reopening and the opening schools. Interest in archeology seems to be started at his hometown, Janjeva and Castle of Veletin, which should be seen as initial inspiration and inciting research curiosity. The time in which he lived is seen also as an important component as the European national archaeologies started to flourish.

Archaeological research in the Albanian lands were originally developed by foreign researchers, therefore estrangement of archaeological treasure became as well an incentive to take concrete steps. Extraction of archaeological objects abroad he considered very dangerous, therefore wrote that it is enough

“a handbag full with old stuff found in our land from one foreigner to live in the darkany dot of history.”

[Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 4, p. 158]

Thus, although he was not an archaeologist by profession, Gjeçovi became the first Albanian autodidact archaeologist. Frequent replacement and sending him in mountain and isolated parishes shows clearly that some saw its activity being dangerous, including archaeological ones.

Summary of his merits include enlightenment of the Albanian past and aims to increase the awareness on recognition and preservation of cultural heritage. To this heritage he held scientific position, without glorification nuances. Archaeological researches, although defective and common autodidacts company, were done on some basic scientific steps, starting from archaeological recognition, excavation, data processing, presentation and publication of results [Gjeçovi, Shtjefën-Kostatin (1920)].

He outlined the need for institutional support for archaeological research within the objectives for care of cultural heritage and for the presentation of discovered archaeological objects in museum. In this term he founded a collection, known as “Shtjefën Gjeçovi Collection”, which apparently he saw it as a basis for a future National Museum.

Gjeçovi acted as humanist and scholar for the recognition of the Albanian nation also through the tangible culture of the ancient Illyrian-Albanian. He acted on the recognition and deserved place of contribution of Albanian ethnic lands in benefit of European and universal culture writing down:

“...We should understand that a nation which has not his history is considered as dead.”

[Gjeçovi, Sh. (1920) Nr. 6, p. 182]

His murder by the Kingdom of Yugoslavia regime (1929) is one more proof of his precious values, as a scholar and as a man of courage.

Bibliografia / Bibliography

- Anamali, Skender (1966) "Mbi kulturën e hershme Shqiptare", Ilirët dhe Gjenezja e Shqiptarëve, Tiranë, ff. 185-196.
- Barleti, Marin (1964) Histori e jetës dhe e veprave të Skenderbeut, Tiranë.
- Buhberger, K.B. (1972) "Vjetët e mija në Shqipëri", Studime historike 4, Tiranë.
- Ceka, Hasan (1965) "Mbishkrime bizantine të unazave të Komanit dhe datimi i tyre", Studime Historike 4, Tiranë, ff. 36-46.
- Çabej, E. (1975) "Mbishkrime unazash të Shqipërisë veriore", Studime gjuhësore V, Rilindja, Prishtinë, ff. 5-8.
- Elsie, Robert (2004) Historical Dictionary of Kosova, Historical Dictionaries of Europe (1 ed.), Scarecrow Press, pp. 66-67.
- Islami, S. - Cekaj, H. (1969) "Të dhënat e reja për vjetërsinë ilire në territorin e Shqipërisë", Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë.
- Jubani, Bep (1967) "Keramika ilire e qytezës së Gajtanit", Studime historike 3, Tiranë, ff. 41-70.
- Kamsi, V. (1966) "Fillimet e arkeologjisë shqiptare dhe kontributi i Shtjefën Gjeçov - Kryeziut", Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik Dyvjeçar të Shkodrës 4, Shkodër.
- Konitza, Faik (1930) "Ca kujtime mbi At Gjechovin", Hylli i Dritës VI, Nr.4, Shkodër, ff. 227-230.
- Kurti, Donat (1965) Provinca Françeskane Shqiptare, Shkodër.
- Gjeçovi, Shtjefën-Kostatin (1920) "Nji argetim Arheologjik", Zani i Shna Ndout VIII, Nr. 4, Nr. 6-9, Shkodër.
- Gjini, Gasper (1992) Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Drita, Prizren.
- Shtjefën Gjeçovi-Kryeziu (1985) Vepra 1-4, Rilindja, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (2003) "At Shtjefën Gjeçovi - Arkeolog dhe mbrojtës i trashëgimisë kulturore", Vjetar XX, Arkivi i Kosovës, Prishtinë.
- Shukriu, Edi (1988) Fortifikata e Veletinit, AP, ADJ, Lubljana, ff. 106-108.
- Shukriu, Edi (1975) "Rezultatet paraprake arkeologjike përgjatë rrjedhës së poshtme të Drinit të Bardhë", GjA, Seria e shkencave historike IV-V, Prishtinë, ff. 177-195.

Ugolini, Luigi Maria (1966) “Les origines de l'archeologie et la contribution de Shtjefën K. Gjeçov-Kryeziu”, Buletin shkencor 4, Tiranë, pp. 405-413.

Ugolini, Luigi Maria (1927) “Albania Antica”, Vol. I, Ricerche archeologiche, Roma-Milano, pp. 18-59.

Burime nga internet:

ECPAH: European Convention on the Protection of the Archaeological Heritage:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168007bd25> (25.12.2005).

Instituti i Arkeologjisë - Tiranë:

http://www.akti.gov.al/kerkimishkencor/institucione_ash/ia.html
(01.02.2016)

Shkurtesa / Abbreviations:

ADJ Arheološko Društvo Jugoslavije
 ANUBH Akademija Nauka i Umjetnosti Bosnje i Hercegovine
 AP Arheološki Pregled
 ASHAK Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
 BFF Buletin i Fakultetit Filozofik
 CBI Centar za balkanološka ispitivanja
 IAK Institut Arkeologjik i Kosovës
 KSAK Kërkime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2002-2012
 GJA Gjurmime Albanologjike
 GCBI Glasnik Centra za Balkanološka Ispitivanja
 GMKM Glasnik Muzeja Kosova i Metohije
 GZMBH Glasnik Zemaljskog Muzeja Bosnje i Hercegovine
 MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 MEST Ministry of Education, Science and Technology
 MKRS Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 PJZ Praistorija Jugoslavenskih Zemalja
 SANU Srpska Akademija Nauka i Umetnosti
 SAZU Slovenska Akademija Znanosti in Umetnosti
 VAMZ Vjesnik Arheološkog Muzeja u Zagrebu

Burimet antike / Ancient sources:

Appianus, *Historiae Romana*.
 Diodorus *Bibliotheca historica*.
 Herodotus, *Historiae*.
 Iustinus, *Historiarum Philippicarum*.
 Livius, *Ab urbe condita*.
 Maximus of Tyre, *Philosophomena*.
 Miraculla *Sancti Demetrii*.
 Plato, *Cratylus*.
 Polybius, *Historiae*.
 Procopius, *Historiae quae dicitur arcane*.
 Strabonis, *Geographica*.
 Solinus, *De mirabilibus mundi*.

LISTA E FOTOVE / PHOTOS LIST

ASPEKTE TË ZHVILLIMEVE ETNOLITIKE NË KOSOVË

ASPECTS OF ETHOLITIC DEVELOPMENTS IN KOSOVA

1. Qeramika dardane e punuar në çark, shek. VI-IV p.K. (Gadime e Epërme)
2. Ulpiana: Bazilika peshkopale dhe Pagëzimorja (Baptiserium: IAK)
3. a. Nekropoli i Komanit; b. Vathë nga nekropoli i Matiçanit
4. Kisha e Shën Prendës në Prizen gjatë periudhës bizantine (Nenadović 1963)

FAZA PARAQYTETARE DARDANE E KOSOVËS

PREURBAN DARDANIAN PHASE IN KOSOVA

1. Zhvillimi i vendbanimeve parahistorike, paraqytetare dhe qytetare
2. Enë me vegje në trajtë gjuhe (VIII-VI p.K.)
3. Enë me buzë të kthyer nga brenda dhe zbukurim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)
4. Broke me zbukurim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)
5. Qeramikë me zbukurim me instrument të dhëmbëzuar (VIII-VI p.K.)
6. Skifosë (VI-IV p.K.)
7. Enët e pikturuara të fazës paraqytetare (VIII-VI p.K.)
8. Disa trajta enësh të fazës paraqytetare (VIII-VI p.K.)
9. Skifosa dhe tas (Katalog 2013)
10. Kantaros (Harilaq) (Peja 2014)
11. a. Mbishkrimi arkaik grek në amforë; b. import i grupit Saint Valentin (Gadime)
12. a. Amforë e Hiosit (Gadime); b. Import i Italisë jugore, Harilaq (Peja 2014)
13. a. Olpa me figura të zeza, Banjë e Pejës (Muzeu i Kosovës); b.

- Menada e Prizrenit (British Museum)
14. Importet e shek. III-II p.K., Romajë
 15. a. Lotore (lacrimarium) shek. III-II p.K., Zotaj (Vojnovc); b. Cjap bronzi:
 16. Shek. III-II p.K., Prizren(Vranjski Muzej); c. Fragment ene e shek. II-I p.K., Vlashnjë (Katalog 2013) Veletini dhe Gradina / Kalaja e Zatriqit
 17. Kalaja e Korishës dhe Gradishta e Vlashnjës
 18. Gradina / Kalaja e Llapushnikut

KULTI I DIELLIT TE DARDANËT

DARDANIAN CULT OF SUN

1. a. Qerrja e Dupljajës (Garašanin 1983);b. Qerrja e Trundholm-it (Denmarke Nationalmuseet)
2. a. Hyjnesha në fron (Muzeu i Kosovës); b.Hyu gojëhapur, Ponesh (Muzeu i Gjilanit)
3. a. Ena neolitike nga Vlashnja; b. Tas eneolitik nga Hisari (Suharekë) (Muzeu i Kosovës)
4. Tumat e gërmuara dhe unazat rrethore
5. Disku diellor, Shirokë: Tuma 2, varri 3 (Muzeu i Kosovës)
6. Disqetdiellore: a. Brazda, varr i shek. VII-VI (Mikulčić 1982); b. Vertishta (Vasić 1987); c. Maqedonci(Vasić 1981)
7. a. Varëse dhe aplikacion me simbol dielli - Grupi Dolenjska (Gabrovec 1983); b. Aplikacione, Grupi Glasinac (Čović 1987)
8. a. Varri princor, Novi Pazar (Vasić 1987); b. Qerrja me shpezë, Gllasinac (Benac 2012)
9. Labriset nga tuma e Romajës
10. Sëpatat dyteheshe: 1. Vojnik (Garašanin 1983); 2. Visoi (Garašanin 1983); 3. Varëse labris, Visoi; 4. Varëse labrise, Slloveni (Gabrovec 1983)
11. Shtyllat e stilizuara nga tempulli i Podit(Benac 2012)
12. Observatori parahistorik i Kokinos dhe motive dielli në qeramikë (Kuzmanovska-Stankovski 2011)
13. Labirinti dardan, Smirë (viz. M. Ademi)

14. Patela nga Branetiqi i Poshtëm (Popović 2008; viz. Shukriu)
15. a. Hyjnesha Dardane, Banja e Kllokotit (Viz. M. Ademi); b. Shtatorja e Therandës / Suharekës

TRAJTESË ARKEOLOGJIKE E TOPONIMIT GRADINË

ARCHAEOLOGICAL ASPECT OF THE TOPONYM GRADINA

1. Figurina indo-europiane eneolitike Bubanj-Hum, Gadime e Epërme (Muzeu i Kosovës)
2. Enë eneolitike Bubanj-Hum me grafit dhe kanelyra, Gadime e Epërme (Katalog 2013)
3. Vazo dhe dyvegiake eneolitike, Hisar i Suharekës (Katalog 2013)
4. Enë të epokës së hershme të bronzit: a, b: Vlashnjë, c. Korishë, ç. Glladnicë (Katalog 2013)
5. Enë të epokës së mesme të bronzit: a. Korishë, b. Vlashnjë (Katalog 2013)
6. Urnë e epokës së vonë të bronzit, Bërnice e Poshtme (Katalog 2013)
7. Gralishta e Korishës
8. Kalaja e Prizrenit
9. Kalaja e Zveçanit (Mitrovicë)

MONUMENTI MORTOR PARAROMAK I DARDANËS

PRE-ROMAN MORTAR MONUMENT FROM DARDANA

1. Monumenti mortor i Dardanës
2. I ndjeri dhe femra që prek arkën
3. Tri valltare mortore
4. Doriforët ushtarë me përkrenare ilire
5. Gjëmëtarët
6. Shtazët e kultit: dreri dhe kali
7. Kulina e Dardanës / Kamenicës
8. Skica e Kulinës së Dardanës (2000)
9. Prerja vertikale: Kulina e Dardanës (2000)

PËRKRENARJA ILIRE E DENJIT (KOSOVË) DHE ZHVILLIMI I PËRKRENAREVE ILIRE

HELMET FROM DENJ (KOSOVA) AND DEVELOPMENT OF THE ILLYRIAN HELMETS

1. Përkrenaret ilire të gjetura në Kosovë: 1 Denji; 2, 3, 4 Banja e Pejës; 5, 6 Korisha; 7 Shiroka (?); Dardana
2. Përkrenarja ilire e Denjit
3. Përkrenarja ilire e Denjit (Viz. 1, 2 M. Ademi)
4. Përkrenarja ilire 1 dhe 2: Banjë e Pejës (Vasić 2010)
5. Përkrenarja ilire 1, Korishë (Foto U. Ukimeri)
6. Përkrenarja ilire dhe korintase e hershme
7. Tipologjia e përkrenareve (Kravur-Pravadur 2012)
8. Përkrenarja ilire III A 1, Trebenishtë (Narodni Muzej, Beograd)
9. Përkrenarja ilire III A1b, Trebenishtë
10. Maskat prej ari të shoqëruara me përkrenare ilire (Trebenishtë, VI-V p.K.)
11. Përkrenarja ilire me maskë: Sindos (Varri 115, Muzeu Arkeologjik, Selanik)
12. Velje Ledine, Gostilj: a. Pafta e varrit 126; b. Monedhatë varreve 34, 59 (Basler 1969)
13. Pafta me ushtarë me përkrenare ilire, Selcë e Poshtme (Ceka 1971)
14. Monedhën e Bastareut, Kustendil (shek. V p.K.: Sokolovska 1997)
15. Monedha nga Maqedonia antike me përkrenare ilire (Hockey 1992)
16. Përkrenaret ilire në monumentin mortar të Dardanës
17. Lokalitetet me përkrenare ilire në Kosovë
18. Përkrenarja e Denjit
19. Përkrenarja e Korishës 1

DY SHANDANE PALEOKRISTIANE PREJ BRONZI ME KRYQ NGA DARDANIA

THE EARLY CHRISTIAN BRONZE CANDLESTICKS WITH CROSS FROM DARDANIA

1. Pitosi ku u gjetën shandanet
2. Shandani 1 (Tërnoc i Madh)
3. Shandani 2 (Tërnoc i Madh)
4. a. Shandani 1; b. Shandani 2 (Tërnoc i Madh)
5. Muret rrethuese të Tarracës I

Skica 1. Lokaliteti arkeologjik Gradishta / Kalaja, Tërnoc i Madh
Harta 1.

DARDANËT DHE KOMEDITË E ARISTOFANIT, MENANDRIT DHE CECIL STATIT

DARDANIANS AND THE COMEDIES OF ARISTOPHANES, MENANDER AND CAECILIUS STATIUS

1. Menandri me maska të Komedisë së Re, shek. I p.K.- I (Princeton University Art Museum)
2. Aristofani dhe Cecil Stati

ARKEOLOGJIA DHE ÇËSHTJE TË ANTROPOLOGJISË FIZIKE NË KOSOVË

ARCHAEOLOGY AND THE PHYSICAL ANTHROPOLOGY ASPECTS IN KOSOVA

1. Gërmimet në Ulpianë 2009
2. Kafka nga Ulpiana (L. Gashi 2007)
3. Vërmicë: Bazilika e shek. V-VI dhe nekropoli mesjetar
4. Vërmicë: Varri mesjetar mbi bazilikën e shek. V-VI
5. Antropologu Nemesheki dhe skulptori Çavdarbasha: Rikonstruim i pamjes së Ymer Prizrenit

Tab. 1 Disa lokalitete të Kosovës me mbetje njerëzore (trupvënie / djegëje)

**ARKEOLOGJIA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE:
AT SHTJEFËN GJEÇOVI**

ARCHAEOLOGY AND CULTURAL HERITAGE: SHTJEFËN
GJEÇOVI

1. At Shtjefën Gjeçovi
2. Fortifikata e Veletinit
3. At Shtjefën Gjeçovi (Kolë Idromeno, vaj)
4. Monumenti i Shtjefën Gjeçovit, Zym (Kosovë)

Edi Shukriu
STUDIME PËR DARDANINË
2016

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Shefqet Riza

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 15.5 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

94(496.51).014
904(496.51)

Shukriu, Edi

Studime për Dardaninë / Edi Shukriu. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2016. – 246 f.: ilustr. me ngjyra; 24 cm. - (ASHAK: Botime të Veçanta; CLXIII: Seksioni i Shkencave Shoqërore; Libri 56)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. - Summary: f. 236-237.
– Bibliografia: f. 238-240

ISBN 978-9951-615-71-6